



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**Mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së
Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave**

Tiranë, Shtator 2023

Nr.	PËRMBAJTJE	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	9
II.	HYRJA	11
1	Objekti i auditimit	11
2	Qëllimi i auditimit	12
3	Identifikimi çështjes	12
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	12
5	Përgjegjësitë e audituesve	13
6	Kriteret e vlerësimit	13
7	Standardet e auditimit	14
8	Metodat e auditimit	15
9	Dokumentimi i auditimit	15
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	16
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	16
2.2	Programimi i të ardhurave doganore dhe realizimi i tyre sipas zërave përkatës të treguesve për vitin 2022	24
2.3	Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim	37
2.4	Auditimi i përputhshmërisë ligjore mbi vlerësimin doganor, referuar kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi sipas drejtorive: a. Drejtoria e Vlerësimit në Qendër b. Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit (Aposterior operativ 3 ditor) c. Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit	50
2.5	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit dhe të Drejtorisë së Antikontrabandës	50
2.6	Auditimi i përputhshmërisë ligjore të procedurave të ndjekura nga ana e drejtorive të kontrollit: a. Drejtoria e Teknikës e Akcizës b. Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Pas zhdoganimit (Aposteriori)	75
2.7	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit vjetor	130
2.8	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjor të veprimtarisë së Departamentit Administrativ: a. Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve. b. Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi. c. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë Juridike	138
2.9	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	201
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	216

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 283/1 prot., datë 03.04.2023, i ndryshuar, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022. Auditimi u fokusua në planifikimin, realizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore; menaxhimin e borxhit doganor; menaxhimin e burimeve njerëzore; planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të DPD; menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, prokurimet publike, veprimtarinë e Drejtorisë së Hetimit dhe të Drejtorisë së Antikontrabandës, procedurave të ndjekura nga ana e Drejtorisë Teknike të Akcizës dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Pas zhdoganimit (Aposteriori), Drejtorisë Juridike, etj.

Në përfundim të auditimit u hartua Projekt Raporti i Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjekti DPD. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në DPD me shkresën nr. 283/20 prot., të KLSH, datë 04.08.2023, njohja e të cilit është konfirmuar nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 11604/9 prot., datë 01.09.2023, protokolluar në KLSH me nr.283/9 prot., datë 04.09.2023. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit. Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se u konstatuan problematika që i përkasin kryesisht strukturave përgjegjëse të Akcizës, Hetimit, Antikontrabandës, Juridikut në DPD. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) në fund të vitit 2022 rezulton me një nivel borxhi doganor në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste. Borxhi Doganor i trashëguar përgjatë viteve rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 rritja paraqitet në vlerën 979,324 mijë lekë, ose me 2,14 %. Nga auditimi u konstatuan të ardhura doganore të munguara në buxhetin e shtetit, të shkaktuara si pasojë e problematikave të identifikuar në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në strukturën përgjegjëse të hetimit, antikontrabandës, akcizës në totalin prej 19,117 mijë lekë; dhe efekte financiare negative në përdorimin e fondeve publike si pasojë e likuidimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e larguar nga puna në vlerën totale prej 8,210 mijë lekë. Problematika të tjera të konstatuara kanë konsistuar në veprimtarinë e sektorit juridik, në procedurat e prokurimit dhe monitorimit të kontratave, në procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore, administrimin e burimeve njerëzore, mos finalizimi i procesit të ristrukturimit të institucionit dhe mos plotësim i strukturës organizative të institucionit, shoqëruar me numrin e lartë të transferimeve.

I.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

Gjetja nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
A. 3	Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 të ardhurat doganore janë realizuar në masën 101% kundrejt planit të të ardhurave të rishikuar me Aktin Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, (me një tejkallim në shumën 1,080 milion lekë), shkaktuar	Drejtimi 2.2	E mesme	Titullari i DPD, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, të marrë masat për analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mos realizimin e planit të të ardhurave doganore sipas zërave, referuar degëve

	<p>kryesisht nga rritja e importeve dhe rritja e të ardhurave për njësi për të cilat ka ndikuar rritja e çmimit të importit të këtyre artikujve. Megjithatë, konstatohet se pavarësisht këtij niveli realizimi për total të ardhurat, të ardhurat doganore sipas llojit në të gjitha zërat e tjerë me përjashtim të TVSH-së në import, rezultojnë me mos realizim, ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga akciza, renta minerare dhe taksa doganore.</p>			<p>doganore që operojnë nën juridiksionin e DPD, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse për situatën, në funksion të arritjes së objektivave institucional, si dhe duke garantuar një raportim mbi realizimin e të ardhurave të harmonizuar me modelin e MFE, në mënyrë që të evidentohet qartazi rimbursimi i akcizës apo zërave të tjerë që mund të përbëjnë shkak për diferenca në raportimet mes dy institucioneve si në fazën e planifikimit ashtu edhe realizimit.</p>
A. 4	<p>Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), në fund të vitit 2022, rezulton një nivel borxhi doganor në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste, i cili rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 979,324 mijë lekë, ose me 2,14%. Nga auditimi konstatohet një diferencë në borxhin doganor prej 3,101 mijë lekë më shumë se borxhi i raportuar nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, si rezultat i raportimit të gabuar nga ana e Degës Doganore Rinas. Gjithashtu transferimi i përgjegjësive për vjeljen e detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave drejt Degëve Doganore, ku në pjesën më të madhe të Degëve Doganore ka vetëm një punonjës përgjegjës për arkëtimin e detyrimeve, si dhe nisur nga fakti që ekziston një numër i lartë rastesh dhe rritje e stokut të borxhit, veprimtaria e ndjekjes së detyrimeve është jo efektive, fakt që evidentohet nga viti në vit me rritjen e stokut të borxhit.</p>	Drejtimi 2.3	E lartë	<p>Nga ana e DPD-së të analizohet me kujdes situata e krijuar përsa i përket rritjes së borxhit doganor në mënyrë të përvitshme, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të plotësohet struktura organike për këtë qëllim, të rritet niveli i bashkëpunimit me DPT, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore me qëllim rekuperimin e borxhit doganor në shumën prej 46,690,911 mijë lekë, duke parandaluar rritjen e mëtejshme të borxhit, duke rritur monitorimin edhe ndaj zyrave përmbarimore.</p>
A. 18	<p>Nga auditimi kontatohet se VKM nr. 355 datë 26.05.2022, nuk është zbatuar brenda afatit të parashikuar, për shkak të vonesave në vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit. Kështu, deri në fund të vitit 2022 janë marrë vetëm 2 vendime për transferimin e përhershëm të punonjësve me status nëpunësi civil duke mos realizuar procesin e ristrukturimit në nivel sistemi. Për sa i përket vendimmarrjes së komisionit për punonjësit jashtë shërbimit civil, është marrë vetëm 1 vendim për largimin e 15 punonjësve si rezultat i ristrukturimi.</p> <p>Duke qenë se ristrukturimi ka patur vonesa, nuk është bërë inicimi i procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve vakante pranë DPD. Gjithashtu, edhe procedurat e</p>	Drejtimi 2.8	E lartë	<p>Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin masat për kryerjen e të gjitha procedurave e nevojshme për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës organizative të DPD të miratuar me VKM-në nr. 355 datë 26.05.2022, në kuadër të mbarëvajtjes së punës, rritjen e performancës së punonjësve publik, si dhe me qëllim shmangien e praktikave të transferimeve të punonjësve në pozicione të tjera.</p>

	<p>transferimeve të përkohshme të punonjësve kanë vijuar deri në pritje të përfundimit të procesit të ristrukturimit.</p> <p>Për shkak të numrit të lartë të vakancave në administratën doganore, mos zbatimi në afat i efekteve të VKM-së, pavarësisht se nuk rezulton në efekte financiare, nxjerr në pah mangësitë që ekzistojnë në drejtim të garantimit të performancës optimale në punë, për sa kohë detyrat realizohen nga një personel më i ulët nga sa parashikuar; apo në drejtim të një organike të planifikuar në nivele më të larta nga sa janë nevojat reale të DPD, për sa kohë objektivat institucional raportohen të realizuar pavarësisht vakancave.</p>			
A. 22	<p>Në ndjekjen e proceseve gjyqësore me objekt pavlefshmërinë e rivlerësimit doganor në gjykimin në shkallë të parë, Sektori i Ankimimeve i Drejtorisë Juridike në DPD nuk ka paraqitur argumentet e mjaftueshme mbështetur në prova për metodën e vlerësimit të zbatuar, bazueshmërinë në ligj të formularëve të rivlerësimit doganor të nxjerra pa kërkesën e paditësve, plotësimin e kushteve në mospranim të vlerës së transaksionit dhe arsyetimin e mungesës së zbatimit të metodave dytësore të vlerësimit doganor, me pasoja në argumentimin kundërshtues të plotë të provave të sjellë në gjykim nga palët paditëse.</p> <p>- Gjithashtu, konstatohet se Sektori i Ankimimeve ka shfaqur dobësi në vperimtarinë e tij për të ndjekur praktikën përbarimore për ecurinë në ekzekutimin e vendimeve, pasi nuk ka kërkuar informacione në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e ekzekutimit të tyre, dhe nuk ka ushtruar kontrollin e dosjeve përbarimore mbi zbatimin e kontratave nga përbaruesit gjyqësor.</p>	Drejtimi 2.8	E lartë	<p>Sektori i Ankimimeve i Drejtorisë Juridike në DPD të marrë të gjitha masat për të siguruar argumentimin dhe provat e nevojshme në proceset gjyqësore, për bazueshmërinë në ligj dhe në fakte të veprimeve të kryera prej autoriteteve doganore në rastin e rivlerësimit doganor. Gjithashtu, të kryejë një analizë të të gjitha dosjeve përbarimore për të arritur në konkluzione mbi ecurinë e tyre, si dhe të ndjekë në vijimësi praktikën përbarimore duke marrë informacione të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimeve nga përbaruesit gjyqësor.</p>
A. 23	<p>Nga auditimi konstatohet se Sektori i Legjislacionit nuk ka përgatitur një akt administrativ për mënyrën e trajtimit të shkeljeve doganore, me qëllim që të ketë uniformitet në trajtimin klasifikimin dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, sipas përcaktimeve në nenet 737 dhe 739 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 50, 54, 64 dhe 82 të Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”</p>	Drejtimi 2.8	E lartë	<p>Sektori i Legjislacionit të hartojë dhe më pas të miratohet nga Titullari i institucionit një akt administrativ për zbatimin e dispozitave mbi shkeljet doganore, si dhe të përfshijë në planin vjetor aktet që do të konsultohen me publikun, periudhën dhe mënyrën e konsultimit, informacion shpjegues për objektin dhe qëllimin e projekt aktit përkatës.</p>

	<p>miratuar me Urdhrin nr.146, datë 07.05.2018 të MFE.</p> <p>Gjithashtu, Sektori i Legjislacionit nuk ka kryer konsultimin publik në hartimin e akteve dhe dhënien e mendimeve juridike për to, si një aspekt i rëndësishëm i mirëqeverisjes, pasi janë 2 Projekt urdhra/udhëzime dhe rregullore dhe 2 Projektvendime të cilat janë iniciuar/hartuar ose DPD ka qenë pjesëmarrëse, për të cilat ka munguar dokumentimi një vperimtarie të tillë.</p>			
B.1	<p>Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit janë konstatuar 5 raste me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,087,317 lekë (3 subjekte: H.S SHPK, A.C; person fizik A.G, dhe 2 agjenci doganore: “S-AD” dhe X, si pasojë e sanksioneve jo të plota të vendosura nga ana e kësaj Drejtorie referuar hetimeve të kryera, nga ku janë evidentuar problematika si klasifikim i gabuar i shkeljes së kryer, me pasoja në vlerën e sanksionit për kundërvajtjen administrative në nenin 256/1/a, e cila duhet të ishte sipas nenit 257/1/a, në të cilin penalteti përcaktohet në masën 2 fish të detyrimit të munguar.</p> <p>-Gjithashtu, ka rezultuar se në 75 raste të evidentuara si kontrabandë nga ana e Drejtorisë së Hetimit, gjatë konstatimit të shkeljes nga ana e kësaj Drejtorie nuk janë konsideruar edhe kundravajtje me masë administrative në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 259 dhe me nenet 260, 262, 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 3,750,000 lekë (50,000 lekë*75 raste).</p> <p>Pra, gjithsej kanë rezultuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 5,837,317 lekë, nga veprimet dhe mosveprimet e Drejtorisë së Hetimit në DPD.</p>	Drejtimi 2.5	E lartë	<p>Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Sarandë, Kapshticë, Elbasan, Shkodër, Morinë dhe Tre Urat, si struktura vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e hetimit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Hetimit me efekte negative, të marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 5,837,317 lekë.</p>
B.2	<p>Nga auditimi u veprimtarisë së Drejtorisë së Antikontrabandës janë konstatuar 3 raste, të cilat i përkasin 3 subjekteve: G.S, K.B dhe T.P, me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 1,875,870 lekë, si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura nga ana e kësaj Drejtorie, si kundravajtje me përgjegjësi objektive, dhe nuk janë trajtuar si kundravajtje të kryera me neglizhencë,</p>	Drejtimi 2.5	E lartë	<p>Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Tiranë dhe Kakavijë, si strukturë vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës me efekte negative si pasojë e keq klasifikimit të</p>

	<p>sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 252, dhe klasifikimin e sanksionit sipas pikës 1, germa “a” të nenit 257 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.</p> <p>-Gjithashtu, është konstatuar 1 rast lidhur me subjektin “A ” SHPK, në të cilin vlera e transaksionit është dukshëm më e ulët se vlera e referencës, si dhe mangësi në kryerjen e kontrollit të plotë, duke mos zbatuar metodën 6 të vlerësimit (metoda e të dhënave të disponueshme) me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 162,199 lekë.</p> <p>Pra, gjithsej kanë rezultuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej 2,038,069 lekë, nga veprimet dhe mosveprimet e Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD.</p>			<p>sanksioneve të vendosura në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 2,038,069 lekë.</p>
B.3	<p>Nga auditimi është konstatuar se në kontrollin e ushtruar në operatorin “N.P ” në aspektin tatimor, nuk është analizuar procesi prodhimit sipas kartës teknologjike, si dhe nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare pas rivlerësimit doganor të konkluduar me detyrime shtesë akcize në vlerën 2,652,000 lekë, pasi me detyrimet shtesë të akcizës, nga rillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme rezultojnë detyrime shtesë për TVSH-në vlerën 530,400 lekë dhe gjobë për 100% të vlerë, pra në total 1,060,800 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.</p>	Drejtimi 2.6	E lartë	<p>DPD të përcjellë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë problematikën e mësipërme, për të cilën të merren masat për të kaluar në ri kontroll veprimtarinë e operatorit “N.P ” për aspektin tatimor të kontrollit, me qëllim realizimin e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e detyrimeve dhe penaliteteve administrative të vlerësuar para praktikisht në vlerën gjithsej 1,060,800 lekë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.</p>
B.4	<p>Nga auditimi u konstatua se subjekti H.D.A ka kryer shkelje administrative doganore në fushën e akcizës pasi nga rillogaritjet e kryera nga grupi auditues për të dhëna të marra nga sistemi Aszcuda Word pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në lidhje aktivitetin e kryer për periudhën 12.08.2020 deri më datën e përfundimit të kontrollit nga strukturat e Departamentit të Akcizës pranë Departamentit të Akcizës për procedura importi për mallrat të hyra sipas procedurës doganore 4700 (hyrje në magazinë fiskale) dhe procedura doganore dalje nga magazina fiskale sipas tipit DSHA 4 dhe DSHA 6 ku rezultoi se subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta ligjore për sasinë prej 2,617 litra me vlerë malli në shumën 101,893 euro pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila,</p>	Drejtimi 2.6	E lartë	<p>Drejtorja e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për të kaluar në procedurë ri kontrolli veprimtarinë e operatorit “H”, me qëllim realizimin e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e situatës për periudhën e kontrolluar sipas Program Kontrollit nr.17747 datë 07.10.2022 sipas gjetjeve dhe konstatimeve të ri llogaritura për sasinë prej 2,617 litra pije alkolike te rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën prej 1,109,372 lekë, të cilat rezultojnë të shmangura dhe të papaguara.</p> <p>Gjithashtu Drejtorja e Përgjithshme te Doganave të kryejë raportim shkresor me DPT (DRT) në lidhje me sasinë e mallit të gjetur në mungesë me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të vlerësuar para praktikisht në shumën</p>

	<p>Whisky, Vodka, Rum me gradë alkolike nga 37.5% deri 40% të rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën prej 909,372 lekë, për të cilat është shmangur pagesa, mbi të cilën aplikohet gjobë në masën 200,000 lekë, pra detyrim total akcize 1,109,372 lekë. Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk është kryer raportim shkresor bazuar në “Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355, datë 19.06.2018 në lidhje me sasinë e mallit të evidentuar me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve me detyrime tatimore në shumën 8,839,140 lekë për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi, detyrim i cili në total për operatorin bashkë me akcizën përbëjnë 9,948,512 lekë të ardhura të munguara.</p>			<p>8,839,140 lekë për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH-së dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në total detyrime në vlerën 9,948,512 lekë.</p>
B.5	<p>Për detyrimin e nxjerrë nga kontrolli i operatorit E.D për agjentin doganor “L.C” nuk është nxjerrë nga Dega Doganore Tiranë mbi penalitetin e vendosur në vlerën 380,000 lekë për përpilimin e 19 DAV jo të sakta. DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penalitetin e vendosur në vlerën 50,000 lekë më të vogël se ai i caktuar në proces verbalin e kontrollit aposterior, duke rezultuar në një vlerë të ardhurash të munguara prej 430,000 lekësh, si pasojë e mos vendimmarrjes së Degëve Doganore.</p>	Drejtimi 2.6	E lartë	<p>Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Degët Doganore Tiranë dhe Rinas në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 430,000 lekë.</p>
C.1	<p>Gjatë vitit 2022 janë likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë për 8 ish punonjës të DPD të larguar nga puna, në vlerën 5,847,000 lekë. Referuar vendimeve të përcjella për t’u likuiduar, rezultojnë të kenë mbetur pa paguar deri në datën 31.12.2022 vendime për ish punonjës në vlerën 2,362,000 lekë, të cilat janë likuiduar përgjatë muajit Janar dhe Shkurt të vitit 2023. Pra në total, rezultojnë 9 vendime në vlerën totale prej 8,210 mijë lekë, ku 3 vendime i përkojnë vitit 2022, dhe 6 vendime të periudhave të mëparshme, dhe nga të cilat vlera prej 416,535 lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore. Nga ana e DPD nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimet gjyqësore për</p>	Drejtimi 2.7	E lartë	<p>DPD nëpërmjet strukturave të brendshme saj të marrin masat për krijimin e kushteve të favorshme që linjat e raportimit mes sektorëve të garantojnë njoftimin e menjëhershëm të Sektorit të Financës në momentin e marrjes në dorëzim të një vendimi nga Sektori Juridik, me qëllim shmangien e tarifave përmbartimore që shoqërohen me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.</p> <p>-Titullari i DPD të marrë masa për të garantuar një vendimmarrje sa më të drejtë lidhur me marrëdhëniet e punës së punonjësve të DPD (duke përfshirë këtu largimet, transferimet apo orët e punës për të cilat punonjësit e DPD janë aktualisht në procese gjyqësore), për të shmangur krijimin e efekteve financiare</p>

<p>largimet nga puna, duke mos vepruar sipas kërkesës së pikës 60 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “ Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.</p> <p>-Sipas informacionit të vendosur në dispozicion lidhur me çështjet gjyqësore në proces që lidhen me marrëdhëniet me punonjësit, rezultojnë në total 46 të tilla, nga të cilat 15 çështje lidhen me ish punonjës dhe 31 çështje paraqiten me objekt transferimesh apo orësh jashtë orarit të punonjësve aktual të autoritetit doganor.</p>			<p>të buxhetit të shtetit në të ardhmen.</p>
---	--	--	--

I. 3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT:

Opinion i auditimit të përputhshmërisë.

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore, nën ligjore dhe rregullatore (kriteret e paracaktuara të vlerësimit¹) në lidhje me: planifikimin, realizimin dhe raportimin e të ardhurave doganore; menaxhimin e borxhit doganor; menaxhimin e burimeve njerëzore; planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të DPD; menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, prokurimet publike, veprimtarinë e Drejtorisë së Hetimit dhe të Drejtorisë së Antikontrabandës, procedurave të ndjekura nga ana e Drejtorisë Teknike të Akcizës dhe Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Pas zhdoganimit (Aposteriori), Drejtorisë Juridike, etj., për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave në lidhje me çështjet e cilësuar më lart. Në kryerjen e këtij auditimi ne u mbështetëm në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin mbi të cilin u kryen teste analitike.

Opinion i modifikuar/kualifikuar²

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Baza për opinionin e modifikuar” subjekti i audituar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë, Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor; Udhëzimi nr. 15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, Rregulloren e Brendshme të DPD, etj.) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj për vitin 2022.

Baza për opinionin e modifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA- të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin e mëposhtëm, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të shërbyer si bazë për opinionin tonë (ISSAI 400 & ISSAI 4000). Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me kriteret

¹ ISSAI/IFPP-4900, të INTOSAI

² Opinioni i modifikuar, i cilësuar/kualifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të cilësuar, kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura

e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) në fund të vitit 2022 rezulton me një nivel borxhi doganor në shumën **46,690,911 mijë lekë**, e përfaqësuar nga **4,858 raste**. Borxhi Doganor i trashëguar përgjatë viteve rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 rritja paraqitet në vlerën **979,324 mijë lekë**, ose me 2,14 %.

- Nga auditimi u konstatuan të ardhura doganore të munguara në buxhetin e shtetit, të shkaktuara si pasojë e problematikave të identifikuar në zbatimin e kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në strukturën përgjegjëse të hetimit, antikontrabandës, akcizës në totalin **prej 19,314 mijë lekë**.

- Nga auditimi u konstatuan problematika në procedurat e prokurimit dhe monitorimit të kontratave; në veprimtarinë e sektorit juridik; në procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave doganore; administrimin e burimeve njerëzore; mos finalizimi i procesit të ristrukturimit të institucionit.

- Efekte financiare negative në përdorimin e fondeve publike si pasojë e likuidimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për ish punonjësit e larguar nga puna, në vlerën totale prej **8,210 mijë lekë**, nga të cilat vlera prej 416 mijë lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave:

Strukturat drejtuese të DPD, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave doganore, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit; menaxhimit e të ardhurave, borxhit doganor; menaxhimit e burimeve njerëzore, etj. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projekt Raportit të Auditimit dhe Programit të Auditimit nr. 283/1 prot. datë 03.04.2023, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 03.04.2023 deri më datë 14.07.2023, u krye auditimi në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), për

periudhën nga 01.01.2022-31.12.2022, me objekt: “Auditim Përputhshmërie” nga grupi i auditimit:

1. J.T, Përgjegjës Grupi
2. G.T, Auditues
3. A.D, Auditues
4. XH.XH, Auditues
5. F.D, Auditues

1.Objekti i Auditimit

Objekti i Auditimit është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së DPD, mbi drejtimit e auditimit të përcaktuara në Programin e auditimit, në raport me kriteret e paracaktuara të vlerësimit, të cilat rrjedhin nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullative, ku DPD mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe realizimin e misionit kryesor, realizimi i të ardhurave doganore. Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

- Evidentimi i shmangieje të veprimtarisë së DPD me kriteret e vlerësimit në bazë të kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për periudhën objekt i auditimit;
- Evidentimi i të metave dhe mangësive në lidhje me rregullshmërinë e proceseve sipas legjislacionit dhe rregullave të funksionimit të miratuara nga DPD;
- Vlerësimi i veprimeve, zbulimi i mospërputhjeve me pasojë të ardhura të pa llogaritura, mungesë të ardhurash, etj;
- Vlerësimi i përmbushjes së misionit të DPD për realizimin e të ardhurave doganore;
- Vlerësimi i transparencës me publikun dhe biznesin, krahasimi i rezultateve të veprimtarisë së institucionit midis viteve objekt i auditimit;
- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës;
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, shlyerjen e dëmeve të mundshme ekonomike dhe parandalimin e mospërputhjeve në të ardhmen;
- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i auditimit është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhshmërisë së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare, me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, të cilësuar si kriteret vlerësimi, në lidhje me realizimin dhe rakordimin e të ardhurave doganore; vjeljen e borxhit doganor dhe efektivitetin e masave shtrënguese në rikuperimin e tij; zbatimin e buxhetit të DPD; menaxhimin e burimeve njerëzore, etj., vlerësimi dhe evidentimi i gabimeve materiale. Nëpërmjet kryerjes së këtij auditimi KLSH synon të promovojë:

- Transparencën, duke ofruar raport të besueshëm për fondet nëse janë administruar sipas një procesi të rregullt dhe është respektuar kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre;
- Qeverisjen e mirë, duke identifikuar dobësitë dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm, si dhe duke marrë parasysh riskun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë.

3. Identifikimi i çështjes

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së DPD për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përbërëse në DPD referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, ku janë identifikuar fushat me risk më të lartë.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Drejtori i Përgjithshëm i DPD (Përgjegjës Menaxherial i Institucionit) është përgjegjës për vendosjen dhe përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet. Për të siguruar administrim efektiv dhe përmbushjen e misioneve, kompetencave dhe detyrave funksionale të administratës doganore, bashkëpunon dhe bashkërendon punën nëpërmjet zëvendës drejtorëve dhe drejtuesve që ka në varësi të drejtpërdrejtë.

Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Doganave (nëpunësi autorizues) janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor sipas funksioneve dhe përgjegjësi të përcaktuara për të siguruar një administrim të efektshëm si dhe drejton, bashkërendon punën dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryer nga drejtoritë e departamentit që mbulon.

Drejtorët e Drejtorive së bashku me sektorët përkatës (nëpunësi zbatues) janë përgjegjës për zbatimin e legjislacionit doganor sipas funksioneve dhe përgjegjësi të përcaktuara në rregulloren e brendshme të DPD në të cilën janë përcaktuar edhe detyrat sipas pozicioneve të punës.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësit e audituesit, lidhen me faktin e marrjes së sigurisë së arsyeshme, në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

ISSAI/IFPP 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit. Më konkretisht:

Parimi i Plotësisë, kërkon që audituesi të marrë parasysh të gjitha dëshmitë e provat përkatëse të auditimit si dhe të trajtojë të gjithë informatat dhe evidencat e duhura e të mjaftueshme para se të lëshojë raportin e angazhimit;

Parimi i Objektivitetit, kërkon që audituesi të zbatojë gjykimin dhe skepticizmin profesional për t'u siguruar që raporti është faktikisht i saktë, dhe se gjetjet e konkluzionet janë të paraqitura në mënyrën e duhur, të drejtë dhe të ekuilibruar;

Parimi i Afatit nënkupton përgatitjen e raportit në kohën e duhur, pasi vetëm në këtë mënyrë ai është i rëndësishëm për përdoruesit e synuar;

Parimi i Kundërshtimit ose Kontradiksionit, nënkupton përfshirjen e komenteve nga subjekti përgjegjës në formën e përshtatshme, duke u përgjigjur dhe vlerësuar për këto reagime dhe komente.

6. Kriteret e vlerësimit

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të DPD, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe përcaktimet në marrëveshjet ndërkombëtare që kanë lidhje me sistemin doganor në Republikën e Shqipërisë.

Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kritere përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit:

- Akte ligjore:
 - Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”;
 - Ligji nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Shqipëri”;
 - Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;
 - Ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”;
 - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
 - Ligji nr. 9720 datë 23.04. 2007, i ndryshuar nr. 114/2015, dt. 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
 - Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
 - Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;
 - Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”;
 - Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me ndryshime, etj.
- Akte nënligjore
 - VKM nr. 651 datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të KD”;
 - VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për Dispozitat zbatuese të ligjit Për Akcizat”, i ndryshuar;
 - VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”;
 - VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
 - VKM nr. 185, datë 29.03.2018 “Procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, etj.
 - VKM nr. 187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit (1)(2);
- Udhëzime:
 - Udhëzimi i DPD, nr. 15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
 - Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
 - Udhëzimi i MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;
- Rregullore:
 - Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimit administrativ KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
 - Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së e ndryshuar;
 - Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, etj.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në:

Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI- P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë: ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë” Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;

- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka pasur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;

- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për t’u siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

-ISSA 130 “Kodin Etik”. Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.

- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.

- Ruajtjen e sekretit profesional.

- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.

- Sjelljen profesionale.

ISSAI/IFPP400, Paragrafi 46 “Risku i auditimit” dhe ISSAI/IFPP 4000, Kapitulli 5 “Kërkesat e përgjithshme të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ($RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;

- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;

- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;

- U përcaktua e rreziku i mos zbulimit;

- U aplikua Modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

ISSAI/IFPP400, Paragrafi 47 “Materialiteti” dhe ISSAI/IFPP 4000, Kapitulli 5 “Kërkesat e përgjithshme të auditimit të përputhshmërisë”

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

ISSAI/IFPP 400, Paragrafi 48 “Dokumentimi” dhe ISSAI/IFPP 4000, Kapitulli 5 “Kërkesat e përgjithshme të auditimit të përputhshmërisë”

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme (ISSAI/IFPP-2330), duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit

- Rëndësia e evidencës së auditimit

- Burimet e evidencës së auditimit

- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

8. Metodat e auditimit

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve, informacioneve relevante dhe që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

c. Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

d. Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin; gjurmën e auditimit për aktivitetet kryesore, si dhe mënyrën e funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji, si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësi e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA). Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimit të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, teknikat e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore. Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë të mjaftueshme, të plotë, të saktë mbi transaksionet e testuara.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e ISSAI/IFPP 400; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH.

Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, është një njësi funksionale që varet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në Republikën e Shqipërisë. DPD ka në varësi të saj 17 Degë Doganore që operojnë në territorin e RSH, të cilat kryejnë operacione të deklarimit dhe zhdoganimit. Misioni i Administratës Doganore Shqiptare është të ruajë interesat financiarë dhe ekonomikë të Shqipërisë, të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë dhe të partnerëve tanë të biznesit duke u mbështetur në menaxhimin e riskut dhe kontrollin efikas dhe efektiv të lehtësojë tregtinë duke implementuar metoda dhe teknologji moderne pune dhe të bashkëpunojë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.

Kuadri rregullator nga e cila udhëhiqet administrata e DPD, është legjislacioni doganor ku respektivisht detyrat funksionale sipas funksionit organik janë sanksionuar në Rregulloret e Brendshme të miratuara nga MFE.

Autoritet Doganore kanë si objektiva kryesore:

- Sigurimin e mbledhjes korrekte dhe të efektshme të detyrimeve dhe taksave nëpërmjet rritjes së efikasitetit në punë të stafit doganor, zbatimin korrekt të legjislacionit, uljen e kohës së përpunimit të deklaratës doganore, duke ulur njëkohësisht dhe kostot shtesë të operatorëve ekonomikë që kryejnë veprime doganore në këtë pikë doganore;

-Rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj udhëtareve dhe subjekteve që operojnë nëpër Degë Doganore duke krijuar lehtësi në lëvizje, e kontroll eficient duke synuar uljen e evazionit fiskal nëpërmjet zbulimit dhe ndëshkimit të shkeljeve doganore sipas legjislacionit në fuqi;

Për institucionin tonë, kryerja e këtij auditimi, ka rëndësi lidhur me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve dhe anomalive materiale me pasojë të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Në zbatim të drejtimit 1 të Programit të Auditimit “*Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme*” u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacionet:

-*Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së nr. 362/22 Prot, datë 15.09.2022.*

-*Shkresa, materiale, evidenca mbi marrjen e masave për zbatimin e Rekomandimeve*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar të kërkuar dhe të vënë në dispozicion konstatohet se:

-Me shkresën nr.362/22 Prot të datës 15.09.2022 Kontrolli i Lartë i Shtetit ka dërguar: Raportin përfundimtar të auditimit “*Auditim Përputhshmërie në DPD, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 (Pjesa I)*” të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në përfundim të auditimit janë konstatuar disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore në fuqi të cilat janë finalizuar me Vendimin nr.159 të datës 14.09.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

a. Hartimi i programit (Planit të veprimit), si dhe respektimi i afatit ligjor **prej 20 ditësh** nga data e marrjes së kërkesës për informimin e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (gërma “j” e nenit 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

- Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka zbatuar detyrimin ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes në KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.362/22 të datës 15.09.2022.

Nga ana e subjektit është kthyer përgjigja për hartimin e programit të punës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH konkretisht me nr.6729 Prot., të datës 05.10.2022 përsa i përket Raportit Përfundimtar të Auditimit.

b. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014).

-Nga auditimi rezultoi se, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur informacion për zbatimin e rekomandimeve me anë të shkresës nr. 6729/63 Prot, datë 15.03.2023 brenda afatit 6 mujor përsa i përket Raportit të Auditimit (Pjesa I) të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.362/22 Prot të datës 15.09.2022.

Realizimi i rekomandimeve

Në zbatim të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (pjesa I) dërguar me shkresën nr 362/22 Prot., datë 15.09.2022 nga ana e DPD rezulton sipas verifikimit të kryer se nga totali i 20 rekomandimeve janë zbatuar 3 rekomandime, janë të zbatuara pjesërisht 12 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime.

B. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 1.1-Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Grupi i Menaxhimit Strategjik, si dhe strukturat e menaxhimit të borxhit në DPD, të marrin masa për hartimin e një strategjie mbi menaxhimin e borxhit doganor, si dhe të ndërmarrin aktivitete kontrolli shtesë, si rishikimi apo nxjerrja e udhëzimeve apo metodikave të reja, krijimi i strukturave efikase me qëllim eliminimin e mangësive dhe rritjen e efektivitetit në rikuperimin e borxhi.

Komenti i subjektit: -Referuar këtij rekomandimi, 9 degë doganore i kanë dërguar informacion DPD-së përsa i përket trajtimit dhe nivelit të zbatimit të tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të shkresave të dërguara nga degët doganore pranë DPD-së konstatohet se këto shkresa përmbajnë evidentimin e situatës së borxhit doganor, pa pasur propozime mbi hartimin e një strategjie të re apo kontrolle aktiviteteve shtesë. Gjithashtu Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka ndërmarrë hapa konkrete për trajtimin e rekomandimit.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 1.2- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të marrë masa, për plotësimin e organikës me specialistë të borxhit në degët doganore dhe mundësojë shtimin e saj, kryesisht në degët me borxhit doganor më të lartë (Dega e Doganës Tiranë, Durrës dhe Fier).

Komenti i subjektit: -Referuar këtij rekomandimi, drejtoria e menaxhimit të burimeve njerëzore me anë të shkresës me nr 3523 Prot të datës 27.02.2023 informon drejtorin e përgjithshëm të DPD-së se ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Edhe pas marrjes së masave për plotësimin e organikës, përsa i përket vitit 2022 organika e specialistëve të borxhit në degë doganore rezulton e paplotësuar.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 1.3- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me degët doganore, të rishikojë procedurat mbi ekzekutimin me forcë të borxhit, nëpërmjet angazhimit të tyre dhe me mbështetjen e Departamentit Operativ Hetimor, etj.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, 9 degë doganore i kanë dërguar informacion DPD-së përsa i përket trajtimit dhe nivelit të zbatimit të tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të shkresave të dërguara nga degët doganore pranë DPD-së konstatohet se këto shkresa përmbajnë evidentimin e situatës së borxhit doganor, pa rishikuar procedurat e ekzekutimit me forcë të borxhit doganor.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 2.1- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për zbatimin në mënyrë rigorozë të procedurave të konkurrimit, në mënyrë të tillë që rekrutimi i punonjësve të jetë sa më i hapur dhe transparent, si dhe të sigurojë që kandidatët e kualifikuar dhe të shpallur fitues, të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kushteve për aplikim dhe gjithashtu të respektojnë afatet e dorëzimit të dokumentacionit.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, drejtorja e menaxhimit të burimeve njerëzore me anë të shkresës me nr 3523 Prot të datës 27.02.2023 informon drejtorin e përgjithshëm të DPD-së se ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, por edhe pas konstatimit të problematikave të ngjashme përsa i përket procedurave të konkurrimit përgjatë vitit 2022 me ato të 2021, ky rekomandim nuk konsiderohet plotësisht i zbatuar.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Rekomandimi 3.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave dhe Drejtorja e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, duhet të marrin masa të menjëhershme për:

-Respektimin e afateve dhe njoftimin në kohë të punonjësve të cilët rregullojnë marrëdhëniet e punës sipas Kodit të Punës, për të gjitha rastet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, si dhe për rastet e zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës nga punëdhënësi;

-Evitimin e vendimmarrjeve nga ana Komisionit Disiplinor, pa përfaqësimin e duhur, si dhe evitimin e vendimeve të Komisionit Disiplinor, në dhënien e masave disiplinore të nivelit “Largim nga shërbimi civil” në mënyrë të paargumentuar, pa bazuar në fakte dhe të pambështetur në aktet ligjore dhe nënligjore, me qëllim mos krijimin e efekte financiare negative në buxhetin e shtetit, për likuidime vendimesh gjyqësore, për largime të padrejta nga puna, ndaj ish punonjësve.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, drejtorja e menaxhimit të burimeve njerëzore me anë të shkresës me nr 3523 Prot të datës 27.02.2023 informon drejtorin e përgjithshëm të DPD-së se ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi dhe ka marrë masa për respektimin e afateve dhe procedurave të njoftimit në kohë të pjesëmarrësve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, por edhe pas konstatimit të problematikave të ngjashme përsa i përket procedurave të konkurrimit dhe vendimmarrjeve të komisionit disiplinor pa përfaqësimin e duhur përgjatë vitit 2022 me ato të 2021, ky rekomandim nuk konsiderohet plotësisht i zbatuar.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Rekomandimi 4.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të nxjerrë përgjegjësitë e shkeljeve ligjore për transferimin e punonjësve, si dhe të marrë masa të menjëhershme, për eliminimin e tyre në të gjitha rastet e evidentuara, referuar tabelave anekse dhe të specifikuara sipas natyrës së shkeljeve ligjore si më poshtë:

-në 5 raste, sipas Tabelës anekse. 6.5, për transferime të punonjësve që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil në pozicione të shërbimit civil dhe anasjelltas;

-në 74 raste, sipas Tabelës anekse nr.6.6, për vitin 2021 transferimi është realizuar për një periudhë me kohëzgjatje mbi 6 muaj në tejkallim të afateve ligjore.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, drejtorja e menaxhimit të burimeve njerëzore me anë të shkresës me nr 3523 Prot të datës 27.02.2023 informon se është në proces rikonstruktimi dhe në përfundim të procesit rekomandimi do të zbatohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe pas përfundimit të procesit të ristrukturimit konstatohet se problematikave përsa i përket afateve të transferimeve nuk janë të zgjidhura plotësisht.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 4.2- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për nevoja të punës, në rastet e transferimit të punonjësve, duhet të respektojë afatet kohore të transferimeve, ku dhe në urdhrin e transferimit të parashikohet kohëzgjatja dhe transferimi të kryhet brenda të së njëjtësi kategori që punonjësi zotëron, në mënyrë të tillë që transferimet e kryera të mos sjellin efekte financiare negative në buxhetin e shtetit.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, drejtorja e menaxhimit të burimeve njerëzore me anë të shkresës me nr 3523 Prot të datës 27.02.2023 informon se është në proces ristrukturimi dhe në përfundim të procesit rekomandimi do të zbatohet.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar nga ana e drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, dhe pas përfundimit të procesit të ristrukturimit konstatohet se problematikat përsa i përket afateve të transferimeve nuk janë të zgjidhura plotësisht.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 5.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme, për zbatimin e të gjitha kërkesave dhe kritereve të përcaktuara, për shqyrtimin në kohë nga ana e Komisionit të Posaçëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt “Rikthim në punë të punonjësve”, duke parashtruar alternative të pranueshme ndaj gjyq fituesve, me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e shtetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD nuk i ka paraqitur asnjë dokumentacion grupit të auditimit në lidhje me masa e marra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi 6.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Drejtorja e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, duhet të marrë masa për:

-Hartimin dhe miratimin e udhëzuesit/metodikë, mbi planifikimin e të ardhurave nga dogana, për aq sa informacioni dhe analizat e DPD, në këtë proces janë të mjaftueshme dhe të dobishme. DPD duhet të përcaktojë strukturat e duhura brenda sistemit doganor, të cilat do të jenë pjesë e procesit të planifikimit; afatet; metodikën e aplikuar, në lidhje me marrjen e informacionit, përpunimin e tij; diskutimet mbi hartimin e projekt planit të të ardhurave doganore dhe dërgimin e tij në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

-Hartimin e një projekt plani mbështetur në një analizë të treguesve, si dhe duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e riskut të brendshëm dhe të jashtëm, me qëllim finalizimin e një plani sa më real.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD nuk i ka paraqitur asnjë dokumentacion grupit të auditimit në lidhje me masa e marra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi 7.1- Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në vijim të dokumentojë sipas përcaktimeve ligjore mënyrën e llogaritjes së fondit limit, si dhe të ndjekë me përgjegjshmëri procedurat ligjore për realizimin në kohë të prokurimeve/blerje me vlerë të vogël, sipas përcaktimeve kontraktuale apo sipas kritereve të vendosura në ftesën për ofertë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD nuk i ka paraqitur asnjë dokumentacion grupit të auditimit në lidhje me masa e marra për zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi 8.1- Drejtoria e Përgjithshëm i Doganave, të marrë masa për përditësimin e Strategjisë Institucionale, apo hartimin e një strategjie të re afatmesme, miratimin e plan veprimit mbi zbatimin e kësaj strategjie, duke kryer periodikisht përditësim të saj dhe të plan veprimeve vjetore, me qëllim përcaktimin e aktiviteteve, strukturave përgjegjëse/personave përgjegjës, afatet e realizimit të objektivave, si dhe kostot respektive.

Komenti i subjektit: - Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Integritimit Evropian përmes shkresës me nr.3034 Prot të datës 21.02.2023 drejtuar drejtorit të përgjithshëm të DPD-së i bashkëngjit observacionin që i ka dërguar drejtorit të përgjithshëm të DPD-së me datë 05.10.2022 në të cilën shprehet se nuk është struktura përkatëse për të udhëhequr procesin e miratimit të strategjisë së re.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD i ka paraqitur me anë të observacioneve grupit të auditimit strategjinë e re të biznesit të administratës doganore 2023-2027.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

Rekomandimi 9.1- Drejtoria e Përgjithshëm i Doganave dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për vlerësimin e cilësisë dhe gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm, për hartimin e “Deklaratës së cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm”, si dhe dorëzimin e saj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (Nëpunësi i Parë Autorizues).

Komenti i subjektit: - Me anë të shkresës me nr.4724 Prot të datës 15.03.2023 Drejtoria e Buxhetit dhe Financës njofton se për vitin 2023 është dorëzuar deklarata e cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm nënshkruar nga NA.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se kjo deklaratë është dërguar mbi një muaj me vonesë nga parashikimi i pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

Rekomandimi 10.1- Drejtoria e Përgjithshëm i Doganave në bashkëpunim me Drejtorin e Auditit të Brendshëm të marrin masa për ndjekjen e procedurave të pajisjes me Certifikatë të Audituesve të Brendshëm dhe ndjekjen e trajnimeve të detyrueshme në këtë fushë.

Komenti i subjektit: - Me anë të shkresës me nr.3430 të datës 24.02.2023 Drejtoria e Auditimit të brendshëm informon se 3 nga audituesit e pa certifikuar kanë filluar procedurat për pajisjen me certifikatë të audituesve të brendshëm.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se 3 audituesit e pa certifikuar kanë filluar procedurat e pajisjes me certifikatë të audituesve të brendshëm.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar.

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Rekomandimi 1.1- Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në DPD, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 966,239 lekë nga OE “E.” SHPK, shkaktuar nga përllogaritja e gabuar e penaltetit, për mos lëvrimin e mallit të prokuruar brenda afateve të parashikuara në kontratën në kuadër të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagente kimik”.

Komenti i subjektit: - Me anë të shkresës me nr.4274 të datës 15.03.2023 Drejtoria e Buxhetit dhe Financës informon se me shkresën me nr.1083/1 Prot të datës 28.01.2022 ka mbajtur penaltitet në vlerën 120,525 lekësh në faturën tatimore 11/2022 likuiduar shoqërisë “E”, gjithashtu me shkresën me nr.10126/1 Prot të datës 08.02.2023 ka mbajtur penaltitet në faturën tatimore me

nr 21/2022 likuiduar shoqërisë “E” ka mbajtur penalitet në vlerën 2,748 lekë. Gjithashtu ka evidentuar debitor shoqërinë “E” për shumën 842,966 lekë (966,239-123,723 sa mbajtur penalitet në vitin 2022) për sanksione të pa mbajtura si dëm ekonomik.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka marrë masat për arkëtimin e vlerës 966,239 lekë nga OE “E.”, por ende vlera totale nuk është arkëtuar.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet pjesërisht i zbatuar.

C.2. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE

Rekomandimi 1.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, si dhe strukturat e menaxhimit të borxhit doganor në qendër dhe degë doganore, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të analizuar situatën e rritjes së stokut të borxhit nga viti në vit, si dhe të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët ligjore me qëllim rikuperimin e borxhit në shumën 45,711,586,000 lekë, nga i cili vlera prej 657,647,764 lekë është shtuar gjatë vitit 2021.

Komenti i subjektit: - Referuar këtij rekomandimi, 9 degë doganore i kanë dërguar informacion DPD-së për sa i përket trajtimit dhe nivelit të zbatimit të tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të shkresave të dërguara nga degët doganore pranë DPD-së konstatohet se këto shkresa përmbajnë evidentimin e situatës së borxhit doganor, pa pasur propozime mbi hartimin e një strategjie të re apo kontrole aktivitetesh shtesë. Gjithashtu Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk ka ndërmarrë asnjë hap për trajtimin e rekomandimit.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 2.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të marrë në analizë të gjitha vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative ndaj personave shkaktarë, me qëllim shmangien e efekteve të tilla negative në Buxhetin e Shtetit.

Komenti i subjektit: - Drejtoria e Buxhetit dhe Financës me anë të shkresës me nr.4274 të datës 15.03.2023 informon se ka rakorduar në vazhdimësi me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në analizë për vendimet gjyqësore me objekt rikthimin në punë, duke dhënë mendimin e saj në mbrojtje të institucioni

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të shkresës së dërguar për marrjen e masave midis rakordimeve të drejtorive përkatëse, por edhe pas konstatimit edhe përgjatë vitit 2022 të së njëjtës situatë për sa i përket vendimeve gjyqësore me objekt rikthimin në punë.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 2.2- Drejtoria Juridike, duhet të marrë masa për njoftim të menjëhershëm të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës në momentin e disponimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për likuidim page për ish punonjësit, në mënyrë të tillë që ekzekutimi i këtyre vendimeve të realizohet në kohë dhe në mënyrë vullnetare me qëllim eliminimin e pagesave shtesë, si tarifa përmbartimore.

Komenti i subjektit: - Drejtoria e Buxhetit dhe Financës me anë të shkresës me nr.4274 të datës 15.03.2023 informon se ka marrë masa duke krijuar mundësi likuidimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda vitit kalendarik buxhetor apo dhe duke evituar detyrimet e prapambetura për likuidim page për ish punonjësit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas shqyrtimit të shkresës së dërguar nuk konstatohet marrja e masave nga ana e Drejtorisë Juridike për njoftimin e menjëhershëm të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 3.1- Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të nxjerrë përgjegjësitë e shkeljeve ligjore, për transferimin e punonjësve, si dhe të marrë masa të menjëhershme, për kthim të tyre në pozicione punë brenda së njëjtës kategori, me qëllim eliminimin e efekteve financiare negative, për të gjitha rastet e evidentuara, referuar tabelave anekse 6.3 dhe 6.4, pjesë e Pjesë e Projekt Raportit të Auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD nuk i ka paraqitur asnjë dokumentacion grupit të auditimit në lidhje me masa e marra për zbatimin e këtij rekomandimi. Gjithashtu edhe përgjatë vitit 2022 konstatohet e njëjta problematik.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar .

D. MASA DISIPLINORE

Rekomandimi 1.1- Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, që në vlerësim të shkeljeve, të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “a” dhe “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sipas nenit 58, shkronja “b”, “c” dhe “ç” të ligjit. nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

Komenti i subjektit: - Me anë të urdhrorit me nr.6729/3 Prot të datës 05.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së ka nisur analizimi dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Me anë të urdhrorit të sipërcituar ka nisur analizimi dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna por nuk ka filluar ende procedura përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i zbatuar pjesërisht .

E.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Rekomandimi 1.1- Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: DPD nuk i ka paraqitur asnjë dokumentacion grupit të auditimit në lidhje me masa e marra për zbatimin e këtij rekomandim.

Për sa më sipër rekomandimi konsiderohet i pazbatuar .

Tabela nr. 1 Përmbledhese e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm

Rekomandime	Total		Të zbatuara		Të zbatuara pjesërisht		Të pazbatuara	
	Numë r	Mijë Lekë	Numë r	Mijë Lekë	Numë r	Mijë Lekë	Numë r	Mijë Lekë
Masa Organizative	13	-	3	-	7	-	3	-
Masa Shpërblim Dëmi	1	966,			1	966,239		
Masa për eliminimin e efekteve financiare negative	4	684,855			3	684,855	1	-
Masa Disiplinore	1				1			
Njoftimi i departamentit të administratës publike dhe komisionerit të mbikëqyrjes të shërbimit civil	1						1	
Total	20	685,281	3	-	12	685,281	5	

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

1. Titulli i Gjetjes: **Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm**

Në zbatim të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (pjesa I-rë) dërguar me shkresën nr. 362/22 prot, datë 15.09.2022, nga ana e DPD është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh dhe 6 muajsh për kthimin e përgjigjes në KLSH mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, respektivisht me shkresat nr. 6729 prot., datë 05.10.2022 dhe nr 6729/63 prot., datë 15.03.2023.

Nga auditimi rezultoi se, nga 20 rekomandime gjithsej të lëna, janë zbatuar 3 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 12 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime, si në vijim:

Situata:

- Për masat organizative nga 13 masa gjithsej të rekomanduara, rezulton se 3 masa janë të zbatuara, 7 masa të zbatuara pjesërisht dhe 3 prej tyre janë të pazbatuara.

- Për masat për eliminimin e efekteve financiare negative nga 4 masa të rekomanduara, rezulton se 1 prej tyre janë të pazbatuara dhe 3 janë të zbatuara pjesërisht.

-Për 1 masë shpërblim dëmi të rekomanduar, në vlerën 966,239 lekë, ajo rezulton e zbatuar pjesërisht.

-Për 1 masë disiplinore të rekomanduar, ajo rezulton e zbatuar pjesërisht.

-Për 1 masë për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil të rekomanduar, rezulton se ajo nuk është zbatuar.

Kriteri:

Ligji nr. 154.2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j” dhe “k” dhe pika 2 e nenit 30.

Ndikimi/Efekti:

Mungesë në zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Shkaku:

Neglizhenca e nëpunësit autorizues në marrjen e masave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia:

E lartë

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e 5 rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe 12 rekomandimeve të zbatuara pjesërisht të lëna në auditimin e mëparshëm.

Rekomandim:

Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së, të analizojë situatën lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse me rekomandime konkrete për zyrtarët përgjegjës.

Për sa i përket zbatimit të rekomandimeve të lëna sipas shkresës nr.360/43, prot datë 15.02.2023 të KLSH me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar (Pjesa e II-të) dhe rekomandimet për auditimin e përrputshmërisë të ushtruar në DPD”, në respektim të afatit 6 mujor për raportimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna sikundër përcaktuar në pikën 2 të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, faza e auditimit në terren për këtë drejtim të auditimit në zbatim të Programit të Auditimit nr 283/1 prot., datë 03.04.2023, i ndryshuar, do të vazhdojë deri më datë 13.10.2023.

2.2 Programimi i të ardhurave doganore dhe realizimi i tyre sipas zërave përkatës të treguesve për vitin 2022

Mbi procedurat e ndjekura për planifikimin e të ardhurave doganore

1. Në zbatim të ligjit nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, me shkresën nr. 1677, prot datë 31.01.2022, prot në DPD nr. 1858, datë 01.02.2022, saktësuar më pas me shkresën nr. 3567, prot datë 23.02.2022, prot në DPD nr. 3957, datë 25.02.2022, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është përcjellë plani i të ardhurave të administratës doganore në vlerën 202,988 milion lekë, sipas muajve. Ndryshimet e saktësuara kanë konsistuar në shpërndarjen sipas muajve të planit, ku konkretisht:

Plani sipas shkresës datë 31.01.2022 paraqitet si më poshtë:

Pasqyra nr. 2 Plani mujor i të ardhurave për DPD në vitin 2022

Në milion lekë

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
TVSH	8,492	8,854	10,877	11,067	11,122	11,681	11,767	11,610	11,770	11,196	12,821	14,743	136,000
Akciza	3,518	3,866	4,192	4,149	4,930	5,062	5,277	5,866	4,824	4,791	4,579	5,424	56,478
Renta	260	230	230	230	268	280	280	230	240	252	250	250	3,000
Taksë doganore	430	450	500	500	545	680	752	750	701	712	694	795	7,508
Totali	12,700	13,400	15,798	15,947	16,864	17,703	18,076	18,456	17,535	16,951	18,344	21,213	202,988

Progressive

Në milion lekë

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
TVSH	8,492	17,346	28,223	39,290	50,412	62,093	73,860	85,470	97,240	108,436	121,257		136,000
Akciza	3,518	7,384	11,576	15,725	20,655	25,717	30,993	36,859	41,683	46,474	51,054		56,478
Renta	260	490	720	950	1,218	1,498	1,778	2,008	2,248	2,500	2,750		3,000
Taksë doganore	430	880	1,380	1,880	2,425	3,105	2,857	4,607	5,308	6,020	6,714		7,509
Totali	12,700	26,100	41,899	57,846	74,710	92,412	110,488	128,944	146,479	163,430	181,775		202,988

Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar kësaj shkrese konstatohen pasaktësi në detajimin e planit mujor, krahasimisht me planin progresiv për zërin e të ardhurave nga taksa doganore, ku konkretisht sipas planit mujor totali për këtë zë rezulton në vlerën 7,508 milion lekë; ndërkohë që sipas planit progresiv në 7,509 milion lekë. Kjo diferencë nuk ka impaktuar planin total të të ardhurave sipas dy tabelave.

Pasqyra nr. 3 Plani sipas shkresës datë 23.02.2022 paraqitet si më poshtë:

Plani mujor 2022

Në milion lekë

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
TVSH	9,100	10,000	10,600	10,000	11,122	11,271	11,767	11,610	11,770	11,196	12,821	14,743	136,000
Akciza	3,500	4,000	4,192	4,149	4,814	5,062	5,277	5,866	4,825	4,791	4,579	5,423	56,478
Renta	277	300	230	230	181	280	280	230	240	252	250	250	3,000
Taksë doganore	464	575	500	421	465	680	752	750	700	712	694	795	7,508
Totali	13,341	14,785	15,522	14,800	16,582	17,392	18,076	18,456	17,545	16,951	18,344	21,211	202,988

Progressive

Në milion lekë

Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
TVSH	9,100	19,100	29,700	39,700	50,822	62,093	73,860	85,470	97,240	108,436	121,257	136,000
Akciza	3,500	7,500	11,692	15,841	20,655	25,717	30,884	36,860	41,685	46,476	51,055	56,478
Renta	277	577	807	1,037	1,218	1,498	1,778	2,008	2,248	2,500	2,750	3,000
Taksë doganore	464	1,039	1,539	1,960	2,425	3,105	3,857	4,607	5,307	6,019	6,713	7,509
Totali	13,341	28,216	43,738	58,538	75,120	92,413	110,489	128,945	146,480	163,431	181,755	202,986

Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Sipas kësaj shkrese konstatohen pasaktësi në detajimin e planit mujor, krahasimisht me planin progresiv për zërin e të ardhurave nga taksa doganore, ku konkretisht sipas planit mujor totali për këtë zë rezulton në vlerën 7,508 milion lekë; ndërkohë që sipas planit progresiv në 7,509 milion lekë. Gjithashtu, konstatohet se ekzistojnë diferenca mes totalit të planit të të ardhurave sipas dy tabelave, i cili sipas muajve rezulton në vlerën 202,988 milion lekë; ndërkohë që sipas planit progresiv në 202,986 milion lekë. Shumatorja sipas zërave të të ardhurave e planit, sipas tabelës së planit mujor rezulton 202,986 milion lekë, dhe 202,987 milion lekë sipas planit progresiv.

Në planin e përcjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave të DPD plani fillestar është raportuar në vlerën totale prej 202,986 milion lekë, nga të cilat të ardhurat nga TVSH në vlerën 136,000 milion lekë, të ardhurat nga akciza 56,478 milion lekë, të ardhurat nga taksa doganore 7,508 milion lekë dhe të ardhurat nga renta minerare në vlerën 202,986 milion lekë.

2. Ky plan më pas është rishikuar në zbatim të:

-Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, përcjellë me shkresën nr. 7675, prot datë 26.04.2022 të MFE, prot në DPD nr. 8688, datë 29.04.2022. Sipas kësaj shkrese konstatohen pasaktësi në detajimin e planit mujor, krahasimisht me planin progresiv për zërin e të ardhurave nga taksa doganore, ku konkretisht sipas planit mujor totali për këtë zë rezulton në vlerën 7,507 milion lekë; ndërkohë që sipas planit progresiv në 7,508 milion lekë. Kjo diferencë nuk ka impaktuar planin total të të ardhurave sipas dy tabelave.

- Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, përcjellë me shkresën nr. 15209, prot datë 11.08.2022 të MFE, prot në DPD nr. 14860, datë 12.08.2022. Sipas kësaj shkrese konstatohen pasaktësi në detajimin e planit mujor, krahasimisht me planin progresiv për totalin e të ardhurave, ku sipas planit mujor totali për vitin 2022 paraqitet në vlerën prej 221,001 milion lekë; ndërkohë që plani progresiv në 221,000 milion lekë. Shumatorja e planit sipas llojit të të ardhurave rezulton e njëjtë në të dyja tabelat, konkretisht në vlerën 221,000 milion lekë.

Pasqyra nr. 4- Plani i të ardhurave dhe ndryshimet

Në milion lekë

Të ardhurat doganore sipas llojit	Plani përfundimtar i të ardhurave 2021	Realizimi i të ardhurave 2021	Plani fillestar i vitit 2022 sipas ligjit nr. 115, datë 25.11.2021	Plani i rishikuar sipas Aktit Normativ nr. 3, datë 12.03.2022	Plani i rishikuar sipas Aktit Normativ nr. 12, datë 29.07.2022
TVSH	118,751	131,301	136,000	141,200	153,001
Akcizë	51,400	51,962	56,478	58,478	55,000
Rentë minerare	3,900	2,445	3,000	3,000	4,500
Taksë doganore	7,000	7,458	7,508	7,508	8,499
Total	181,051	193,166	202,986	210,186	221,000

Burimi: DPD

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, niveli i planifikimit është ndryshuar vetëm 3 muaj pas fillimit të vitit 2022, me aktin normativ nr.12.03.2022, situatë kjo që përbën një tregues për mangësitë në procedurat e ndjekura për planifikimin dhe parashikimin e drejtë të ligjit të buxhetit,

duke filluar nga faza e PBA-së, në projekt buxhet dhe për t'u finalizuar më pas me ligjin vjetor, e cila nuk ka mund të parashikojë drejt impaktin e faktorëve të brendshëm, apo atyre të jashtëm.

Nga ana e DPD nuk u vendosën në dispozicion korrespondencat përkatëse që vërtetojnë rolin e institucionit gjatë kësaj vendimmarrje, nëpërmjet propozimeve referuar analizave të kryera nga strukturat përgjegjëse të planifikimit të të ardhurave.

Si rezultat, nuk dokumentohen analizat e kryera nga DPD gjatë planifikimit të të ardhurave doganore (apo edhe gjatë realizimit, trajtuar më poshtë në këtë material) duke konsideruar faktorë të tillë si efektet e paketës fiskale, shkalla e reduktuar e TVSH-së 10 % e furnizimit me inpute bujqësore, apo efekti i ndryshimit të ligjit për akcizën.

KLSH ka evidentuar se plani i të ardhurave për DPD është rishikuar për të ardhurat nga TVSH sipas AN nr.17 date 1.12.2022, duke u planifikuar në vlerën 155.500 milion lekë, nga 153,001 milion lekë që paraqitet sipas DPD. Për rrjedhojë, edhe analizat e kryera nga DPD krahasuar me ato të MFE për nivelin e realizimit të të ardhurave për zërin e TVSH dhe për total të ardhurat nga DPD, paraqiten me diferenca.

Plani përfundimtar i të ardhurave doganore në vitin 2022 sipas DPD, rezulton në vlerën 221,000 milion lekë, ku krahasuar me planin fillestar të të ardhurave nga doganore, rezulton me një rritje në vlerën 18,014 milion lekë, ose në masën 8.8% më shumë, dhe krahasuar me një vit më parë, ky plan rezulton 39,949 milion lekë më shumë, pra me një rritje në masën 22%.

Sipas strukturës së të ardhurave doganore, të ardhurat nga TVSH rezultojnë të kenë shënuar rritjen më të madhe në planifikim cila konsiston në një vlerë absolute prej 34,250 milion lekë më shumë se viti paraardhës (29% më tepër) dhe 17,001 milion lekë më shumë se plani fillestar (13% më tepër); për t'u ndjekur më pas nga të ardhurat nga akciza të cilat krahasuar me vitin 2021 paraqiten në vlerën 3,600 milion lekë më shumë (7%), por krahasimisht me planin fillestar rezultojnë në ulje në masën 3%, ose 1,478 milion lekë më pak. Të ardhurat nga taksa doganore janë rritur në masën 21% ose 1,499 milion lekë më shumë se viti paraardhës, dhe 991 milion lekë më tepër se plani fillestar i të ardhurave (13% më shumë). Të ardhurat nga renta minerare paraqiten me një rritje në masën 15% krahasuar me vitin 2021, ose 600 milion lekë më shumë, dhe 1,500 milion lekë më tepër se plani fillestar (50% më shumë).

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me metodikën e përdorur për planifikimin e të ardhurave të vitit 2022, ku u informuam se ndarja e planit bëhet në bazë të përqindjes që zë secila degë doganore, për secilën taksë, në periudhën paraardhëse progresive. Kjo metodikë mund të korrigjohet nga faktorë të jashtëm, referuar informacioneve që gjenerohen nga burime të tjera (p.sh. informacioni që disponohet se në Degën Doganore Tiranë do të ketë një fluks të shtuar të zhdoganimit të energjisë elektrike, etj). Pra, konstatohet se DPD nuk disponon një metodologji konkrete të miratuar për procedurën që do të ndiqet për planifikimin e të ardhurave. Lidhur me metodikën e përdorur për planifikimin e të ardhurave doganore dhe aplikimin e modelit ekonometrik të 60 mallrave kryesore, u kërkua një informacion më i detajuar nga ana e DPD-së ku konsiston kjo analizë, për të cilin nuk u vendosën në dispozicion analizat/ informacionet/ dokumentacionet përkatëse, duke u kufizuar vetëm me një informacion të përgjithshëm, cituar si më sipër. Duke qenë se përllogaritja konkrete e planit sipas kësaj metodike nuk u vendos në dispozicion, grupi i auditimit e ka të pamundur të vlerësojë nivelin e këtij planifikimi sipas DPD, krahasimisht me planin e buxhetit të miratuar me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2022. Referuar kërkesës së grupit të auditimit për përcjelljen e shkresave për planifikimin dhe detajimin e planit të të ardhurave vjetore të DPD në nivel dege doganore për vitin 2022, nga ana e institucionit u

informuam se ndarja e planit kryhet në bazë të periudhës progresive, për çdo muaj, në mënyrë që të reflektohen edhe faktorë të tjerë që mund të impaktojnë realizimin e planit përgjatë vitit. Pra, konstatohet mungesa e një plani vjetor të detajuar për çdo muaj sipas degën doganore dhe llojit të të ardhurave, objekt zbatimi nga ana e degëve doganore.

Plani i rishikuar vjetor sipas degëve doganore paraqitet si më poshtë, ku shumatorja e planeve mujore paraqitet në shumën 221,000 milion lekë, ku rezulton se nuk ka diferenca mes planin përfundimtar të aktit të fundit normativ për planifikimin e të ardhurave doganore:

Pasqyra nr.5-Plani i rishikuar i të ardhurave sipas degëve doganore dhe llojit të të ardhurave

Në mijë lekë

Dega doganore	Takse doganore	TVSH	Akçize	Renta	Total
Tiranë	4,632,214	63,647,340	17,810,905	238	86,090,697
Rinas	149,550	2,476,508	67,337	0	2,693,395
Durrës	2,250,254	58,283,398	24,584,238	938,469	86,056,359
Shkodër	99,117	3,889,681	235,595	9,135	4,233,528
Pogradec	104,515	1,795,539	83,581	44,247	2,027,881
Gjirokastrë	478,918	6,315,838	8,108,303	3,444	14,906,502
Korçë	14,314	391,189	179,197	1	584,701
Kapshticë	224,131	5,107,137	812,839	491	6,144,598
Vlorë	99,530	3,630,666	2,012,190	3,480,427	9,222,813
Fier	206,090	2,502,591	750,368	587	3,459,636
Sarandë	6,127	285,944	7,964	593	300,628
Elbasan	171,761	1,961,188	243,863	677	2,377,489
Lezhë	26,366	650,090	17,665	1,816	695,936
Berat	26,672	426,919	47,915	3,081	504,588
Kukës	7,578	1,507,666	2,949	16,754	1,534,947
Peshkopi	1,851	127,820	33,222	30	162,923
Tri Urat	12	1,486	1,872	8	3,379
Total	8,498,999	153,001,000	55,000,002	4,499,999	221,000,000

Burimi: DPD

Nga sa më sipër rezulton se Dega e Doganës Tiranë dhe Dega e Doganës Durrës janë degët doganore që planifikohet të realizojnë të ardhurat më të larta në rang sistemi, respektivisht me 86,090 milion lekë dhe 86,056,359 milion lekë, për t'u ndjekur më pas nga Dega Doganore Gjirokastrë me 14,906 milion lekë.

Pasqyra nr. 6- Plani sipas muajve krahasuar me realizimin e vitit 2021

Në milion lekë

Muaji	Realizim 2021	Plan 2022	Diferenca plani i rishikuar 2022 me realizimin e vitit 2021
Janar	11,575	13,396	1,821
Shkurt	12,223	16,173	3,950
Mars	14,478	18,700	4,222
Prill	14,580	17,217	2,637
Maj	15,055	18,303	3,248
Qershor	16,875	19,155	2,280
Korrik	17,160	19,615	2,455
Gusht	17,335	20,784	3,449
Shtator	16,859	19,241	2,382
Tetor	17,951	18,520	569
Nëntor	18,509	18,836	327
Dhjetor	20,567	21,060	493
Totali	193,166	221,000	27,834

Burimi: DPD

Për sa i përket nivelit të planifikimit sipas muajve, krahasimisht me realizimin në të njëjtën periudhë një vit më parë, rezulton se diferenca më të larta konsistojnë në muajin Mars 2022, ku plani rezulton rreth 4,222 milion lekë më tepër se realizimi për këtë muaj në vitin 2022, për t'u ndjekur më pas nga muaji Shkurt me një diferencë 3,950 milion lekë më tepër; Gusht me 3,449 milion lekë më tepër dhe Maj me 3,248 milion lekë më tepër.

Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për vendosjen në dispozicion të raporteve të hartuara nga DPD për realizimin vjetor të të ardhurave, u përcoll memoja e datës 04.01.2023 në version elektronik nga znj. F.M . Sipas kësaj memoje mbi realizimin e të ardhurave, plani i rishikuar në faqen rezulton në vlerën 220,999,236 mijë lekë, ndërkohë që përgjatë pjesës tjetër të materialit, i referohet një niveli planifikimi në vlerën 221,000,000 mijë lekë , pra me një diferencë prej 764,000 lekë. Përgjatë auditimit në terren u kërkua vendosja në dispozicion e planit të të ardhurave dhe realizimit në rang dege doganore sipas llojit, ku totali i planit paraqitet në vlerën 221,000,000 lekë.

Mbi realizimin e të ardhurave doganore

Për sa përket nivelit të realizimit të të ardhurave, situata paraqitet si më poshtë:

Pasqyra nr. 7- Niveli i realizimit të të ardhurave

Në milion lekë

Të ardhurat doganore sipas llojit	Realizimi 2021	Plani dhe realizimi 2022			Realizimi 2022 kundrejt planit		Realizimi 2022 kundrejt vitit 2021	
		Plani fillestar 2022	Plani i rishikuar, përfundimtar 2022	Realizimi 2022	Diferenca mes realizimit dhe planit të rishikuar	% e realizimit mbi planin përfundimtar	Diferenca kundrejt realizimit të vitit 2021	Ndryshimi në %
TVSH	131,301	136,000	153,001	156,898	3,897	103%	25,597	19%
Akcizë	51,962	56,478	55,000	53,781	-1,219	98%	1,819	4%
Rentë minerare	2,445	3,000	4,500	4,198	-302	93%	1,753	72%
Taksë doganore	7,458	7,508	8,499	8,447	-52	99%	989	13%
Total	193,166	202,988	221,000	223,323	2,323	101%	30,157	16%

Burimi: DPD

Niveli i realizimit të vitit 2022 paraqitur në tabelën e mësipërme i referohet evidencës së të ardhurave miratuar nga Dega e Thesarit Tiranë dhe DPD, përcjellë me shkresën nr. 550, prot datë 12.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD. Gjithashtu, me shkresën nr. 1062, prot datë 20.01.2023 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të DPD është përcjellë pranë Ministrisë së Financave i njëjti informacion.

Grupi i auditimit krahasoi evidencat e raportuara në Raportin “Raport mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, kapitulli 3.2.6 “Të ardhurat nga tatimet dhe doganat”, ku konstatohen diferenca. Konkretisht:

Pasqyra nr. 7- Raportin “Raport mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022”, kapitulli 3.2.6 “Të ardhurat nga tatimet dhe doganat”


Tabela 8 Të ardhurat nga tatimet dhe doganat (në milione lekë)

Lloji i Taksave	Fakt 12 mujor 2021	Fakt 12 mujor 2022	Plan Rishikuar 2022	Diferenca (Fakt 2022/Plan 2021)	Ndërgjithësi Faktive % 2022/2021	Diferenca Fakt/Plan Rishikuar 2022	Ndërgjithësi % Fakt/Plan Rishikuar 2022	2022 (plan i rishikuar)	Diferenca Fakt/Plan Rishikuar 2022	Ndërgjithësi % Fakt/Plan Rishikuar 2022
TVSH TOTAL	161,536	191,412	166,061	29,876	18.5%	25,351	15.3%	193,000	-1,588	-0.8%
Të ardhurat nga importi	131,301	156,898	136,000	25,597	19.5%	20,856	15.4%	152,500	1,108	0.9%
Të ardhurat brenda vendit	30,235	34,514	30,061	4,279	14.2%	4,495	14.9%	37,500	-2,986	-8.0%
Rimbursim TVSH	24,182	22,481	18,500	1,621	-6.7%	3,981	21.5%	18,500	3,981	21.5%
Tatimi mbi fitimin	35,610	47,693	35,586	12,073	33.9%	12,097	34.0%	46,000	1,603	3.7%
Akcia	51,637	53,547	56,478	1,910	3.7%	-2,931	-5.2%	55,000	-1,453	-2.6%
Tatimi mbi të ardhurat personale	39,312	44,983	45,161	5,671	14.4%	-178	-0.4%	47,000	-2,017	-4.3%
Taksa nacionale dhe të tjera	42,521	44,821	49,741	2,300	5.4%	-4,920	-9.9%	48,500	-3,679	-7.6%
Taksa nacionale	40,676	40,623	46,740	547	1.4%	-6,117	-13.1%	44,000	-3,377	-7.7%
Renta Minerare	2,445	4,198	3,000	1,253	71.7%	1,198	39.9%	4,500	-302	-6.7%
Taksa Doganore	7,457	8,447	7,509	990	13.3%	938	12.5%	8,500	-53	-0.6%
TOTALI TATIME + DOGANA	338,073	390,893	360,535	52,820	15.6%	30,358	8.4%	398,000	-7,107	-1.8%
Kontributet e mbledhura (DPF)	106,266	118,467	108,100	12,201	11.5%	10,367	9.6%	117,135	1,332	1.8%
TOTALI TATIME + DOGANA (përfshirë kontributet)	444,339	509,360	468,635	65,021	14.6%	40,725	8.7%	515,135	-5,775	-1.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Të ardhurat nga Administrata Doganore për vitin 2022 arritën në 223.1 miliardë lekë, me një realizim në masën 99.8 % të planit të rishikuar, ose 411 milionë lekë më pak. Në krahasim me vitin 2021, performanca ka qenë pozitive me rreth 30.2 miliardë lekë më shumë sesa një vit më parë, me rritje 15.7%. Krahasuar me vitin 2021, paraqiten me rritje Tatimi mbi vlerën e shtuar në import (+19.5%), Akciza (+3.7%), Taksa doganore (+13.3%) dhe Renta minerare (+71.1%). Krahasuar me planin, të gjithë zërat e të ardhurave doganore paraqiten me mbirealizim. Performanca pozitive krahasuar me planin ku vlen të theksohet rritja e volumit të importeve shocëruar me rritjen së çmimeve të mallrave në tregjet ndërkombetare çka ndikon pozitivisht në të ardhura nga veprimtaria doganore.

Grafiku 12 Të ardhurat doganore, rritja vjetore sipas llojit të taksave 2022 - 2021 (në milionë lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023)

Burimi: Raporti i zbatimit të buxhetit të MFE

Grupi i auditimit kërkoi zyrtarisht informacion nga DPD lidhur me **diferencat në të dhënat e raportuara nëpërmjet dy institucioneve, si në planifikim edhe në realizim**, për të cilin deri në fund të auditimit në terren dhe pas dorëzimit të akt konstatimeve nuk u vendosën në dispozicion argumentet përkatëse. I vetmi argument i paraqitur lidhet me diferencat për shkak të mos raportimit të rimbursimit të akcizës, për të cilën nuk u përcollën evidencat mbështetëse që justifikojnë situatën në këtë rast, apo edhe për zëra të tjerë.


Referuar evidencës së konfirmuar mes DPD dhe Degës së Thesarit Tiranë, të ardhurat doganore në vitin 2022, janë realizuar në shumën 223,323 milion lekë, me një tejkalim të tyre në shumën 2.324 milion lekë, kundrejt planit përfundimtar të vitit 2022 (realizimi në masën 101%). Peshën

më të lartë në realizimin e të ardhurave doganore e zënë të ardhurat nga TVSH me 70 %, për t'u ndjekur më pas të ardhurat nga akciza me 24 %, taksa doganore me 4 % dhe renta minerare 2%. Në krahasim me vitin 2021 konstatohet se të ardhurat janë realizuar 30,158 milion lekë më shumë (ritje në masën 16%), ku veçanërisht rritja më e madhe vjen nga të ardhurat e realizuara nga TVSH të cilat rezultojnë 19% më shumë se viti 2021, ose 25,597 milion lekë më shumë.

Realizimi i të ardhurave doganore kundrejt planit të vitit 2022 (223,500 milion lekë), në terma bruto paraqiten në 223,324 milion lekë dhe në terma neto 223,090 milion lekë, të cilat respektivisht rezultojnë 176 milion lekë më pak në terma bruto (99.9%), dhe 410 milion lekë më pak në terma neto (99.8%). Nga realizimi i të ardhurave doganore rezulton se për vitin 2022, të ardhurat nga 60 grup artikujt kryesor përbëjnë 89% të të ardhurave doganore gjithsej, në pothuajse të njëjtat nivele me një vit më parë.

Ecuria e realizimit të planit për periudhën 2021-2022, paraqitet si më poshtë:

Pasqyra nr. 8: Ecuria e realizimit të planit për periudhën 2021-2022



Burimi:DPD

Ndikim më të lartë në realizimin e të ardhurave e zënë 60 artikujt kryesore, të cilët përbëjnë 89.62% të ardhurave doganore, sikundër vërehet në tabelën më poshtë:

Pasqyra nr. 9: Te ardhurat sipas peshës

Në mijë lekë

Viti	Te ardhurat nga 60 produktet kryesore	Te ardhurat ne total DPD	Pesha specifike në % e 60 produkteve
2020	137,756,197	153,627,973	89.67%
2021	173,598,263	193,165,822	89.87%
2022	200,151,066	223,323,498	89.62%

Burimi:DPD

Grupi i auditimit analizoi impaktin që ka pesha specifike e 60 produkteve kryesore në realizimin e të ardhurave, duke krahasuar totalin e të ardhurave të realizuara prej tyre për vitin 2022 në nivel të sasisë krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu, niveli i të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2022 referuar volumit të importeve dhe eksporteve, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Pasqyra nr. 10: Niveli i të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2022 referuar volumit të importeve dhe eksporteve

Në peshë

Në mijë lekë

Muajt	Import Total	Import me TVSH te Përfshuar Makineri dhe Pajisje	Import me TVSH te Përfshuar Barna dhe Ar I pastër	Import me të gjitha Taksat të përfshuara (Proç 42)	Import i Taksuar	Eksport Total	Eksport Definitiv	Rieksport nga Përpunimi Aktiv
Progresive 2020	5,119,481	9,535	11,113	9,216	4,260,424	4,097,494	6,778,150	528,923
Progresive 2021	5,964,438	8,164	15,575	18,188	4,777,662	4,343,123	3,712,962	599,477
Progresive 2022	5,443,739	8,607	9,347	30,818	4,430,270	3,910,651	3,346,721	502,674

Burimi:DPD

Në vlerë

Pasqyra nr. 11: Niveli i të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2022 referuar volumit të importeve dhe eksporteve

Në milion lekë

Muajt	Import Total	Import me TVSH te Përfshuar Makineri dhe Pajisje	Import me TVSH te Përfshuar Barna dhe Ar I pastër	Import me të gjitha Taksat të përfshuara (Proç 42)	Import i Taksuar	Eksport Total	Eksport Definitiv	Rieksport nga Përpunimi Aktiv
Progresive 2020	606,261	10,466	26,252	6,294	479,222	271,912	94,774	173,819
Progresive 2021	802,093	7,843	34,100	14,402	636,021	369,177	151,837	214,218
Progresive 2022	951,810	8,362	30,498	12,713	752,729	497,193	221,350	254,899

Burimi:DPD

Për sa i përket nivelit të realizimit të të ardhurave sipas llojit:

Të ardhurat nga TVSH:

Gjatë vitit 2022, realizimi i të ardhurave nga TVSH paraqitet në shumën 156,898 milion lekë, nga 153,001 milion lekë të planifikuara (realizimi 103%), me një tejkalim në shumën 3,897 milion lekë sipas DPD, dhe 1,398 milion lekë më shumë sipas MFE (realizimi 101%); ose 25,597 milion lekë më shumë se viti paraardhës (rritje në masën 19%), e stimuluar kryesisht sipas analizës së DPD nga:

- 5.3 miliard lekë nga rritja e çmimit të karburantit;
- 5.1 miliard lekë nga rritja e importit të energjisë elektrike;
- 3.7 miliard lekë nga rritja e mallrave të konsumit të përgjithshëm;
- 3.1 miliard lekë nga rritja e importit të metaleve bazë;
- 1.5 miliard lekë nga rritja e importit të gazit të lëngshëm;
- 0.8 miliard lekë nga rritja e importit të cigares etj.

Efekt negativ në realizimin e të ardhurave kanë sjellë auto veturat e përdorura, me një rënie prej 650 milion lekë dhe telefonat celularë me një rënie prej 555 milion lekë.

Të ardhurat nga akciza:

Gjatë vitit 2022, realizimi i të ardhurave nga akciza paraqitet në shumën 53,781 milion lekë, nga 55,000 milion lekë të planifikuara, me një mos realizim në vlerën 1,219 milion lekë, ose me një tejkalim në masën 1,819 milion lekë më shumë se viti paraardhës (4% më tepër). Faktorë në këtë nivel realizimi janë parashtruar rritja e akcizës së cigares me 1.9 miliard lekë dhe konsumit me rreth 191 ton, duke rezultuar në një rritje prej rreth 2.3 miliard lekë; dhe rritja e sasisë së konsumit të gazit me 500 milion lekë më shumë, pijeve alkoolike me 50 milion lekë më shumë, si dhe indeksimi i akcizës me 3.3%. Negativisht në nivelin e realizimit të të ardhurave të akcizës kanë

ndikuar importit i karburantit me 1.2 miliard lekë më pak si pasoje e rënies se konsumit të tij me rreth 57,000 ton, e ndikuar nga situata e luftës në Ukrainë dhe embargos Ruse.

Të ardhurat nga akciza referuar sasisë dhe të ardhurave për njësi paraqiten si më poshtë:

Pasqyra nr. 12: Të ardhurat nga akciza

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	SASI			TE ARDHURAT PER NJESI			AKC		
		Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022
1	Cigare	2,714	2,934	3,147	6,049	6,512	6,788	16,417,206	19,105,374	21,361,676
2	Duhan Importi	92	104	106	5,568	5,747	5,682	512,025	595,115	602,195
3	Duhan Prodhim Vendi	41	54	49	2,995	2,969	3,483	122,621	161,423	170,929
4	Birre Importi	41,988	49,892	51,992	32	33	33	1,360,208	1,622,403	1,721,569
5	Birre Prodhim Vendi	38,826	40,082	40,517	21	15	16	813,870	596,709	643,801
6	Pije Alkoolike Import	889	1,408	1,952	232	209	233	206,560	294,123	454,932
7	Pije Alkoolike Prodhim Vendi	537	771	788	224	233	247	120,328	179,958	194,632
8	Vere Import	4,125	5,562	5,458	55	52	57	224,995	289,546	313,344
9	Vere Prodhim Vendi	928	1,181	1,154	34	34	36	31,414	40,352	41,698
10	Kafe	8,162	8,941	7,649	50	49	55	411,109	441,364	422,066
11	Karburante Import	532,971	610,695	556,653	43	43	44	22,660,603	26,108,417	24,681,231
12	Karburante Prodhim Vendi	13,053	20,179	19,929	37	37	38	482,955	746,640	760,233
13	Gaz i Lëngët	151,912	179,767	178,860	5	4	6	748,057	665,399	1,160,850
14	Goma te reja	7,799	8,678	7,469	20	20	21	155,973	173,551	153,883
15	Bateritë Akumulatorët	3,972	4,269	4,023	19	19	20	76,313	81,582	79,059
16	Vaj Lubrifikant	8,392	8,267	8,777	28	32	30	234,944	263,748	261,143
17	ushqime te përgatitura	77,804	89,048	89,263	0.28	0.33	0.24	22,029	29,150	21,177
18	Kimikatet inorganik kimik	129,837	146,555	128,981	0.06	0.05	0.21	8,110	7,082	26,699
19	Detergjentet; parfumeri	69,037	69,697	63,789	0.16	0.18	0.19	11,368	12,220	12,247
	TOTAL	1,093,079	1,248,084	1,170,555	41	41	45	44,620,687	51,414,157	53,083,365

Burimi:DPD

Të ardhurat nga renta:

Gjatë vitit 2022, realizimi i të ardhurave nga renta paraqitet në shumën 4,198 milion lekë, nga 4,500 milion lekë të planifikuara, me një tejkalim në shumën 302 milion lekë, ose me një tejkalim në masën 1,753 milion lekë më shumë se viti paraardhës (72%), për shkak të efektit të rritjes së çmimit të bursës me 70%, e kuantifikuar në 1.8 miliard lekë më tepër. Sipas DPD, rritja paraqitet në masën 1.1 miliard lekë për naftën bruto dhe 600 milion lekë për mineraret e tjerë, pavarësisht se sipas eksportit rezultojnë të jenë eksportuar 20.000 ton naftë bruto më pak dhe 410,000 ton minerare të tjera më pak. Të ardhurat nga renta referuar sasisë dhe të ardhurave për njësi paraqiten si më poshtë:

Pasqyra nr. 13: Të ardhurat nga renta

Në mijë lekë

Emërtimi	SASI			RENTA			TE ARDHURAT PER NJESI		
	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022	Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Dhjetor 2022
Rente Minerare Naftë Bruto	587,530	617,151	598,235	1,340,824	1,986,540	3,260,444	2.28	3.22	5.45
Rente Minerare Minerale te tjera	2,126,843	2,099,424	1,667,637	431,420	477,877	937,168	0.20	0.23	0.56

Burimi:DPD

Të ardhurat nga taksa doganore:

Gjatë vitit 2022, realizimi i të ardhurave nga taksa doganore paraqitet në shumën 8,447 milion lekë, nga 8,499 milion lekë të planifikuara, me një mos realizim në shumën 52 milion lekë, dhe me një tejkalim në masën 989 milion lekë më shumë se viti paraardhës (13% më tepër), ku si faktorë të rritjes nga ana e DPD paraqitet rritja e importeve nga Kina. Për sa i përket nivelit të realizimit kundrejt planit në degët doganore, situatë paraqitet si më poshtë:

Pasqyra nr. 14: Niveli i realizimit kundrejt planit në degët doganore

Në mijë lekë

Dogana	Plani	Realizimi	Realizimi në %
Tiranë	86,090,697	87,517,424	102
Rinas	2,693,395	2,777,356	103
Durrës	86,056,359	85,762,918	100
Shkodër	4,233,528	4,371,575	103
Pogradec	2,027,881	2,035,815	100
Gjirokastrë	14,906,502	15,254,623	102
Korçë	584,701	596,029	102
Kapshticë	6,144,598	6,280,272	102
Vlorë	9,222,813	9,582,586	104
Fier	3,459,636	3,529,994	102
Sarandë	300,628	280,711	93
Elbasan	2,377,489	2,442,798	103
Lezhë	695,936	653,271	94
Berat	504,588	500,454	99
Kukës	1,534,947	1,574,547	103
Peshkopi	162,923	159,694	98
Tri Urat	3,379	3,431	102
Total	221,000,000	223,323,498	101

Burimi:DPD

Për sa i përket nivelit të realizimit të planit në rang degësh doganore, sipas llojit të të ardhurave, situatë paraqitet si më poshtë:

Pasqyra nr. 15: Niveli i realizimit kundrejt planit në degët doganore

Në mijë lekë

Doganat	TVSH			Akcize			Taksa doganore			Renta		
	Plan	Total	Përqindje	Plan	Total	Përqindje	Plan	Total	Përqindje	Plan	Total	Përqindje
Tiranë	63,647,340	65,665,313	103	17,810,905	17,274,980	97	4,632,214	4,576,912	99	238	219	92
Rinas	2,476,508	2,568,877	104	67,337	54,070	80	149,550	154,405	103	0	4	900
Durrës	58,283,398	59,001,376	101	24,584,238	23,643,062	96	2,250,254	2,206,467	98	938,469	912,013	97
Shkodër	3,889,681	3,999,584	103	235,595	258,390	110	99,117	105,979	107	9,135	7,623	83
Pogradec	1,795,539	1,823,560	102	83,581	85,780	103	104,515	88,248	84	44,247	38,228	86
Gjirokastrë	6,315,838	6,457,156	102	8,108,303	8,303,982	102	478,918	490,350	102	3,444	3,135	91
Korçë	391,189	421,570	108	179,197	158,823	89	14,314	15,636	109	1	-	-
Kapshticë	5,107,137	5,233,031	102	812,839	812,697	100	224,131	233,960	104	491	584	119
Vlorë	3,630,666	4,153,587	114	2,012,190	2,081,378	103	99,530	131,814	132	3,480,427	3,215,807	92
Fier	2,502,591	2,564,540	102	750,368	761,506	101	206,090	203,509	99	587	440	75
Sarandë	285,944	266,637	93	7,964	8,277	104	6,127	5,244	86	593	553	93
Elbasan	1,961,188	2,030,201	104	243,863	251,405	103	171,761	161,125	94	677	68	10
Lezhë	650,090	607,046	93	17,665	8,097	46	26,366	36,720	139	1,816	1,409	78
Berat	426,919	427,596	100	47,915	42,201	88	26,672	27,948	105	3,081	2,708	88
Kukës	1,507,666	1,549,713	103	2,949	3,099	105	7,578	6,920	91	16,754	14,816	88
Peshkopi	127,820	127,871	100	33,222	30,176	91	1,851	1,632	88	30	15	51
Tri Urat	1,486	298	20	1,872	3,122	167	12	10	82	8	-	-
Total	153,001,000	156,897,955	103	55,000,002	53,781,045	98	8,498,999	8,446,877	99	4,499,999	4,197,621	93

Burimi:DPD

Për sa më sipër është përcjellë Projektraporti pranë DPD dhe për këtë çështje Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, znj. F.M me shkresën nr. 283/23 prot., datë 21.08.2023, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Mosrakordimet që përmban tabela mujore me atë progresive janë si rezultat i faktit që detajimi në muaj dhe ndarja në periudhën progresive të çdo takse është bërë në format Excel duke përdorur formulat. Janë pikërisht detajimet mbas presjes dhjetore që rezultojnë nga përdorimi i formulave, ato që sjellin në dukje “gabimet“. Ky fenomen ka ekzistuar në vazhdimësi por nga ana jonë janë bërë rregullimet dhe në fund rezultojnë me të njëjtën shifër me MFE, si në planin sipas muajve ashtu edhe sipas taksave.

							Ne mln leke
Taksa	PLANI FILLESTAR 2022	PLANI I RISHIKUAR	PLANI PERFUNDIMTAR 2022	REALIZIMI 2022	DIFERENCA P/F NE VLERE ABSOLUTE	REALIZIMI NE %	
Takse dogan	7,508	7,508	8,499	8,447	-52	99	
Akcize	56,478	58,478	55,000	53,781	-1,219	98	
Tvsh	136,000	141,200	153,001	156,898	3,897	103	
Renta min.	3,000	3,000	4,500	4,198	-302	93	
Totali	202,986	210,186	221,000	223,323	2,323	101	

Për sa i përket raportimeve tona ato kanë qenë të sakta si për planin ashtu edhe për faktin i cili është i detajuar bruto dhe neto (me dhe pa akcizën e rimbursuar). Për sa i përket rolit të institucionit në procesin e planifikimit të të ardhurave, pjesëmarrja jonë ka qenë prezente nëpërmjet analizës së hollësishme të mundësive për periudhën përkatëse. Modeli ynë ekonometrik i analizës së 60 grupmallrave me ndikim më të madh në realizimin e të ardhurave, zbatohet me sukses dhe me një marzh gabimi minimal për çdo periudhë planifikimi në këto momente nga ana jonë është bërë kjo analizë dhe është paraqitur pranë strukturave që merren me hartimin e politikave fiskale në MFE duke parashtruar dhe ndikimin e faktorëve konkrete, ku megjithatë edhe pse ne kemi ndjekur këtë procedurë, vendimmarrja nuk ka qenë e jona. Bashkëngjitur një model dërguar nga ana jonë në MFE në periudhë planifikimi për parashikimin e pritshmërisë së periudhës së ardhshme në momentin e planifikimit. Për sa i përket mungesës së një metodologjie planifikimi, shprehemi se një dokument i miratuar do të ishte formal dhe nuk do të theksonte diçka të re. Lidhur me mungesën e një plani vjetor të detajuar sipas degëve doganore sipas muajve dhe sipas taksave shprehemi se është e përcaktueshme për faktin se situatat në doganë janë shumë të paqëndrueshme dhe të parashikueshme. Gjatë vitit ka ndryshime situatash dhe politikash lidhur me import eksportet e mallrave të cilat nuk mund të parashikohen që në fillim të vitit. Hartimi i një dokumenti të tillë do të ishte formal dhe precedent për interpretime të ndryshme nga strukturat kontrolluese. Planifikimi i detyrave të çdo dege bëhet në fillim të çdo muaji duke marrë në analizë të gjithë faktorët konkretë. Lidhur me mosrealizimin e të ardhurave nga akciza, renta minerare, taksa doganore sqarojmë se analiza në projektraport është bërë e hollësishme në nivel produkti dhe me ndikim faktorësh. Kjo analizë vazhdon të bëhet e tillë periodikisht mujore dhe progresive. Për sa i përket mangësive dhe nxjerrjes së përgjegjësive procedura vijon në nivel javor në takimet online të titullarit të institucionit me kryetarët e degëve doganore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa i përket shkaqeve të diferencave në raportimet e planit të të ardhurave për shkak të rrumbullakosjeve të formulave të excel, sqarojmë se ky argument nuk ndryshon konstatimin e grupit për diferencat në raportime.

Lidhur me argumentin se komunikimi me MFE për procesin e planifikimit ka qenë nëpërmjet email, sqarojmë se dokumentimi i proceseve të punës është përgjegjësi e strukturave përkatëse, dhe linjat e ndjekura të raportimit, nuk duhet të çenojnë ekzistencën e gjurmëve të auditimit për këto procese, ku hartimi i metodologjisë mund të shërbejë për saktësimin edhe të kësaj shtate nëpërmjet miratimit të hartave të manualeve të punës që do të ndiqet së bashku me rolin dhe përgjegjësitë e strukturave përgjegjëse. Për sa i përket mungesës së planit të të ardhurave për çdo degë doganore, sqarojmë se procesi dinamik i pretenduar në autoritetin doganor, në struktura të ngjashme (ku përmendim për analogji p.sh. autoritetin

tatimor për të cilin hartohen planet në total dhe sipas zërave për çdo DRT) në asnjë rast nuk është vijuar me mos hartimin e planit të ardhurave për njësitë e varësisë/nën juridiksion. Lidhur me arsyet e diferencave për shkak të mos raportimit të rimbursimit të akcizës dhe diferencat në terma bruto dhe neto, sqarojmë se argumenti i sjellë nuk justifikon diferencat në tabelën e raportuar nga MFE për zërat që i përkasin të ardhurave të DPD, me ndryshimet sipas të gjitha AN të dala gjatë vitit 2022 për ndryshimet në planin e të ardhurave. Gjithashtu observacioni nuk u shoqërua me evidenca të plotë pasi materialet e dërguara (me lëndë: mbi pritshmëritë e të ardhurave për vitin 2023; analiza 12 mujore 2022) janë të pa firmosura nga titullari i institucionit dhe të pa protokolluara.

1. Titulli gjetjes: Mangësi të konstatuara gjatë procesit të ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e DPD-së nuk u vendosën në dispozicion korrespondencat përkatëse që vërtetojnë rolin e institucionit gjatë procesit të planifikimit të të ardhurave doganore, nëpërmjet propozimeve referuar analizave të kryera nga strukturat përgjegjëse të institucionit, duke konsideruar faktorë të tillë si efektet e paketës fiskale, shkalla e reduktuar e TVSH-së 10 % e furnizimit me inpute bujqësore apo efekti i ndryshimit të ligjit për akcizën, etj. DPD nuk disponon një metodologji konkrete të miratuar për procedurën që do të ndiqet për planifikimin e të ardhurave doganore, ku ndarja e planit bëhet në bazë të përqindjes që zë secila degë doganore, për secilën taksë, në periudhën paraardhëse progresive, e cila përgjatë vitit mund të korrigojë nga faktorë të jashtëm, referuar informacioneve që gjenerohen nga burime të tjera. Lidhur me metodikën e përdorur për planifikimin e të ardhurave doganore dhe aplikimin e modelit ekonometrik të 60 mallrave kryesore, nuk u vendosën në dispozicion analizat/informacionet/dokumentacionet përkatëse që dokumentojnë konkretisht analizat e kryera, duke u kufizuar vetëm me një informacion të përgjithshëm në bazë të të cilit grupi i auditimit e ka të pamundur të vlerësojë nivelin e planifikimit sipas DPD, krahasimisht me planin e miratuar me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2022.

Situata :

- Nga auditimi konstatohet mungesa e një plani vjetor të detajuar për çdo muaj sipas degëve doganore dhe llojit të të ardhurave, objekt zbatimi nga ana e degëve doganore për vitin 2022, në vijim të planit të miratuar sipas ligjit të buxhetit dhe aktet normative të dala në zbatim të tij. Nga auditimi i kryer lidhur me procesin e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që pritet të gjenerohen, konstatohet se degët doganore nuk përfshihen në këtë vendimmarrje, por plani sipas çdo muaji përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe është pikërisht ky autoritet që kryhen dhe ndjekjen e realizimit. Ky planifikim përcillet elektronikisht dhe pëson ndryshime të shpeshta edhe përgjatë muajit, të cilat ndjekin nivelin e realizimit. Duke qenë se plani mujor pëson ndryshime të shpeshta, ai mbetet një faktor kryesor në finalizimin e realizimit të të ardhurave doganore me mbi realizim apo me realizim të lartë të planit sipas degëve. Si rezultat, mos përcaktimi i planeve për degët doganore, ka shkaktuar që kontributi i tyre në monitorimin e realizimit të të ardhurave, të kufizohet vetëm në paraqitjen e statistikave në nivel tepër sintetik dhe të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizim apo mosrealizim.

Kriteri :

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit”, germa a; Neni 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, pika 2.

Ndikimi/Efekti:

Mangësi në garantimin e realizimit të analizave reale në drejtim të realizimit të të ardhurave kundrejt planit dhe realizimit të të ardhurave në nivel dege (plan/fakt), në kushtet kur nuk është hartuar një plan vjetor në nivel dege, dhe nuk dokumentohen analizat e kryera për përcaktimin e planit.

Shkaku:	Qëndrimi i DPD se një dokument të miratuar në lidhje me metodikën që aplikohet për planifikimin e të ardhurave, strukturat, afatet dhe procesin e shqyrtimit të planit të propozuar, si dhe dërgimin e këtij propozimi në MFE është i panevojshëm, dhe mos përcaktimi i planeve sipas degëve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i DPD, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, të marrë masat për hartimin e një dokumenti që të shërbejë si metodologji për hartimin e planit të të ardhurave doganore dhe monitorimit të realizimit të tyre në rang degësh doganore, duke përfshirë në këtë dokument çështje si harta e procesit të punës, strukturat pjesëmarrëse, afatet, metodika e informacionit, faktorët e riskut, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit të të ardhurave doganore, duke u finalizuar me një produkt real të planit dhe që përfaqëson objektivat institucionale.
2. Titulli gjetjes:	<p>Mos realizimi i disa prej zërave të të ardhurave doganore si të ardhurat nga akciza, renta minerare, taksa doganore.</p> <p>Realizimi i të ardhurave doganore kundrejt planit të vitit 2022 (223,500 milion lekë), në terma bruto paraqiten në 223,324 milion lekë dhe në terma neto 223,090 milion lekë, të cilat respektivisht rezultojnë 176 milion lekë më pak në terma bruto (99.9%), dhe 410 milion lekë më pak në terma neto (99.8%).</p> <p>Nga auditimi konstatohet se plani i të ardhurave për DPD është rishikuar për të ardhurat nga TVSH sipas AN nr.17 date 1.12.2022, duke u planifikuar në vlerën 155.500 milion lekë, nga 153,001 milion lekë që paraqitet sipas DPD. Për rrjedhojë, edhe analizat e kryera nga DPD krahasuar me ato të MFE për nivelin e realizimit të të ardhurave për zërin e TVSH dhe për total të ardhurat nga DPD, paraqiten me diferenca.</p> <p>Realizimi në masën mbi 99% i të ardhurave doganore është shkaktuar kryesisht nga rritja e importeve dhe rritja e të ardhurave për njësi për të cilat ka ndikuar rritja e çmimit të importit të këtyre artikujve. Të ardhurat doganore sipas llojit në të gjitha zërat e tjerë me përjashtim të TVSH-së në import, rezultojnë me mos realizim, ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga akciza, renta minerare dhe taksa doganore, ku konkretisht:</p>
Situata:	<p>-Të ardhurat nga akciza, e cila është dhe kontribuesi i dytë kryesor në të ardhurat doganore janë realizuar në terma bruto në shumën 53,781 milion lekë, dhe të ardhurat neto nga akciza rezultojnë me një realizim 53,547 milion lekë. Vlera e rimbursimit rezulton 234 milion lekë, nga 325 milion lekë që rezultonte një vit më parë (91 milion lekë më pak). Krahasuar me 55,000 milion lekë të planifikuara, të ardhurat neto nga akciza paraqiten me një mos realizim në vlerën 2,931 milion lekë, me një mos realizim në vlerën 1,219 milion lekë, ose me një tejkalim në masën 1,910 milion lekë më shumë se viti paraardhës (4% më tepër). Negativisht në nivelin e realizimit të të ardhurave të akcizës sipas analizës së DPD kanë ndikuar importit i karburantit me 1.2 miliard lekë më pak, si pasoje e rënies së konsumit të tij me rreth 57,000 ton, e ndikuar nga situata e luftës në Ukrainë dhe embargos Ruse.</p> <p>-Të ardhurat nga renta minerare janë realizuar në shumën 4,198 milion lekë, ose në masën 93 % të planit, me një mosrealizim në shumën 302 milion lekë; ndërsa krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 1,753 milion lekë më shumë.</p> <p>-Të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në shumën 8,447 milion lekë, ose në masën 99 % të planit, me një mosrealizim në shumën 52 milion lekë; ndërsa krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 989 milion lekë më shumë.</p> <p>Për mos realizimin e të ardhurave nga renta minerare dhe taksa doganore në raportet e DPD, nuk rezultojnë të jenë kryer analiza në këtë drejtim, pasi raportet e ecurisë së</p>

realizimit të të ardhurave doganore konstatohet se është bazuar kryesisht në analiza krahasimore me periudhën një vit më parë, dhe jo me planin e të ardhurave doganore.

Nga auditimi u konstatuan diferenca mes planit mujor dhe progresiv të të ardhurave doganore të përcjella sipas shkresave hartuar nga MFE, krahasimisht me planin e raportuar nga DPD, shkaktuar kryesisht si rrjedhojë e pasaktësive në detajimin e këtyre vlerave në njësinë “mijë lekë”. Gjithashtu, konstatohet se evidencat e paraqitura nga DPD nuk paraqesin të dhëna lidhur me realizimin e të ardhurave pa përfshirë rimbursimin e akcizës. Si rezultat, konstatohen diferenca mes të ardhurave të raportuara nga MFE lidhur me zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022 në të cilin paraqiten të ardhurat doganore dhe tatimore, që konsistojnë në diferenca si në realizimin e të ardhurave bruto, ashtu edhe në disa zëra tjerë, impaktuar sërish kryesisht nga detajimi i evidencave, apo mos reflektim në plan të të gjitha ndryshimeve me akte normative. Ligji nr.115, datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Akti Normativ nr. 3, datë 12.03.2022, Akti Normativ nr. 12, datë 29.07.2022, AN nr.17 date 1.12.2022.

Kriteri :

Ndikimi/Efekti:

Shkaku:

Rëndësia:

Rekomandimi

Risku për cënimin e arritjes së objektivave institucional, ku një ndër to është dhe realizimi i të ardhurave doganore; Konfuzion lidhur me të dhënat e sakta të përcaktuara si në planifikim dhe realizim të të ardhurave doganore nga DPD dhe MFE.

Performancë e ulët e realizimit të disa prej zërave të të ardhurave si akciza, renta dhe taksa doganore; Mangësi në përlllogaritjet e kryera gjatë dërgimit të planit sipas zërave nga MFE, dhe raportimit të tyre.

E lartë

Titullari i DPD, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, të marrë masat për analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mos realizimin e planit të të ardhurave doganore sipas zërave, referuar degëve doganore që operojnë nën juridiksionin e DPD, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse për situatën, në funksion të arritjes së objektivave institucional, si dhe duke garantuar një raportim mbi realizimin e të ardhurave të harmonizuar me modelin e MFE, në mënyrë që të evidentohet qartazi rimbursimi i akcizës apo zërave të tjerë që mund të përbëjnë shkak për diferenca në raportimet mes dy institucioneve si në fazën e planifikimit ashtu edhe realizimit.

2.3. Auditimi i borxhit doganor, gjendja dhe masat e marra për rikuperimin e tij për periudhën nën auditim

Për trajtimin këtij drejtimi të auditimit u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacionet:

-Evidenca të Borxhit Doganor, për gjithë periudhën 2022;

-Vendimet e ekzekutimit të BD, për periudhën 2022;

-Vendimet dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga DPD për vjeljen e BD.

a. Gjendja e detyrimeve të subjekteve debitorë, krijimi i detyrimeve, gjendja në fillim dhe në fund.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), në fund të vitit 2022, rezulton një nivel borxhi doganor në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste, të cilat analizohen si më poshtë:

Pasqyra nr. 16: Borxhi doganor (Detyrim/gjoha/interesa) 2018-2022 sipas Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave në DPD

Në mijë lekë


Periudha	Raste	Totali	Shtesa/Pakësime (vlerë absolute)	Ne %
2018	4,520	27,596,148	3,649,549	
2019	4,364	41,972,864	14,376,716	34.25
2020	4,708	45,053,939	3,081,074	6.84
2021	4,688	45,711,587	657,648	1.44
2022	4,858	46,690,911	979,324	2.14

Burimi: Të dhëna të DPD të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Nga tabela e mësipërme rezulton se borxhi doganor në fund të vitit 2022 krahasuar me vitin 2021, ka pësuar një rritje prej 979,324 mijë lekë ose me 2,14 %.

Nga auditimi konstatohet një borxh doganor më i madh prej 3,101 mijë lekësh nga borxhi i raportuar nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave (46,687,810 mijë lekë) si rezultat i raportimit të gabuar nga ana e Degës Doganore Rinas për vlerën e mësipërme për shkak të pagimit të kësaj vlerë në muajin Janar të vitit 2023(dhe raportimit si të paguar në vitin 2022).Nga auditimi konstatohet se në këtë rast raportimi i nivelit të borxhit doganor nga ana e degëve doganore nuk është verifikuar për saktësinë e tij nga ana e drejtorisë së planifikimit dhe analizimit të të ardhurave.

Në mënyrë grafike më poshtë do të paraqitet ecuria e borxhit doganor në 6 (gjashtë) vitet e fundit. Grafiku nr. 1 Ecuria e borxhit 2016-2022



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Nisur nga të dhënat e mësipërme rritja më e madhe e borxhit doganor ka ndodhur në vitin ushtrimor 2019, ku rezulton se është rritur në shumën 14,376,716 mijë lekë ose 34,25% krahasuar me vitin 2018. Kjo rritje e konsiderueshme e borxhit doganor në vitin 2019 ka ardhur si rezultat i transferimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), në zbatim të Udhëzimit të MFE-së nr.9, datë 11.03.2019 “Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet e akcizës të cilat rezultojnë me detyrime të papaguara” në vlerën 13,274,570 mijë lekë ose në masën 28,4 % krahasuar me totalin e borxhit doganor në fund të vitit 2022.

Pasqyra nr. 17: Borxhi doganor (detyrim/gjoha/interesa) i klasifikuar sipas degëve doganore

Në mijë lekë


Dega Doganore	Nr. Raste Debitorë	Totali I detyrimeve	Ne % mbi totalin
TIRANE	1,982	18,368,661	39.34
RINAS	18	11,776	0.02
DURRES	979	7,307,067	15.65
SHKODER	142	448,876	0.96
POGRADEC	25	83,783	0.18
KAKAVIJE	275	410,475	0.88
KORCE	133	504,815	1.08
KAPSHTICE	125	97,714	0.21
VLORE	277	725,029	1.55
FIER	294	14,718,396	31.53

SARANDE	90	212,349	0.45
ELBASAN	90	318,352	0.68
LEZHE	88	1,900,121	4.07
BERAT	66	1,293,677	2.77
KUKES	76	94,115	0.20
PESHKOPI	28	123,991	0.27
TRE URAT	169	71,714	0.15
TOTALI	4,858	46,690,911	100.00

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nisur nga të dhënat e tabelës më sipër, rezulton se pesha kryesore të stokut të borxhit doganor në 31 dhjetor 2022, paraqitet në Degën Doganore Tiranë në masën 39.34%, Dega Doganore Fier në masën 31.53%, Dega Doganore Durrës në masën 15.65%, DD Lezhë në masën 4.07%, DD Berat në masën 2.77%, DD Vlorë në masën 1.53%.

Në mënyrë grafike më poshtë do të paraqitet borxhit doganor i klasifikuar sipas Degëve Doganore. Grafiku nr. 2 "Ecuria e borxhit 2016-2022"



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Nga auditimi rezulton se për 3 (tre) Degët Doganore (Tiranë, Fier dhe Durrës), stoku i borxhit është në vlerën **40,394,124 mijë lekë** ose në masën **86,52% e totalit**. Për rrjedhojë risku i rekuperimit të borxhit doganor paraqitet më i lartë për këto 3 (tre) Degë Doganore më sipër të specifikuar.

Pasqyra nr. 18: Shtesa dhe pakësime të borxhit doganor gjatë vitit 2022 sipas Degëve Doganore

Në mijë lekë

D. Doganore	Debitorë nga fillimi vitit 2022		Debitorë shtesë viti 2022		Debitorë të shlyer 2022		Debitorë në fund 2022	
	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë	Raste	Vlerë
Tiranë	1,891	18,143,822	1,205	437,846	1,114	213,008	1,982	18,368,661
Rinas	14	8,508	79	9,700	75	6,432	19	11,776
Durrës	947	7,187,459	1,363	254,879	1,331	135,271	979	7,307,067
Shkodër	143	426,236	51	27,532	52	4,892	142	448,876
Pogradec	23	13,558	34	71,615	32	1,389	25	83,783
Kakavijë	261	401,791	72	14,362	58	5,678	275	410,475
Korçë	112	497,308	76	16,209	55	8,701	133	504,815
Kapshticë	121	89,727	228	32,135	224	24,147	125	97,714
Vlorë	275	718,344	200	20,343	198	13,657	277	725,029
Fier	300	14,299,802	87	466,809	93	48,215	294	14,718,396
Sarandë	80	189,365	57	25,330	47	2,345	90	212,349
Elbasan	100	312,408	68	18,021	78	12,077	90	318,352
Lezhë	95	1,884,246	57	17,439	64	1,564	88	1,900,121
Berat	59	1,256,067	62	42,591	55	4,981	66	1,293,677
Kukës	72	92,665	31	2,520	27	1,070	76	94,115
Peshkopi	31	124,755	29	1,399	32	2,163	28	123,991
Tre Urat	164	65,528	12	10,342	7	4,156	169	71,714
Totali	4,688	45,711,587	3,711	1,469,071	3,543	489,746	4,858	46,690,911

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nisur nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër rezulton se gjatë vitit 2022, kemi një shtesë

të rasteve të debitorëve në numër prej 3,711 raste dhe vlerë 1,469,071 mijë lekë, si dhe pakësim të debitorëve në numër 3,543 raste dhe në vlerë 489,746 mijë lekë. Për rrjedhojë konstatohet se vazhdon të paraqitet një trend rritës i numrit të debitorëve nga viti 2022 krahasuar me vitin 2021 në shumën 979,324 mijë lekë. Kryesisht rritjen më të madhe të debitorëve paraqitet në Degën Doganore Tiranë në shumën 224,838 mijë lekë ose 23%, DD Durrës në shumën 119,608 mijë lekë ose 12.2% dhe DD Fier në shumën 418,594 mijë lekë ose 42.9%.

Në lidhje me pakësimin e borxhit doganor përgjatë vitit 2022 nga shlyerja e detyrimit nga subjektet rezulton të jetë në shumën 492,847 mijë lekë ose 1% e totalit të borxhit. Për rrjedhojë kjo tregon një situatë të dështuar në rikuperimin e stokut të borxhit të krijuar gjatë viteve.

Pasqyra nr. 19: Borxhi Doganor i ndarë sipas zërave

Në mijë lekë

DEGA	Numër Rastesh	Detyrime Doganore	Penalitetet	Kamate Vonesa	Total Borxhi
TIRANE	1,982	5,136,755	10,269,413	2,962,494	18,368,661
RINAS	19	2,504	8,549	724	11,776
DURRES	979	1,414,034	4,723,556	1,169,477	7,307,067
SHKODER	142	72,289	262,506	114,081	448,876
POGRADEDEC	25	70,865	9,172	3,746	83,783
KAKAVIJE	275	136,947	149,574	123,954	410,475
KORCE	133	192,375	172,703	139,736	504,815
KAPSHTICE	125	32,401	50,697	14,616	97,714
VLORE	277	197,458	428,782	98,790	725,029
FIER	294	4,870,693	7,989,568	1,858,134	14,718,396
SARANDE	90	59,755	108,774	43,820	212,349
ELBASAN	90	28,129	204,010	86,213	318,352
LEZHE	88	470,058	932,676	497,386	1,900,121
BERAT	66	263,253	747,228	283,196	1,293,677
KUKES	76	34,320	34,728	25,067	94,115
PESHKOPI	28	19,412	66,138	38,442	123,991
TRE URAT	169	13,139	53,867	4,708	71,714
TOTALI	4,858	13,014,386	26,211,941	7,464,584	46,690,911

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nisur nga të dhënat e tabelës më sipër, rezulton se në klasifikimin e borxhit sipas zërave peshën më të madhe specifike paraqitet nga penalitetet në shumën 26,211,941 mijë lekë ose 56.2% e totalit të borxhit, detyrimet doganore në masën 27.8% dhe kamatëvonesat në masën 16% në raport me totalin e borxhit në fund të vitit 2022.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të monitorimit të borxhin nuk ekziston një databazë e cila evidenton strukturën e borxhit doganor të ndarë sipas zërave (TVSH, Akcizë, Rentë Minerare etj).

Pasqyra nr. 20: Performimi sipas degëve doganore, niveli i detyrimeve në raport me të ardhurat për vitin 2022

Në mijë lekë

Dega Doganore	Detyrime te papaguara	Te ardhura për vitin 2022	Ne %
TIRANE	18,368,661	87,517,424	20.99
RINAS	11,776	2,777,356	0.41
DURRES	7,307,067	85,762,918	8.52
SHKODER	448,876	4,371,575	10.27
POGRADEDEC	83,783	2,035,815	4.12
KAKAVIJE	410,475	15,254,623	2.69
KORCE	504,815	596,029	84.70
KAPSHTICE	97,714	6,280,272	1.56
VLORE	725,029	9,582,586	7.57
FIER	14,718,396	3,529,994	416.95
SARANDE	212,349	280,711	75.65
ELBASAN	318,352	2,442,798	13.03
LEZHE	1,900,121	653,271	290.86

BERAT	1,293,677	500,454	258.50
KUKES	94,115	1,574,547	5.98
PESHKOPI	123,991	159,694	77.64
TRE URAT	71,714	3,431	2,090.44
TOTALI	46,690,911	223,323,498	20.91

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga verifikimi i të dhënave, rezulton se borxhi doganor në total krahasuar me të ardhurat e vitit 2022 është në masën 20%. Degët Doganore të cilat paraqesin raportin më të ulët të borxhit krahasuar me të ardhurat janë Degët Doganore Rinas me 0.3%, DD Pogradec me 4%, DD Kapshticë me 1.5%.

Për 3 (tre) Degët Doganore (Tiranë, Fier dhe Durrës), të cilat përbëjnë 78.1% të totalit të stokut të borxhit, situata për DD Tiranë rezulton se raporti i borxhit me të ardhurat e vitit 2022 janë në masën 20.99%, për DD Durrës rezulton në masën 8.52% dhe për DD Fier rezulton në masën 516.95%. Situata kjo që tregon një dështim të tre Degëve Doganore në rikuperimin e borxhit dhe një performim jo të mirë gjatë vitit 2022.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 11.03.2019 “Mbi modalitetet e transferimit pranë Administratës Doganore të të dhënave për subjektet të cilat rezultojnë me detyrime të papaguar”, nga ana e DPT (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) janë transferuar në DPD gjatë vitit 2019 (sipas aneksit 3.1), 47 subjekte debitorë në shumën 13,274,569,648 lekë ose në masën 28.4% krahasuar me totalin e stokut të borxhit doganor në fund të vitit 2022. Nga lista e 47 subjekteve debitorë të transferuara nga DPT në DPD në vitin 2019 vlera prej 13,274,569,648 lekësh përbëhet nga 3,931,649,726 lekë që janë detyrim doganore ose sa 29.6% e borxhit, 7,308,675,173 lekë janë penalitete ose sa 55% e totalit dhe 2,034,244,749 lekë janë kamatëvonesa ose sa 15.4% e totalit.

Nga verifikimi i të dhënave rezulton se subjekti “A” ka detyrimin më të madh në shumën 12,009,711,256 lekë ose në masën 90% e totalit të detyrimeve të transferuara nga DPT në DPD gjatë vitit 2019. Ky detyrim i subjektit për vitin 2022 ka arritur në vlerën 12,215,283,950 lekë dhe rezulton të jetë akoma në fazën proces gjyqësor, dhe nuk ka urdhër ekzekutimi për rikuperimin me forcë nga Autoritetet Doganore.

Referuar subjekteve që u është transferuar borxhi nga DPT në zbatim të Udhëzimit të MFE nr.9 datë 11.03.2019, konstatohet se me 31.12.2022 rezultojnë 31 subjekte (sipas aneksit 3.2) debitorë në shumën 13,514,572,860 lekë ose në masën 29% krahasuar me totalin e stokut të borxhit doganor në fund të vitit 2022. Nga lista e 31 subjekteve debitorë të transferuara nga DPT në DPD në vitin 2019 vlera prej 13,514,572,860 lekësh përbëhet nga 3,927,930,007 lekë që janë detyrim doganore ose sa 29% e borxhit, 7,307,977,507 lekë janë penalitete ose sa 54% e totalit dhe 2,278,665,346 lekë janë kamatëvonesa ose sa 17% e totalit.

Nga verifikimi konstatohet se nga momenti i transferimit të borxhit është ulur me 16 numri i subjekteve debitorë, duke shkuar në 31 nga 47 por është shtuar me 240,003,212 lekë kryesisht për shkak të rritjes së kamatëvonesave. Gjithashtu referuar subjekteve të sipërcituara borxhi doganor është rritur në vlerën 240,003,212 lekë, kjo kryesisht për shkak të rritjes së kamatëvonesave.

b. Strukturat konstatuese të detyrimeve, vjetërsia e borxhit, pesha specifike në total.

Pasqyra nr. 21: Vjetërsia e borxhit sipas periudhave

Në mijë lekë

Vitet	Nr.	Vlere	% ndaj totalit
2002	1	21,424	0.05
2010	14	492,472	1.05
2011	299	1,447,794	3.10
2012	224	1,039,752	2.23

2013	310	5,180,957	11.10
2014	383	3,288,545	7.04
2015	690	8,917,336	19.10
2016	454	3,275,898	7.02
2017	382	1,146,324	2.46
2018	287	3,704,979	7.94
2019	409	14,241,728	30.50
2020	439	3,009,461	6.45
2021	275	472,828	1.01
2022	691	451,413	0.96
Totali	4,858	46,690,911	100.00

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nisur nga të dhënat e paraqitur në tabelën më sipër rezulton se peshën më të madhe specifike për vitet e krijimit të borxhit paraqitet në vitin 2019 në masën 30.5% dhe borxhi i krijuar në vitin 2015 në masën 19.1%.

Borxhi i krijuar përgjatë vitit ushtrimor 2022, paraqitet në shumën 451,413 mijë lekë ose 1% e totalit dhe në numër prej 691 raste.

Këto detyrime sipas degëve doganore paraqiten si më poshtë:

Pasqyra nr. 22: Burimi sipas degëve doganore

Në mijë lekë

Dega	Nr. Raste	Totali i Detyrimeve	% Ndaj Totalit
Tiranë	371	116,071	25.89
Rinas	6	3,301	0.07
Durrës	156	30,114	6.71
Shkodër	8	16,188	3.6
Pogradec	2	70,035	15.6
Kakavije	22	4,080	0.91
Korçë	26	6,337	1.41
Kapshticë	15	14,427	3.22
Vlorë	29	7,831	1.75
Fier	13	115,853	25.84
Sarandë	12	21,444	4.78
Elbasan	8	4,629	1.03
Lezhë	1	852	0.19
Berat	9	30,487	6.80
Kukës	4	366	0.08
Peshkopi	-	-	0.00
Tre Urat	9	9,398	2.10
Totali	691	451,413	100.00

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Pasqyra nr. 23: Borxhi Doganor i konstatuar sipas strukturave për vitin 2022


Në mijë lekë

Organi Konstatues	Numër Raste	Shuma e Borxhit	% Ndaj Totalit
DOH	48	104,994	23.12
KLSH	107	13,359	2.98
Degët Doganore	387	235,312	52.10
Auditi dhe te Tjera	139	90,953	20.29
Dep.Akcizes	10	6,795	1.52
Totali	691	451,413	100

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga verifikimi rezulton se për vitin 2022, borxhi i konstatuar nga Degët Doganore përbën peshën më të lartë specifike në masën 52,1% ndaj totalit, dhe në shumën 235,312 mijë lekë.

Në mënyrë grafike paraqitja e borxhit bazuar në vitin e krijimit
Grafiku 4: Borxhi sipas krijimit



Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga sa më sipër konstatohet se një rritje e konsiderueshme e borxhit doganor rezulton në vitin 2019, si shkak i transferimit të borxhit nga ana e DPT-së. Për periudhën pasuese niveli i borxhit rezulton me një rritje konstante në thuajse të njëjtat nivele për vitin 2021 dhe 2022.

Pasqyra nr. 24: Vjetërsia e BD në Dhjetor 2022

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Raste	Vlerë (mijë lekë)	Në %
1	1 vit	691	451,413	0.96%
2	2 vjet	275	472,828	1.01%
	3 vjet	439	3,009,461	6.44%
3	4 vjet	409	14,241,728	30.44%
4	Mbi 5vjet	3,044	28,515,481	61.07%
5	Gjithsej	4,858	46,690,911	

Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër konstatohet se mosha e borxhit mbi 5 vjet nga momenti i lindjes së detyrimit është në vlerën 28,515,481 mijë lekë ose në masën 61% mbi totalin e stokut të detyrimeve, për rrjedhojë duke qenë se më shumë se gjysma e borxhit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet tregon një situatë shqetësuese mbi mënyrën e rekuperimit me forcë të borxhit doganor nga ana e strukturave të doganës.

C. Masat e marra për vjeljen dhe rikuperimin e borxhit doganor.

Fazat e ndërmarra nga DPD, për rikuperimin e Borxhit Doganor, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Pasqyra nr. 25: Fazat për rikuperimin e borxhit doganor

Në mijë lekë

Te dhënat sipas statusit	Borxhe deri me 31 dhjetor 2022	
	Raste	Vlere
Urdhër Ekzekutimi	2,513	27,370,418
Proces gjyqësor	482	18,083,553
detyrime te papaguara ne ndjekje	1,863	1,236,940
Totali	4,858	46,690,911

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga sa më sipër rezulton se nga totali i borxhit për vitin 2022 prej 46,690 milion lekë për 4,858 raste, rezulton se 2,513 prej tyre (27,370 milion lekë) janë me urdhër ekzekutimi; 482 raste janë në proces gjyqësor (18,083 milion lekë) dhe 1,863 raste (1,236 milion lekë) detyrime të papaguara në ndjekje.

DEGA	Detyrime totale me Urdhër Ekzekutimi		Detyrime totale pa Urdhër Ekzekutimi			
	Raste	Shume	Ne proces gjyqësor		Ne procedure	
			Raste	Shume	Raste	Shume
TIRANE	423	4,114,342	298	13,649,269	1,261	605,050
RINAS	9	7,484		0	10	4,293
DURRES	836	7,217,386	5	70,819	138	18,862
SHKODER	105	412,366	9	9,562	28	26,948
POGRADEC	24	13,783		0	1	70,000
KAKAVIJE	171	347,669	29	28,008	75	34,798
KORCE	107	378,286	1	122,939	25	3,590
KAPSHTICE	119	95,585		0	6	2,129
VLORE	216	705,648	42	12,450	19	6,931
FIER	160	10,440,812	19	3,915,571	115	362,013
SARANDE	60	188,830	12	13,924	18	9,595
ELBASAN	42	82,026	5	212,283	43	24,043
LEZHE	33	1,848,754	6	14,903	49	36,463
BERAT	57	1,287,681	2	137	7	5,859
KUKES	43	85,499		0	33	8,616
PESHKOPI	28	123,991		0	0	0
TRE URAT	80	20,276	54	33,688	35	17,751
TOTALI	2,513	27,370,418	482	18,083,553	1,863	1,236,940

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Referuar të dhënave në tabelat e mësipërme rezultojn se për detyrime të papaguara për të cilat janë lëshuar Urdhëra Ekzekutimi paraqiten për 2,513 raste me vlerë 27,370,418 mijë lekë ose në masën 58.6% e totalit të borxhit doganor, ku pjesën më të lartë e kanë Degët Doganore Tiranë, Durrës dhe Fier.

Detyrime të papaguara në proces gjyqësor për 482 raste paraqiten me vlerë të lartë përkatësisht 18,083,553 mijë lekë ose 38,7% e totalit të stokut, peshën kryesore të këtyre detyrimeve e paraqet Dega Doganore Tiranë në masën 75,5%.

Detyrime të papaguara në ndjekje të procedurave rezultojn të kenë një numër të lartë rastesh përkatësisht 1,863 në vlerë 1,236,940, mijë lekë, janë në proces të plotësimit të procedurave për rikuperimin me forcë të borxhit. Peshën më të madhe e ka Dega Doganore Tiranë, për rrjedhojë situatë që tregon mos plotësimin e procedurave të ndjekjes së borxhit në kohë dhe punën e pamjaftueshme të specialistëve të borxhit pranë Degëve Doganore.

Nga informacioni i paraqitur nga DPD, rezultojn se volumi i punës për Degën Doganore Fier është i pamundur të përballohet pasi nuk është plotësuar struktura organike, kjo një situatë e përsëritur ndër vite në këtë degë doganore.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të monitorimit të borxhit nuk ekziston një databazë e numrit të proceseve gjyqësore (numër rastesh dhe vlerë) të zhvilluara apo të fituara për rikuperimin e borxhit në vitin 2022.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e sektorit të monitorimit të borxhit nuk ekziston një databazë e cila evidenton numrin e subjekteve që kanë detyrime doganore të cilët rezultojnë aktivë, pasivë apo të çregjistruar në QKB.

Hapat për vjeljen e borxhit përfshijnë fillimisht prekjen e gjendjes kreditore të subjekteve; garancitë e vendosura; shlyerja vullnetare, ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor, ekzekutimi me forcë, "Sekuestro konservative"; titull ekzekutiv; bllokimi i llogarive deri në ekzekutim të detyrueshëm, sekuestros ekzekutive dhe ekzekutimi i saj nga autoriteti doganor.

Nga informacioni i kërkuar, është konstatuar se, nga Degët Doganore në lidhje me ekzekutimin e titujve ekzekutive për rikuperimin me forcë të borxhit doganor/akcizës, janë lidhur kontrata

shërbimi me Shërbimin Gjyqësor Përmbartimor (shtetëror dhe privat).

Në kontratat e shërbimit të lidhura midis SHPP dhe Kreditorit “Degët Doganore”, janë përcaktuar detyrimet e SHPP, ku ndër të tjera është cilësuar se:

‘Të kryejë në favor të kreditorit, të gjitha veprimet e duhura ligjore, për ekzekutimin e titullit ekzekutiv; Të informojë kreditorin, për të gjitha veprimet e kryera dhe në rast se i kërkohet të japë informacion me shkrim, lidhur me statusin aktual të ekzekutimit të titullit ekzekutiv’.

Nga auditimi, ka rezultuar se përgjithësisht nuk ka dokumentacion mbi veprimet e kryera nga SHPP, si dhe nuk ka informacion me shkrim në lidhje me veprimet e kryera dhe statusin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

Ky veprim është në kundërshtim me, kushtet e kontratës së shërbimit dhe me udhëzimet përkatëse “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor dhe të akcizës”, në të cilin përcaktohet se është detyrim i administratës doganore (DD dhe DPD), rikuperimi i detyrimeve të papaguara nga ana e subjekteve, pavarësisht formave dhe mënyrave që ndjekin në lidhje me realizimin e hapave për rikuperimin e tij. Nga auditimi konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion nga DPD përse i përket situatës së debitorëve me datë 31.12.2022 rezultojnë 2,409 kontrata shërbimi me SHPP në të cilat nuk ka informacion mbi veprimet e kryera dhe situatën e debitorëve, ku vetëm përgjatë vitit 2022 janë lidhur 164 të tilla për një vlerë detyrimesh në total prej 1,389,719 mijë lekësh.

Nga auditimi konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion nga DPD përse i përket situatës së debitorëve me datë 31.12.2022 rezultojnë 3,890 vendime të Rikuperimit të Borxhit me Forcë (nga të cilat 346 gjatë vitit 2022 për një vlerë detyrimesh në total prej 163,927 mijë lekë,) për të cilat është bërë njoftim për 2,870 raste. Rastet kur njoftimi nuk është bërë i mundur ka ardhur si pasojë e kthimit të zarfit të njoftimit.

Nga auditimi konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion nga DPD përse i përket situatës së debitorëve me datë 31.12.2022 rezultojnë 1,724 njoftime dërguar bankave të nivelit të dytë për Rikuperimin e Borxhit me Forcë ndaj debitorëve (nga të cilat 73 gjatë vitit 2022 për një vlerë detyrimesh në total prej 49,397 mijë lekë) në databazën e vendosur në dispozicion nuk evidentohen rezultatet konkrete të këtyre njoftimeve.

Nga auditimi konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion nga DPD përse i përket situatës së debitorëve me datë 31.12.2022 rezultojnë 1,548 njoftime dërguar ish ZVRPP për Rikuperimin e Borxhit me Forcë ndaj debitorëve (bllokim pasurish) (nga të cilat 6 gjatë vitit 2022 për një vlerë detyrimesh në total prej 35,229 mijë lekë), në databazën e vendosur në dispozicion nuk evidentohen rezultatet konkrete të këtyre njoftimeve.

Nga auditimi konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion nga DPD përse i përket situatës së debitorëve me datë 31.12.2022 rezultojnë 312 njoftime dërguar DPSHTRR për Rikuperimin e Borxhit me Forcë ndaj debitorëve (bllokim mjetesh) (nga të cilat 15 gjatë vitit 2022 për një vlerë detyrimesh në total prej 47,479 mijë lekë) në databazën e vendosur në dispozicion nuk evidentohen rezultatet konkrete të këtyre njoftimeve.

Pasqyra nr. 27: Lista e urdhrave të ekzekutimit që janë ekzekutuar plotësisht përgjatë vitit 2022 sipas autoritetit ekzekutues

Në mijë lekë

Dega Doganore	Detyrimi Doganor	Penalite	Interesa	Shuma Totale	Numër rastesh	Autoritet Ekzekutues
Berat	0	83	6	89	1	Dega Doganore
Bllatë	750	739	31	1,520	3	Dega Doganore
Durrës	6,047	988	372	7,408	25	Dega Doganore
Elbasan	59	0	1	60	1	Dega Doganore
Fier	45	0	2	47	1	Dega Doganore

Kapshtice	1,722	3,058	305	5,085	8	Dega Doganore
Korçe	38	164	90	292	2	Dega Doganore
Rinas	34	0	0	34	1	Dega Doganore
Sarandë	56	0	10	67	1	Dega Doganore
Shkodër	392	281	232	905	7	Dega Doganore
Tiranë	874	1,239	142	2,255	8	Dega Doganore
Total	10,018	6,553	1,191	17,763	58	

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Pasqyra nr. 28: Lista e urdhrave të ekzekutimit që janë ekzekutuar plotësisht përgjatë vitit 2022 sipas autoritetit ekzekutues

Në mijë lekë

Dega Doganore	Detyrimi Doganor	Penalitetet	Interesa	Shuma Totale	Numër rastesh	Autoritet Ekzekutues
Durrës	3,902	2,027	73	6,003	49	Zyra Përbarimore
Fier	461	210	15	686	4	Zyra Përbarimore
Gjirokastrë	30	19	14	63	2	Zyra Përbarimore
Tiranë	173	260	39	472	3	Zyra Përbarimore
Tre Urat	329	697	33	1,059	4	Zyra Përbarimore
Totali	4,896	3,213	174	8,284	62	Zyra Përbarimore

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Pasqyra nr. 29: Lista e urdhrave të ekzekutimit që janë ekzekutuar plotësisht përgjatë vitit 2022 sipas autoritetit ekzekutues

Në mijë lekë

Dega Doganore	Detyrimi Doganor	Penalitetet	Interesa	Shuma Totale	Numër rastesh	Autoritet Ekzekutues
Vlorë	184	121	5	310	7	Bashkëpunim Dege doganore Zyra Përbarimi
Totali	184	121	5	310	7	

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 referuar urdhrave për ekzekutim është ekzekutuar plotësisht shuma prej 26,357 mijë lekësh në 127 raste, e ndarë në 17,763 mijë lekë e ekzekutuar nga degët doganore në 58 raste, 8,284 mijë lekë në 62 raste e ekzekutuar nga zyrat përbarimore dhe në 310 mijë lekë në 7 raste e ekzekutuar nga bashkëpunimi midis degëve doganore dhe zyrave të përbarimit.

Nga auditimi konstatohet se rezultatet e arrira nga zyrat e përbarimit janë të papërfillshme të cilat kanë arritur të ekzekutojnë plotësisht përgjatë vitit 2022 urdhrat e ekzekutimit të cilat përbëjnë 0,03% të borxhit doganor me urdhër ekzekutimi (27,370,418 mijë lek). Masa më efektive deri në 31.12.2022 ka qenë pezullimi i NIPT-it të subjekteve në sistemin Asycuda World nga ana e Sektorit të Monitorimit të Borxhit deri në momentin e shlyerjes së detyrimeve të konstatuara.

Subjektet kryesorë të cilat kanë çuar në rritjen e detyrimeve gjatë vitit 2022, nga shkeljet e konstatuara janë si më poshtë:

- Shkeljet ligjore në akcizës: subjekti "A" në shumën 150,086 mijë lekë, subjekti "B.T" në shumën 23,716 mijë lekë, subjektin "N.P" në shumën 18,628 mijë lekë.
- Shkelje ligjore nga kontrabanda: subjekti "A.G" në shumën totale 31,101 mijë lekë, subjekti "S.P" në shumën totale 26,802 mijë lekë.
- Shkelje nga Regjimi Përpunimit Aktiv: subjekti "M.C" në shumën 24,320 mijë lekë.
- Shkeljet ligjore nga rivlerësimi: subjekti "P" në shumën 9,207 mijë lekë, subjekti "E.D" në shumën totale 5,596 mijë lekë.

d. Mbi organizmin e strukturës së punonjësve për ndjekjen e borxhit pranë degëve doganore.

Sektori i Monitorimit të Borxhit në DPD është pjesë e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave dhe përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe 2 specialistë.

Pasqyra nr.30: Mbi organizimin e strukturës së borxhit në degët doganore

Degët Doganore	Nr. i punonj. Sipas strukturës	Nr. faktik i punonjësve	Diferencat
Tiranë	1	1	0
Rinas	1	1	0
Durrës	2	2	0
Shkodër	1	1	0
Pogradec	1	1	0
Kakavijë	1	1	0
Korçë	1	1	0
Kapshticë	1	1	0
Vlorë	1	1	0
Fier	2	1	1
Sarandë	1	1	0
Elbasan	1	1	0
Lezhë	1	1	0
Berat	1	1	0
Kukës	1	1	0
Peshkopi	1	1	0
Tre Urat	1	0	1

Burimi: Grupi i Auditimit bazuar në të dhënat e DPD-së

Nga verifikimi i kryer rezulton se për Degët Doganore Tre Urat dhe Fier nuk është plotësuar organika e miratuar për punonjësit e sektorit të borxhit.

Në lidhje me 3 (tre) Degët Doganore përkatësisht Tiranë, Durrës dhe Fier, në të cilat stoku i borxhit është në masën 58.6% e totalit, duke përfshirë DD Durrës që në organikën e saj ka 2 punonjës për rekuperimin e borxhit, Dega Doganore Tiranë ka të miratuar në organikë vetëm 1 punonjës, për rrjedhojë duke qenë dhe dega me peshën më të madhe të stokut të borxhit është e pamjaftueshme realizimi i procesit të ndjekjes së borxhit. Si Dega Doganore me peshën më të madhe do të duhej të kishte në organikën e saj të paktën 2 punonjës për ndjekjen e borxhit.

Gjithashtu situatë shqetësuese paraqet dhe Dega Doganore Fier, ku në organikën e miratuar ka 2 punonjës por numër faktik është vetëm 1 punonjës, një situatë e përsëritur ndër vite mosplotësimi i organikës së punonjësve në sektorin e borxhit në Degën Doganore Fier.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), në fund të vitit 2022, rezulton një nivel borxhi doganor në shumën **46,690,911 mijë lekë**, e përfaqësuar nga **4,858 raste**.

Borxhi Doganor i trashëguar përgjatë viteve rezulton gjithmonë dhe në rritje, ku për vitin 2022 periudhë auditimi ka pësuar një rritje prej **979,324 mijë lekë** ose me 2,14%.

Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, Sektori i Borxhit, është mjaftuar vetëm në evidentimin e borxhit doganor të raportuar nga degët doganore, por nisur nga situata e vështirë e stokut të borxhit nuk ka nxjerrë udhëzime ose manuale të reja me qëllim specifik vjeljen e detyrimeve dhe përmirësimin e situatës aktuale.

Nga auditimi konstatohet një diferencë në borxhin doganor më e madhe prej 3,101 mijë lekësh nga borxhi i raportuar nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave (46,687,810) për vitin 2022, si rezultat i raportimit të gabuar nga ana e Degës Doganore Rinas për vlerën e mësipërme për shkak të pagimit të kësaj vlerë në muajin Janar të vitit 2023 (dhe raportimit si të paguar në vitin 2022).

Nga auditimi rezulton se transferimi i përgjegjësive për vjeljen e detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave drejt Degëve Doganore, në pjesën më të madhe të Degëve Doganore ka

vetëm 1 (një) punonjës përgjegjës për arkëtimin e detyrimeve, për rrjedhojë nisur nga fakti që ekziston një numër i lartë rastesh dhe rritje e stokut të borxhit, situata e ndjekjes së detyrimeve vetëm nga një punonjës përgjegjës (jurist) është e pa përballueshme dhe jo efektive, fakt që evidentohet nga viti në vit në rritjen e stokut të borxhit.

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se për detyrime të papaguara në ndjekje të procedurave të jetë një numër i lartë rastesh përkatësisht 1,863 ,në vlerë 1,236,940,mijë lekë, të cilat janë në proces të plotësimit të procedurave për rekuperimin me forcë të borxhit. Peshën më të madhe e ka Dega Doganore Tiranë , për rrjedhojë situatë që tregon mos plotësimin e procedurave të ndjekjes së borxhit në kohë dhe punën e pamjaftueshme të specialistëve të borxhit pranë Degëve Doganore.

Në lidhje me 3 (tre) Degët Doganore përkatësisht Tiranë, Durrës dhe Fier, në të cilat stoku i borxhit është në vlerën **40,394,124 mijë lekë** ose në masën **86,52%** e totalit, duke qenë se janë dhe degët me peshën më të madhe të stokut të borxhit si dhe kanë një performancë negative në vjeljen e detyrimeve mos plotësimi i pozicioneve të punës dhe mungesa e shtesës së organikës për këtë sektor ka sjellë që realizimi i procesit të ndjekjes së borxhit të jetë i pa mjaftueshëm. Gjithashtu nga ana e DPD-së nuk janë marrë masa në vlerësimin e Kryetarëve të këtyre Degëve Doganore të cilat kanë performuar negativisht në uljen e borxhit dhe në mos realizimin e objektivave gjatë vitit 2022.

Nga auditimi rezulton se nga ana e Autoriteteve Doganore, urdhrat e ekzekutimit të cilat janë dërguar pranë zyrave të përmbartimit (shtetërore ose private), rezultatet e arritura janë të papërfillshme, për rrjedhojë nuk kanë një efektivitet në rekuperimin e borxhit. Nga korrespondenca me zyrat e përmbartimit është konstatuar se shumica e subjekteve debitore nuk kanë gjendje në llogaritë bankare apo nuk kanë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme të regjistruara në emrin e tyre.

Nga ana e DPD-së dhe Degëve Doganore janë mjaftuar që për urdhrat e ekzekutimit dhe rekuperimin me forcë të detyrimeve të papaguara (sekuestros konservative) të kryhen vetëm përmes zyrave të përmbartimit, por duke qenë se rezultatet e arritura janë të papërfillshme, do të duhej që ekzekutimin me forcë ta kryenin dhe vetë autoritet doganore përmes strukturave të rikuperimit me forcë duke sekuestruar pasuritë e subjekteve nga Dega Doganore dhe Drejtoria e Antikontrabandës me mbështetje të Departamentit Operativ Hetimor dhe strukturave të tjera.

Nga auditimi konstatohet se nuk ka programe pune të përbashkëta përsa i përket mbledhjes së detyrimeve të papaguara midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPD-së dhe DPT-së së datës 19.06.2018 të ndryshuar të protokolluar pranë DPD-së me nr.14355.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.102/2014, datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, neni nr.106 ku përcaktohet se: *“Kur shuma e detyrimit të importit ose eksportit nuk është paguar brenda afatit të caktuar, autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore në fuqi për të siguruar ekzekutimin e pagesës”*, neni nr.280 *“Vjelja e detyrueshme e borxhit”*, me Ligjin nr.61/2012, datë 24.05.2012 *“Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar neni nr.103 ku përcaktohet *“Rekuperimi me forcë i borxhit të akcizës”*, me Udhëzimin e DPD-së nr.15, datë 03.12.2018 *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*, kapitulli VII ku përcaktohet *“Ekzekutimi i vendimit të shpalljes debitor”* pika 2 ku përcaktohet *“Ekzekutimi me forcë/Vendimi”*, kapitulli IX ku përcaktohet *“Ekzekutimi i urdhrat të ekzekutimit”*, pika 2 ku përcaktohet *“Ekzekutimi i Urdhrat të ekzekutimit nga vetë Autoriteti Doganor”*.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi:

- Z. G.G. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së.
- Kryetarët e Degëve Doganore
- Znj. F.M. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave pranë DPD-së.
- Znj. D.L. në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Monitorimit të Borxhit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave pranë DPD-së.

1. Titulli gjetjes: **Niveli shqetësues i rritjes së borxhit doganor nga viti në vit, rezultatet e pa përfillshme në rikuperimin me forcë të detyrimeve.**

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në fund të vitit 2022, rezulton një nivel borxhi doganor në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste, i cili rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 979,324 mijë lekë, ose me 2,14%.

- Nga auditimi konstatohet një diferencë në borxhin doganor prej 3,101 mijë lekë më shumë se borxhi i raportuar nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave (46,687,810 mijë lekë) për vitin 2022, si rezultat i raportimit të gabuar nga ana e Degës Doganore Rinas për vlerën e mësipërme, për shkak të pagimit të kësaj vlerë në muajin Janar të vitit 2023 (dhe raportimit si të paguar në vitin 2022). Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, Sektori i Borxhit, është mjaftuar vetëm në evidentimin e borxhit doganor të raportuar nga degët doganore, por nuk ka nxjerrë udhëzime ose manuale të reja me qëllim specifik vjeljen e detyrimeve dhe përmirësimit të situatës aktuale.

Situata:

Gjithashtu transferimi i përgjegjësisë për vjeljen e detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave drejt Degëve Doganore, ku në pjesën më të madhe të Degëve Doganore ka vetëm një punonjës përgjegjës për arkëtimin e detyrimeve, si dhe nisur nga fakti që ekziston një numër i lartë rastesh dhe rritje e stokut të borxhit, veprimtaria e ndjekjes së detyrimeve është jo efektive, fakt që evidentohet nga viti në vit me rritjen e stokut të borxhit.

- Nga auditimi konstatohet se nuk ka programe pune të përbashkëta përsa i përket mbledhjes së detyrimeve të papaguara midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPD-së dhe DPT-së nr.14355 prot, datë 19.06.2018, e ndryshuar.

- Nga ana e DPD-së nuk janë marrë në analizë vlerësimi i përgjegjësisë së Kryetarëve të këtyre Degëve Doganore të cilat kanë performuar negativisht në uljen e borxhit dhe në mos realizimin e objektivave gjatë vitit 2022.

- Nga auditimi konstatohet se rezultatet e arrira nga zyrat e përmbarimit janë të papërfillshme, të cilat kanë arritur të ekzekutojnë plotësisht përgjatë vitit 2022 urdhrat e ekzekutimit që përbëjnë rreth 0,03% të borxhit doganor pajisur me urdhër ekzekutimi.

Ligji nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar Neni 106, 280.

Kriteri :

Udhëzimi i DPD-së nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës” Kapitulli XII dhe IX.

Ndikimi/Efekti:

Performancë e ulët në vjeljen e borxhit.

Shkaku:

Mungesa e organikës përsa i përket punonjësve të borxhit në degë doganore dhe gjithashtu mos marrja e të gjitha masave për rikuperimin me forcë të borxhit.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Nga ana e DPD-së të analizohet me kujdes situata e krijuar përsa i përket rritjes së borxhit doganor në mënyrë të përvitshme, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të plotësohet struktura organike për këtë qëllim, të rritet niveli i bashkëpunimit me DPT, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore me qëllim rekuperimin e borxhit doganor në shumën prej 46,690,911 mijë lekë, duke parandaluar rritjen e mëtejshme të borxhit, duke rritur monitorimin edhe ndaj zyrave përmbarimore.

2.4. Auditimi i përputhshmërisë ligjore mbi vlerësimin doganor, referuar kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi sipas drejtorive:

- Drejtoria e Vlerësimit në Qendër
- Drejtoria e Kontrolleve Paszhdoganimit (Aposterior operativ 3 ditor)
- Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit

Për sa i përket çështjeve të mësipërme, faza e auditimit në terren për këtë drejtim të auditimit, në zbatim të Programit të Auditimit nr 283/1 prot., datë 03.04.2023, i ndryshuar, është duke vijuar.

2.5. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit dhe Drejtorisë së Antikontrabandës

Për trajtimin këtij drejtimi të auditimit u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacioni si më poshtë:

- Databazën e veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit
- Analizën vjetore të Drejtorisë së Hetimit
- 16 praktika verifikimesh të hetimit për shkelje doganore të kryera nga Drejtoria e Hetimit
- Databazën e veprimtarisë së Drejtorisë së Antikontrabandës
- Analizën vjetore të Drejtorisë së Antikontrabandës
- Praktika verifikimesh të kontrollit të plotë për shkelje doganore të kryera nga Drejtoria e Antikontrabandës
- Çdo dokumentacion tjetër të konsideruar të nevojshëm

Drejtoria e Hetimit

Në bazë të VKM-së Nr.921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore” datë 09.01.2018, struktura e Drejtorisë së Hetimit përmban 4 sektorë. Sektori i Koordinimit për Mashtrimet Fiskale, Sektori i Hetimit për Çështjet e Sigurisë, Sektori i Analizës dhe Raportimit dhe Sektori Task Forca.

Pasqyra nr. 31: Drejtoria e Hetimit

Pozicioni	Numri
Drejtor Drejtorie	1
Përpunues Informacioni	1
Përgjegjës Sektori	4
Specialist	18

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022 nga Drejtoria e Hetimit janë konstatuar 21 shkelje doganore administrative dhe 19 shkelje doganore kontrabandë.

Përsa më sipër janë dërguar degëve doganore 30 Informacione për marrje vendimi për rastet e mësipërme. Nga 30 informacionet dërguar degëve, vlera totale e detyrimit dhe penalteteve sipas analizës për vitin 2022 dërguar me datë 25.04.2023 është 127,875,027 lekë. Nga auditimi

konstatohet se sipas databazës së vendosur në dispozicion vlera totale e detyrimeve dhe penaliteteve është në 128,118,654 lekë, me një diferencë prej 243,627 lekësh nga ajo e raportuar në analizën e vitit 2022 nga Drejtoria e Hetimit.

Referuar aktivitetit të Drejtorisë së Hetimit përgjatë vitit 2022, konkretisht shkeljeve të konstatuara në vlerën 128,118,654 lekë u morën për shqyrtim 16 praktika me një vlerë totale të detyrimit dhe penaliteteve në 125,151,220 lekë ose sa 97,7% e shkeljeve të konstatuara.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17083 Prot të datës 27.09.2022 drejtuar Doganës Shkodër. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.0009977, datë 20.09.2022, konstaton se shtetasi R.SH ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë 23 mjete me targa angleze të cilët nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Me datë 01.11.2021 Drejtoria e Hetimit i ka kërkuar Drejtorisë së Vlerës në Qendër të informojë për sa i përket vlerës së detyrimeve doganore për automjetet objekt hetimi.

Drejtorja e Vlerës në Qendër në vijim të emailit ka informuar Drejtorinë e Hetimit se për sa i përket detyrimeve doganore të automjeteve objekt hetimi rezultojnë në 4,023,271 lekë.

Për sa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit në databazën Reshda se shtetasi R.SH rezulton i penalizuar nga administrata doganore, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 28,162,897 lekësh (4,023,271 detyrime+ 24,139,626 penalitete) dhe ka referuar materialet në Prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekuestrimin/konfiskimin)(seksioni 14 i procesverbalit)i Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër janë përgjegjës hetuesit K.M dhe H.P.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17082 Prot të datës 27.09.2022 drejtuar Doganës Shkodër. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr. 0009980, datë 20.09.2022, konstaton se shtetasi A.F ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë 10 mjete me targa angleze të cilët nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Me datë 01.11.2021 Drejtoria e Hetimit i ka kërkuar Drejtorisë së Vlerës në Qendër të informojë për sa i përket vlerës së detyrimeve doganore për automjetet objekt Hetimi.

Drejtorja e Vlerës në Qendër në vijim të emailit ka informuar Drejtorinë e Hetimit se për sa i përket detyrimeve doganore të automjeteve objekt hetimi rezultojnë në 1,045,706 lekë.

Për sa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit në databazën Reshda se shtetasi A.F rezulton i penalizuar nga administrata doganore, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 7,319,942 lekësh (1,045,706 detyrime+ 6,274,236 penalitete) dhe ka referuar materialet në Prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekuestrimin/konfiskimin) (seksioni 14 i procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër janë përgjegjës hetuesit K.M dhe H.P.

-Nga auditimi konstatohet se referuar problematikave të dy informacioneve për marrje vendimi me nr.17082 të datës 27.09.2022 dhe me nr.17083 Prot të datës 27.09.2022 identifikohen si

problematika pas marrjes së informacionit nga Mbretëria e Bashkuar nëpërmjet emailit të datës 09.09.2019 dhe më pas përcjellë Drejtorisë së Hetimit me datë 16.10.2019 nga ana e Drejtorisë së Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.5182 Prot të datës 15.03.2022 drejtuar Doganës Tiranë për marrje vendimi për shkeljet e kryera nga shoqëria “H.S ”SHPK me NIPTL.....A dhe agjent doganor A.C me ID H.....O, pranë agjencisë doganore “S” SHPK me kod J046.

Drejtorja e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr. 0015488 dhe 0015489, datë 04.03.2022, konstaton se Operatori “H.S ” SHPK me NIPT L.....A ka deklaruar produkte pranë Degës Doganore Tiranë me deklaratën doganore IMP4 me nr R57978 të datës 04.08.2020 me vlerë 83,246.8 euro. Nga dokumentacioni bashkëngjitur praktikës “Deklarata e eksportit Italian me nr.8118U datë 31.07.2020 ka një vlerë më të lartë se ajo e deklaruar pranë autoriteteve Shqiptare, me një diferencë prej 3001 Euro.

Përsa më sipër në procesverbal Drejtorja e Hetimit ka vendosur për operatorin një detyrim të shmangur total prej 135,048 lekësh(67,524 detyrime+67,524 penalitete) dhe 20,000 lekë penalitete për agjentin doganor.

Nga auditimi konstatohet në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet në mënyrë të plotë përshkrimi dhe kryerja e shkeljes(seksioni 6 i procesverbalit).

Nga auditimi konstatohet se hetimi nuk është i plotë, pasi hetuesit nuk kanë vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes ku ka mospërputhje edhe midis vlerës së deklaruar për zhdoganim dhe deklaratës së eksportit dhe deklaratës së tranzitit. Shkelja e kryer dhe mënyra e kryerjes nuk ka ardhur vetëm për faktin, se: “ *agjenti doganor ka parë dhe ka skanuar në sistem vetëm një faqe të faturës me nr.6339, datë 22.07.2022*”. Agjenti nuk ka treguar nivelin e duhur të kujdesit për të kontrolluar gjithë dokumentacionin shoqëruar. Pra jemi në kushtet e kundërvajtjes së kryer në neglizhencë. Cilësimi i shkeljes së kryer nga subjekti në nenin 251/1/2/a është i gabuar dhe duhet të cilësohet sipas nenit 252/b të Kodit Doganor. Ky klasifikim i gabuar i shkeljes së kryer ka sjellë një klasifikim të gabuar të sanksionit për kundërvajtjen administrative në nenin 256/1/a e cila duhet të jetë sipas nenit 257/1/a. Ndodhur në kushtet kur shoqëria dhe agjencia doganore janë përsëritës, janë penalizuar nga administrata doganore dhe rrjedhimisht në vijim duhet të veprojnë me kujdes të lartë kur paraqesin mallrat në doganë, penalteti duhet të ishte në masën 2 fish të detyrimit të munguar ose në vlerën 135,048 lekë.

Për pasojë vlera prej 67,524 lekësh(135,048-67,524) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Nga auditimi konstatohet mangësi në proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.0015489, datë 04.03.2022, në kutinë 12 shuma me shifra e sanksionit është 20,000 lekë , në informacion për marrje vendimi është 30,000 lekë. Cilësimi i shkeljes së kryer nga agjencia duhet të jetë sipas nenit 252/b të Kodit Doganor dhe klasifikimi i sanksionit sipas nenit 257/1/b të Kodit Doganor në shumën 50,000 lekë.

Për pasojë vlera prej 20,000lekësh(50,000-30,000) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Nga auditimi konstatohet se në 2 procesverbalet e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sequestrimin/konfiskimin) (seksioni 14 i procesverbalit). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 252,257 ,268 dhe 274 Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me nenin 77 dhe 271 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër janë përgjegjës hetuesit z.E.C dhe z. K.M.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4491 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Sarandë, Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00006310, datë 28.02.2022, konstaton se shtetasi A.G ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë 31 mjete me targa Angleze të cilët nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 2,967,087 lekë.

Përsa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit në databazën Reshda se shtetasi A.G rezulton i penalizuar nga administrate doganore, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penaltetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 20,769,609 lekësh (2,967,087 detyrime+ 17,802,522 penaltete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekuestrimin/konfiskimin) (seksioni 14 i procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit K.M, G.T.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.7265 Prot., të datës 15.04.2022 drejtuar Doganës Tiranë i cili ka lidhje me shkresën me nr 13050 prot., datë 19.07.2021 me lëndë Informacion për marrje vendimi administrative për agjencinë doganore “S” SHPK me numër kodit J023 dhe subjektin “A.C ” SHPK me NIPT L..T e cila lidhet me shkresën me nr.11985 prot., datë 29.06.2020 të DPD-së.

Drejtorja e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr. 0006361, datë 07.04.2022, konstaton se nga periodiku “Gusht 2019” ardhur në drejtorinë e hetimit me shkresën nr.11985 prot,datë 29.06.2020,rezulton se nga deklarimi i deklaratës doganore IMP4 me nr R71463 datë 13.08.2019 në doganën Tiranë, krahasuar me deklaratën Italiane Ex me nr 21320 datë 07.08.2019 ka diferencë në vlerë ku në Shqipëri është deklaruar 45,000 euro më pak. Në shkresën me nr 7265 Prot të datës 15.04.2022 drejtuar Doganës Tiranë, Drejtoria e Hetimit informon se ka konstatuar se detyrimet doganore të subjektit duhet të llogariteshin edhe mbi taksën doganore (TD 6%) dhe jo vetëm mbi TVSH. Pas rillogaritjeve të kryera nga DVQ Drejtoria e Hetimit ka propozuar penaltetin në masën 1 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 3,523,900 lekësh (1,761,950 detyrime+1,761,950 penaltete).

Nga auditimi konstatohet vonesa në kohë për mbledhjen dhe grumbullimin e fakteve dhe provave si dhe organizimin me efikasitet te dosjes hetimore e cila ka nisur në 29.06.2020 dhe dokumentacioni shtesë është në datë 15.04.2022.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk është kryer nga drejtoria e hetimit arsyetimi i plotë i aktit të nxjerrë dhe gjithashtu nuk janë marrë në shqyrtim të gjitha kushtet dhe të dhënat në procedurën administrative.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Hetimit nuk ka bërë klasifikimin e saktë të shkeljes doganore dhe nuk kane vlerësuar të gjitha faktet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes, konkretisht mospërputhjen edhe midis vlerës së deklaratave të eksportit dhe vlerës së deklaruar për zhdoganim, pasi shkelja e kryer dhe mënyra e kryerjes nuk ka ardhur vetëm për faktin, se : “*agjenti doganor ka parë vetëm vlerën totale që ndodhet në fund të faturave*”. Nga shpjegimet e përfaqësuesit të subjektit, agjentit doganor dhe doganierit te vlerës, në përshkrimet dhe mënyrat e kryerjes së shkeljes tregohet qartë se nuk është treguar niveli i kujdesit për kryerjen e detyrave nga secili prej tyre, pra qartësisht jemi në kushtet e neglizhencës së kryerjes së kundërvajtjes, kjo sjelle që cilësimi juridik i shkeljes së kryer është sipas nenit 252/b të KD dhe jo sipas nenit 251/1/2/a të

Kodit Doganor. Sanksioni sipas nenit 257/1/a të KD. a) *kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferencë në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar, pra penalteti duhet të ishte në masën 2 fish të detyrimit të munguar ose në vlerën 3,523,900 lekë.*

Për pasojë vlera prej 1,761,950 lekësh (3,523,900 -1,761,950) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekustrimin/konfiskimin) (seksioni 14 i procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 252,257 ,268 dhe 274 Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me nenin 77 dhe 271 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit K.M, E.C dhe Drejtori i Drejtorisë së Hetimit A.S.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4492 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Kapshticë, Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00006311, datë 28.02.2022, konstaton se shtetasi A.G ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë 21 mjete me targa Angleze të cilët nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 1,424,235 lekë.

Për sa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit në databazën Reshda se shtetasi A.G rezultoi i penalizuar nga administrata doganore, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penaltetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 9,969,645 lekësh (1,424,235 detyrime+ 8,545,410 penaltete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekustrimin/konfiskimin) (seksioni 14 i procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022 .

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit K.M, G.T .

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.1138 Prot të datës 21.01.2022 drejtuar Doganës Tre Urat e cila ka lidhje me shkresën nr.20845 të datës 14.09.2017. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr 3236 të datës 22.01.2022 ,konstaton se shtetasi S.D në deklaratën doganore IMP4 R21 DATË 17.01.2017 ka deklaruar për zhdoganim mjetin Land Rover si vit të prodhimit vitin 2004. Ndërkohë nga të dhënat e marra nga Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor mjeti në fjalë rezultoi vit prodhimi 2014. Sa më sipër, Drejtoria e Hetimit del në përfundim se deklarimi në doganë në fjalë ka ardhur me qëllim shmangien e pagesës së plotë të detyrimit doganor në shumën 1,184,672 lekë. Përsa më sipër Drejtoria e Hetimit me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022 ka propozuar që shtetasi S.D të paguajë penaltetin në masën 2 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 3,554,016 lekësh(1,184,672 detyrime+2,369,344 penaltete) dhe ka referuar materialet në prokurori. Referuar rastin në fjalë, periudha e cila është bërë deklarata doganore i përket vitit 2017, vit në të cilin në fuqi ka qenë Ligji me nr. 8449 “Kodi Doganor” i datës 27.01.1999. Në përcaktimin e llojit dhe masës së shkeljes është i aplikueshëm ligji që ka qenë në fuqi në momentin e shkeljes doganore. Përsa më sipër penalteti i parashikuar është në përputhje me nenin 276 të Ligjit me nr. 8449 “Kodi Doganor” i datës 27.01.1999.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17470 Prot të datës 03.10.2022 drejtuar Doganës Shkodër. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00009981, datë 20.09.2022, konstaton se shtetasi D.B ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë disa 9 automjete me targa Angleze të cilët nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 1,465,235 lekë.

Për sa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit në databazën Reshda se shtetasi D.B rezultoi i penalizuar nga administrata doganore, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 10,193,645 lekësh (1,465,235 detyrime+ 8,737,410 penalitete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekuestrimin/konfiskimin) (seksioni 14 I procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17973 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Kapshticë, Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00009984, datë 07.10.2022 ,konstaton se shtetasi E.C mbante në servisën e tij 3 automjete të cilët sipas sistemit TIMS nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 255,300 lekë.

Përsa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit të problematikave të njëjta për të njëjtin shtetas, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 1,787,100 lekësh (255,300 detyrime+ 1,531,800 penalitete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17977 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Elbasan. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00009985, datë 07.10.2022, konstaton se shtetasi E.C mbante në servisën e tij 7 automjete të cilët sipas sistemit TIMS nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 625,700 lekë.

Përsa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit të problematikave të njëjta për të njëjtin shtetas, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 4,379,900 lekësh (625,700 detyrime+ 3,754,200 penalitete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4489 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Tre Urat. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00006307, datë 16.02.2022, konstaton se shtetasi A.G ka futur në territorin e Republikës së Shqipërisë 1 mjet me targë Angleze për të cilën nuk ka kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 69,281 lekë.

Përsa më sipër, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 3 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 277,124 lekësh (69,281 detyrime+ 207,843 penalitete) dhe ka referuar materialet në Prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekustrimin/konfiskimin)(seksioni 14 i procesverbalit). Nga auditimi konstatohet se për shtetasin A.G në informacionin për marrje vendimi me nr.4491 Prot dhe 4492 Prot ky shtetas rezulton i dënuar në databazën Reshda se dhe rezulton i penalizuar nga administrata doganore. Përsa më sipër në përputhje të nenit 269 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” por edhe në bazë të praktikave për marrje vendimi me nr.4491 Prot dhe 4492 Prot për të njëjtin shtetas rezulton se penaliteti duhet të ishte në masën 6 fish të detyrimit të munguar.

Përsa më sipër vlera prej 207,843 lekësh (415,686-207,843) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268,269 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit K.M, G.T.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17984 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Shkodër. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00009982, datë 07.10.2022, konstaton se shtetasi E.C mbante në servisën e tij 10 automjete të cilët sipas sistemit TIMS nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 796,000 lekë.

Përsa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit të problematikave të njëjta për të njëjtin shtetas, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 5,572,000 lekësh (796,000 detyrime+ 4,776,000 penalitete) dhe ka referuar materialet në Prokurori.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sekustrimin/konfiskimin)(seksioni 14 i procesverbalit). Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022 .

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit K.M, H.P.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17972 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Morinë, Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr.00009983, datë 07.10.2022, konstaton se shtetasi E.C mbante në servisën e tij 2 automjete të cilët sipas sistemit TIMS nuk kanë kryer procedurat doganore dhe as nuk i ka nxjerrë nga territori i Republikës së Shqipërisë pas kalimit të afatit 6 mujor. Referuar përlllogaritjes së detyrimit doganor për automjetet e mësipërme ka rezultuar në vlerën 236,933 lekë.

Përsa më sipër dhe gjithashtu pas verifikimit të problematikave të njëjta për të njëjtin shtetas, Drejtoria e Hetimit ka propozuar penalitetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 1,658,531 lekësh (236,933 detyrime+ 1,421,598 penalitete) dhe ka referuar materialet në prokurori.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17081/2 Prot të datës 18.11.2022 drejtuar Doganës Shkodër, Drejtoria e Hetimit informon se përsa: 1)i përket informacionit për marrje vendimi me nr.17081 Prot të datës 27.09.2022 për shtetasin A.V për të cilin është mbajtur procesverbali për verifikimin e kundravajtjes administrative me nr.0006371 datë 20.10.2022 ku është marrë masa administrative për 50,000 lekë për çdo automjet(3 automjete në total),2) i përket informacionit për marrje vendimi me nr.17470 Prot të datës 03.10.2022 për shtetasin D.B.B për

të cilin është mbajtur procesverbali për verifikimin e kundravajtjes administrative me nr.0009981 datë 20.09.2022 ku është marrë masa administrative për 50,000 lekë për çdo automjet (9 automjete në total) 3) i përket informacionit për marrje vendimi me nr.17082 Prot të datës 27.09.2022 për shtetasin A.B.F për të cilin është mbajtur procesverbali për verifikimin e kundravajtjes administrative me nr.0006369 datë 20.10.2022 ku është marrë masa administrative për 50,000 lekë për çdo automjet (10 automjete në total), 4) i përket informacionit për marrje vendimi me nr.17083 Prot të datës 27.09.2022 për shtetasin R.R.SH për të cilin është mbajtur procesverbali për verifikimin e kundravajtjes administrative me nr.0006368 datë 20.10.2022 ku është marrë masa administrative për 50,000 lekë për çdo automjet(23 automjete në total). Referuar rasteve të mësipërme janë dërguar njoftimet për paraqitje për shtetasit e sipërcituar dhe asnjëri nuk është paraqitur për të dhënë shpjegime.

Nga auditimi konstatohet se informacioni për marrje vendimi me nr.17081/2 Prot të datës 18.11.2022 drejtuar Doganës Shkodër, Drejtoria e Hetimit e ka dërguar pas shkresës me nr. 1568 të datës 14.10.2022 të Doganës Shkodër e cila njofton se për rastet e mësipërme është konsideruar në procesverbalin e konstatimit shkelje kontrabandë dhe jo edhe kundravajtje nga ana e Drejtorisë së Hetimit. Ndërkohë për të njëjtin shtetas Drejtoria e Hetimit në vite të ndryshme e ka konsideruar shkeljen edhe kundravajtje edhe kontrabandë. Përsa më sipër Dega Doganore Shkodër i ka kërkuar Drejtorisë së Hetimit mbajtjen e një qëndrim të unifikuar (Fakt që ka sjelle në dërgimin e informacionit me nr.17081/2 Prot).

Nga auditimi konstatohet se mbështetur në praktikën e mësipërme nga ana e Drejtorisë së Hetimit nuk janë konsideruar edhe kundravajtje rastet:1) Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4491 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Sarandë për shtetasin A.G (31 automjete). 2) Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4492 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Kapshticë për shtetasin A.G (21 automjete). 3) Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17973 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Kapshticë për shtetasin E.C (3 automjete). 4) Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17977 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Elbasan për shtetasin E.C (7 automjete). 5) Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.4489 Prot të datës 03.03.2022 drejtuar Doganës Tre Urat për shtetasin A.G (1 automjet). 6)Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17984 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Shkodër për shtetasin E.C (10 automjete). 7)Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.17972 Prot të datës 11.10.2022 drejtuar Doganës Morinë për shtetasin E.C (2 automjete).

Përsa më sipër vlera prej 3,750,000 lekësh konsiderohet si e ardhur e munguar, pasi duhet të konsideroheshin edhe kundravajtje me masë administrative 50,000 lekë për çdo automjete për shtetasit e mësipërm me një total prej 75 automjetesh.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 260,262,268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.3136 Prot të datës 17.02.2022 drejtuar Doganës Tiranë. Drejtoria e Hetimit në procesverbalin e mbajtur me nr. 0003238 dhe 0003239, datë 17.02.2022, konstaton se subjekti “S.P” me NIPT L.....A gjatë deklarimit në doganë është deklaruar një kompani importuese e ndryshme (nga “V.L.G” në “S.P”) në sasi, lloj, cilësi dhe vlerë malli e ndryshme me atë të deklaruar në Greqi. Sipas llogaritjeve detyrimi doganor i shmangur është në shumën 3,644,928 lekë e ndarë në 602,463 lekë për IM4 me nr.R114901 dt 29.11.2019 dhe në shumën 3,042,465 lekë për IM4 nr,R115353 dt 30.11.2018. Për detyrimin e shmangur me anë të procesverbalit me nr. 0003238 Drejtoria e Hetimit ka propozuar penaltetin në masën 3 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 2,409,852 lekësh (602,463 detyrime+

1,807,389 penalitete) dhe për detyrimin e shmangur me anë të procesverbalit me nr. 0003239 Drejtoria e Hetimit ka propozuar penaltetin në masën 6 fish të detyrimeve të shmangura për një total prej 21,297,255 lekësh(3,042,465 detyrime+ 18,254,790 penalitete).

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sequestrimin/konfiskimin)(seksioni 14 i procesverbalit) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi hetuesit E.Gj, E.C dhe H.P.

-Referuar informacionit për marrje vendimi me nr.1885/2 Prot të datës 10.02.2022 drejtuar Doganës Fier. Grupi hetimor në bashkëpunim me Degën Doganore Fier ka ushtruar kontroll në kontenierin me numër.OOCU8111922 ngarkuar në kamionin me targa A...Z për praktikën doganore IM4 me nr.R721 datë 01.02.2022 të deklaruar nga agjencia doganore “X” me kod identifikimi J-113,si përfaqësues i subjektit “E.M ” me NIPT L.....E. Pas përfundimit të kontrollit ka rezultuar problematika në deklarim në sasi dhe në një rast për artikullin 35 nuk është bërë deklarim. Pas përllogaritjes së detyrimit nga ana e DVQ ka rezultuar se detyrimi doganor është në shumën 68,930 lekë.

Drejtorja e Hetimit në procesverbalin e mbajtur për verifikimin e kontrabandës me nr. 0003237 ka propozuar penaltetin në masën 3 fish për një total prej 275,720 lekë (68,830 detyrime+ 206,709 penalitete) për subjektin “E.M” dhe në procesverbalin për verifikimin e kundravajtjes me nr.0015486, datë 04.02.202 ka propozuar penaltet në vlerën 20,000 lekë për agjencinë doganore “X ”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin me nr.0003237 mbajtur mungon shënimi për masat e marra për sigurimin e borxhit doganor dhe gjobës (sequestrimin/konfiskimin)(seksioni 14 I procesverbalit).

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin me nr. 0015486, penalteti duhet të ishte në masën 50,000 lekë. Për sa më sipër vlera prej 30.000 lekësh(50,000-20,000) lekë konsiderohet si e ardhur e munguar.

Nga auditimi konstatohet se në rastin në fjalë hetimi nuk është kryer i plotë, pasi nga ana e drejtorisë së hetimit nuk është verifikuar në sistemin RESHDA nëse subjekti “E.M” rezulton i dënuar në administratën doganore. Nëse një fakt i tillë do të vërtetohej do të ndikonte në penalizimin në mashën 6 fish të subjektit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenet 257,268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me praktikën e ngjashme të Drejtorisë së Hetimit të mbajtur me anë të procesverbalit me nr 3236 të datës 22.01.2022.

Përsa më sipër janë përgjegjës hetuesit M.B , E.C dhe H.P.

Për çështjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: z. E.H me detyrë Zv.Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e drejtuesit të Departamentit Operativ Hetimor, z. A.S në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr11853/2 Prot të datës 13.09.2023 protokolluar me tonën me nr.283/35 të datës 20.05.2023, ku janë shprehur objeksionet për sa i përket çështjeve ne lidhje me akt kostatimin të cilat janë reflektuar në projekt raportin e dërguar.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në bazë të observacionit të ardhur, grupi i auditimit gjykon se ky është një observacion i cili i drejtohet akti i kostatimit dhe jo projektraportit, dhe si i tillë ai është reflektuar në qëndrimin në projektraport. Si rezultat, observacioni nuk merret në konsideratë.

1. Titulli gjetjes:	Sanksione jo të plota të vendosura nga Drejtoria e Hetimit pranë DPD me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Drejtoria e Hetimit përgjatë vitit 2022 ka rezultuar me shkelje në vlerën 128,118,654 lekë për 30 informacione për marrje vendimi. -Nga auditimi janë konstatuar 5 raste me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 2,087,317 lekë (nga të cilët 3 subjekte: H.S SHPK, A.C; 1 person fizik: A.G, dhe 2 agjenci doganore: "S" dhe X) si pasojë e sanksioneve jo të plota të vendosura nga ana e Drejtorisë së Hetimit referuar hetimeve të kryera, nga ku janë evidentuar problematika si: klasifikim i gabuar i shkeljes së kryer duke sjellë një klasifikim të gabuar të sanksionit për kundërvajtjen administrative në nenin 256/1/a, e cila duhet të ishte sipas nenit 257/1/a, dhe rrjedhimisht në vijim penaliteti duhet të ishte në masën 2 fish të detyrimit të munguar.
Situata:	-Gjithashtu, referuar informacioneve për marrje vendimi drejtuar degëve doganore, ka rezultuar se në 75 raste të evidentuara si kontrabandë nga ana e Drejtorisë së Hetimit sipas dokumentacionit bashkëlidhur informacionit për marrje vendimi të administruara nga grupi i auditimit, gjatë konstatimit të shkeljes nga ana e Drejtorisë së Hetimit dhe më pas sipas vendimmarrjes për marrjen e vendimit nga ana e degëve doganore përkatëse, konstatohet se këto shkelje duhet të ishin konsideruar edhe kundravajtje me masë administrative në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 259 dhe me nenet 260,262,268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 3,750,000 lekë(50,000 lekë*75 raste). -"Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, nenet 95,251,252,253,257,258,261,268,269,273,274,276 të Ligjit nr.102/2014.
Kriteri :	- Udhëzimi i drejtorit të përgjithshëm të doganave me nr.05 të datës 31.03.2016, Pika 4 - Urdhri Nr.146 datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave, neni 9.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve, kane rezultuar të ardhura të munguara.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e hetuesve të Drejtorisë së Hetimit.
Rëndësia:	E lartë Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Sarandë, Kapshticë, Elbasan, Shkodër, Morinë dhe Tre Urat, si struktura vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e hetimit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Hetimit me efekte negative, si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, apo mos evidentim të kundravajtjes administrative doganore e cila ka sanksionin përkatës, të marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 5,837,317 lekë.
Rekomandimi:	

Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar)

Në bazë të VKM-së Nr.921, datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", datë 09.01.2018, struktura e antikontrabandës përmban 3 sektorë. Sektori i Antikontrabandës Detare, Sektori i antikontrabandës Tokësore dhe Sektori i Koordinimit dhe Operativitetit në Terren.

Pasqyra nr. 32: Struktura e antikontrabandës

Pozicioni	Antikontrabanda tokësore		Antikontrabanda detare		Koordinimi dhe operativiteti ne terren	
	Numri ne strukture organike	Numri mesatar ne fakt 2022	Numri ne strukture organike	Numri mesatar ne fakt 2022	Numri ne strukture organike	Numri mesatar ne fakt 2022
Përgjegjës Sektori	1	0	1	0	1	1
Komandant Grupi	18	18	4	4		
Inspektor Antikontrabande	32	30	13	13		
Doganier Pike Kontrolli	8	8				
Specialist			6	4	2	2
Magaznier dhe Teknik			2	2		
Gjithsej	59	56	26	23	3	3

Burimi: DPD

Gjatë vitit **2022** nga Drejtoria e Antikontrabandës (Sektori Tokësor & Detar), janë ushtruar **2,324** kontrolle nga të cilat **189** ose rreth **8.13%** kanë qenë të plota. Nga 189 kontrollet e plotë të realizuara në 28 raste ka kundërvajtje administrative dhe vetëm në 2 raste kontrabandë, ndërsa në 159 kontrolle nuk është zbuluar asnjë shkelje e legjislacionit doganor.

Gjatë vitit 2022 në 30 kontrollet në të cilat janë konstatuar shkelje doganore vlera totale e detyrimit dhe penaliteteve është 6,268,265 lekë, në 28 raste të klasifikuara kundërvajtje administrative vlera totale detyrimit dhe penaltetit është 6,154,840 lekë dhe 2 raste të klasifikuara kontrabandë vlera totale e detyrimit dhe penaltetit është 113,425 lekë.

Nga auditimi konstatohet se nga totali i raportuar nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës për sa i përket vlerës totale të detyrimit dhe penaliteteve nuk rezulton 6,268,265 lekë, por 5,889,713 lekë për arsye se nga ana e degëve doganore, në rastin e një subjekti (G.S) është bërë saktësimi i llogaritjeve nga ana e DVQ dhe detyrimi doganor dhe penalteti është zbritur me 378,552 lekë. Gjithashtu për sa i përket procesverbalit të subjektit “A” Dega Doganore ka vendosur të mos procedojë me vendimmarrje administrative për sa i përket penaltetit 20,000 të konstatuar nga grupi i antiktrabandës. Ndërsa për sa i përket subjekteve “F.K ” dhe “M” dokumentacioni nuk është paraqitur nga grupi i antiktrabandës pranë degës doganore vendimmarrëse, duke mos proceduar rrjedhimisht me vendimmarrje administrative për sa i përket penaltetit prej 40,000 lekësh të konstatuar nga grupi i antiktrabandës.

Nga 28 rastet e konstatuara si kundërvajtje administrative në 11 raste ose 39% të kontrolleve të plota janë konstatuar: 1 rast klasifikuar shkelje të kompetencës territorial me penaltet 20 000 lekë, 5 raste nga të cilat me mungesë dokumentacioni me penaltet nga 20,000 lekë, 5 raste parregullsi në deklarim nga të cilat 4 raste me penaltet nga 20,000 lekë dhe 1 rast me penaltet në vlerën 30 000 lekë . Në këto raste nuk ka detyrime të shmangura e janë vendosur vetëm penaltete me vlerë totale 230 000 lekë. Tre nga këto raste janë kundërshtuar nga degët doganore.

Nga auditimi konstatohet se nga 11 raste të zbuluara të shkeljeve, rezultati dhe klasifikimi i shkeljeve nuk janë në përputhje me argumentimin e kryerjes së kontrollit nga burimi i informacionit (sektori i monitorimit, Drejtoria e A/K), sipas të cilëve kontrolli është argumentuar për dyshime në natyrë e sasi dhe ka rezultuar i ndryshëm. Për sa më sipër konstatohet mungesë efikasiteti të analizës së riskut.

Nga auditimi konstatohet se nga 28 kontrolle të plota të ushtruara e të gjetura me shkelje në 39 % të rasteve të konstatuara me shkelje (11 nga 28) kanë një vlerë totale të shkeljeve 230 000 lekë ose sa 3.7 % të totalit të kundërvajtjeve. Numri i rasteve të kontrabandës së zbuluar gjatë vitit 2022 është shumë i ulët jo vetëm në numër rastesh por edhe në vlerë. Ka vetëm 2 raste nga 189 kontrolle të plota të ushtruara, me vetëm 1% zbulueshmëri. Vlera e dy rasteve të kontrabandës është 113 425 lekë ose 1,8%, e vlerës totale të shkeljeve. Përsa më sipër konstatohet mungesë efikasiteti të kontrolleve të kryera.

Veprimet e mësipërme janë mangësi e zbatimit të pikave “2” “3” “4” “5” “7” dhe “8” të nenit 47 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar si dhe të pikës “4” të nenit 76 të rregullores së brendshme të DPD-së me nr.146 të datës 07.05.2018.

Referuar aktivitetit të Drejtorisë së Antikontrabandës përgjatë vitit 2022 konkretisht shkeljeve të konstatuara në vlerën 6,268,265 lekë u morën për shqyrtim 5 praktika me një vlerë totale të detyrimit dhe penaliteteve në 5,123,142 lekë ose sa 82 % e shkeljeve të konstatuara dhe gjithashtu 3 praktika me shkelje të konstatuara në vlerën 60,000 lekë të cilat nuk kanë krijuar asnjë efekt.

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “G.S” me NIPT K.....R i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim dhe penaltet) në vlerën 3,168,380 lekë (1,584,190 lekë detyrim+ 1,584,190 lekë penaltet) për të cilin Dega Doganore Tiranë ka dalë me vendimin me nr.1233 të datës 09.12.2022, konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.001335 datë 02.12.2022 , përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “u konstatuan diferenca në sasi sipas evidencë kontrollit”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes (seksioni 12 i procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundërvajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penaltetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar.

Nga auditimi konstatohet në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes(seksioni 6 i procesverbalit) për verifikimin e kundërvajtjes administrative në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ku cilësohet: “Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë: ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja”. Këto përshkrime të shkeljes së kryer dhe mënyra se si është kryer shkelja sjell evidentimin e dallimeve ndërmjet rasteve të shkeljeve sipas neneve : Neni 251 “Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive”, Neni 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë”, Neni 253 “Kundërvajtje të kryera me dashje” dhe zbatimin korrekt të këtyre neneve dhe rrjedhimisht të masës së sanksionit për shkeljen e kryer.

Nga auditimi konstatohet se vendimi i Degës Doganore me datë 09.12.2022 është më një vonesë 1 javore nga momenti i mbajtjes së procesverbalit në kushtet e flagrancës nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e sipërcituar kemi diferenca në sasi të mallit, përse më sipër, ky rast, pra diferenca në sasi duhet trajtuar si kundërvajtje e kryer me neglizhencë dhe kjo kundërvajtje klasifikohet sipas pikës 1 të nenit 252 dhe sanksioni duhet klasifikuar sipas pikës 1 “a” të nenit 257 ku cilësohet: “Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar”. Në këtë rast, penaltetin duhet të ishte në vlerën 3,168,380

lekë).Përsa më sipër vlера prej 1,584,190 lekësh(3,168,380-1,584,190) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “f” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274 dhe pika 2 e nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Përса më sipër mbajnë përgjegjësi: z.E.GJ, z.L.M, në cilësinë e komandantëve të grupit të antikntrabandës përса i përket këtij verifikimi dhe z. I.H, z. E.K, z.A.RR dhe z.D.P në cilësinë e inspektorëve përса i përket këtij verifikimit.

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “4”, me NIPT K.....B i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim dhe penalitet) në vlerën 304,420 lekë (76,105 lekë detyrim+ 228,315 lekë penalitet) për të cilin Dega Doganore Tiranë ka dalë me vendimin me nr.1155 të datës 07.11.2022, konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative me nr.0018007 datë 02.12 2022, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “u konstatuan parregullsi dhe diferenca”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes (seksioni 12 I procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me e kryer me dashje, sipas nenit 258 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 3 fish të detyrimit të munguar.

Nga auditimi konstatohet në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes(seksioni 6 i procesverbalit) për verifikimin e kundravajtjes administrative në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ku cilësohet: “Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë: ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja”. Këto përshkrime të shkeljes së kryer dhe mënyra se si është kryer shkelja sjell evidentimin e dallimeve ndërmjet rasteve të shkeljeve sipas neneve : Neni 251 “Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive”, Neni 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë”, Neni 253 “Kundërvajtje të kryera me dashje” dhe zbatimin korrekt të këtyre neneve dhe rrjedhimisht të masës së sanksionit për shkeljen e kryer.

Nga auditimi konstatohet se vendimi i Degës Doganore me datë 07.11.2022 është më një vonesë 2 javore nga momenti i mbajtjes së procesverbalit në kushtet e flagrancës nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “f” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274 dhe pikën 2 të nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar *Përса më sipër mbajnë përgjegjësi: z.E.M, z.A.G në cilësinë e komandantëve të grupit të antikntrabandës përса i përket këtij verifikimi dhe z.G.N, z.D.P dhe z.A.XH në cilësinë e inspektorëve përса i përket këtij verifikimi.*

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “D” me NIPT K.....A i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim dhe penalitet) në vlerën 1,142,662 lekë (571,331 lekë detyrim+ 571,331 lekë penalitet) për të cilin Dega Doganore Durrës ka dalë me vendimin me nr.906 të datës 15.07.2022, konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “klasifikim në nivelin tarifor”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes (seksioni 12 i procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar.

Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “Nenet e shkelura” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ku cilësohet:

“Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë: ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja”.

Nga auditimi konstatohet se vendimi i Degës Doganore me datë 15.07.2022 është me një vonesë 10 ditore nga momenti i mbajtjes së procesverbalit në kushtet e flagrancës nga ana e Drejtorisë së Antikontabandës.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274 dhe me pikën 2 të nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe me pikën 4 të udhëzimit të drejtorit të përgjithshëm të doganave me nr.05 të datës 31.03.2016 *Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi: z.R.K në cilësinë e komandantëve të grupit të antikontabandës përsa i përket këtij verifikimi, z.I.M dhe z.R.S, në cilësinë e inspektorit përsa i përket këtij verifikimi.*

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “K.B” me NIPT L.....H i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim dhe penaltet) në vlerën 432,000lekë (216,000 lekë detyrim+ 216,000 lekë penaltet) për të cilin Dega Doganore Tiranë ka dalë me vendimin me nr.1104 të datës 25.10.2022, konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është *“sasi më tepër”*. Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “Nenet e shkelura” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

Nga auditimi konstatohet se në seksionin 12 të procesverbalit “sanksionet e zbatuara” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë sanksioni doganore aplikohet për shkeljen e kryer.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e grupit të antikontabandës caktohet penalteti i aplikuar në vlerë për subjektin pa u identifikuar neni i shkeljes doganore të kryer dhe sanksioni doganor në bazë të shkeljes doganore.

Nga auditimi konstatohet në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes(seksioni 6 i procesverbalit) për verifikimin e kundërvajtjes administrative në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ku cilësohet: *“Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë: ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja”*. Këto përshkrime të shkeljes së kryer dhe mënyra se si është kryer shkelja sjell evidentimin e dallimeve ndërmjet rasteve të shkeljeve sipas neneve: Neni 251 “Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive”, Neni 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë”, Neni 253 “Kundërvajtje të kryera me dashje” dhe zbatimin korrekt të këtyre neneve dhe rrjedhimisht të masës së sanksionit për shkeljen e kryer.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e sipërcituar kemi diferencë në sasi të mallit, përsa më sipër, ky rast, pra diferenca në sasi duhet trajtuar si kundërvajtje e kryer me neglizhencë dhe kjo kundërvajtje klasifikohet sipas pikës 1 të nenit 252 dhe sanksioni duhet klasifikuar sipas pikës 1 “a” të nenit 257 ku cilësohet: *“Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar”*. Në këtë rast, penalteti duhet të ishte në vlerën 432,000 lekë). Përsa më sipër vlera prej 216,000 lekësh (432,000-216,000) konsiderohet si e ardhur e munguar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “ç” “d” dhe “f” të pikës 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar duke mos përmbushur elementet bazë që duhet të përmbajë procesverbali i verifikimit.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi: z.F.R, z.E.K, znj.J.GJ, në cilësinë e komandantëve të grupit të antikontrabandës përsa i përket këtij verifikimi dhe z.B.K në cilësinë e doganierit fizik.

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “T.P ” me NIPT M.....I i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim dhe penalitet) në vlerën 75,680 lekë (37,840 lekë detyrim+ 37,840 lekë penalitet) për të cilin Dega Doganore Kakavijë ka dalë me vendimin me nr.42 të datës 05.09.2022, konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “ *diferencë në peshë dhe natyrë*” .

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes (seksioni 12 I procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar. Nga auditimi konstatohet në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes (seksioni 6 I procesverbalit) për verifikimin e kundravajtjes administrative. Këto përshkrime të shkeljes së kryer dhe mënyra se si është kryer shkelja sjell evidentimin e dallimeve ndërmjet rasteve të shkeljeve sipas neneve: Neni 251 “Kundërvajtjet me përgjegjësi objektive” ,Neni 252 “Kundërvajtje të kryera në neglizhencë”,Neni 253 “Kundërvajtje të kryera me dashje” dhe zbatimin korrekt të këtyre neneve dhe rrjedhimisht të masës së sanksionit për shkeljen e kryer. Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “*Nenet e shkelura*” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontrabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar ku cilësohet:

“Procesverbali i verifikimit duhet të përmbajë: ç) llojin e shkeljes së kryer; d) mënyrën me të cilën është kryer shkelja”. Nga auditimi konstatohet se vendimi i Degës Doganore me datë 05.09.2022 është më një vonesë 1 mujore nga momenti i mbajtjes së procesverbalit në kushtet e flagrancës nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e sipërcituar kemi diferencë në sasi dhe natyrë të mallit, përsa më sipër, ky rast, pra diferenca në sasi dhe natyrë duhet trajtuar si kundravajtje e kryer me dashje dhe kjo kundravajtje klasifikohet sipas pikës 1 të nenit 253 dhe sanksioni duhet klasifikuar sipas pikës 1 “a” të nenit 258 ku cilësohet: “*Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 253 dhe 254 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 3-fish të detyrimit të munguar*”. Gjithashtu i njëjti grup i antikontrabandës në një rast tjetër(ndaj subjektit “4” me NIPT K....B) për të njëjtën shkelje “diferenca në sasi dhe natyrë” ka trajtuar rastin e kundravajtje sipas pikës 1 të nenit 253. Në këtë rast, penaliteti duhet të ishte në vlerën 113,520 lekë. Përsa më sipër vlera prej 75,680 lekësh(113,520-37,840) konsiderohet si e ardhur e munguar. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274 dhe me pikën 2 të nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Nga auditimi konstatohet se në 5 procedurat e kontrolleve të plota të mësipërme nuk është kryer nga drejtoria e antikontrabandës marrja e dëshmimeve dhe deklarimeve nga shkelësi dhe/apo dëshmitarët. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 275 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi: z.E.M dhe z.R.V, në cilësinë e komandantëve të grupit të antikontabandës përsa i përket këtij verifikimi.

Nga auditimi konstatohet se në rastin e subjektit 4”, me NIPT K.....B përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “u konstatuan diferenca në sasi dhe natyrë,” dhe sanksioni i vendosur për këtë shkelje është 3-fish të detyrimit të shmangur, ndërsa për subjektin “T.P ” për të njëjtin përshkrim shkelje është vendosur sanksion 1-fish të detyrimit të shmangur. Mungesa e përshkrimit të plotë dhe të detajuar, të mënyrës së kryerjes së shkeljes dhe arsyetimit të aktit sipas përcaktimeve të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar duke mos evidentuar ndryshimin midis kundravajtjes me përgjegjësi objektive dhe kundravajtjes të kryer me dashje, ka sjellë mos njehsim të vendimeve dhe trajtim jo uniformë të shkeljeve doganore. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën “1”,”2” dhe “3” të nenit 273 Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe të Manualin Udhëzues të drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.05 i datës 31.03.2016, synimi i të cilit është zbatimi korrekt dhe trajtimi uniform i shkeljeve doganore.

Nga auditimi konstatohet se në 5 procedurat e kontrolleve të plota të mësipërme nuk është kryer nga grupet e drejtorisë së antikontabandës arsyetimi i aktit të nxjerrë dhe gjithashtu nuk janë marrë në shqyrtim të gjitha kushtet dhe të dhënat në procedurën administrative. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 14 dhe 100 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”. Nga auditimi konstatohet se në 5 procedurat e kontrolleve të plota të mësipërme nuk është identifikuar struktura verifikuese. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me germën “b” të pikës 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “F.K” me NIPT L.....I i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim) në vlerën 20,000 lekë konstatohet se në Procesverbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “mungesa e manifestit”. Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes(seksioni 12 I procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar ose sanksion në masën nga 20,000 deri në 50,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “Nenet e shkelura” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

Nga auditimi konstatohet se pas përfundimit të verifikimit nga ana e grupit të antikontabandës ka moszbatim të procedurës së verifikimit të shkeljes doganore (seksioni 17 i procesverbalit), duke mos u dërguar autoritetit doganor kompetent procesverbalin përfundimtar dhe duke mos u përgatitur dosja e plotë në lidhje me shkeljen. Si rrjedhojë, ky akt administrativë, deri në momentin e përfundimit të fazës së auditimit në terren nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me germën “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274, pika 5 e nenit 273 dhe pika 1 e nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar. *Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi z.F.O. në cilësinë e komandantit të grupit të antikontabandës përsa i përket këtij verifikimi, z.B.Z. dhe z.E.K. në cilësinë e inspektorit përsa i përket këtij verifikimi.*

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “MI” me NIPT L.....K i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim) në vlerën 20,000 lekë konstatohet se në Procesverbal për

verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “*mungesa e manifestit*”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes (seksioni 12 I procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penaltetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar ose sanksion në masën nga 20,000 deri në 50,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “*Nenet e shkelura*” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontrabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

Nga auditimi konstatohet se pas përfundimit të verifikimit nga ana e grupit të antikontrabandës ka moszbatim të procedurës së verifikimit të shkeljes doganore(seksioni 17 i procesverbalit),duke mos u dërguar autoritetit doganor kompetent procesverbali përfundimtar dhe duke mos u përgatitur dosja e plotë në lidhje me shkeljen. Si rrjedhojë, ky akt administrativë, deri në momentin e përfundimit të fazës së auditimit në terren nuk ka prodhuar asnjë efekt juridik. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 274,pika 5 e nenit 273 dhe pika 1 e nenit 276 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi z.F.O. me detyrën e komandantit të grupit të antikontrabandës përsa i përket këtij verifikimi, z.B.Z. dhe z.E.K. në cilësinë e inspektorit përsa i përket këtij verifikimi.

Referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “A” me NIPT K.....J i cili u konstatua nga ana e Drejtorisë së A/K me shkelje (detyrim) në vlerën 20,000 lekë konstatohet se në Proces verbal për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “*parregullsi në dokumentacion nga ana e agjencisë doganore*”.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes(seksioni 12 i procesverbalit) doganore se përse klasifikohet si kundravajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penaltetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar ose sanksion në masën nga 20,000 deri në 50,000 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në seksionin 7 të procesverbalit “*Nenet e shkelura*” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontrabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

Nga auditimi konstatohet se në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra së si është kryer shkelja. Referuar problematikave të mësipërme, Dega Doganore Durrës me anë të vendimit të protokolluar me nr.7315/3 të datës 31/05/2022 ka vendosur të mos procedojë me vendimmarrje referuar procesverbalit të mësipërm.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me gërmën “ç” “d” dhe “f” të pikës 1 të nenit 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar duke mos përmbushur elementet bazë që duhet të përmbajë procesverbali i verifikimit.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi z.M.T. në cilësinë e komandantit të grupit të antikontrabandës përsa i përket këtij verifikimi dhe z.N.S., z.E.H. në cilësinë e inspektorëve dhe z.M.V. në cilësinë e doganierit fizik.

Nga auditimi konstatohet se në 3 procedurat e kontrolleve të plota të mësipërme nuk është kryer nga grupet e drejtorisë së antikontrabandës arsyetimi i aktit të nxjerrë dhe gjithashtu nuk janë marrë në shqyrtim të gjitha kushtet dhe të dhënat në procedurën administrative. Veprimet e

mësipërme bien në kundërshtim me nenin 14 dhe 100 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar aktivitetit të drejtorisë së antikontabandës përgjatë vitit 2022, konkretisht 107 kontrolleve të plotë që kanë rezultuar pa shkelje u morën në shqyrtim 11 praktika. Nga auditimi i kontrollit të plotë të kryer nga grupi antikontabandës nr.03 me akt kontrolli nr.5330, datë 04.08.2022 rezultati i kontrollit fizik është në rregull, konform deklaramentit.

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit konstatohet se:

Nga kontrolli I DAV IM4 me nr.R528, datë 04.08.2022 të subjektit “A.” SHPK me NIPT J.....U u konstatua se për artikullin Tubo dhe Rakorderi PVC nga Plastikë e ricikluar me peshë totale 7820 kg (nga të cilat Tubo-3,820 kg dhe Rakorderi-4,000 kg) është pranuar metoda e vlerësimit me transaksion Referuar pikës 7, të Udhëzimit nr. 3, datë 23.01.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, në të përcaktohet qartë që:

“Profilizimi i riskut në vlerësimin doganor Indikatorët që mund të evidentojnë një shqyrtim më të thelluar të vlerës doganore, mund të jenë:

Ekziston një ndryshim i dukshëm midis vlerës së deklaruar dhe çmimeve të Database-it Kombëtar të Vlerësimit apo të dhënave të disponueshme për artikujt që përditësohen nga bursat apo agjenci ndërkombëtare.”

Nga auditimi konstatohet se vlera e transaksionit është dukshëm më e ulët se vlera e referencës, përse më sipër duhet të zbatohet metoda 6 e vlerësimit (metoda e të dhënave të disponueshme) për të cilat për Tubo dhe shkarkime Hidraulike çmimi i referencës është 1.8€/kg ndërsa për rakorderi çmimi I referencës është 2.3€/kg. Nga llogaritja sipas metodës 6 rezulton se vlera e mallrave rezulton 16,076 €. Sipas kursit të këmbimit në momentin dhe datën e deklaratës vlera totale e mallit është 1,915,133 lekë. Nga auditimi konstatohet se detyrimi i munguar është në vlerën 162,199 lekë (1,915,133-1,103,138=810,995*0.2=162,199).

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 66 dhe nenin 70 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe me nenin 161 dhe 165 të VKM-së nr.651 të datës 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Ligjit 102/2014”.

Përse më sipër mbajnë përgjegjësi znj.I.M. në cilësinë e përgjegjëses së grupit të antikontabandës për sa i përket këtij verifikimi dhe znj.A.S., z.Y.S. cilësinë e inspektorëve.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 19 të Antikontabandës me akt kontrolli nr.5401, datë 24.02.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontabandës janë në përputhje me aktet nënligjore, pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre ka rezultuar në rregull, konform deklaramentit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R3505, datë 22.02.2022 të subjektit “B.S” SHPK me NIPT L....E.

Në lidhje me mënyrën e vlerësimit konstatohet se nuk është pranuar metoda e vlerësimit me transaksion, por është përdorur metoda 6 e vlerësimit (metoda e të dhënave të disponueshme).

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 13 të Antikontabandës me akt kontrolli nr.334, datë 07.10.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontabandës janë në përputhje me aktet nënligjore, pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre është në rregull, konform deklaramentit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R154189, datë 07.10.2022 të subjektit “A.GJ” SHPK me NIPT K.....A.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 17 të Antikontabandës me akt kontrolli nr.3054, datë 13.05.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontabandës janë në përputhje me aktet nënligjore, pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre i ka rezultuar në rregull, konform deklaramentit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R45857, datë 12.05.2022 të subjektit “F.D”.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 15 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.8435, datë 26.01.2022 rezultati i kontrollit fizik të antikontrabandës nuk është në përputhje, konform deklaramit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R8185,datë 26.01.2022 të subjektit “R. R” PF me NIPT M...V dhe IM4 R8252, datë 26.01.2022 të subjektit ”I.H” PF me NIPT J....K. Nga evidenca e kontrollit fizik me nr 32 të datës 26.01.2022 për mjetin G...0 konstatohen mos evidentimi në procesverbal nga ana e grupit të antikontrabandës të mallrave sipas deklaratës IM4 R8252.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi: I.Z, F.Z dhe G.D në cilësinë e inspektorëve të grupit të antikontrabandës.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 9 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.3252, datë 23.05.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontrabandës janë në përputhje me aktet nënligjore,pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre për mjetin me targë A...k i cili rezultoi pa mallra kontrabandë konstatohet pa shkelje.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 11 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.3186, datë 26.02.2022 rezultati i kontrollit fizik të antikontrabandës nuk është konform analizës së riskut dhe natyrës së mallit, pasi në evidencën e kontrollit është bërë verifikimi vetëm i copëve të blloqeve të granitit dhe jo i sasisë së m3 sipas deklaratave doganore. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me R122,123,124,127,130,131 dhe dy deklaratave të tranzitit T2 datë 25.02.2022 të subjektit “A.” me NIPT K.....L . Kontrolli i m3 është i detyrueshëm për të verifikuar saktësinë e deklarimeve të subjektit.

Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi: V.G, R.D, SH.L, A.K, A.J dhe E.L, në cilësinë e inspektorëve të grupit të antikontrabandës.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 7 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.6689, datë 26.03.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontrabandës janë në përputhje me aktet nënligjore,pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre i ka rezultuar në rregull, konform deklaramit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R653,datë 25.03.2022 të subjektit “T.L” SHPK me NIPT L.....A.

Referuar praktikës së kontrollit të plotë të grupit 2 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.05307, datë 15.01.2022 rezultati i kontrollit fizik të tyre i ka rezultuar në rregull,konform deklaramit. Ky kontroll është kryer për DAV IM4 me nr.R134,datë 14.01.2022 të subjektit “F.K” SHPK me NIPT K.....M.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 1 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.5378, datë 13.08.2022 procedurat e ndjekura nga drejtoria e antikontrabandës janë në përputhje me aktet nënligjore,pasi rezultati i kontrollit fizik të tyre i ka rezultuar në rregull, konform deklaramit. Ky kontroll është kryer për manifestin me nr deklarate 22AL190000P000000733 të subjektit “M.P”.

Nga auditimi i praktikës së kontrollit të plotë të grupit 5 të Antikontrabandës me akt kontrolli nr.6648, datë 07.03.2022 konstatohet se kjo procedurë nuk është përfunduar, pasi është mbajtur akt bllokimi dhe ka kaluar për verifikimet të mëtejshme hetimore drejtorisë së hetimit.

Referuar aktivitetit të drejtorisë së antikontrabandës përgjatë vitit 2022, konkretisht 117 kontrolleve të pjesshme/shoqërime/skanime/mbikëqyrje që kanë rezultuar pa shkelje u morën në shqyrtim 9 praktika(sipas aneksit 5.1).

Nga auditimi konstatohet se nga praktikat e marra për shqyrtim rezultuan 7 shoqërime,1 kërkesë skanimi dhe 1 kontroll I pjesshëm. Referuar shoqërimeve konstatohet se praktikat përmbajnë

procesverbalet përkatëse të shoqërimit me datë, orë,mjet,numër plumbçesh dhe marrësish në dorëzim.

Nga auditimi konstatohet se praktika shoqërime/skanime të marra për shqyrtim përmbajnë procesverbalet e shoqërimeve dhe skanimeve me datat përkatëse, por pa përmbajtur deklaratat doganore dhe pa identifikuar nëse në këto raste ka pasur mallra në sasi apo natyrë të ndryshme nga ato të deklaruara.

Nga auditimi konstatohet se në praktikën e kontrollit të pjesshëm mbahet një procesverbal kontrolli i cili identifikon natyrën e mallit, por nuk mbahet evidenca e kontrollit fizik e cila verifikon nëse sasia dhe natyra e mallit është në përputhje me deklarin.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 4 të nenit 76 të Urdhrit Nr.146 datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave.

Për çështjet e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi: *z.E.H me detyrë Zv.Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e drejtuesit të Departamentit Operativ Hetimor, z.I.B në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Antikontrabandës për një periudhë 7 mujore dhe z.F.SH në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Antikontrabandës për një periudhë 5 mujore.*

1.Titulli gjetjes: Mangësi në klasifikimin e sakonsioneve nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Drejtoria e Antikontrabandës përgjatë vitit 2022 ka kryer 189 kontrolle të plota, nga të cilat kanë rezultuar shkelje nga kontrollet e plota në vlerën 6,268,265 lekë për 30 raste.

Situata:

-Nga auditimi janë konstatuar 3 raste (të cilat i përkasin 3 subjekteve: G.S , K.B dhe T.P) me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 1,875,870 lekë, si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës, referuar kontrolleve të plota të kryera për të cilat problematikat e konstatuara nga kontrollet e drejtorisë janë trajtuar si kundravajtje me përgjegjësi objektive, por faktikisht duhet të ishin trajtuar si kundravajtje të kryera me neglizhencë e cila klasifikohet sipas pikës 1 të nenit 252, dhe sanksioni duhet klasifikuar sipas pikës 1 “a” të nenit 257 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

-Gjithashtu, është konstatuar 1 rast lidhur me subjektin “A” SHPK, në të cilin vlera e transaksionit është dukshëm më e ulët se vlera e referencës ,dhe nga ana e grupit të antikontrabandës janë konstatuar mangësi në kryerjen e kontrollit të plotë duke mos zbatuar metodën 6 të vlerësimit (metoda e të dhënave të disponueshme) me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 162,199 lekë.

Kriteri:

- Ligji nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar nenet 95,251,252,253,258,261,273,274,276.

- Udhëzimi i drejtorit të përgjithshëm të doganave me nr.05 të datës 31.03.2016, Pika 4.

- Urdhri Nr.146 datë 07.05.2018 të Ministrit të Financave, Neni 9.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve, kane rezultuar të ardhura të munguara.

Shkaku:

Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore lidhur me punën e inspektorëve të Drejtorisë së Antikontrabandës.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Tiranë dhe Kakavijë, si strukturë vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës

me efekte negative si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej 2,038,069 lekë.

2.Titulli gjetjes: **Mangësi të konstatuara gjatë procedurave të ndjekura për verifikimin e shkeljeve doganore nga ana e grupeve të antikontabandës.**

Situata: Nga auditimi konstatohet se në 2 raste pas përfundimit të verifikimit nga ana e grupit të antikontabandës ka moszbatim të procedurës së verifikimit të shkeljes doganore (seksioni 17 i procesverbalit), duke mos i dërguar autoritetit doganor kompetent procesverbalin përfundimtar dhe duke mos u përgatitur dosja e plotë në lidhje me shkeljen. Si rrjedhojë, këto akt administrative, nuk kanë prodhuar asnjë efekt juridik. Konkretisht, referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit “F.K” me NIPT L.. dhe “M.” me NIPT L....., konstatohet se në proces verbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “ *mungesa e manifestit*”, dhe nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes doganore (seksioni 12 i procesverbalit) se përse klasifikohet si kundërvajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar ose sanksion në masën nga 20,000 deri në 50,000 lekë. Në seksionin 7 të procesverbalit “*Nenet e shkelura*” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

Kriteri : - Ligji nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar Gërma “ç” dhe “d” e pikës 1 të nenit 274,pika 5 e nenit 273 dhe pika 1 e nenit 276.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e vendimmarrjes nga ana e Degës Doganore.

Shkaku: Mos dërgimi tek autoriteti doganor kompetent i procesverbalit përfundimtar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Departamenti Operativ Hetimor dhe Drejtoria e Antikontabandës të ndjekë zbatimin në praktikë të planeve operacionale dhe të mbikqyrë veprimtarinë e kryer, gjithashtu për rastet e konstatimit të shkeljeve të dispozitave të kodit doganor, procesverbali i verifikimit të shkeljes, duhet të mbahet në 3 kopje sipas përcaktimeve ligjore, ku kopja e parë duhet të administrohet nga Dega Doganore vendimmarrëse, kopja e dytë duhet t’i jepet shkelësit dhe kopja e tretë duhet të depozitohet në arshivën e strukturës verifikuese.

3.Titulli gjetjes: **Mangësi të konstatuara gjatë procedurave të ndjekura për verifikimin e shkeljeve doganore nga ana e grupeve të antikontabandës.**

Situata: Nga auditimi konstatohet se në 7 raste referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e Drejtorisë së Antikontabandës në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes doganore (seksioni 12 i procesverbalit), në kundërshtim me nenin 250, 251, 252 dhe 253 të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se në 4 raste referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e kësaj drejtorie në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes (seksioni 6 i procesverbalit) për verifikimi i kundërvajtjes administrative në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të ligjit nr.102/2014 të ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se në 6 raste referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e kësaj drejtorie në procesverbalin e mbajtur nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti (seksioni 7

	i procesverbalit) “Nenet e shkelura” në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të ligjit nr.102/2014 të ndryshuar.
Kriteri :	Ligji nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” Neni 250, 251, 252, 254, Pika 1 e nenit 274.
Ndikimi/Efekti:	Paqartësi e shkeljes së kryer në momentin e vendimmarrjes së degës doganore.
Shkaku:	Mosplotësimi i seksioneve përkatëse të procesverbaleve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupet e kontrollit të Drejtorisë së Antikontrabandës të plotësojnë me korrektesë procesverbalet e shkeljeve përkatëse me informacion të detajuar lidhur me llojin e kontrollit të ushtruar, rezultatet e kontrollit, llojin e shkeljes, klasifikimin dhe mënyrën me të cilën është kryer shkelja, penalitetet e vendosura, bazën ligjore dhe masat e tjera të marra.

Mbi rolin e Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD për zbatimin e kontratës së koncesionit të skanimit në dogana

Pranë **Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD** u kërkuar informacion lidhur me rastet në të cilat janë identifikuar problematika pas kontrolleve të kryera në kontratën e koncesionit të skanimit në dogana miratuar sipas ligjit nr. 123/2013 *"Për miratimin e kontratës së koncesionit nëpërmjet MFE si autoritet kontraktues, si dhe shoqërisë R.."* si koncesionar për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të konteniereve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit, i ndryshuar", dhe sipas parashikimeve të Manualit nr.8, date 8.8.2017 *"Mbi procedurat standarde të punës mbi përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe/ose mjeteve të transportit"*. Më hollësisht, u kërkuar të dhënat që disponoheshin lidhur me rastet të cilat kanë rezultuar me problematika në vijim të kontrolleve të kryera të mjeteve, duke identifikuar edhe rezultatet e skanimit të tyre (nëse rezultatet e skanimit të mjeteve respektive kanë qenë pa ngjyrë, me ngjyrë të verdhë apo të kuqe), sipas pikave doganore për çdo vit. Gjithashtu për çdo rast u kërkuar edhe burimi i sinjalizimit për kryerjen e verifikimeve (nëse kontrolli është kryer në vijim të sinjalizimit nga rezultati i skanimit të mjetit; nëse është propozuar nga policia; nëse është kërkuar nga doganieri i skanimit, etj). Në vijim të kërkesës, informacioni u vendos në dispozicion vetëm për vitin 2021 dhe 2022 të kontrolleve dhe shoqërimeve të mjeteve për skanim, të raportuara dhe evidentuara nga grupet e terrenit të kësaj drejtorie, ku kanë mbajtur/dorëzuar dhe dokumentacion përkatës, sipas aneksit më poshtë. Informacioni është përcjellë vetëm për rastet, ku në dokumentacion është shënuar se ka patur markim nga skaneri, ndërsa për deklaratat e pastra nuk janë raportuar të jenë kryer kontrole që kanë rezultuar me parregullsi nga ana e kësaj drejtorie. Drejtoria nuk dispononte një databazë përmbledhëse të të gjitha rasteve kur kjo strukturë është përfshirë në kontrole që lidhen me rezultatet e skanerit, për të dokumentuar kështu diferencën të mundshme që mund të kenë rezultuar nga përgjigja e skanerit me atë që ka rezultuar pas kontrollit, për të cilat kontrata parashikon penalitete nga 30,000 euro për çdo gabim në skanim, deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës.

Titulli i gjetjes: **Mangësi në procedurat e ndjekura për verifikimin e ekzistencës së gabimeve në skanim dhe raportimin e tyre në mënyrë të konsoliduar, për të cilat në rastet e identifikuar parashikohen penalitete nga 30,000 euro për çdo gabim në skanim, deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës.**

Nga auditimi i kryer pranë Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD konstatohet se nuk është identifikuar **asnjë rast i ekzistencës së gabimeve në skanim, për të cilat sipas kontratës** është vlerësuar aplikimi i penaliteteve në situatat në të cilat **“analiza e dështuar e imazheve”**, e cila përfshin rastet kur nga ana e skanerit nuk janë identifikuar parregullsi, po ndërkohë nga ana e personelit doganor janë identifikuar përmbajtje të lëndëve të paligjshme. Ligji 123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë R. si koncesionar” parashikon se: **Penalitetet për vonesat në shërbim: R. do të jetë subjekt i penaliteteve si më poshtë:** 1. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e sistemeve G60 të vendosura në Durrës, në rastet kur njoftimi për jo disponueshmërinë tejkalon një (1) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t’i vlerësohet një penalitet prej 3,000.00 euro për çdo vonesë; 2. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e sistemeve të tjera G60, në rastet kur njoftimi për jo disponueshmërinë tejkalon dy (2) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t’i vlerësohet në penalitet prej 3,000.00 euro për çdo orë vonesë; 3. Për çdo vonesë të reagimit në lidhje me mosfunksionimin e njësisve të lëvizshme, në raste kur njoftimi për jo disponueshmërinë tejkalon tri (3) orë metrike përgjigje, Rapiscan do t’i vlerësohet një penalitet prej 375.00 euro për çdo orë vonesë; 4. Për çdo periudhë 30-ditore vonese nga data e fillimit të operimeve për çdo vend (sipas shtojcës C “Plani kohor i zbatimit”) Rapiscan do t’i vlerësohet një penalitet prej 30,000.00 euro, me kusht që ky penalitet do të zbatohet vetëm për periudha të plota 30-ditore dhe Rapiscan nuk do të jetë përgjegjës për vonesat lidhur me datën e fillimit të operimeve të cilat janë më pak se 30 ditë.; 5. **R. do t’i vlerësohet një penalitet prej 30,000.00 euro për çdo analizë të dështuar të imazheve, në qoftë se nga shërbimi i skanimit të imazhit rezulton prania e kontrabandës dhe/ose anomali që janë haptazi dhe qartësisht të dukshme dhe kur veprimet e mëposhtme kanë ndodhur sipas radhës në vijim:**

Situata:

- a) Rapiscan dështon në identifikimin dhe regjistrimin e një anomalie ose një kontrabande të tillë; dhe
- b) Autoriteti bazuar në analizën e tij të mëpasshme për të njëjtin imazh identifikon praninë e kontrabandës dhe/ose një anomalie që është haptazi dhe qartësisht e dukshme; dhe
- c) Një kontroll fizik i kryer më pas konfirmon praninë e kontrabandës dhe/ose një anomalie të tillë; dhe
- d) Autoriteti dhe R. kanë, pasi kanë shkëmbyer informacionin e duhur të të dhënave dhe provat, konsiderojnë se penalitetet e përmendura më lart janë një masë e përshtatshme; 6. Pavarësisht pikës 5 më lart vlera e penaliteteve që do të vendosen sipas pikës 5 më lart, do të vlerësohet vetëm për periudha rishikimi të plota dhe nuk do të jetë më e madhe se 200,000.00 (dyqind mijë) euro për çdo periudhë rishikimi. Për qëllim të kësaj shtojce “Periudhë rishikimi” nënkupton periudhat e njëpasnjëshme prej 12 muaj të plotë, duke filluar 6 muaj pas datës në të cilën të gjitha vendet kanë filluar operimin; 7. Nëse në një periudhë rishikimi të caktuar, numri i penaliteteve që vendosen sipas pikës 5 më lart për shkak të një analize të dështuar të imazhit është më i madh se 2% e numrit total të skanimeve të kryera në atë periudhë rishikimi, autoriteti do të njoftojë R. dhe nëse përqindja e analizave të dështuara të imazheve për tre muajt që pasojnë këtë periudhë rishikimi vazhdon që të jetë jo më e vogël se 2%, atëherë autoriteti rezervon të drejtën për zgjidhjen e parakohshme të kësaj kontrate. Gjithashtu, Manuali nr. 18378, date 08.08.2017 te DPD "Mbi procedurat standarde të punës mbi përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe/ose mjeteve të transportit" miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, znj. B. I. me qëllim miratimin e një manuali që

përcakton Procedurat Standarde të Punës (PSP) që drejtojnë përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe mjeteve të tyre të transportit që kalojnë kufijtë e Republikës së Shqipërisë me anë të skanerëve fiks dhe të lëvizshëm që operohen nga shoqëritë “S” SHPK dhe “R.” INC. Kapitulli IV “Analizimi i imazheve të skanimit” parashikon në pikën 5 të tij se: “Imazhi i skanimit mund të përmbajë: “*Mungesë shënimesh “Në këtë rast, analisti i imazheve të shoqërisë koncesionare nuk ka dyshime për parregullsi dhe për rrjedhojë nuk ka asnjë kuadrat të shënuar në imazhin e skanimit” *Shënim të verdhë në kuadratin e përzgjedhur “Në këtë rast analisti i imazheve të shoqërisë koncesionare ka dyshime të bazuara për parregullsi, të cilat në imazhin e skanimit janë pasqyruar në kuadrat të shënuar” *Shënim të kuq në kuadratin e përzgjedhur “Në këtë rast, analisti i imazheve të shoqërisë koncesionare ka dyshime të forta për parregullsi, të cilat në imazhin e skanimit janë pasqyruar në kuadrat të shënuar dhe që mund të paraqesin element rrezikshmërie. Kjo mund të kërkojë sipas rastit marrjen e masave paraprake për ushtrimin e kontroleve më të specializuara” dhe Pika V/1 “Natyra dhe lloji i kontrollit” parashikon procedurat që do të ndiqen nga ana e autoritetit doganor, në varësi të rezultateve të skanimit. “2. Përzgjedhja në procedurat doganore të importit/eksportit apo mjeteve të mjeteve/ngarkesave të pa shoqëruara me deklaratë doganore, tranzitit ku nga skanimi ka rezultuar ngjyra e verdhë vijohet me procedurat e zakonshme të kontrollit doganor dhe saktësimin e dyshimeve për parregullsitë; në rastet e shënimit të kuq bllokohet praktika doganore dhe mjeti dhe njoftohet kryetari i Degës Doganore i cili vë në dijeni Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm Operativ-Hetimor dhe komunikon me strukturat lokale të policisë së shtetit, për të vijuar më pas me kontrollin në bashkëpunim me struktura më të specializuara sipas natyrës së dyshimit të parregullsisë së konstatuar.”

Drejtoria e **Antikontrabandës në DPD** nuk dispononte një databazë përmbledhëse historike të të gjitha rasteve kur kjo strukturë është përfshirë në kontrole që lidhen me rezultatet e skanerit, për të dokumentuar kështu diferencat të mundshme që mund të kenë rezultuar nga përgjigja e skanerit me atë që ka rezultuar pas kontrollit, për të cilat kontrata parashikon penaltete nga 30,000 euro për çdo gabim në skanim, deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës. Informacioni u hartua në vijim të kërkesës së grupit vetëm për vitin 2021 dhe 2022 të kontroleve dhe shoqërimeve të mjeteve për skanim, të raportuara dhe evidentuara nga grupet e terrenit të kësaj drejtorie, ku kanë mbajtur/dorëzuar dhe dokumentacion përkatës vetëm për rastet ku ne dokumentacion është shënuar se ka patur markim nga skaneri, ndërsa për deklaratat e pastra nuk janë raportuar të jenë kryer kontrole që kanë rezultuar me parregullsi nga ana e kësaj drejtorie. Sipas informacionit për vitin 2021 janë raportuar 26 raste si indicie nga skaneri me detyrim në vlerën 12,522,264 lekë, nga të cilat pas kontrollit janë identifikuar parregullsi në 4 raste; dhe për vitin 2022 janë raportuar 7 raste si indicie nga skaneri ku është përllogaritur detyrimi në vlerën 56,716 lekë, nga të cilat pas kontrollit janë identifikuar parregullsi në 2 raste. Këto dobësi të identifikuara në drejtim të sistemit të ngritur për të kontrolluar/verifikuar procesin e punës së lidhur me skanerin, konstatohet se vonojnë vlerësimin e **rezultateve të skanimit, për të gjykuar kështu nëse ka patur ose jo dështime në analizat e imazheve.**

Kriteri:

Ligji 123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave si autoriteti kontraktues dhe shoqërisë R. si koncesionar” “Penalitetet për vonesat në shërbim”, Manuali nr. 18378, date 08.08.2017 te DPD “Mbi procedurat standarde të punës mbi përzgjedhjen dhe skanimin e bazuar në risk të ngarkesave dhe/ose mjeteve të transportit”, Kapitulli IV “Analizimi i imazheve të skanimit”, Pika V/1 “Natyra dhe lloji i kontrollit”.

Ndikimi:	<p>Mos realizimi i krahasimeve mes rezultateve të skanimit dhe atyre të kontrollit fizik; Mos dokumentimi i kryerjes së analizave të mësipërme, në drejtim të vlerësimit të analizës së imazhit të skanimit, në kushtet kur kontrata e nënshkruar parashikon aplikimin e penaliteteve që mund të shkojnë deri në pezullimin e kontratës, e cila përbën shmangie të detyrave funksionale të pozicionit të punës si nga ana e autoriteteve doganore që nuk kanë hartuar dhe nuk kanë dorëzuar këto raporte, ashtu edhe nga ana e strukturave përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e këtyre informacioneve.</p> <p>Mangësitë në implementimin e kontrolleve për identifikimin, monitorimin, raportimin dhe marrjen e masave përkatëse në rastet e gabimeve të mundshme në skanim, mos ekzistenca e një mjedisi kontrolli të nevojshëm që mundëson aplikimin e sistemeve të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe linjave të raportimit me qëllim monitorimin e rezultateve të skanimit, kundrejt gjetjeve kryesore në rastet kur nga ana e skanerit është sinjalizuar për dyshime të bazuara apo të forta për parregullsi.;</p>
Shkaku:	<p>Mos ekzistenca e një mjedisi kontrolli të nevojshëm që mundëson aplikimin e sistemeve të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe linjave të raportimit me qëllim monitorimin e rezultateve të skanimit, kundrejt gjetjeve të konstatuara nga ana e autoritetit doganor në rastet kur nga ana e skanerit nuk është sinjalizuar për dyshime të bazuara apo të forta për parregullsi (pra imazhi ka dalë i pastër) dhe më pas nga kontrollet e degës doganore të sinjalizuara nga ajo vetë apo burime të tjera janë kryer kontrollet fizike që kanë rezultuar me parregullsi (trajtuar si analiza të dështuara imazhesh.</p>
Rëndësia:	<p>E lartë</p> <p>Drejtoria e Antikontrabandës pranë DPD të marrë masat për dokumentimin e të gjitha kontrolleve të kryera nga kjo njësi që lidhen me rezultatin e skanerit, me qëllim verifikimin e saktësisë së skanerit dhe identifikimin e mundshëm të gabimeve në skanim për të cilat kontrata koncesionare parashikon penalitete , duke parashikuar një marzh për kryerjen e kontrolleve fizike të mjeteve të identifikuar nga skaneri si të rregullta (pa ngjyrë), të cilat deri tani janë jashtë fushës së kontrollit të autoriteteve doganore.</p>
Rekomandimi:	

Për këtë çështje z. I.B dhe z. F.SH me shkresën nr.11604/11, prot në DPD datë 04.09.2023, dhe prot në KLSH nr.283/32, datë 07.09.2023, kanë bërë komente dhe shpjegime mbi Projektraportin e auditimit, dhe konkretisht:

Referuar VKM nr. 921, datë 29.12.2014, drejtuesit e kësaj drejtorie kanë përmbushur me korrektësi detyrat duke hartuar planet e shërbimit, urdhrat e punës. Grafikët e shërbimit, planet operacionale dhe ushtrimi i kontrolleve nuk ka detyrimisht qëllim penalizimin e OE por parandalimin, zbulimin dhe goditjen ndaj antikontrabandës, evazionit, etj. Sa më sipër Drejtori i Antikontrabandës nuk ka kompetencë të ndikojë në penalitetin, masën apo procesverbalet e mbajtura nga grupet e kontrollit në terren. Lidhur me mungesën e databazës për skanimet e kryera ju bëjmë me dije se databaza e të dhënave që disponon Drejtoria e Antikontrabandës përfshin edhe kontrollet ku është bërë skanimi i mjeteve nga ana e grupeve të terrenin të cilat i shërbejnë analizave tona. Të dhënat lidhur me kontrollet e kryera me objekt skanimin e mjetit dhe rezultatet përkatëse janë të dhëna që disponohen nga degët doganore. Informacioni ynë paraqet të dhëna vetëm ku ka patur markim. Drejtoria e Antikontrabandës nuk e ka detyrë funksionale mbajtjen e këtij regjistri , konfirmuar edhe nga Manuali nr. 8, datë 08.08.2017.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me përgjegjësinë e drejtuesit të drejtorisë, sqarojmë se referuar rregullores së DPD dhe kontratës së punës, pjesë e detyrave të drejtorit është edhe mbikëqyrja/monitorimi i aktivitetit të drejtorisë. Për sa i përket koncesionit të skanerit, rekomandimi i lënë lidhur me procesin e deritanishëm të ndjekur nga Drejtoria e Antikontrabandës për ruajtjen dhe përpunimin e informacionit lidhur me verifikimet e kryera të lidhura ngushtë me procesin e skanerit, duke shtuar këtë databazë me të dhëna që paraqesin edhe rezultatin e raportuar nga skaneri krahasimisht me atë që ka rezultuar nga

kontrolli, kanë për qëllim një monitorim sa më të plotë dhe efektiv të kontratës koncesionare për skanimin në dogana, ku sikundër cituar edhe në gjetjen e auditimit, në raste të identifikimit të gabimeve në interpretimin e imazheve të skanuara parashikohen edhe penalitete që shkojnë deri në pezullim të kontratës.

2.6. Auditimi i përrputhshmërisë ligjore të procedurave të ndjekura nga ana e drejtorive të kontrollit

Drejtoria Teknike e Akcizës

Të ardhurat nga akciza gjatë vitit 2022 sipas evidencës së vënë në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, në total kanë qenë në vlerën e rreth 54 milion lekëve sipas raporteve të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave DPD.

Sikurse evidentohet në tabelë rreth 34 milion lekë ka qenë akciza e mbledhur nga importi dhe rreth 20 milion lekë nga prodhimi vendas, dhe sipas produkteve në mënyrë të detajuar jepet në tabelë ku sikurse evidentohet peshën më të madhe e zënë produktet energjetike dhe ato të duhanit.

Pasqyra nr. 33: Akciza paguar sipas produkteve

Në lekë

Burimi	Produkti	Akciza Paguar 2022
Import	Produkte energjetike	20,628,556,603
	Produkte të duhanit	10,204,439,458
	Birrë	1,667,315,458
	Pije alkolike	409,924,443
	Verë/shampanjë/spumante	292,298,246
	Kafe	199,504,607
	Goma	159,380,637
	Akumulator	79,578,680
	Fishekzjarre	22,242,864
	Alkol etilik	13,820,681
	Total	33,677,061,677
Prodhim Vendas	Produkte të duhanit	12,068,584,705
	Produkte energjetike	6,803,940,986
	Birrë	701,629,814
	Kafe	244,242,512
	Pije alkolike	236,772,238
	Verë/shampanjë/spumante	56,494,379
	Raki	10,247,265
	Alkol etilik	652,209
	Total	20,122,564,108
Total		53,799,715,785

Burimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, DPD

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion evidenca me vendimet e kontabilizuara të borxhit me shkelje në fushën e akcizës deri në 2022 dhe ato të dala gjatë vitit 2022, nga përpunimi i të cilave është evidentuar si në tabelat më poshtë.

Pasqyra 34: Detyrime të papaguara nga subjektet e akcizës deri më 31.12.2022

Dega Doganore	Numër Rastesh	Detyrime Doganore	Penalitetet	Kamatë Vonesa	Total Borxhi	Shuma e Paguar	Shuma për t'u Paguar
TIRANË	141	3,783,476,399	7,095,613,802	2,115,791,843	12,994,882,044	34,064,334	12,960,817,710
RINAS	-	-	-	-	-	-	-
DURRËS	55	68,335,139	242,960,695	95,815,179	407,111,013	2,840,909	404,270,104
SHKODËR	35	24,341,184	124,831,357	33,524,474	182,697,015	795,677	181,901,338
POGRADEC	-	-	-	-	-	-	-
KAKAVIJË	18	3,862,133	13,457,299	2,757,369	20,076,801	476,556	19,600,245
KORCË	13	118,113,661	48,819,078	32,237,132	199,169,871	8,875,852	190,294,019
KAPSHITICË	2	616,400	1,753,905	164,200	2,534,505	-	2,534,505
VLORË	34	119,224,134	319,484,112	43,642,388	482,350,634	143,181	482,207,453
FIER	106	4,752,673,318	7,356,613,397	1,730,205,028	13,839,491,742	92,251,712	13,747,240,030
SARANDË	7	12,874,945	29,584,885	2,201,769	44,661,599	240,514	44,421,085
ELBASAN	20	14,567,791	34,654,200	14,379,286	63,601,277	400,848	63,200,429
LEZHË	11	16,937,606	50,944,040	24,384,435	92,266,081	890,370	91,375,711
BERAT	21	283,344,645	703,455,534	267,741,174	1,254,541,353	56,624,751	1,197,916,602
KUKËS	4	139,526	1,353,954	348,773	1,842,253	249,682	1,592,571
PESHKOPI	2	111,222	462,444	135,927	709,593	10,000	699,593
TRE URAT	14	1,691,109	6,890,737	839,906	9,421,752	286,750	9,135,002
TOTALI	483	9,200,309,212	16,030,879,439	4,364,168,882	29,595,357,532	198,151,136	29,397,206,396

Burimi: Sektori i Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, DPD.

Deri në datë 31.12.2022 totali i borxhit nga detyrimet dhe penalitetet e evidentuara në fushën e akcizës ka qenë në vlerën e 29,397 milion lekë, ndër të cilat degët doganore me vlerë më të lartë janë Tirana, Fieri dhe Berati.

Ndërkohë nga evidenca e vënë në dispozicion nga Sektori i Monitorimit të Borxhit konstatohet të kenë dalë 22 vendime në total gjatë vitit 2022 me shkelje në fushën e akcizës detyrimi për të cilat kap vlerën rreth 50 milion lekë dhe penalitetet mbi to vlerën e rreth 153 milion lekë dhe në total rreth 163 milion lekë.

Pasqyra 35: Vendime të kontabilizuara dalë në 2022 për akcizën

Njesia monetare

NIPT-i	Detyrime Doganore	Penalitetet	Kamatë Vonesa	Shuma Totale	Shuma e paguar	Për t'u paguar	Datë
J....F	4,234,158	19,481,152		23,715,310	4,234,158	19,481,152	7/15/2022
L....T	6,192,000	12,384,000	51,728	18,627,728	-	18,627,728	9/30/2022
K.....Ë	25,634	76,902		102,536	-	102,536	11/16/2022
K.....M	3,272	-	-	3,272	-	3,272	09.03.2022
L....T	17,080	50,000	506	67,586	-	67,586	17.03.2022
K.....M	20,774	262,322	-	283,096	173,796	109,300	28.02.2022
K.....B	13,800	200,000	0	213,800	80,461	133,339	11.08.2022
H.....N	330,000	1,650,000	8,922	1,988,922	-	1,988,922	29.03.2022
J.....P	845,650	2,536,950	7,321	3,389,921	-	3,389,921	12/7/2022
K....N	19,920	59,760	498	80,178	-	80,178	2/22/2022

K....Q	11,750	35,250	-	47,000	11,750	35,250	8/2/2022
J....U	37,168,558	111,505,673	1,412,402	150,086,632	37,168,558	112,918,074	17.01.2022
L....E	-	50,000	-	50,000	-	50,000	28.04.2022
L....E	12,420	50,000	196	62,616	12,420	50,196	27.07.2022
L....M	12,080	36,240	585	48,905	38,560	10,345	24.02.2022
L....A	97,075	291,225	2,473	390,773	-	390,773	16.02.22
L....I	78,045	200,000	3,139	281,184	-	281,184	12.01.2022
L....I	1,051,860	3,155,580	42,311	4,249,751	-	4,249,751	12.01.2022
L....I	55,344	166,032	2,226	223,602	-	223,602	12.01.2022
K....S	12,120	200,000	462	212,582	-	212,582	12.01.2022
K....S	98,632	200,000	3,762	302,394	-	302,394	12.01.2022
K....D	-	50,000	-	50,000	-	50,000	03.03.2022
Totali	50,300,172	152,641,086	1,536,532	204,477,789	41,719,703	162,758,086	31.12.2022

Burimi: Sektori i Monitorimit të Borxhit, Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, DPD.

Gjithashtu përveç evidencës së mësipërme gjatë vitit 2022 kanë dalë edhe 75 vendime të tjera me debitor akcize të cilët janë pakësuar gjatë vitit 2022 konkretisht për vlerën totale të rreth 35 milion lekëve, prej të cilave 28 milion lekë detyrim dhe 6.6 milion penalitet.

DREJTORIA TEKNIKE E AKCIZËS

Gjatë vitit 2022 Drejtoria Teknike e Akcizës ka funksionuar me dy sektor, Sektori i Autorizimeve dhe Sektori i Aplikacioneve, detyrat funksionale të të cilëve përcaktohen në rregulloren nr.146 datë 07.05.2018 “Mbi organizimin e brendshëm të DPD”, neni 66.

Pasqyra 36: Struktura funksionale plan/fakt për DTA

Drejtoria Teknike Akcizës	Drejtor	Plan	Fakt
		1	1
Sektori i Aplikacioneve	Përgjegjës	1	1
	Specialist	3	3
Sektori i Autorizimeve	Përgjegjës	1	1
	Specialist	2	2
Total		8	8

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, DPD.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion plani i punës dhe raporti i veprimtarisë së drejtorisë për 2022, në të cilin evidentohet si më poshtë.

Sektori i Aplikacioneve

- janë dhënë /lëshuar 114 autorizime për përfitimin e nivelit të diferencuar të akcizës;
- janë dhënë/lëshuar 44 autorizime të përjashtimit nga akciza Trupin Diplomatik në bazë të kuotave të miratuara nga Ministria e Jashtme Përjashtimet nga akciza për Trupin Diplomatik;
- janë krijuar kodit shtesë për 1241 përjashtime nga akciza të karburantit të anijeve të peshkimit;

- janë regjistruar 727 garanci në sistemin informatik doganor të dërguara nga degët doganore për depozituesit e miratuar si dhe garancitë për pullat fiskale;

- janë bërë aplikime në sistemin e prodhimit dhe shpërndarjes së pullave SICPATRACE si më poshtë: Porosi pulla fiskale – 2256 porosi të miratuara; SKU- 204 aplikime; Shtesë furnitori- 237 aplikime; Krijim profili- 149 aplikime.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion evidencat e detajuara mbi procedurat e realizuara nga sektori mbi nivelet e diferencuar, nga të cilat janë përzgjedhur për testim me zgjedhje rastësore 6 autorizime si më poshtë:

Subjekti “W” SHPK me Nipt L....G ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00008842 datë 03.03.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur në datë 13.03.2022 vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues nivelin e prodhimit vjetor 2021 për 357 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 18.03.2022.

Subjekti “A” SHPK me Nipt K....K ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00007797 datë 27.01.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur në datë 27.01.2022 vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues (pa përkthyer) për nivelin e prodhimit vjetor 2021 më të ulët se 10,000 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 01.02.2022.

Subjekti “A” SHPK me Nipt K...K ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00008046 datë 06.02.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur në datë 05.02.2022 vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues për nivelin e prodhimit vjetor 2021 më të ulët se 10,000 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 11.02.2022.

Subjekti “V” SHPK me Nipt K...O ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00007793 datë 27.01.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur në datë 03.02.2022 vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues nivelin e prodhimit vjetor 2021 më të ulët se 10,000 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 08.02.2022.

Subjekti “A” SHPK me Nipt K....I ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00007632 datë 21.01.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues nivelin e prodhimit vjetor 2021 më të ulët se 10,000 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 03.02.2022.

Subjekti “P” SHPK me Nipt M....R ka paraqitur me shkresën nr.ref. DPD-2022-00015432 datë 31.10.2022 kërkesën për përfitim të nivelit të diferencuar të akcizës dhe ka bashkëngjitur vërtetimin e prodhimit të verës lëshuar nga kantina dhe miratuar nga autoritetet e vendit importues nivelin e prodhimit vjetor 2021 më të ulët se 10,000 HL, e cila është miratuar nga DPD datë 01.11.2022.

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës lista e deklaratave doganore tip DSHA me procedurë rimbursimit e akcizës për mallra të akcizës të prodhimit vendas për nevoja vetjake si dhe rimbursime akcize në procedura importi për të gjithë territorin doganor në RSH për vitin 2022, informacion i cili në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Pasqyra 37: Pagesat për rimbursim akcize 2022

Akciza e rimbursuar	Vlera (lekë)
Akcizë e rimbursuar për serat dhe industrinë	224,241,781
Akcizë e rimbursuar për ambasadat	9,670,960
Totali	233,912,741

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPD

Sikurse evidentohet edhe në tabelë akciza e rimbursuar për vitin 2022 ka qenë në vlerën e 234 milion lekëve, konfirmuar kjo edhe në treguesit fiskal të konsoliduar 2022.

Nga auditimi është konstatuar se për këtë vendimmarrje me risk të lartë dhe efekt të drejt për drejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit nuk është zhvilluar asnjë kontroll për periudhën nga Sektori Produkteve Energjetike në DKAP për të cilin urdhri nr.146 datë 07.05.2012 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, në nenin 73, pika 4.3 ‘Detyrat funksionale të Sektorit të Produkteve Energjetike’ përcakton se “Sektori i Produkteve Energjetike ka këto detyra funksionale: -Monitoron zbatimin e kushteve si dhe respektimin nga operatorët e akcizës të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve brenda fushës së kompetencës”, si dhe strukturat e Auditit të Brendshëm në DPD.

Nga auditimi i evidencës së rimbursimeve të akcizës me 115 rekorde, 85 prej të cilave nga përfaqësitë diplomatike dhe 30 nga operatorët ekonomik subjekt i parashikimit ligjor, vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës kërkesat të sjella nga Degët Doganore rezultojnë të jenë paguar në një afat kohor nga 0 ditë (pra brenda ditës) deri në 66 ditë nga mbërritja e kërkesës në DPD.

Sa më sipër janë evidentuar 4 kërkesa të miratuara në shkelje të afatit 45 ditor përcaktuar në ligjin nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2 në të cilat citohet se ‘vendimi për një kërkesë për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.

Pasqyra 38: Kërkesa për rimbursim akcize miratuar jashtë afatit

Nr.	Subjekti	Miratim DPD	Dorëzuar nga DD	Shuma (lekë)	Afati (ditë)
1	A	08.01.2022	26.05.2022	302,290	67
2	R	06.06.2022	01.04.2022	3,468,343	66
3	R	06.06.2022	01.04.2022	496,059	66
4	R	31.01.2022	06.12.2021	9,065,481	56
	Total			13,332,173	

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPD.

Nga auditimi i evidencës së rimbursimit të akcizës vendosur në dispozicion është konstatuar se ka thyerje në radhën e shlyerjes sipas parimit FIFO (First In First Out), pasqyruar në anekset bashkëngjitur.

Nga evidenca e vendosur në dispozicion janë përzgjedhur për testim 4 dosje rimbursimi bazuar në vlerën e rimbursuar dhe afatin e miratimit, si më poshtë:

Pasqyra 39: Dosje rimbursim akcize

Nr.	Subjekti	Urdhër DPD	Datë DPD	Dega Doganore	Kërkesa DD	Data DD	Shuma (lekë)	Afati (ditë)
1	R	6316/1	6.6.2022	Elbasan	6316	1.4.2022	3,468,343	66
2	R	16775/1	27.9.2022	Elbasan	16775	27.9.2022	2,104,181	0
3	A	5338/1	31.3.2022	Fier	5338	16.3.2022	21,203,368	15
4	A	15681/1	1.9.2022	Fier	15681	31.8.2022	7,536,263	1
	Total						34,312,155	

Burimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, DPD.

-Sikurse evidentohet edhe në tabelën më sipër kërkesa për rimbursim e ardhur nga DD Elbasan për operatorin “R” nr.6316 datë 01.04.2022 me vlerën 3,468,343 lekë është miratuar në DPD nga DP me urdhrin nr.6316/1 datë 06.06.2022 pra 66 ditë pas dorëzimit të kërkesës dhe dosjes nga DD Elbasan. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës në dosje gjendet miratimi i shumës për rimbursim nga DDE, urdhri i rimbursimit nga DDE, kërkesa për çelje fondi për rimbursim drejtuar DPD, urdhri DP për rimbursim dhe urdhër xhirimi nr.62 datë 09.06.2022.

-Kërkesa për rimbursim e ardhur nga DD Elbasan për operatorin “R” nr.16775 datë 27.09.2022 me vlerën 2,104,181 lekë është miratuar në DPD nga DP me urdhrin nr.16775/1 datë 27.09.2022, pra në të njëjtën ditë që është dorëzuar kërkesa dhe dosja nga DD Elbasan. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës në dosje gjendet miratimi i shumës për rimbursim nga DDE, urdhri i rimbursimit nga DDE, kërkesa për çelje fondi për rimbursim drejtuar DPD, urdhri DP për rimbursim dhe urdhër xhirimi nr.105 datë 03.10.2022.

-Kërkesa për rimbursim e ardhur nga DD Fier për operatorin A nr.5338 datë 16.03.2022 me vlerën 21,203,368 lekë është miratuar në DPD nga DP me urdhrin nr.5338/1 datë 31.03.2022 pra 15 ditë pas dorëzimit të kërkesës dhe dosjes nga DDFier. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës në dosje gjendet miratimi i shumës për rimbursim nga DDF, urdhri i rimbursimit nga DDF, kërkesa për çelje fondi për rimbursim drejtuar DPD, urdhri DP për rimbursim dhe urdhër xhirimi nr.32 datë 05.04.2022.

-Kërkesa për rimbursim e ardhur nga DD Fier për operatorin “A” nr. 15681 datë 31.8.2022 me vlerën 7,536,263 lekë është miratuar në DPD nga DP me urdhrin nr.15681/1 datë 1.9.2022, pra vetëm 1 ditë pas dorëzimit të kërkesës dhe dosjes nga DD Fier. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës në dosje gjendet miratimi i shumës për rimbursim nga DDF, urdhri i rimbursimit nga DDF, kërkesa për çelje fondi për rimbursim drejtuar DPD, urdhri DP për rimbursim dhe urdhër xhirimi nr.102 datë 06.09.2022.

Spektori i Autorizimeve

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i janë vendosur në dispozicion evidencat e detajuara mbi procedurat e realizuara nga sektori për autorizimet e lëshuara, refuzuara, revokuara, modifikuara dhe pezulluara, përmbledhur në vijim.

Janë lëshuar 49 autorizime, prej të cilave 17 për magazinë fiskale prodhimi, 3 për magazinë fiskale stokimi dhe 29 për pritës të regjistruar.

Është në proces 1 aplikim për magazinë fiskale prodhimi, janë refuzuar 3 aplikime, janë revokuar 29 autorizime, janë pezulluar 20 autorizime, janë bërë 23 modifikime/shtesa autorizimi dhe është rinovuar afati për 230 pritës të regjistruar.

Nga sa më sipër janë përzgjedhur për testim me zgjedhje rastësore procedurat si më poshtë:

1. I.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
2. S. - Autorizim për magazinë fiskale stokimi Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale stokimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
3. S.T.- Autorizim për magazinë fiskale prodhimi Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
4. B.G. -Autorizim për magazinë fiskale prodhimi. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
5. D.F. -Autorizim për magazinë fiskale prodhimi. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
6. A. -Autorizim për magazinë fiskale prodhimi. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5), llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia.
7. E. - Autorizim për magazinë fiskale prodhimi. Nga auditimi u konstatua se aplikimi operatorit në datë 27.09.2022 është ende i pa miratuar nga DP, edhe pse miratimet sipas strukturës janë bërë që në datën 13.12.2022. Nga auditimi u konstatua se në dosjen e procedurës së miratimit gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinioni DD (Aneksi 5) datë 11.10.2022, llogaritja e garancisë nga DD dhe garancia. Sa më sipër konstatohet se edhe pse është paraqitur nga operatori i gjithë dokumentacioni i kërkuar dhe i domosdoshëm për miratim të aplikimit për magazinë fiskale prodhimi ende nuk është marrë vendimi për kërkesën e operatorit, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, në të cilat citohet se *‘vendimi për një*

kërkesë të personit për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’.

8. H.- Kërkesë për ndryshim adrese në autorizim. Nga auditimi u konstatua se në dosje gjendet dokumentacioni justifikues dhe konkretisht ngritja e grupit të punës (Aneksi 1), konfirmimi dokumentacionit për hapje magazinë fiskale prodhimi (Aneksi 2), procesverbali i kryerjes së vizitës në ambientet e operatorit me qëllim verifikimin teknik (Aneksi 3), relacioni përmbledhës (Aneksi 4), opinionin DD (Aneksi 5) dhe ekstrakti QKR, kontrata dhe foto të ambientit.

9. I.- Kërkesë për shtim kategorie T403 në autorizim, si efekt i ndryshimeve ligjore në kategori produkti me ligjin nr.114/2021 “Për akcizat në RSH”. Në dosje gjendet autorizimi magazinës, korrespondenca me operatorin, relacioni shpjegues i DTA për DP dhe ndryshimet në kode miratuar nga DP.

10. E.- Pushim vlefshmërie autorizimi. Në dosje gjendet ekstrakti e regjistrimit tregtar të subjektit, vendimi nr.36 datë 12.07.2022 i DD Korçë me detyrim akcize 845,650 lekë dhe penalitet 2,536,950 lekë, vendimi nr.935 datë 11.08.2022 i DDK për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, kërkesa e DDK nr.17602 datë 05.10.2022 për sekuestrimin e garancisë së akcizës dhe pezullimin e autorizimit të akcizës nr.AL2S120009009, relacioni shpjegues për DP hartuar nga sektori autorizimeve datë 14.10.2022 dhe shkresa nr.17602/1 datë 18.10.2022 e DP për pezullim autorizimi. Gjithashtu gjendet relacioni shpjegues i sektorit të autorizimeve për DP mbi operatorin, si dhe shkresa nr.17602/8 datë 07.12.2022 e DP për pushimin e vlefshmërisë së autorizimit.

11. S.- Pushim vlefshmërie autorizimi. Në dosje gjenden ekstraktet e regjistrimit tregtar të subjektit, shkresa nr.3971 datë 12.12.2022 me opinionin e DD Vlorë mbi revokimin e autorizimit nr.16818/1 datë 07.01.2013 të depozitesit të miratuar sipas të cilit operatori ka pezulluar veprimtarinë tregtare, magazina nuk funksionon më që prej vitit 2014, garancia për mbulimin e detyrimeve nuk është rinovuar dhe operatori rezulton debitor për 301,024 leke detyrime dhe 924,780 lekë penalitet. Gjithashtu gjendet relacioni shpjegues i sektorit të autorizimeve për DP mbi operatorin, si dhe shkresa nr.21642/1 datë 23.12.2022 e DP për pushimin e vlefshmërisë së autorizimit.

Sa i takon zbatimin të afateve procedurale në miratimin e autorizimeve për dosjet e audituara rezultojnë si në tabelën më poshtë.

Pasqyra 40: Afate miratimi të magazinave fiskale

Operatori	Datë Aplikimi	Datë opinon DD për plotësim dokumentacioni	Datë miratimi	Diferenca (2)-(3)
I	13.06.2022	20.06.2022	01.07.2022	11
S	16.11.2022	13.12.2022	30.12.2022	17
S.T	25.10.2022	28.10.2022	21.11.2022	24
B	24.05.2022	30.05.2022	09.11.2022	101
D.F	21.12.2022	03.02.2022	23.02.2022	20
A	15.05.2022	20.05.2022	10.06.2022	21
E	27.09.2022	11.10.2022	S’ka	Mbi 260

Burimi: Drejtoria Teknike e Akcizës, DPD.

Gjatë auditimit është kërkuar informacion nga sektori mbi monitorimin periodik të degëve doganore për afatet e garancive të autorizimeve për magazinat fiskale, si dhe korrespondenca me degët. Është vendosur në dispozicion korrespondenca me degët sipas të cilës DTA ka kërkuar nga Degët Doganore me shkresën nr.4727 datë 07.03.2022 dhe shkresën nr.10764 datë 03.06.2022

“informacion mbi operatorët që nuk kanë rinovuar garancitë, si dhe nisjen e procedurave të revokimit të autorizimeve për operatorët që nuk e kanë rinovuar” dhe në përgjigje të së cilës janë kthyer nga degët shkresat respektive sipas të cilave DD Tiranë ka evidentuar 21 operator me afat garancie të përfunduar, DD Shkodër ka evidentuar 6 operator me afat garancie të përfunduar, DD Sarandë nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Pogradec nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Lezhë nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Kukës ka evidentuar 1 operatorë me afat garancie të përfunduar, DD Korçë nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Kakavij ka evidentuar 2 operator me afat garancie të përfunduar, DD Fier ka evidentuar 3 operatorë me afat garancie të përfunduar, DD Elbasan nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Durrës ka evidentuar 6 operator me afat garancie të përfunduar, DD Bllatë nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar, DD Berat nuk ka evidentuar operator me afat garancie të përfunduar dhe DD Tre Urat ka evidentuar 1 operator me afat garancie të përfunduar.

Është kontrolluar me zgjedhje në sistem afati vlefshmërisë së garancisë së magazinës fiskale për 125 operator ekonomik, të cilët edhe janë kontrolluar gjatë vitit nga DKA.

Nga auditimi është konstatuar se nga 125 operator me autorizim magazine fiskale 8 prej tyre gjatë 2022 kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të pa mbuluar me garanci të vlefshme, në mos përmbushje të përcaktimeve ligjore dhe ende nuk kanë nisur procedurat e revokimit të autorizimit nga degët doganore përkatëse.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, në nenin 51 “Procedurat e aplikimit dhe të autorizimit të magazinave fiskale” përcakton se “3.Kërkesa për marrjen e autorizimit të magazinës fiskale i drejtohet zyrës doganore territorialisht kompetente të vendit ku ndodhet magazina e prodhimit, përpunimit apo stokimit/depozitimit të produkteve të akcizës. 4. Kërkesës tip duhet t’i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme: gj) Dokumenti i garancisë;” si dhe ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, në nenin 20, pika 4, 5 dhe pika 6 përcakton se “4.Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni sjell si pasojë revokimin e autorizimit; 6.Autoritetet doganore mund të revokojnë një autorizim për depozituesin e miratuar nëse: a) depozituesi i miratuar nuk plotëson më kushtet e vendosura në autorizimin e depozituesit të miratuar ose nuk siguron sistemin e duhur për monitorimin e stokeve, ose kur nuk plotëson listat e stokeve brenda afateve kohore të përcaktuara në autorizimin e depozituesit të miratuar;b) ai nuk depoziton garancinë e llojit të duhur për pagesën e akcizës ose nuk depoziton një garanci në shumën e nevojshme për të paguar akcizën;c) nuk ekzistojnë më kushtet për dhënien e një autorizimi për depozitues të miratuar;”

Gjithashtu VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, në nenin 60 “Pushimi i vlefshmërisë së autorizimit për magazinë fiskale në rastin e revokimit nga autoritetet doganore” përcakton në mënyrë të detajuar edhe procedurën që duhet ndjekur nga autoritetet doganore ku konkretisht “3. Me konstatimin e njërit prej rasteve të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ë”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, dhe në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 6, të nenit 20, të ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për pezullimin e autorizimit, për një afat deri në 30 ditë. Ky vendim paraqet arsyet e këtij pezullimi dhe u njoftohet operatorit ekonomik dhe zyrës doganore mbikëqyrëse, e cila merr të gjitha masat e duhura për të siguruar që gjatë këtij afati kohor operatori ekonomik të mos kryejë asnjë aktivitet tregtar në magazinën fiskale. 4. Kur operatori ekonomik nuk ka mundur të rregullojë situatën brenda 30 ditëve, por siguron që kushtet mund të përmbushen nëse afati i pezullimit zgjatet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mund të shtyjë afatin e pezullimit edhe për 30 ditë të tjera.5. Nëse brenda afatit të pezullimit operatori ekonomik plotëson kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen

sipas ligjit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave anulon pezullimin dhe informon operatorin ekonomik dhe zyrën doganore mbikëqyrëse lidhur me këtë vendim.6. Nëse brenda këtij afati kohor, të përcaktuar në pikat 3 dhe 4, operatori ekonomik nuk plotëson mangësitë që kanë çuar në pezullimin e autorizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave merr vendim për revokimin e autorizimit: a) duke njoftuar zyrën doganore mbikëqyrëse dhe depozituesin e miratuar në lidhje me vendimin e revokimit; b) duke përcaktuar detyrat e zyrës doganore mbikëqyrëse për procedurat e mëtejshme sipas nenit 61, të këtij vendimi; c) duke përcaktuar detyrimet e depozituesit të miratuar për procedurat e mëtejshme sipas nenit 61, të këtij vendimi; ç) duke përcaktuar të drejtën e depozituesit të miratuar për t'u ankimuar dhe organin pranë të cilit ushtrohet ky ankimim.”

Pasqyra 41: Vlefshmëria e garancive të magazinave fiskale

Nr.	Operatori	NIPT	Tipi i magazinës fiskale	Fillimi i afatit të vlefshmërisë	Afati gjatë 2022	Vlefshmëria në vazhdim	D.D
1	I	K...Q	Stokim	5/10/2021	3/10/2022	Pa rinovuar	Tiranë
2	M.D	K...J	Prodhim	15/12/2021	25/11/2022	Pa rinovuar	Tre Urat
3	LA	K...N	Prodhim	7/1/2022	24/12/2022	Pa rinovuar	Durrës
4	AL.G	K...B	Prodhim	7/1/2020	5/1/2021	Pa rinovuar	Durrës
5	E.H	L...D	Prodhim	14/02/2017	6/2/2018	Pa rinovuar	Berat
6	P.P	L...M	Prodhim	24/12/2021	21/12/2022	Pa rinovuar	Lezhë
7	U	J...N	Prodhim	27/03/2020	Pa rinovuar	Pa rinovuar	Lezhë
8	E.R	K...J	Prodhim	31/12/2021	29/12/2022	Pa rinovuar	Lezhë

Burimi: Drejtoria e Teknikës Akcizës, DPD.

E gjithë praktika procedurale mbi magazinat fiskale dhe garancitë për to ndiqet nga Sektori i Autorizimeve sikurse përcakton rregullorja dhe nga intervista në subjekt rezultoi që vetëm vlera e garancisë të hidhet në sistem nga Sektori Aplikacioneve.

Sipas nenit 20 të ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Magazinat fiskale janë objekt mbikëqyrjes dhe kontrollit doganor”.

Sa më sipër nga auditimi është konstatuar se nga DPD nuk është bërë një monitrim periodik mbi Degët Doganore dhe subjektet mbi zbatimin e kushteve për lëshimin e autorizimit të magazinës fiskale në përgjithësi dhe afatit të garancisë së tyre në veçanti.

1. Titulli i Gjetjes:

Mos kryerja e kontroleve për procedurat e miratimit të kërkesave për rimbursim akcize nga Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe strukturat e Auditit të Brendshëm në DPD.

Situata:

Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2022 janë miratuar 115 kërkesa në vlerën e 234 milion lekëve për rimbursim akcize, për të cilat nuk është ushtruar asnjë kontroll për procedurat e miratimit të këtyre kërkesave nga Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe strukturat e Auditit të Brendshëm në DPD. Gjithashtu janë evidentuar 4 kërkesa të miratuara jashtë afatit 45 ditor dhe thyerje në radhën e shlyerjes, vendimmarrje kjo me risk të lartë dhe efekt të drejt për drejtë në shpenzimet e buxhetit të shtetit nuk është zhvilluar asnjë kontroll për periudhën nga Sektori Produkteve Energjetike në DKAP për të cilin urdhri nr.146 datë 07.05.2012 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, në nenin 73, pika 4.3 ‘Detyrat funksionale të Sektorit të Produkteve Energjetike’ përcakton se “Sektori i Produkteve Energjetike ka këto detyra funksionale:-Monitoron zbatimin e kushteve si dhe respektimin nga operatorët e akcizës të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve brenda fushës së kompetencës”, si dhe strukturat e Auditit të Brendshëm në DPD. Gjithashtu janë evidentuar 4 kërkesa të miratuara në shkelje të afatit 45 ditor përcaktuar në ligjin nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2 në të cilat citohet se

‘vendimi për një kërkesë për zbatimin e këtij ligji, do të merret nga autoritetet doganore kompetente jo më vonë se 45 ditë nga data në të cilën i gjithë informacioni i kërkuar prej tyre është paraqitur’, si dhe nga auditimi i evidencës së rimbursimit të akcizës vendosur në dispozicion është konstatuar se ka thyerje në radhën e shlyerjes sipas parimit FIFO (First In First Out), pasqyruar në anekset bashkëngjitur.

Kriteri:

Ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2; Urdhri nr.146 datë 07.05.2012 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, në nenin 73, pika 4.3.

Impakti:

Mungesë kontrolli dhe sigurie në procedurat e rimbursimit të akcizës dhe miratimit të kërkesave.

Shkaku:

Mos zbatimi i kriterëve dhe detyrave funksionale.

Rëndësia

E lartë

Rekomandimi:

Drejtoria e Auditit të Brendshëm dhe Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Pas zhdoganimit të identifikojnë rimbursimin e akcizës në fushat me risk të lartë dhe të marrin masat për kontrollin periodik të procedurave të miratimit të kërkesave për rimbursim.

2. Titulli i Gjetjes:

Mangësi të konstatuara në vlefshmërinë e garancive të autorizimeve për magazinat fiskale.

Situata:

Gjatë auditimit është kërkuar informacion nga sektori mbi monitorimin periodik të degëve doganore për afatet e garancive të autorizimeve për magazinat fiskale, si dhe korrespondenca me degët dhe është kontrolluar me zgjedhje në sistem afati vlefshmërisë së garancisë së magazinës fiskale për 125 operator ekonomik, të cilët edhe janë kontrolluar gjatë vitit nga DKA. Nga auditimi është konstatuar se nga 125 operator me autorizim magazine fiskale 8 prej tyre gjatë 2022 kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të pa mbuluar me garanci të vlefshme, në mos përmbushje të përcaktimeve ligjore dhe ende nuk kanë nisur procedurat e revokimit të autorizimit nga degët doganore përkatëse. VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, në nenin 51 “Procedurat e aplikimit dhe të autorizimit të magazinave fiskale” përcakton se “3.Kërkesa për marrjen e autorizimit të magazinës fiskale i drejtohet zyrës doganore territorialisht kompetente të vendit ku ndodhet magazina e prodhimit, përpunimit apo stokimit/depozitimit të produkteve të akcizës. 4. Kërkesës tip duhet t’i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme: gj) Dokumenti i garancisë;” si dhe ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, në nenin 20, pika 4, 5 dhe pika 6 përcakton se “4.Mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni sjell si pasojë revokimin e autorizimit; Gjithashtu VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, në nenin 60 “Pushimi i vlefshmërisë së autorizimit për magazinë fiskale në rastin e revokimit nga autoritetet doganore” përcakton në mënyrë të detajuar edhe procedurën që duhet ndjekur nga autoritetet doganore. Konkretisht 8 rastet e evidentuara jepen në tabelën më poshtë.

Nr.	Operatori NIPT	Tipi i magazinës fiskale	Fillimi i afatit të vlefshmërisë	Afati gjatë 2022	D.D
1	K...Q	Stokim	5/10/2021	3/10/2022	Tiranë

2	K....J	Prodhim	15/12/2021	25/11/2022	Tre Urat
3	K....N	Prodhim	7/1/2022	24/12/2022	Durrës
4	K....B	Prodhim	7/1/2020	5/1/2021	Durrës
5	L....D	Prodhim	14/02/2017	6/2/2018	Berat
6	L....M	Prodhim	24/12/2021	21/12/2022	Lezhë
7	J....N	Prodhim	27/03/2020	Pa rinovuar	Lezhë
8	K....J	Prodhim	31/12/2021	29/12/2022	Lezhë

E gjithë praktika procedurale mbi magazinat fiskale dhe garancitë për to ndiqet nga Sektori i Autorizimeve sikurse përcakton rregullorja dhe nga intervista në subjekt rezulton që vetëm vlera e garancisë të hidhet në sistëm nga Sektori Aplikacioneve, veprimtaria e të cilin nuk lidhet me magazinat fiskale.

Sipas nenit 20 të ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Magazinat fiskale janë objekt mbikqyrjes dhe kontrollit doganor”.

Sa më sipër nga auditimi është konstatuar se nga DPD nuk është bërë një monitorim periodik mbi Degët Doganore dhe subjektet mbi zbatimin e kushteve për lëshimin e autorizimit të magazinës fiskale në përgjithësi dhe afatit të garancisë së tyre në veçanti.

Gjithashtu sa i takon afateve procedurale në miratimin e autorizimeve për magazina fiskale nga 7 dosje të përzgjedhura 2 prej tyre janë jashtë afatit ligjor.

Ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, në nenin 20, pika 4, 5 dhe pika 6;

Kriteri:

VKM nr.612 datë 05.09.2012“Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 51, pika 3 dhe 4, neni 60, pika 3,4,5 dhe 6.

Impakti:

Autorizime magazinash fiskale të vlefshme pa garanci të vlefshme.

Shkaku:

Mos zbatim i procedurës ligjore nga Degët Doganore, mos monitorim periodik dhe mos marrje masash shtrënguese për degët.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

DPD të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në çështjen e autorizimeve të magazinave fiskale të cilat rezultojnë të pa mbuluar me garanci sipas legjislacionit doganor për të cilat nuk kanë nisur ende procedurat e revokimit të autorizimit të magazinës fiskale, si dhe të marrë masa për monitorimin periodik të veprimtarisë së DD lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore, duke identifikuar këtë procedurë në mënyrë të detajuar në rregulloren funksionale, së bashku me evidentimin dhe caktimin e detyrave të sektorit për procedurat që mbulon shqyrtimin e të dhënave të operatorit në sistem.

Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Pas zhdoganimit (Aposteriori)

Gjatë vitit 2022 Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit ka funksionuar sipas strukturës organizative miratuar me VKM nr.2 datë 8.01.2018 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, në të cilën identifikohen gjashtë sektor:

1. Sektori i Metodikave dhe Kontrollit;
2. Sektori Produkteve të Cigareve dhe Pijëve Alkolike;

- 3.Sektori i Produkteve Energjetike;
- 4.Sektori i Produkteve të tjera;
- 5.Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Regjimeve Doganore;
- 6.Sektori i Paisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike.

Pasqyra 42: Struktura funksionale plan/fakt për DKAP

Drejtoria Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit	Drejtor	Plan	Fakt
		1	1
Sektori i Metodikave dhe Kontrollit	Përgjegjës	1	1
	Specialist	2	2
Sektori i Produkteve të Cigareve dhe Pijeve Alkolike	Përgjegjës	1	1
	Specialist	7	7
Sektori i Produkteve Energjetike	Përgjegjës	1	1
	Specialist	9	9
Sektori i Produkteve të tjera	Përgjegjës	1	1
	Specialist	4	4
Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Regjimeve Doganore	Përgjegjës	1	1
	Specialist	6	6
Sektori i Paisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike	Përgjegjës	1	1
	Specialist	4	4
	Total	39	39

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, DPD.

Grupi i auditimit ka kërkuar planin e punës dhe raportin e veprimtarisë 2022 për këta sektor, prej të cilëve i janë vendosur në dispozicion raporte dhe informacion mbi veprimtarinë e 5 sektorëve, përveç Sektorit të Metodikave dhe Kontrollit, sektor ky që nuk ekziston më me implementimin e strukturës së re organizative me vendimin nr.355 datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar.

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe evidencat përkatëse mbi kontrollin e zhvilluar gjatë vitit nga këta sektor dhe analizën e riskut mbi të cilën është realizuar përzgjedhja e subjekteve për kontroll në secilin sektor, prej të cilave janë vendosur në dispozicion evidencat për subjektet e kontrolluara, por mungon një analizë rrisht në nivel drejtorie apo sektori për përcaktimin e tyre sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021, pika 6.3 "Ne përfundim të analizës së rrisht, specialistet e sektorit së bashku me përgjegjësin e sektorit, identifikojnë operatorët me rrisht të lartë dhe i adresojnë tek eprorët direkt (Drejtor Drejtorie/Shef departamenti) dhe mbas shqyrtimit prej tyre përcaktohen operatorët mbi të cilët do të kryhen kontrolle aposterior dhe /apo të akcizës".

Sa i takon dokumentimin të kësaj analize mbi përzgjedhjen e operatorëve është konstatuar se në një pjesë të dosjeve në relacionin relacioni për propozimin e program kontrollit drejtuar DP, evidentohen arsye si ‘indikacione nga tregu’ apo ‘produkt i ri’ etj., evidenca që janë në proces auditimi në vijueshmëri.

Nga auditimi evidencave të kontrolleve dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontrolleve të realizuara nga drejtoria ka variuar në një afat kohor nga 7 ditë - 511 ditë, evidentuar në tabelën më poshtë sipas sektorëve.

Pasqyra 43: Afatet e kontrollit sipas sektorëve

Sektori	Operator të kontrolluar	Kohëzgjatja e procedurës nga programi në raport (ditë)
Produkte të Cigareve dhe Pijeve Alkolike	93	19 - 511
Produkte Energjetike	23	7 - 109
Produkte të tjera	71	8 - 178
Kontrolli Aposterior dhe Regjimet Doganore	33	15 - 106
Pajisjet, Matësit dhe Linjat Teknologjike	49	16 - 170

Burimi: Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit

Sikurse evidentohet edhe në tabelë sektori më problematik sa i takon afatit të kontrollit rezulton të jetë ai i cigareve dhe pijeve alkolike me një maksimum ditësh prej 511 ditë.

Nga auditimi është konstatuar se mungon një rregullim i afateve procedurale për këto procedura kontrolli në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, çka dëshmon për një sistem kontrolli të pa ngritur ende, jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 9 ‘Përgjegjshmëria manaxheriale e nëpunësit autorizues’, pika 4 ‘Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a. Propozimin të nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi’.

Nga auditimi është konstatuar se strukturat përkatëse në DKAP në përfundim të veprimeve përgatitore nuk kanë hapur dosje kontrolli për çdo operator sikurse përcakton Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 6.4.2.

Në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim edhe me përcaktimet e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për ‘Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’, neni 4, pika 8 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 ‘Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit’, pika 2 dhe 3 “2.Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3.Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.”

Nga evidencat e vëna në dispozicion me kontrollet e realizuara janë përzgjedhur për testim me zgjedhje rastësore sipas sektorëve dosjet si më poshtë.

-Sektori Produkteve të Cigareve dhe Pijeve Alkolike:

Nga evidenca e vendosur në dispozicion nga DKAP me 112 kontrole, prej të cilave 93 të përfunduara dhe 19 të mbetura në proces për 2023, janë shqyrtuar 6 dosje operatorësh, trajtuar në vijim në mënyrë të detajuar. Nga auditimi kësaj evidence dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontroleve të realizuara nga ky sektor ka variuar nga 19 ditë - 511 ditë.

1.Opertori i akcizës “KPS” me Nipt J.M grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion dosja me dokumentacionin si më poshtë listuar:

1.Program kontrolli nr.17783/2 datë 08.10.2021 me datë ushtrimi kontrolli 12-14 Tetor 2021 me tematikë kontrolli ‘kontrolli fizik i stokut në magazinë, kontrolli gjendjes së pullave fiskale, kontrolli përputhshmërisë së deklarimeve dhe i detyrave të lëna’, dhe me grup të përbërë nga zj.A.G, zj.A.T, zj.M.J dhe zj.A.ZH;

2.Procesverbalet e kontrollit fizik nr.0002080, nr.0002081 dhe nr.0002082 datë 13.10.2021 ora 15:00 dhe 17:00, mbajtur nga zj.A.G, zj.A.T, zj.M.J dhe zj.A.ZH, në të cilin janë konstatuar mallrat si në vijim: (nr.0002080) alkol 96%= 55,767 litra, alkol 70%=58,551 litra, verë në depozitë =514,213 litra, raki=48,760 litra, konjak rifuxho=45,518 litra, verë e ambalazhuar me pullë=18,205*0.75, verë e ambalazhuar në karton= 1,250*5 L, verë e ambalazhuar në shishe=938*2L, raki e ambalazhuar me pullë 15,708*0.5L, 8,821*0.7L, 11,888*0.2L, 4,887*0.1L, konjak i ambalazhuar me pullë 2,385*0.1L,6,869*0.7L, 1,667*0.2L, fërniet i ambalazhuar me pullë 3,241*0.7L, 29*0.7L, verë e ambalazhuar pa pullë=7,007*0.75, konjak pa pullë= 712 litra, raki e ambalazhuar pa pullë 1,321 litra, (nr.0002081)pulla fiskale alkooli 0.1L=6,7850 copë, 0.125L=1,330 copë, 0.2L=203,000 copë, 0.5L=11,480 copë, 0.7L=230,000 copë, pulla fiskale rakie 0.1L=125,600 copë, 0.125L=800 copë, 0.2L=72,320 copë, 0.5L=114,400 copë, 0.7L=41,000 copë, 0.75L=6,290 copë, 2L=20,590 copë, pulla fiskale vere 0.187L=10,235 copë, 0.75 =220,900 copë, 2L=89,000 copë, 3L=6,160 copë, 5L=7,080 copë, (nr.0002082) verë në vaska betoni=218,500 L, rush+bërsi= 323,100L, lëndë e parë për distilim në vaska betoni=608,000 L, nënshkruar të tre edhe nga operatori ekonomik.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68 ‘Procedura e inventarizimit’ pika 4 përcakton se ‘4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’, pika c dhe ç përcaktohet se ‘c)Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepricë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.’

Sa përcaktuar më sipër nga auditimi është konstatuar se procesverbalet e kontrollit fizik nr.0002080, nr.0002081 dhe nr.0002082 datë 13.10.2021 ora 15:00 dhe 17:00, mbajtur nga zj.A.G, zj.A.T, zj.M.J dhe zj.A.ZH, nuk janë mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat e konstatuara në inventarizim. Gjithashtu nuk i është bashkëlidhur procesverbalit deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c.

3. Procesverbali për kundërvajtje administrative nr.0029561 me penalitet 200,000 lekë për shkelje të nenit 90, pika 4 e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku përcaktohet se “4.

Nëse konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrat kontabël dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli të sasisë së raportuar, depozituesi i miratuar gjobitet me 200 000 lekë. Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël” hartuar nga zj.M.J, zj.A.ZH dhe zj.E.V.

Procesverbali për kundërvajtje administrative nr.0029562 me penalitet 200,000 lekë për shkelje të nenit 90, pika 4 e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku përcaktohet se “4. Nëse konstatohen sasi tepër, krahasuar me regjistrat kontabël dhe nëse sasia tepër nuk kalon 2 për qind të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli të sasisë së raportuar, depozituesi i miratuar gjobitet me 200 000 lekë. Sasia tepër pasqyrohet në regjistrat kontabël” hartuar nga zj.M.J, zj.A.ZH dhe zj.E.V.

Sa më sipër është konstatuar se procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative janë pa datë verifikimi në kundërshtim me nenin 98 ‘Forma e procesverbalit’ ku përcaktohet se “1.Procesverbali duhet të përmbajë: a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja; g) nenet e shkelura, nenet në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;”.

Neni 97 ‘Verifikimi’ përcakton gjithashtu në pikën 4 se “4.Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet a posteriori nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente.”

Udhëzimi nr.05 datë 31.03.2016 “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës”, në shënimet shpjeguese për aneksin 1, e detajon sipas kutive specifike plotësimin e procesverbalit të kundërvajtjes administrative.

4.Informacion për DP nr.12566 datë 04.07.2022 mbi programin e kontrollit nga Drejtori Drejtorisë;

5.Raport përfundimtar kontrolli nr.13625 datë 21.07.2022, në të cilin është përcaktuar detyrimi prej 142,352 lekë për sasi të mangut nën 2% dhe penaliteti 400,000 për sasi të tepër nën 2%, pra në total 542,352 lekë. Gjithashtu i është lënë detyrë Degës Doganore Durrës të dalë me një vendim për pullat fiskale të humbura gjatë tërmetit.

6.Lidhur me raportin kontrollin për operatorin “K.P.S.”, Dega Doganore Durrës ka marrë vendimin nr.1022 datë 11.08.2022, në të cilin është vendosur të paguhet detyrimi akcizës në shumën 142,352 lekë dhe penaliteti në shumën 400,000 lekë. Sipas këtij raporti, sasia e pullave është bazuar në procesverbalin e mbajtur datë 11.12.2019, për të cilin me vendimin e datës 11.08.2022 të Degës Doganore Durrës është lënë detyrë zyrës mbikëqyrëse për të kryer verifikimet e nevojshme për përcaktimin e sasisë së pullave, i cili deri në përfundim të fazës së auditimit në terren nuk rezultoi të jetë kryer.

Në projekt raport, raportin kontrolli dhe dosje nuk ka evidencë mbi njoftimin e operatorit mbi detyrimin dhe penalitetin e nxjerr, si dhe as pretendime të cituara apo sjella nga operatori.

Siç evidentohet edhe më sipër ky kontroll ka zgjatur për një periudhë gati 286 ditore nga programi në raport përfundimtar dhe vendimi për të cilin ka dalë pas 22 ditësh, pra në total 308 ditë.

2.Operator i akcizës “V.S” me Nipt K...K grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion dosja me dokumentacionin si më poshtë listuar:

1. Program kontrolli nr.18072 datë 12.10.2021 me datë ushtrimi kontrolli 27-28.10.2021 dhe anëtar grupi zj.E.M dhe zj.E.N;

2. Procesverbali i kontrollit fizik nr.0021277 datë 27.10.2021 ora 14:00, mbajtur nga zj.E.M dhe zj.E.N në të cilin janë konstatuar mallrat si në vijim: pulla vere 0.2L= 664 copë, pulla vere 1L= 407 copë, pulla vere 5 L =850 copë, pulla pije alkolike 0.05 L=120 copë, pulla pije alkolike 0.5 L=1288 copë, pulla pije alkolike 1 L=610 copë, pulla pije alkolike 0.7 L=4002 copë, verë ambalazhuar në shishe (pulloshur në Itali dhe importuar me pullë)=30744 copë *0.75L=23,058 litra.

3. Relacion shpjegues për DP nr.18072/2 datë 09.02.2022 për zëvendësimin e anëtares së grupit të kontrollit zj.E.M;

4. Shtesë në program kontrolli nr.18072/4 datë 10.02.2022 për zëvendësimin e zj.E.M me z.A.F;

5. Informacion për DP nr.18072/5 datë 12.04.2022 mbi programin e kontrollit nga Zv.DP;

6. Procesverbali për kundërvajtjen administrative nr.0006317 me penalitet 50,000 lekë për shkelje të nenit 96/1, pika 1 e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku përcaktohet se *“1. Shkeljet, të cilave u referohet shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 85, të parashikuara shprehimisht në këtë kre, të cilat nuk kanë sjellë mospagim të detyrimeve që duheshin paguar, dënohen me gjobë 50 000 lekë”, dhe neni 85, pika 1.a “1. Shkelje në fushën e akcizës janë: a) kundërvajtjet administrative”.*

Sa më sipër është konstatuar se procesverbali e verifikimit të kundërvajtjes administrative është pa datë verifikimi dhe i pa firmosur nga shkelësi në kundërshtim me nenin 98 ‘Forma e procesverbalit’ ku përcaktohet se *“1. Procesverbali duhet të përmbajë: a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja; g) nenet e shkelura, nenet në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;”.*

Neni 97 ‘Verifikimi’ përcakton gjithashtu në pikën 4 se *“4. Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet a posteriori nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente.”*

Udhëzimi nr.05 datë 31.03.2016 *“Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës”*, në shënimet shpjeguese për aneksin 1, e detajon sipas kutive specifike plotësimin e procesverbalit të kundërvajtjes administrative.

7. Raport përfundimtar kontrolli nr.1807/6 datë 29.04.2022;

8. Gjendja e pullave në kantinat e furnitorëve datë 27.10.2021 nga operatori;

Lidhur me dosjen e kontrollit për subjektin “V.S”, është kërkuar na nevojitet informacioni dhe sqarimet shtesë mbi daljet nga magazina me DSHA, DSHA me ARC nr.AL20000321A0089122 datë 14.11.2020, hyrjet në magazinë me import 4700, raporti nga Sicpa për periudhën, raport i DSHA në verifikimin e pullave fiskale, raport import 4000 në verifikimin e pullave fiskale, 56 deklaratat e verifikuara për nivelin e diferencuar të akcizës, të cilat janë vendosur në dispozicion.

Në projekt raport, raport kontrolli dhe dosje nuk ka evidencë mbi njoftimin e operatorit mbi detyrimin dhe penalitetin e nxjerr, si dhe as pretendime të cituara apo sjella nga operatori.

Gjithashtu mungojnë miratimet dhe reflektimet sipas hierarkisë së strukturës përcaktuar në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 *“Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”*, pika 8.1.2.

Nga auditimi është konstatuar se është paguar nga operatori detyrimi në vlerën 146,767 lekë me DSHA me ARC nr.AL20000321A0089122 datë 14.11.2020, për sasinë 173.689 litër alkool anhidër, për arsye të mos deklarimit të % së alkoolit sipas zërave nga operatori, ku për sasinë 6.02 litra, 96.06

litra dhe 71.609 litra nëse do të ishte bërë deklarimi i saktë me 43% alkol operatori do t'i llogaritej detyrimi në vlerën 63,110 lekë. Pra operatori ka paguar në total 146,767 lekë detyrim, pra 83,657 lekë detyrim më shumë seç do të duhej të paguante nëse do të ishte specifikuar % e alkolit.

Pasqyra 44: ARC nr. AL20000321A0089122 datë 14.11.2020

Sasia(litër)	% Alkolit	Duhej të paguante (43%)	Ka paguar (100%)	Diferenca
96.06	43	34,903	81,171	46,267
6.02	43	2,187	5,087	2,900
71.609	43	26,019	60,510	34,490
173.689	43	63,110	146,767	83,657

Burimi:Asycuda, DPD.

Nga auditimi u konstatua se në informacionin për DP datë 14.04.2022 është evidentuar vetëm detyrimi në vlerën 34,986 lekë i operatorit për mangësi nën 2%, ndërsa në Raportin Përfundimtar është shtuar dhe penaliteti në vlerën 50,000 lekë sipas shënimeve të Zv.DP. për të cilën është mbajtur edhe procesverbali verifikimit të kundërvajtjes administrative nr.0006317.

Lidhur me sa aplikuar më sipër ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, në nenin 84 ‘Zbatimi sanksioneve’ përcakton se “Autoritetet doganore vendosin sanksione për shkeljet në fushën e akcizës, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Penalitetet duhet të jenë efektive, proporcionale dhe me qëllim parandalimin e mos përsëritjen e shkeljeve.”

Nga marrëveshja e bashkëpunimit me DPT

Grupi i auditimit ka kërkuar gjithashtu të gjitha kontrollet e realizuara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve gjatë vitit 2022, planet e punës apo raportet periodike dërguar DPT dhe analizat/konkluzionet e ardhura nga DPT mbi raportet dhe çdo kontroll të DPD përcjellë pranë DPT, përcaktuar në “Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018, neni 4, pika 2, 3 dhe 4, në përgjigje të së cilës është vendosur në dispozicion shkresa nr.8943/4 datë 09.12.2021 e DPT me kthim përgjigje për ngritjen e grupit të përbashkët të kontrollit në subjektin “N.P” me NIPT L.....T.

Ne vijim te kësaj shkrese grupi auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion dosja e kontrollit të operatorit të akcizës “N.P” me Nipt L.....T, në të cilën gjenden dokumentet si më poshtë:

1.Relacion shpjegues për DP nr.10431 datë 10.06.2021 nga Zv.DP me propozim kontrolli për subjektin ‘N.P’ me indikator rrisht ‘Lloji i prodhimit-nargjile i cili është produkt relativisht i tri dhe ka paqartësi të njohjes dhe zbatimit të ligjit’ dhe ‘Indikacione nga tregu se qarkullojnë produkte të parregullta’;

2.Program kontrolli nr.10431/1 datë 14.06.2021 me datë ushtrimi kontrolli 14-15 Qershor 2021 dhe anëtar grupi zj.G.V dhe zj.A.T;

3.Procesverbali kontrollit fizik nr.0002418 datë 15.06.2021 ora 14:00, mbajtur nga zj.G.V dhe zj.A.T , në të cilin janë konstatuar mallrat si në vijim:

-Duhan i grirë në kuti kartoni 1,010kg; -Duhan në proces fermentimi 420 kg; -Nargjile produkt i gatshëm (0.17kg duhan)2,923 kg; - Aroma 2,970 kg; -Glicerinë+Glukozë 18,500 kg; -Pulla Fiskale 0.17 kg 4,900 copë; Pulla Fiskale 0.045 kg 3,000 copë; Pulla Fiskale 0.2 kg 2,000 copë, nënshkruar edhe nga operatori ekonomik.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68 ‘Procedura e inventarizimit’ pika 4 përcakton se ‘4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e

inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’, pika c dhe ç përcaktohet se ‘c)Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepricë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.’

Sa përcaktuar më sipër nga auditimi është konstatuar se procesverbali i kontrollit fizik nr.0002418 datë 15.06.2021 ora 14:00, mbajtur nga zj.G.V dhe zj.A.T, nuk është mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat e konstatuara në inventarizim. Gjithashtu nuk i është bashkëlidhur procesverbalit deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c.

4.Shkresa nr.8943/3 datë 11.11.2021 drejtuar DPT me propozim për grup të përbashkët pune;

5.Shkresa nr.8943/4 datë 09.12.2021 drejtuar DPD nga DPT për dakortësinë e ngritjes së grupi të përbashkët;

6.Relacion shpjegues për DP nr.10431/2 datë 20.12.2021 mbi ngritjen e grupit të përbashkët të kontrollit me DPT;

7.Shtesë në program kontrolli nr.10431/3 datë 20.12.2021 për ngritjen e grupit të përbashkët me DPD përfaqësuar nga Z.F.P me datë ushtrimi kontrolli 20-30.12.2021 dhe zëvendësimin e zj.G.V me zj.E.M;

8.Relacion shpjegues për DP nr.10431/4 datë 09.02.2022 për zëvendësimin e anëtares së grupit të kontrollit zj.E.M;

9.Shtesë në program kontrolli nr.10431/5 datë 10.02.2022 zëvendësimin e zj.E.M me z.A.F;

10. Shtesë në program kontrolli nr.7598 datë 20.04.2022 për përbërjen e grupit nga zj.E.V dhe z.A.F;

11.Procesverbali për kundërvajtje administrative nr.0029568 me shumë detyrimi 3,540,000 lekë dhe penalitet 2 fish në vlerën 7,080,000 lekë (total 10,620,000 lekë) për shkelje të nenit 90 ‘Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës’, pika 5 e ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku përcaktohet se ‘5.Për teprica në magazinat fiskale, si dhe teprica të produkteve të denaturuara, mbi 2 për qind të sasisë kontabël të llogaritur për periudhën objekt kontrolli dhe të pajustificuara në dokumentacionin përkatës, aplikohet: a) për herën e parë të konstatuar, gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar, por jo më pak se 200 000 lekë’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’ të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar.

Procesverbali për kundërvajtje administrative nr.0029569 me shumë detyrimi 2,652,000 lekë dhe penalitet 2 fish në vlerën 5,304,000 (total 7,956,000) lekë për shkelje të nenit 87 ‘Shmangia nga verifikimi ose pagimi i akcizës’, pika 1 dhe 2 ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku përcaktohet se ‘1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative në fushën e akcizës kushdo që:a) shmang, me çfarëdolloj mjeti apo mënyre, produktet e akcizës nga verifikimi dhe/ose nga pagimi i akcizës.

Të dy procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative janë pa datë verifikimi në kundërshtim me nenin 98 ‘Forma e procesverbalit’ ku përcaktohet se 1. “Procesverbali duhet të përmbajë: a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja; g) nenet e shkelura, nenet në bazë të të cilave përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;”.

Neni 97 'Verifikimi' përcakton gjithashtu në pikën 4 se "4.Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet a posteriori nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente."

Lidhur me sa më sipër në raportin përfundimtar të program kontrollit citohet shënimi se "Datat e procesverbaleve të konstatimit të shkeljes, do të jenë të njëjta me datën e protokollimit në Degën Doganore Tiranë" si dhe se "operatori është njoftuar dhe paraqitur më datë 20.07.2022 pranë zyrave të DPD, Laprakë ku është njoftuar me gjetjet dhe rakorimet e këtij materiali (në pamundësi për të kryer njoftimin nëpërmjet adresës elektronike zyrtare për efekt mosfungsionimi).

Udhëzimi nr.05 datë 31.03.2016 "Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës", në shënimet shpjeguese për aneksin 1, e detajon sipas kutive specifike plotësimin e procesverbalit të kundërvajtjes administrative.

12.Informacion për DP nr.10431/2 datë 21.07.2022 mbi programin e kontrollit;

13.Raport përfundimtar kontrolli nr.15639 datë 31.08.2022, në të cilin janë konstatuar detyrime akcize në vlerën 6,192,000 lekë dhe penalitete në vlerën 12,384,000 lekë.

Mungonte në dosjen e kontrolli raporti i ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore me verifikimin e veprimtarisë ekonomike dhe deklarimeve të periudhës së kontrollit kërkuar nga DPD me shkresën nr.9926 datë 20.05.2022, në bazë të të cilit është mbajtur dhe procesverbali i kundërvajtjes administrative nr.0029569. Ky raport është ri kërkuar nga DPD me shkresën nr.8823 datë 25.05.2023 pranë DRT, ka ardhur në DPD datë 26.06.2023 me shkresën nr.10617 dhe i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit në datë 30.06.2023.

Nga auditimi i përmbajtjes së tij është konstatuar se nuk është analizuar procesi prodhimit sipas kartës teknologjike.

Gjithashtu për sa trajtuar më sipër nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar nga rivlerësimi doganor detyrime shtesë akcize në vlerën 2,652,000 lekë, por nga ana e inspektorit tatimor Z.F.P nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare, sepse me detyrimet shtesë të akcizës do të duhej të ishte kryer rillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme duke rezultuar në detyrime shtesë për TVSH, konkretisht si në vijim.

Pasqyra 45: Detyrime shtesë TVSH-je

Emërtimi	Vlera e tatueshme
VI Tatueshme' (Rivlerësim Akciza)	2,652,000
Detyrime shtesë TVSH (20%)	530,400
Gjobë (100%)	530,400
Totali	1,060,800

Burimi: KLSH.

Neni 5 i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon se: a) "Administratë tatimore" përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; me përjashtim të akcizës. Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe neni 70 "E

drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”: 1. Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.

Gjithashtu neni 39 Vlera e tatueshme të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se “1. Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifrat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.”

Gjithashtu do të duhej të ishte kryer penalizmi i subjektit për vlerën e TVSH-së sipas përcaktimeve të nenit 116 “Evazion tatimor”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mos deklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.”

Gjithashtu lidhur me dosjen e kontrollit për subjektin “N.P” vendosur në dispozicion, është kërkuar dokumentacion shtesë mbi kartën teknologjike të operatorit nr.25175/2 datë 04.11.2019 referuar në raport, ekstremitetet e DSHA-ve të produktit të gatshëm nargjile, raport nga Asycuda për lëndët ndihmëse referuar në raport, raport nga Asycuda për nargjilen me çaj, pretendimet apo dokumentacionet me shkrim të operatorit për kundrvajtjet e konstatuara në procesverbalet e kundërvajtjeve apo raport në datë 20.07.2022 apo më parë/pas, miratimet dhe reflektimet sipas hierarkisë së strukturës përcaktuar në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.1.2., si dhe vendimi Degës Doganore Tiranë nr.1061 datë 30.09.2022 dhe procesverbalet e kundërvajtjeve administrative protokolluar në DDT. Nga auditimi karta që referohet në raport rezulton të jetë raport nga inspektimi i sektorit të linjave teknologjike të operatori mbi përcaktimin e normativave të prodhimit.

Është kërkuar në vijim karta teknologjike e certifikuar e subjektit dhe ajo e vendosur në dispozicion rezulton të jetë e pa certifikuar nga një autoritet kompetent sikurse përcakton VKM nr.434 datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale” ku thuhet se “7. Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove, ku të përfshihen:a) karta teknologjike;b) përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit;c) planimetria e objektit; ç) normativat e konsumit të lëndës së parë dhe të orëve të punës për njësi produkti të gatshëm (karta teknologjike), shoqëruar edhe me të dhënat për:- llojin e lëndës së parë, të përdorur në procesin e prodhimit; -fazat, në procesin teknologjik, ku përdoret lënda e parë. Karta teknologjike, duhet të jetë e konfirmuar /certifikuar nga një institucioni njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Inspektorati Shtetëror, përgjegjës dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, institucione që miratojnë karta të ndryshme teknologjike apo çdo institucion tjetër që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike përkatëse.”

Lidhur me raportin kontrollin për operatorin ‘N.P’ dërguar me shkresën nr.15639 datë 31.08.2022 në DDT, Dega Doganore Tiranë ka marrë vendimin nr.1061 datë 30.09.2022, në të cilin është vendosur detyrimi akcizës në shumën 6,192,000 lekë dhe penaliteti në shumën 12,384,000 lekë.

4. “H” me NIPT L.....P - Në zbatim të Program Kontrollit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr.17747 prot., datë 07.10.2022, të tipit “I paparalajmëruar”, me datë të ushtrimit të kontrollit 10 - 14.10.2022, me grup kontrolli të përbërë nga zj.M.J dhe zj.A.ZH, për të ushtruar kontroll në magazinën fiskale të operatorit ”H” në Tiranë, me qëllim inventarizimin e mallrave të akcizës gjëndje në magazinën fiskale (kontrolli fizik i stokut në magazinë), verifikimin e gjëndjes së stokut të pullave fiskale, verifikimin me skaner të lexueshmërisë së pullave fiskale të vendosura në produktet gjëndje në ambjentet e operatorit dhe kontrollin e ambjenteve të mbajtjes së produktit të gatshëm me akcizë të paguar dhe me akcizë të pezulluar për periudhën “nga kontrolli i fundit i ushtruar”.

Në Programin e kontrollit, me shkrim dore është dhe shënimi “13.10.2022 Mora njoftim A.b (firma)” .

Sipas Procesverbalit me nr. serie 0021316, më datë 13.10.2022 ora 19:50 është kryer kontrolli fizik në magazinat fiskale të subjektit të mësipërm, të mbajtur dhe nënshkruar nga grupi i kontrollit zj.M.J dhe zj.A.ZH, në prani dhe të përfaqësuesit të subjektit A.b është evidentuar gjëndja e magazinës si në vijim:

Pije alkolike me pulle fiskale 0.1L-685 copë, Pije alkolike me pulle fiskale 0.2L-1,292 copë, Pije alkolike me pulle fiskale 0.5L-3,496 copë, Pije alkolike me pulle fiskale 0.7L-15,584 copë, Pije alkolike me pulle fiskale 0.75-6,033 copë, Pije alkolike me pulle fiskale 1L-29,902 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 0.1L- 6,300 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 0.2L-2,500 copë, pije alkolike pa pullë fiskale 0.35L-46 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 0.5L-10,380 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 0.7L-36,320 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 0.75-22,061 copë, Pije alkolike pa pulle fiskale 1L- 76,871 copë, verë në shishe me pullë fiskale 0.75 L-3,218 copë, verë në shishe me pullë fiskale 0.2L-38,448 copë, verë në shishe pa pullë fiskale 0.75L-686 copë, verë në shishe pa pullë fiskale 0.2L-6,000 copë, pulla fiskale pije alkolike 0.1L- 135 copë, pulla fiskale pije alkolike 0.2 L-2,740 copë, pulla fiskale pije alkolike 0.35 L-1,000 copë, pulla fiskale pije alkolike 0.7L- 47,331 copë, pulla fiskale pije alkolike 0.75L- 24,342 copë, pulla fiskale pije alkolike 1 L- 78,725 copë, pulla fiskale verë 0.2 L- 1,952 copë, pulla fiskale verë 0.75L-2,920 copë dhe pulla fiskale birra 0.33L-47,776 copë.

Më datë 01.11.2022, nga Drejtori i Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriorit) z.J.Ç i është dërguar DP informacioni me nr.17747/1 prot., mbi rezultatet kontrollin. Me shkresën nr.17747/2 prot., datë 08.11.2022 i është dërguar operatorit dhe DD Tiranë Raporti përfundimtar i kontrollit, në të cilin janë konstatuar diferenca të munguara 18 litra pije alkolike, sasi kjo nën 2% e lejuar për efekt të kundërvajtjes administrative, si dhe 35 copë pulla fiskale mangët përsëri nën 2%.

Nga analiza e bërë në Raport evidentohet gjëndja e produkteve si në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 46: Situata inventar fizik-dokumentar

Litra

<i>Produkti</i>	<i>Gjëndje fizike 12.08.2020</i>	<i>Importuar 12.08.2020 deri 13.10.2022</i>	<i>DSHA</i>	<i>Stok kontabël</i>	<i>Stok fizik 13.10.2022</i>	<i>Diferenca</i>
	1	2	3	4	5	6=5-4
Pije alkolike	0	218,252	45,647	172,605	172,587	-18
Verë	0	12,034	216	11,818	11,818	0
Birrë	0	773,594	773,594	0	0	0

Burimi: Raporti kontrollit për subjektin, DPD.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion në lidhje me lëvizjen e mallit me Dokumente Shoqërues Administrativ (DSHA) konstatohet, se një ditë pas kryerjes së kontrollit, menjëherë pas mbajtjes së proces verbalit të verifikimit fizik të datës 13.10.2022, subjekti H.D.A ka deklaruar për konsum sasi të konsiderueshme produktesh dhe ka paguar akcizë

në vlerën 5,603,038 lekë dhe në vijim gjatë muajit tetor në total vlerën 30,098,907 lekë, me frekuencë të shpeshtë krahasuar me gjithë lëvizjet e vitit dhe që në total përbën reth 60% të akcizës vjetore të paguar në DSHA nga operatori.

Nga auditimi u konstatua se subjekti “H” me nipt L.....P, ka rezultuar me gjendje malli të artikullit pije alkolike në mangesi të pajustificuar me dokumentacion ligjor **ne sasine 2,617 litra** pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me grade alkolike nga 37.5% deri 40%. Konstatohet se nga analiza e kryer sipas të dhënave të nxjerra nga sistemi Asicuda Word per importet e kryera hyrje ne magazine fiskale dhe daljet e kryera nga magazine fiskale sipas dokumentit tip DSHA 4 dhe DSHA 6 (*te administruara nga sistemi elektronik*) nuk eshte kryer nje analize e thelluar nga grupi i kontrollit prane Departamentit te Akcizes ne lidhje me analizen e bilancit material te magazines fiskale per periudhen e kontrollit nga data 12.08.2020 deri ne daten e mbajtjes se inventarit fizik prane operatorit ekonomik ne daten 13.10.2022.

Sipas analizës së kryer dhe të paraqitur nga grupi i kontrollit zj. M.J dhe zj.A.ZH ne materialin e Raportit Perfundimtar te Kontrollit percjellë me shkresen nr. 17747/2 prot date 08.11.2022 bazuar ne program kontrollin nr 17747 prot date 07.10.2022 rezuton se subjekti “H” me nipt L..P me adrese Mullet /Tirane rezulton se subjekti ka kryer procedura totale tip DSHA per artikullin pije alkolike ne sasine totale **45,647 litra pije alkolike**.

Nga verifikimi i te dhenave te nxjerra nga grupi auditues nga sistemi Asicuda Word per importet e kryera hyrje ne magazine fiskale dhe daljet e kryera nga magazine fiskale sipas dokumentit tip DSHA 4 dhe DSHA 6 (te administruara nga sistemi elektronik) rezulton nje sasi totale e levizjes se mallit sipas dokumentit tip DSHA (4 dhe 6) sasia totale prej **48,338 litra** pijen alkolike nga te cilat sasia prej 45,647 litra dalje per konsum, dhe sasia prej 2,617 litra dalje nga magazine fiskale me procedure DSHA tip 6 (shkaterrim).

Në përfundim, rezulton nje mosperputhje sasiore midis rezultatit te gjendjes se magazines fiskale ne daten 13.10.2022 per artikullin pije alkolike midis rezultatit te Stokut Kontabel te deklaruar nga Operatori “H” me nipt L.....P sipas rezultatit te Stokut Fizik te deklaruar nga grupi i kontrollit znj. M.J dhe znj.A.ZH prane Departamentit te Akcizes ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave, dhe Stoku Fizik qe duhet te ishte raportuar, referuar te dhenave sipas sistemit Asycuda Word ne daten 13.10.2022.

Nga grupi i grupi i kontrollit znj. M.J dhe znj. A.ZH prane Departamentit te Akcizes ne Drejtorine e Pergjithshme te Doganave nuk eshte evidentuar sasia prej 2,617 litra pije alkolike. Gjithashtu, për sa trajtuar më sipër nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar nga rikontrolli detyrime shtesë akcize në vlerën 909,372 leke. Konstatohet se sasia e gjetur nuk kalon nivelin prej 2% te sasise kontabel gjendje te magazines ne momentin e kontrollit, por gjobitet në vlerën 200,000 lekë sipas përcaktimeve të nenit 90 pika 4, ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012.

Bazuar në ligjin nr 61 “Per Akcizat në RSH” sipas Neni 85 Klasifikimi i shkeljeve:

Shkelje në fushën e akcizës janë: a) kundërvajtjet administrative; b) veprat penale. 2. Paguesa e gjobës, që zbatohet për shkeljen në fushën e akcizës, në asnjë rast nuk do të jetë shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve të akcizës që duhen paguar për mallrat, objekt i shkeljes. 3. Vendosja e dënimit administrativ, sipas dispozitave të këtij ligji, nuk e ndalon administratën doganore të paraqesë kallëzim penal në prokurori për veprat penale, të parashikuara në Kodin Penal.

Bazuar në ligjin nr 61, Neni 87 “Shmangia nga verifikimi ose pagimi i akcizës”

1. Pa rënë ndesh me Kodin Penal, kryen kundërvajtje administrative në fushën e akcizës kushdo që:
a) shmang, me çfarëdo lloj mjeti apo mënyre, produktet e akcizës nga verifikimi dhe/ose nga pagimi i akcizës;
2. Shkeljet e referuara në pikën 1, të këtij neni, dënohen: a) për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar.

Konkretisht, po ju pasqyrojme dhe detajojmë sa më poshtë edhe konkluzionet dhe rrillogaritjet e kryera nga grupi auditues bazuar mbi të dhenat e marra nga sistemi Asicuda World duke trajtuar edhe rrillogaritjet e kryera nga grupi auditues ku ka rezultuar me gjendje malli të artikullit pije alkolike në tepricë të pajustificuar me dokumentacion ligjor **ne sasine 2,617 litra** pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me grade alkolike nga 37.5% deri 40% me detyrime akcize ne shumen prej 909,372 leke te cilat rezultojne te papaguara plus gjobën 200,000 lekë:

Tabela 48: Diferenca sasiore ne litra

Produkti	Gjendje fizike 12.08.2020	Importuar 12.08.2020.13.10.2022	Sasi DSHA sipas Sistemit (4 +6)	Stok kontabel sipas operatorit date 13.10.2022	Stok Fizik sipas grupit te kontrollit 13.10.2022	Stoku fizik qe duhej te ishte sipas sistemit ne daten 13.10.2022	Diferencat sasiore ne litra
Birra	-	773,594	773,594	-	-	-	-
Pije alkolike	-	218,261	48,338	172,605	172,587	169,924	2,663
Vera	-	12,026	162	11,818	11,818	11,864	-
Total	-	1,003,881	822,094	184,423	184,405	181,788	2,617

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Tabela 49: Diferenca sasiore ne litra

Lloji i mallit	Sasia	Njesia	Vlera e akcizes se papaguar sipas taksimit ne fuqi (leke)	Vlera mesatare e mallit per njesi sipas cmimit ne import (Euro)	Njesia	Vlera totale e mallit (Euro)
Konjak	178.20	LTR	60,232	44	Euro/liter	7,841
Gin	466.80	LTR	157,778	44	Euro/liter	20,539
Tekila	1,217.25	LTR	411,431	30	Euro/liter	36,518
Ëhisky	277.20	LTR	93,694	46	Euro/liter	12,751
Vodka	4.20	LTR	1,420	44	Euro/liter	185
Rum	546.80	LTR	184,818	44	Euro/liter	24,059
Total	2,690	LTR	909,372	42	Euro/liter	101,893

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Në zbatim të “**Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT**” nr.14355 datë 19.06.2018, pas evidentimit të sasisë të gjeturë në mangësi nën nivelin 1% të sasisë kontabël të llogaritur nuk është njoftuar me shkresë për informim Drejtoria Rajonale Tatimore me verifikimin e veprimtarisë ekonomike dhe deklarimeve të periudhës së kontrollit nga data 12.08.2020 deri më datë 13.10.2022.

Detyrime tatimore nga DPT:

Nga ana e Departamentit te Akcizes prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare, sepse me detyrimet shtesë të akcizës do të duhej të ishte kryer rrillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme duke rezultuar në detyrime shtesë për TVSH, e cila ndiqet dhe trajtohet nga Administrata Tatimore “**Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT**” nr.14355 datë 19.06.2018, ku duhej te ishte kryer edhe bashkëpunimi shkresor me Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve. Me konkretisht:

Tabela 50:Detyrime te subjektit

Emërtimi	Vlera e tatueshme (leke)
VI Tatueshme + Vleren e Akcizes se papaguar)	12,627,346
Detyrime shtesë TVSH (20%)	2,525,469
Gjobë (100%)	2,525,469
Tatim Fitimi	1,894,101
Gjobe100% tatim fitimi	1,894,101

<i>Totali</i>	<i>8,839,140 leke</i>
---------------	-----------------------

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Neni 5 i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se: a) “*Administratë tatimore*” përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; me përjashtim të akcizës. Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe neni 70 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”: 1. *Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.*

Gjithashtu neni 39 Vlera e tatueshme të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se “1. Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifrat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.”. Gjithashtu do të duhej të ishte kryer penalizmi i subjektit për vlerën e TVSH-së sipas përcaktimeve të nenit 124 “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve” e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ne perfundim, rezultojnë:

1. *Diferenca në mangesi të magazines fiskale për sasinë prej 2617 litra nën 2% të stokut kontabel me detyrime potenciale në fushën e akcizës në vlerën 909,372 lekë (për tu trajtuar nga administrata doganore) për një vlerë malli statistikore prej 11,717,983 leke.*
2. *Detyrime në fushën tatimore të cilat duhet të ndiqen nga DPT në vlerën 8,839,140 lekë.*

Bazuar në sa më sipër, nga ana e grupit të kontrollit të specialistëve të Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriorit) zj.M.J dhe zj.A.ZH nuk është kryer siç duhet kontrolli fizik i stokut në magazinë, duke i krijuar kështu subjektit mundësinë për shmangien e pagesës së detyrimeve për penalitet për sasinë e produkteve të munguara, si dhe të detyrimeve për pullat e munguara.

Gjithashtu, dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriorit) z. J.Ç nuk ka shqyrtuar, analizuar dhe monitoruar në kohë rezultatet e këtij kontrolli, për të siguruar zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, megjithëse ka pasur në dispozicion gjithë kohën dhe dokumentacionin e nevojshëm, nga data 13.10.2022 i mbajtjes së Procesverbalit të inventarizimit fizik nga grupi i kontrollit, deri më datë 01.11.2022 i përgatitjes së informacionit përkatës për Drejtorinë e Përgjithshme.

Në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Në përfundim të procedurës audituese për shqyrtimin e dosjes se “H.D.A me NIPT L....P” nga grupi auditues u arrit në konkluzionin që subjekti H.D.A ka kryer shkelje administrative doganore në fushën e akcizës pasi nga rillogaritjet e kryera nga grupi auditues për të dhëna të marra nga sistemi Asicuda Word pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në lidhje me aktivitetin e kryer për periudhën 12.08.2020 deri më datën e përfundimit të kontrollit nga strukturat e Departamentit të Akcizës pranë Departamentit të Akcizës për procedura importi për mallrat të hyra sipas procedurës doganore 4700 (*hyrje në magazinë fiskale*) dhe procedura doganore dalje nga magazina fiskale sipas tipit DSHA 4 dhe DSHA 6 ku rezultoi se subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta ligjore për sasinë **prej 2,617 litra me vlerë malli në shumën 101,893 euro të llojit** pije alkoolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me grade alkoolike nga 37.5% deri 40% të

rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën **1,109,372 lekë** (909,372 lekë detyrim + 200,000 lekë gjobë)te cilat rezultojnë të shmangura dhe të papaguara.

Nga Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave nuk është kryer raportim shkresor bazuar në “*Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT*” nr.14355 datë 19.06.2018 në lidhje me sasinë e mallit të gjetur në mungesë me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve me detyrime tatimore në shumën **8,839,140 leke** për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në total detyrime në vlerën **9,948,512 lekë**.

Në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Lidhur me problematikën e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr.1604/5 datë 18.08.2023 nga zj.A.ZH dhe nr.11604/4 datë 15.08.2023 nga zj.M.J me përmbajtje të ngjashme si më poshtë pasqyruar: Pretendim i subjektit: Në faqen 111 të projekt raportit ku është audituar dosja e kontrollit “**H**”, jeni shprehur se keni konstatuar që pas datës së mbajtjes së procesverbalit të kontrollit nga ana e grupit të kontrollit date 13.10.2022, subjekti ka kryer veprime me sistemin AW duke hedhur për konsum sasi të konsiderueshme produktesh akcize. Ky konstatim në lidhje me DSHA e hartuara më datë 14.10.2022 është i sakte, por nuk qendron pasi veprimet nga ana e operatorit janë kryer një ditë pas mbylljes së inventarit fizik të kryer në vend (Magazinë fiskale).

Në lidhje me këtë konstatim ju bëj me dije se unë si pjesë e grupit të kontrollit kam ndjekur me rigorozitet gjithë procedurat e parashikuara për ushtrimin e kontrollit referuar manualit sipas Udhëzimit nr.02, datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, si dhe pas ushtrimit të kontrollit është mbajtur dhe procesverbali i kontrollit fizik nga grupi i kontrollit me numer Serial:0021316 në datë 13.10.2022 ku është evidentuar gjendja fizike në momentin e konstatimit.

Në përputhje me përcaktimeve ligjore bazuar në procesverbalin e verifikimit fizik të konstatimitmi, si dhe pas verifikimeve të kryera nga zyra është hartuar raporti paraprak për Drejtorin e Përgjithshëm me numër Nr.17747/1 Datë.07/11/2022 dhe pas tij është hartuar dhe raporti përfundimtar Nr.17747/2 Datë.08/11/2022.

Gjithashtu, bazuar në nenin 68 Procedurat e inventarizimit pika 4, 5, dhe 6 të VKM-së Nr. 612, datë .9.2012 “Për Dispozitat Zbatuese Të Ligjit “Për Akcizat”, i ndryshuar, nga ana e grupit të kontrollit është bërë procesi i inventarizimit të produkteve, si dhe janë kryer verifikimet me të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor, regjistrat elektronik, stokun real, si dhe bazuar në deklaratat e periudhës paraardhëse ushtrimore, të dorëzuara nga depozituesi i miratuar, dhe jo ato pasardhëse sikurse pretendohet nga ana juaj.

Nisur nga sa më sipër, grupi i kontrollit nuk mund të pengojë dhe as të gjykojë veprimet e operatorit pas datës së kryerjes së kontrollit, si deklaratime të DSHA-ve hedhje për konsum apo të ndikoj në periodicitetin e kryerjes së tyre për sa kohe është bërë inventarizimi dhe konstatimi i gjendjes fizike të datës 13.10.2022 të produkteve në përputhje me nenin 45 “Kontrolli doganor” të ligjit të akcizës.

Në Akt Konstatimin nr.9 në faqen 12 lidhur me auditimin e operatorit ekonomik ‘H’ citohet vetëm ‘në dosje mungon relacioni për dp mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur...’ Ju sjell në vëmendjen tuaj se në lidhje me këtë i kam paraqitur argumentet e mia në observacionin nr.11857/7 datë 20.07.2023. në asnjë rast në AK nr.9 nuk përmenden gjetjet shitesë sikurse citohet në Projekt Raportin euditimit duke më hequr kështu mundësinë për të dhënë shpjegime/argumente të mëtejshme përpara se ju ti citoni në projekt raport duke u shkelur procedura nga ana juaj për vënien në dijeni sic parashikon ligji, e megjithatë përkundër kësaj po jap sqarimet e mia me shkrim si më poshtë dhe gjithashtu kërkoj nga ana juaj mundësinë për një ballafaqim verbal.

Pas përfundimit të procedurës së inventarizimit detyra e grupit të kontrollit është të bëjë përlllogaritjet mbi bazën e të dhënave që gjenerohen nga sistemi dhe mbi bazën e Proces Verbalit të Verifikimit Fizik të mbajtur ditën e kontrollit vetëm për periudhën që është duke audituar me qëllim nxjerrjen e rezultateve të

kontrollit dhe përgatitjen e materialit për eprorët. Grupi i kontrollit nuk mund të ndërmarrë veprime për një periudhë që fillon pas datës së kontrollit dhe të ndjekë të gjitha veprimet apo lëvizjet që bëjnë një operator në magazinën e tij fiskale, pasi në bazë të VKM nr.612 datë 05.09.2012, neni 85, pika 2 është Dega Doganore Mbikqyrëse ajo që ka tagrin të mbikqyrë në mënyrë periodike aktivitetin e magazinave fiskale.

Inventarizimi finalizohet me mbajtjen e një PV që pasyron gjëndjen fizike të momentit. Në bazë të manualit ky PV përbën bazën për hartimin e informacionit paraprak për eprorët duke filluar nga përgjegjësi i sektorit, i cili nëse ka vërejtje, paqartësi apo dyshime se kontrolli nuk është kryer sic duhet nga ana e specialistëve do të duhej ta kthente të grupi i kontrollit duke i pasqyruar vërejtjet/dyshimet e tij tek eprorët më lart ku nëse do provohej dhe faktohej se procedura e inventarizimit nuk është kryer sic duhet (ashtu sikurse pretendohet në gjetjet tuaja) do të duhej të ndërmerreshin të gjitha hapat sic parashikon ligji për fillimin e ecurisë disiplinore për specialistin/grupin e kontrollit. Në dosjen e kontrolluar prej jush ndodhën të gjitha materialet e praktikës ku në asnjë prej tyre Raporti Paraprak apo ai Përfundimtar nuk janë evidentuar masa për shkelje të procedurës së kontrollit. Pra sikurse shihet ka pasur dakordësi nga të gjitha palët që nga dita e kontrollit deri në dorëzimin e Raportit Përfundimtar, ku një kopje e të cilit i dërgohet Degës Doganore dhe një operatorit ekonomik.

Kontrolli ka qënë i tipit i 'pa paralajmëruar' cka nënkupton se nqs subjekti do të ishte i favorizuar presupozohet se ai do të ishte lajmëruar më para fillimit të datës së fillimit të kontrollit dhe do të ishte bërë kjo/këto DSHA për sasi të sipërcituara duke i dhënë kështu mundësinë subjektit që të rregullonte situatën, të shmangte detyrimet dhe penalitetet ashtu sikurse pretendohet nga ana juaj.

Shpresoj që argumentet e paraqitur më lart të merren në konideratë dhe gjithashtu kërkoj ballafaqim verbal për të dhënë të gjitha sqarimet e mia si dhe të drejtën për tu informuar mbi një akt administrativ, ashtu sikurse e parashikon dhe Kodi Procedurës Administrative e drejtë kjo që më është mohuar. Për sa më sipër shpresoj të vlerësohen të gjitha sqarimet dhe të reflektohen në raportin final të auditimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa pretenduar më sipër sqarojmë se në Akt Konstatimin nr.9, faqe 3, është evidentuar konstatimi se *'Në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 "Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës", pika 8.4 'Administrimi i dokumentacionit'.*

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim edhe me përcaktimet e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për 'Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin', neni 4, pika 8 "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve" dhe neni 16 'Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit', pika 2 dhe 3 "2.Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3.Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi."

Në dosje nuk administrohet informacioni si më poshtë listuar parashikuar në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 "Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës", pika 7.1 'Grupi i kontrollit administron: a.Kopje DSHA-së së fundit në hyrje dhe në dalje; b. Kopje të fundit të faturës tatimore të shitjes (për shitjet dhe blerjet); c.evidentimin e ngarkimit manual të fundit për secilën kategori produkti; d.deklarimin me shkrim të operatorit mbi stokun kontabël në momentin e ushtrimit të kontrollit për: lëndët e para, produktet në proces, produktet e gatshme sipas kategorive, stokun e pullave fiskale, si dhe cdo lloj dokumenti, mjeti, të dhëne etj. që mund të shërbejë për kryerjen e kontrollit.'. Nga thellimi auditimit është konstatuar se në llogaritjet e bëra dhe diferencat e nxjerra në inventar nuk janë përfshirë DSHA tip 6 të operatorit.

Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj se nga testimi i bërë për përzgjedhjen e kampionit të auditimit në raportin e nxjerrë nga sistemi për operatorët e akcizës në asnjë nga 30 rastet e testuara nuk rezultoi të jenë bërë deklarime DSHA hedhje për konsum në një % kaq të lartë krahasuar veprimtarinë vjetore të operatorëve një ditë pas kontrollit dhe ditët në vijim.

Procedura audituese mbyllet me raportin përfundimtar të auditimit, deri në hartimin e të cilit materialet audituese janë subjekt rishikimi dhe miratimi për sigurimin e cilësisë së punës sipas hierarkisë institucionale dhe jo pa arsye procedura parashikon mundësinë e observimit edhe në fazë projekt raporti.

5.M.d me Nipt K....J - në zbatim të Program Kontrollit nr.14063 datë 05.08.2021 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.G dhe zj.E.N dhe zj.A.ZH ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "M.d", në datat 04-10 gusht 2021 në Këlcyrë qëllim inventarizimin e mallrave të akcizës gjëndje në magazinën fiskale, verifikimin e gjendjes së stokut të pullave fiskale, kontrollin e lëndëve të para apo produkteve në proces, kontrolli i përputhshmërisë së deklarimeve dhe i zbatimit të detyrave të lëna për periudhën "*nga kontrolli i fundit i ushtruar*".

Në datë 06.08.2021 ora 13:00 është mbajtur nga grupi i kontrollit proces verbali i kontrollit fizik nr.0013492 i firmosur nga grupi kontrollit zj.A.G dhe zj.E.N dhe zj.A.ZH dhe subjekti, në të cilin evidentohet gjëndje verë në bidonë plastike 1,800 litra, pulla fiskale rakië 0.5 L- 27 copë dhe pulla fiskale vere 0.75 L-925 copë.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat", i ndryshuar, neni 68 'Procedura e inventarizimit' pika 4 përcakton se '4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real' dhe neni 69 'Tepricat dhe mangësitë në inventarizim', pika c dhe ç përcaktohet se 'c) Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën 'Hyrje të kontabilitetit të stokut', me përshkrimin 'Tepricë e evidentuar nga kontrolli', si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën "c", të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.'

Sa përcaktuar më sipër nga auditimi është konstatuar se procesverbali i kontrollit fizik nr.0013492 mbajtur nga zj.A.G dhe zj.E.N dhe zj.A.ZH, nuk është mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat e konstatuara në inventarizim. Gjithashtu nuk i është bashkëlidhur procesverbalit deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c.

Janë vendosur në dispozicion proces verbalet e verifikimit të shkeljeve administrative nr.0029560 me penalitet 50,000 lekë, nr.0029557 me penalitet 200,000 lekë, nr.0029558 me penalitet 200,000 lekë.

I është dërguar DP informacioni nr.14063/1 mbi kontrollin dhe i është dërguar operatorit dhe DD Tre Urat raporti përfundimtar i kontrollit nr.9456 datë 13.05.2022, në të cilin janë konstatuar detyrime akcize 57,917 lekë dhe penalitet 800,000 lekë.

Sa më sipër nuk dokumentohet ecuria procedurës se si nga 450,000 lekë në total në PV detyrimi ka shkuar në 857,917 lekë në raport.

Në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 "Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës", pika 8.4 'Administrimi i dokumentacionit'.

6.A.M me Nipt L....E - në zbatim të Program Kontrollit nr.12413 datë 08.07.2021 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.G dhe zj.E.N ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "A.M PF", në datat 15-16 korrik 2021 në Durrës me qëllim inventarizimin e mallrave të akcizës gjëndje në magazinën fiskale, verifikimin e gjendjes së stokut të pullave fiskale, kontrollin e lëndëve të para apo produkteve në proces, kontrolli i përputhshmërisë së deklarimeve dhe i zbatimit të detyrave të lëna për periudhën "*nga kontrolli i fundit i ushtruar*".

Në datë 16.07.2021 ora 15:20 është mbajtur nga grupi i kontrollit proces verbali i kontrollit fizik nr.0013485 i firmosur nga grupi kontrollit zj.A.G dhe zj.E.N dhe subjekti, në të cilin evidentohet gjendja fizike.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68 ‘Procedura e inventarizimit’ pika 4 përcakton se ‘4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’, pika c dhe ç përcaktohet se ‘c) Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepricë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.’

Sa përcaktuar më sipër nga auditimi është konstatuar se procesverbali i kontrollit fizik nr.0013485 mbajtur nga zj.A.G dhe zj.E.N, nuk është mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat e konstatuara në inventarizim. Gjithashtu nuk i është bashkëlidhur procesverbalit deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c.

I është dërguar DP informacioni nr.13843 datë 02.08.2021 mbi kontrollin, në të cilin janë konstatuar detyrime në të cilin nga kontrolli fizik janë konstatuar diferenca minus 509 litra pije, mangësi mbi 2% me detyrim akcize 132,340 lekë dhe penalitet të caktuar 3 fish në vlerën 397,020 lekë, dhe pulla fiskale mangët të konvertuara në 420.2 litra me fortësi 40% alkol për të cilat është vendosur detyrimi 109,252 lekë dhe penalitet 3 fish 327,756 lekë, si dhe diferencë tepër nga kontrolli i lëndëve të para në proces 1133 litra alkol, për të cilat janë ngarkuar detyrimet 736,260 lekë dhe penaliteti 2fish 1,472,520 lekë.

Në dosje nuk gjenden as proces verbalet e verifikimit të kundërvajtjeve të cituara në informacionin për Drejtorin e Përgjithshëm.

Me shkresën nr.20319 datë 18.11.2022 është ndryshuar grupi kontrollit, ku është zëvendësuar zj.A.G nga zj.E.V.

Është vendosur në dispozicion me observacione Raporti Përfundimtar i kontrollit nr.20921 datë 01.12.2022 në të cilin janë evidentuar detyrime në vlerën 3,225,943 lekë total prej të cilave 978,267 lekë detyrim akcize dhe 2,247,676 lekë penalitet, por gjendet shkresa nr.20910 datë 01.12.2022 e DD për DP në të cilën citohet se “nga verifikimet e herë pas hershme lidhur me programin rezulton se raportet përfundimtare të dërguara tek eporët për miratim nuk janë kthyer në sektor dhe as në Degën Doganore mbikëqyrëse”.

Në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.

Lidhur me problematikën e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr.283/25 datë 22.08.2023 nga zj.A.G, me përmbajtje të njëjtë me observacionin nr.283/6 datë 21.07.2023, trajtuar në projekt raportin e auditimit.

-Sektori i Produkteve Energjetike:

Nga auditimi i veprimtarisë së këtij sektori gjatë vitit 2022 është konstatuar se janë zhvilluar 23 programe kontrolli, të cilat kanë dalë pa rezultate kontrolli, prej të cilave 20 janë kontroll GLN dhe 3 kontroll magazinë fiskale.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe 17 kontrolle markimi të karburanteve pranë GFI me rezultat total detyrimi 1,418,711 lekë dhe penalitet 7,093,5655 lekë.

Nga auditimi i evidencës së këtij sektori dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontrolleve të realizuara nga ky sektor ka variuar nga 7 ditë – 109 ditë. Prej tyre janë përzgjedhur për testim 2 dosjet si më poshtë:

1. “2 Sha” (Kontroll GLN) në zbatim të Program Kontrollit nr.13312 datë 18.07.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.D.SH. dhe zj.H.Xh. inspektuan në ambientet e operatorit “2 sha” me NIPT K.....C në datat 25-27 korrik 2022 në Lushnje me qëllim verifikimin e inventarit fizik dhe dokumentar të produktit energjetik (gaz i lëngshëm), si dhe kontrollin e dokumentacionit dhe të gjithë lëvizjes së zinxhirit të produktit për periudhën nga 01.01.2021 deri ditën e kontrollit.

Në dosje mungon relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit Fizik datë 26.07.2022, në të cilin ka rezultuar gjendje fizike në total 98,860 litra.

Gjithashtu në dosje gjendet vetë deklarimi subjektiv për gjendjen e gazit në datë 26.07.2022 për 52.036 kg, si dhe gjendja e deklaruar në tatime datë 31.12.2020 dhe konkretisht gaz për ngrohje 102,916 kg.

Është dërguar te DP raporti paraprak për kontrollin me shkresën nr.13312/2 datë 12.09.2022, si dhe raporti përfundimtar mbi kontrollin nr.13312/3 datë 05.10.2022.

Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, ka rezultuar 62kg mangët nga krahasimi stokut fizik me atë kontabël, mangësi nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

2. “J SHA” – (kontroll magazinë fiskale prodhimi) në zbatim të Program Kontrollit nr.17749 datë 07.10.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.S dhe zj.H.Xh inspektuan në ambientet e operatorit “J SHA” me NIPT K....J, në datat 10 deri në 14 tetor 2022 në Sarandë me qëllim kontrollin fizik dhe kontabël të produkteve në ambientet e magazinës fiskale me nr.AL2N120038005 dhe dokumentacionit përkatës, si dhe verifikimin e ambienteve të magazinës dhe deklarimeve të produkteve të akcizës për periudhën nga ‘*nga kontrolli fundit prej autoritetit doganor*’.

Në dosje mungon relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur .

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit Fizik nr.0021610 datë 12.10.2022 ora 17:00, në të cilin ka rezultuar gjendje fizike: - Vaj lubrifikant NKM 27101981- $8,680\text{litra} \cdot 0.88 = 7,638$ kg; -Vaj hidraulik NKM 27101983 - $2,528\text{ litra} \cdot 0.88 = 2,225$ kg; -Graso NKM 27121090- 2,756 kg; -Vaj bazë NKM 27101999- në 3 depozita gjithsej $16,988\text{ litra} \cdot 0.88 = 14,949$ në fuçi $190\text{kg} \cdot 29 = 5,510$ kg vaj bazë gjithsej 20,459 kg.

Gjithashtu në dosje gjendet vetë deklarimi subjektiv për gjendjen fizike të produkteve në datë 12.10.2022 dhe konkretisht vaj bazë= 20,466 kg, vaj lubrifikant 7,731 kg, vaj hidraulik 2,264 kg, graso 2,772 kg dhe deklarimi se ‘*densiteti i konvertimit nga litra në kg që ne përdorim është 0.88 kg/litër*’ .

Është dërguar te DP raporti paraprak për kontrollin me shkresën nr.17749/2 datë 12.12.2022, si dhe raporti përfundimtar mbi kontrollin nr.17749/3 datë 22.12.2022.

Nga verifikimet dhe analiza e bërë në raport për operatorin kanë rezultuar 7 kg mangët vaj bazë, 43 kg mangët vaj lubrifikant, 1 kg mangët vaj hidraulik dhe 11 kg tepër graso sasi këto nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68 ‘Procedura e inventarizimit’ pika 4 përcakton se ‘4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’, pika c dhe ç përcaktohet se ‘c) Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepricë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.’

Sa përcaktuar më sipër nga auditimi është konstatuar se procesverbali i kontrollit fizik nr.0021610 datë 12.10.2022 ora 17:00, mbajtur nga zj.A.S dhe zj.H.Xh nuk është mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat apo mangësitë e konstatuara në inventarizim.

3. “E. SHA” (Kontroll GLN) në zbatim të Program Kontrollit nr.13502 datë 20.07.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.D.SH dhe zj.H.Xh inspektuan në ambientet e operatorit “E. SHA” me NIPT L....D, në datat 08 deri në 12 gusht 2022 në Tiranë me qëllim verifikimin e inventarit fizik dhe dokumentar të produktit energjetik (gaz i lëngshëm), si dhe kontrollin e dokumentacionit dhe të gjithë lëvizjes së zinxhirit të produktit për periudhën nga 01.01.2021 deri ditën e kontrollit.

Në dosje mungon relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit Fizik në datën 08.08.2022, në të cilin ka rezultuar gjëndje fizike: -Depozita 1 me kapacitet 110,000 litra, gjëndje produkti GLN 2,200 litra; -Depozita 2 me kapacitet 110,000 litra, gjëndje produkti GNL 4,400 litra, pra në total gjendja produktit gaz I lëngshëm 6,600 litra.

Gjithashtu në dosje gjendet vetë deklarimi subjektiv për gjendjen kontabël të gazit në datë 08.08.2022 ora 10 për 6,684 litra, si dhe gjendja e deklaruar në tatime datë 31.12.2020 dhe konkretisht gaz për automjete 131,145 litra dhe gaz për ngrohje 22,160 litra.

Është dërguar te DP raporti paraprak për kontrollin me shkresën nr.1502/1 datë 19.08.2022, si dhe raporti përfundimtar mbi kontrollin nr.13502/2 datë 28.10.2022.

Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, ka rezultuar 84 litra mangët nga krahasimi stokut fizik me atë kontabël, mangësi nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

Nga auditimi është konstatuar se në analizën e bërë në raport mbi lëvizjen e gazit të lëngshëm në raportin e kontrollit mungon një pasqyrim i qartë mbi hyrje daljet e produktit sipas dokumentacionit kontabël apo regjistrat elektronik në sistemin Asycuda Word si dhe nuk gjenden bashkëngjitur evidenca të gjeneruara nga sistemi mbi këto lëvizje.

Gjithashtu në raport nuk është bërë një analizë për të evidentuar lëvizjen e produktit “gaz për automjete” dhe “gaz për ngrohje” deri në momentin e trajtimit të diferencuar ligjor të tyre në % e akcizës.

Gjithashtu ndryshe nga sa përshkruhet në raportin paraprak, në raportin përfundimtar thuhet se ‘janë verifikuar me përzgjedhje fatura tatimore të blerjes dhe shitjes, për të cilat nuk janë konstatuar parregullsi’, dokumentacion ky që nuk gjendet bashkëngjitur në dosje (faturat).

Nga evidenca me 17 rekorde e vendosur në dispozicion me kontrollin e markimit të karburanteve nga DPD pranë GFI janë përzgjedhur për testim 2 dosjet si më poshtë:

1.”Gj.” (Kontroll markimi i PE)-bazuar në planin vjetor të punës nr.425 datë 11.01.2022 është ushtruar kontroll në datë 19.07.2022 pranë pikës së ambienteve të subjektit “Gj.” me N....C në Tiranë.

Në dosje gjendet PV testimi të markimit nr.1170926JQ9JQ datë 19.07.2022 ora 1:59 me rezultat FAIL 74.5%, pra produkt ‘Gazoil’ i pa markuar, firmosur nga përfaqësuesit e autoritetit e.g GFI, Y.L DPD.

Gjithashtu PV kontrollit fizik nr.0014207 datë 19.07.2022 ora 17:20 firmosur nga z.Y.L dhe z.R.G dhe përfaqësuesi operatorit që ka refuzuar sasinë në të cilin konstatohet se “*Nga subjekti u deklarua sasia 20,000 litra naftë dhe nga testimi rezultoi FAIL 74.5% të sasisë. Depozita vertikale dhe cilindrike nga matjet teorike të grupit të kontrollit rezultoi sasia 30,000 litra dhe mbetet të përcaktohet sasia e saktë nga verifikimi fizik duke e shkarkuar lëngun në një bot të pajisur me pasaportë mbajtjeje. U krye plumbosja në pikën fundore të depozitës me plumbçe AL-P262550, pistoletat me plumbçe AL-P262549 dhe AL-P262548 dhe pika furnizimit me plumbçe AL-P262546. Objekti i bllokuar i lihet në ruajtje subjektit deri në krijimin e kushteve për vazhdimin e procedurës së kontrollit për verifikimin fizik të sasisë së lëngut të bllokuar”.*

Në datë 20.07.2022 ora 14:30 është mbajtur PV verifikimit të kundërvajtjes administrative nr.0006512, për nenet 54, 85 piak 1/a dhe 95 a,b të ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku citohet ndër të tjera se ‘*Mbajtja, hedhja në qarkullim të lirë, tregtimi, importimi, shpërndarja, transportimi, rafinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër me produktet që markohen/shënjojnë apo ngjyrosen apo që nuk kanë markuesin/shënjesin apo ngjyruen në sasinë dhe përqendrimin e duhur dënohen si më poshtë: a) në çdo rast të konstatuar, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për sasinë e produktit të gjendur të pa markuar/shënjuar apo ngjyrosur, bazuar në rezultatet e analizimit/testimit’* firmosur nga z.Y.L, z.R.G, Z.A.S dhe z.G.Y.

I është dërguar DDTiranë informacioni për marrje vendimi nr.13563 datë 20.07.2022 nga DP mbi kundërvajtjen e konstatuar me vlerë detyrimi 854,239 lekë dhe penalitet 5 fish të detyrimit për 4,271,195 lekë, pra në total 5,125,434 lekë. Është marrë vendimi nr.872 datë 27.07.2022 nga DDT bazuar në aktet e sipër përmendura për vlerën e sipër cituar dhe bashkëngjitur gjendet edhe shlyerja e detyrimit dhe penalitetit nga subjekti po në datë 27.07.2022.

Për sa më sipër në dosje nuk ka asnjë dokument mbi ndjekjen e procedurës dhe verifikimin e sasisë së konstatuar në PV fizik me shkarkim sikurse citohet më sipër.

2.”G.” (Kontroll markimi i PE)-bazuar në planin vjetor të punës nr.425 datë 11.01.2022 është ushtruar kontroll në datë 24.10.2022 pranë pikës së ambienteve të subjektit “G. SHPK” me Nipt K....T në Tiranë.

Në dosje gjendet PV testimi të markimit nr.1170916OPVG6 datë 24.10.2022 ora 1:43 me rezultat FAIL 92.5%, pra produkt ‘Gazoil’ i pa markuar, firmosur nga përfaqësuesit e autoritetit z.I.D (GFI), z.M.M (DPD) dhe z.E.L (GFI).

Gjithashtu PV kontrollit fizik nr.0023956 datë 24.10.2022 ora 17:20 firmosur nga z.M.M, z.R.G, z.N.T, z.K.M dhe z.E.P, prej të cilëve 3 të fundit janë nga Doh por në dosje nuk administrohet dokumentacioni përkatës mbi angazhimin e tyre, dhe përfaqësuesi operatorit, ka konstatuar se “*Nga subjekti u deklarua sasia 19,000 litra naftë dhe nga testimi rezultoi FAIL 92.5% të sasisë. Grupi i kontrollit kreu matjet fizike dhe e tërhoqi të gjithë sasinë duke e depozituar në botin me numër serial pasaporte 0000124 dhe targë AA294NC ku pas shkarkimit rezultoi sasia 9,390 litra dhe në*

bashkëpunim me DDT boti u plumbos me plumbçet nr.AL-P312149, AL-P312150, AL-P312145 dhe AL-P312144, dhe e gjithë sasia e bllokuar iu la në ruajtje subjektit.

Në datë 25.10.2022 ora 09:30 është mbajtur PV verifikimit të kundërvajtjes administrative nr.0025177, për sasinë 9,390 litra të pa markuar, mbështetur në nenet 54, 85 pika 1/a dhe 95 a,b të ligjit nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, ku citohet ndër të tjera se ‘Mbajtja, hedhja në qarkullim të lirë, tregtimi, importimi, shpërndarja, transportimi, rafinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër me produktet që markohen/shënjohe apo ngjyrosen apo që nuk kanë markuesin/shënjesin apo ngjyruetin në sasinë dhe përqendrimin e duhur dënohen si më poshtë:a) në çdo rast të konstatuar, me gjobë sa 5-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për sasinë e produktit të gjendur të pa markuar/shënuar apo ngjyrosur, bazuar në rezultatet e analizimit/testimit’ firmosur nga z.M.M, z.R.G, z.A.S, përgjegjëse sektori dhe z.J.Ç, drejtor drejtorie.

Lidhur me sa më sipër është e pa qartë se mbi c’bazë ligjore është mbështetur përfshirja e nëpunësve të palidhur me konstatimin e shkeljes në proces verbalin e konstatimit të kundërvajtjes administrative.

I është dërguar DDTiranë informacioni për marrje vendimi nr.18772 datë 25.10.2022 nga DP mbi kundërvajtjen e konstatuar me vlerë detyrimi 328,796 lekë dhe penaltet 5 fish të detyrimit për 1,643,980 lekë, pra në total 1,972,776 lekë. Është marrë vendimi nr.1118 datë 03.11.2022 nga DDT bazuar në aktet e sipër përmendura për vlerën e sipër cituar dhe bashkëngjitur gjendet edhe shlyerja e detyrimit dhe penaltetit nga subjekti në datë 11.11.2022.

Gjithashtu nga auditimi është konstatuar se edhe pse Sektori i Produkteve Energjetike ka të përcaktuar në detyrat funksionale të tij “*monitorimin e zbatimit të kushteve si dhe respektimin nga operatorët e akcizës të skemës së përjashtimeve dhe rimbursimeve brenda fushës së kompetencës*” urdhri nr.146 datë 07.05.2012 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, neni 73, pika 4.3, gjatë vitit 2022 nuk ka kryer asnjë kontroll për akcizën e rimbursuar në vlerën 234 milion lekë në total, ku 224 milion lekë kanë shkuar për serat dhe industrinë dhe pothuaj 10 milion lekë për ambasadat.

Lidhur me problematikën e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr.283/4 datë 20.07.2023 nga zj.A.S dhe zj.H.Xh, me përmbajtje si më poshtë:

Pretëdim i subjektit: Për rastin e kontrollit të ushtruar pranë operatorit 2 sha, sqarojmë se ky operator nuk mban një status operatori të regjistruar dhe të miratuar pranë Autoritetit Doganor dhe nuk kryen veprime deklarative pranë sistemit Asycuda Word. Ky është një operator që mban dhe tregton produkte akcize (në rastin konkret produkte energjetikë gaz i lëngët GLN), pas hedhjes për konsum në territor dhe pas çlirimit nga detyrimet doganore. Për konstatimin e grupit të auditimi se:

‘në dosje mungon relacioni për D.P mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur’ sqarojmë se:

Operatorët e tregtimit të gazit të lëngshëm, janë përzgjedhur për kontroll nga verifikimi i zinxhirit të tregtimit të GLN nga importuesit deri tek pikat fundore, nëpërmjet kontrollit të librave të shitjes dhe të blerjes. Ky verifikim është iniciuar që në vitin 2021, dhe pas çdo kontrolli të importuesve të mëdhenj të nivelit të parë (Shoqëritë Aksionare), nxirreshin blerësit kryesorë dhe vijohej me verifikimet e shitjeve të tyre të diferencuara pa akcizë drejt operatorëve për ngrohje ose me akcizë drejt operatorëve që dispononin pika të tregtimit me pakicë për automjete. Analiza e riskut në disa raste është bërë para çdo kontrolli, ndërsa në disa raste, sikurse është verifikimi i zinxhirit të GLN, është bërë në parim. Bashkëlidhur gjendet memo drejtuar Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave mbi 3 linja të drejtimit të kontrolleve që janë propozuar për tu kryer nga Sektori i Produkteve Energjetike për 6 mujorin e dytë të vitit 2022.

Përsa i përket indikatorëve të riskut, në Janar të vitit 2022, me shkresën nr 1830 prot të datës 31.01.2022, nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, titullar i Departamentit të Analizave dhe Aposteriorit, është

miratuar plani i punës për vitin 2022, për Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit, në të cilën janë përcaktuar indikatorët e riskut si dhe Matrica e Riskut sipas çdo Sektori të kësaj Drejtorie. (bashkëlidhur shkresa nr 1830 prot datë 31.01.2022)

Përsa i përket konstatimit se procesverbali i konstatimit nuk është mbajtur sipas formatit tip të miratuar pa numër serial, sqarojmë se operatori “2 sha” sikurse operatori “E.O sha”, nuk janë operatorë me status Magazine Fiskale për të cilët mbahet procesverbali tip i miratuar. Procesverbali mbahet sipas nenit 273 gërma 3 dhe 5 të Ligjit 102 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Përsa i përket konstatimit se ”Procesverbali i konstatimit të gjendjes fizike është i pa firmosur nga përfaqësuesit e operatorit dhe grupi i kontrollit”, nuk qëndron pasi siç vërehet nga dokumenti bashkëlidhur janë të firmosura nga të dyja palët. Përsa i përket konstatimit se nuk janë të protokolluara veçmas, sqarojmë se nuk është praktikë protokollimi i një dokumenti të tillë gjatë kohës kur zhvillohet kontrolli i cili është i miratuar paraprakisht me program kontrolli. Protokollimi i këtij dokumenti bëhet së bashku me Informacionin që i paraqitet titullarit ”Informacion paraprak për titullarin mbi programin e kontrollit nr ___Prot date ___” në të cilin citohet edhe dokumenti i procesverbalit të konstatimit të gjendjes fizike dhe çdo dokument tjetër i administruar gjatë kontrollit të ushtruar si pjesë e dosjes së kontrollit.

Ne rastin kur ky konstatim do të bëhet një rekomandim nga Raporti i Auditimit të KLSH, është i mirëpritur të merret në konsideratë për të ardhmen.

Lidhur me analizën e bërë mbi lëvizjen e gazit të lëngshëm në raportin e kontrollit mungon një pasqyrim i qartë mbi hyrje daljet e produktit sipas dokumentacionit kontabël apo regjistrin elektronik në sistemin Asycuda Word si dhe nuk gjenden evidenca të gjeneruara nga sistemi mbi këto lëvizje.

Përsa i përket pasqyrimit të hyrje daljeve të produktit GLN sipas dokumentacionit kontabël, nuk qëndron pasi verifikimi që bëhet nga grupi i kontrollit fillon paraprakisht me marrjen e librave të blerjes dhe të shitjes për periudhën në format elektronik ashtu siç deklarohen pranë Tatimeve, dhe që gjenden në emailin zyrtar të punonjësve që kanë kryer kontrollin pas datës së kontrollit por edhe përpara fillimit të kontrollit në verifikimet që ne si strukturë i kemi kërkuar Sektorit të Ndërveprimit me Tatimet pranë Departamentit Operativ e Hetimor përpara fillimit të kontrollit, si dhe librave të shitjes të verifikuara nga furnitorët e këtyre operatorëve të kontrolluar, gjatë programeve të mëparshme të kontrollit.

Të gjitha kontrollet e produktit gaz i lëngshëm, janë bërë për të verifikuar zinxhirin tregtar të shitjeve dhe blerjeve të diferencuar edhe sipas qëllimit të përdorimit, për ngrohje dhe për automjete. Në 1 janar 2022 ka hyrë në fuqi Ligji 114/2021 ”Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 61/2012 ”Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky ligj ka parashikuar aplikimin e akcizës në nivelin prej 6 lekë/ltr për gazin e lëngshëm pa diferencim nga qëllimi i përdorimit që nga data 1 korrik 2022. Çdo kontroll i kryer pas kësaj datë pranë operatorëve ka gjetur një situatë të mbajtjes së kontabilitetit të pandarë nga qëllimi i përdorimit. Lidhur me kontrollin e ushtruar pranë operatorit “J sha”, i cili është mbajtës i Statusit të Depozituesit të Miratuar me Magazinë Fiskale prodhimi të vajit lubrifikant, ju bëjmë me dije që karta teknologjike e subjektit është e konfirmuar/certifikuar nga ISHTI, bashkëlidhur Vërtetimi Teknik.

Grupi i KLSH ka konstatuar se *procesverbali i kontrollit fizik me nr 0021610 datë 12.10.2022, nuk është mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM nr 612 datë 02.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbal tepricat apo mangësitë e konstatuara në inventarizim.* Në zbatim të nenin 69 të VKM nr 612, datë 05.09.2012, grupi i kontrollit (A.S dhe H.Xh) kanë evidentuar tepricat dhe mangësitë e konstatuara për të gjithë artikujt e gjendur në magazinën fiskale të operatorit në Deklaratën përmbledhëse që shoqëron Procesverbalin e kontrollit fizik të gjendjes, i cili është edhe Informacioni paraprak që informon titullarin për rezultatet e kontrollit të kryer. Tepricat dhe mangësitë janë konstatuar dhe në Informacionin për operatorin dhe për Degën Doganore mbikëqyrëse janë lënë detyrat: ”Në zbatim të nenit 69, të VKM 612, datë 05.09.2012, i ndryshuar, për të gjitha diferencat e konstatuara, si mangësi si dhe tepricë nga kontrolli i magazinës fiskale, i lihet detyrë degës doganore mbikëqyrëse që të mbikëqyre operatorin të kryejë veprimet rregulluese në sistem duke depozituar menjëherë DSHA-të përkatëse (DSHA hyrëse për tepricat dhe DSHA dalëse me pagesë për mangësitë), përpara kryerjes së veprimeve të tjera në magazinën fiskale.”

Në lidhje me konstatimin e grupit të Auditimit të KLSH mbi kontrollin e markimit të PE pranë operatorit “Gj. C”, se në dosje nuk është gjetur asnjë dokument për ndjekjen e procedurës dhe verifikimit e sasisë së

konstatuar në PV fizik me shkarkim sikurse është cituar në Proces Verbal, sqarojmë se, matjet janë kryer duke u bazuar në certifikatat e kalibrimit të depozitës, në matjet me metër shirit të sasisë së gjendur dhe referencës së sasisë së mbushur në tabelën e certifikatës së kalibrimit. Subjekti “G. C”, pasi është njoftuar për procesverbalin e konstatimit të kundërvajtjes Administrative të mbajtur nga grupi i kontrollit dhe strukturat mbikëqyrëse që kanë marrë pjesë në verifikimet dhe koordinimet e kontrollit, nuk ka kundërshtuar rezultatet lidhur me sasinë e matur dhe as lidhur me % e pa markuar. Duke qenë se nuk ka patur mundësi të shtojë kosto ekstra për marrjen e një depozite tjetër apo të një autoboti për shkarkimin e sasisë nga depozita e vet, ka pranuar rezultatet nga matjet prej 30,000 litrash duke mos ankimuar vendimin e Degës Doganore dhe duke kryer menjëherë pagesën e detyrimit të munguar si dhe të penaliteteve respektive, sikurse është evidentuar edhe në dosjen e kontrollit të vënë në dispozicion grupit të audituesve të KLSH.

Qëndrim i grupit të auditimit:

Lidhur me pretendimet mbi analizën e riskut dhe regjistrin e riskut vendosur në dispozicion sqarojmë se bazuar në regjistrin e riskut dhe analizën e bërë mund të caktohen në mënyrë periodike subjektet mbi të cilët do të ushtrohet kontroll. Sa i takon pretendimeve për mos protokollimin e Proces Verbaleve, sqarojmë se PV fizik apo ai i verifikimit të shkeljes është një dokument në bazë të të cilit hartohet Projekt Raportit dhe përfaqësojnë dy dokumente të ndryshëm administrativ. Në pretendimet e sjella nuk ka argumente apo dokumente shtesë të pa adminstruara më parë mbi mos zbatimin e nenit 69, të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 të cilës i referohet observacioni. Udhëzimi nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës” përcakton procedurat përgatitore para paraqitjes te operatorët ekonomik që nga gjenerimi raporteve të sistemit për OE, gjendja kontabël etj., veprime në bazë të të cilave do të mund të evidentohen dhe diferencat në inventarin fizik me atë dokumentar.

Për sa pretenduar më sipër për argumentet dhe dokumentacionin shtesë vendosur në dispozicion observacioni merret në konsideratë pjesërisht dhe bëhen reflektimet përkatëse në PR.

-Sektori i Produkteve të tjera:

Nga auditimi i veprimtarisë së këtij sektori gjatë vitit 2022 është konstatuar se janë zhvilluar 71 programe kontrolli, prej të cilave kanë dalë me rezultat vetëm 6 prej tyre, ku konkretisht për katër operator është vendosur penalitet 100,000 lekë, për 1 operator është vendosur penaliteti 87,951 lekë dhe për 1 tjetër operator penaliteti 50,000 lekë. Nga evidenca vendosur në dispozicion me 71 rekorde dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontroleve të realizuara nga ky sektor ka variuar nga 8 ditë – 178 ditë. Prej tyre janë përzgjedhur për testim 3 dosje për operatorët si më poshtë.

1.”M” në zbatim të Program Kontrollit nr.16259 datë 13.09.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.M dhe zj.E.C inspektuan në ambientet e operatorit “M” me NIPT K...E në datat 13 dhe 14 shtator 2022 në Tiranë me qëllim verifikimin e gjendjes fizike të produkteve të akcizës, dokumentacionin kontabël lidhur me tregtimin, importin, eksportin apo veprimet e tjera doganore për produktet e akcizës, me qëllim verifikimin e pagesave të detyrimeve doganore për këto produkte.

Në dosje gjendet gjithashtu relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll pranë ambienteve të operatorit nr.16215 datë 12.09.2022 për shkak të rënies së të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, evidentuar në DSHA tip 4 hedhje në konsum për periudhën janar-gusht 2022, si dhe informacioni mbi programin e kontrollit për DP nr.16259/1 datë 18.10.2022.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit Fizik nr.0023901 datë 14.09.2022 ora 15:45 në të cilin rezultojn gjëndje fizike 107,777 kg kafe e papjekur dhe 6,240 kg kafe e pjekur, bashkëngjitur të cilit mungon deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitatat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar.

Është hartuar dhe dërguar operatorit Raporti Përfundimtar i Kontrollit nr.16259/3 datë 25.10.2022 me të njëjtën përmbajtje me informacionin paraparak. Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, ka rezultuar mangët 7 kg kafe pjekur nga krahasimi stokut fizik me atë kontabël, mangësi nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

2."S" në zbatim të Program Kontrollit nr.18579 datë 20.10.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.M dhe zj.E.C dhe zj.A.L inspektuan në ambientet e operatorit "S" me NIPT L...T, në datat 27 dhe 28 tetor 2022 në Tiranë me qëllim verifikimin e gjendjes fizike të produkteve të akcizës, dokumentacionin kontabël lidhur me tregtimin, importin, eksportin apo veprimet e tjera doganore për produktet e akcizës, me qëllim verifikimin e pagesave të detyrimeve doganore për këto produkte.

Në dosje gjendet gjithashtu relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll pranë ambienteve të operatorit nr.18684 datë 21.10.2022 përzgjedhur për arsye se kishte mbi 2 vjet pa u kontrolluar, si dhe informacioni mbi programin e kontrollit për DP nr.18579/1 datë 08.11.2022.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Verifikimit Fizik nr.0002174 datë 28.10.2022 ora 12:00 në të cilin rezultoi gjëndje fizike 2,120 kg kafe e papjekur dhe 4,223 kg kafe e pjekur, bashkëngjitur të cilit mungon deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat", i ndryshuar.

Është hartuar dhe dërguar operatorit Raporti Përfundimtar i Kontrollit nr.18579/2 datë 15.11.2022 me të njëjtën përmbajtje me informacionin paraparak. Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, ka rezultuar mangët 8 kg kafe pjekur nga krahasimi stokut fizik me atë kontabël, mangësi nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

3."G" SHPK në zbatim të Program Kontrollit nr.16246 datë 13.09.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga zj.A.M dhe zj.E.C inspektuan në ambientet e operatorit "G SHPK" me NIPT L...Q, në datat 13 deri 16 shtator 2022 në Berat me qëllim verifikimin e gjendjes fizike të produkteve të akcizës, dokumentacionin kontabël lidhur me tregtimin, importin, eksportin apo veprimet e tjera doganore për produktet e akcizës, me qëllim verifikimin e pagesave të detyrimeve doganore për këto produkte.

Në dosje gjendet gjithashtu relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll pranë ambienteve të operatorit nr.16215 datë 12.09.2022 për shkak të rënies së të ardhurave krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, evidentuar në DSHA tip 4 hedhje në konsum për periudhën janar-gusht 2022. si dhe informacioni mbi programin e kontrollit për DP nr.16246/1 datë 18.10.2022.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Verifikimit Fizik nr.0023902 datë 15.09.2022 ora 16:45 në të cilin rezultoi gjëndje fizike 796,830 kg kafe jeshile e papjekur, bashkëngjitur të cilit mungon deklarata përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012 "Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat", i ndryshuar.

Është hartuar dhe dërguar operatorit Raporti Përfundimtar i Kontrollit nr.16246/2 datë 25.20.2022 me të njëjtën përmbajtje me informacionin paraparak. Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, ka rezultuar mangët 8 kg kafe pjekur nga krahasimi stokut fizik me atë kontabël, mangësi nën 2% të sasisë kontabël dhe pa shkelje.

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion nga grupi i kontrollit të dosjes mbi kontrollin dhe testet specifike të zhvilluara në zbatim të pikës së dytë të tematikës së programit të kontrollit, në të cilën përcaktohet "*Të verifikohet dokumentacioni kontabël lidhur me tregtimin, importin, eksportin apo veprimet e tjera doganore për produktet e akcizës, me qëllim verifikimin e pagesave të detyrimeve doganore për këto produkte*", në përgjigje të së cilit është sqaruar nga specialistet se nuk janë bërë

kontrolle specifike me arsyetimin se këto kontrolle janë përgjegjësi e një tjetër sektori. Lidhur me pretendimin sa më sipër urdhri nr.146 datë 07.05.2012 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, në nenin 73, pika 4.4 ‘Detyrat funksionale të Sektorit të Produkteve të Tjera’ përcakton se “*Sektori i Produkteve të Tjera ka këto detyra funksionale: -Ushtron kontrolle fizike dhe dokumentare (DSHA, regjistra kontabël, karta teknologjike, si dhe çdo dokument tregtar shitje dhe blerje) pranë operatorëve të akcizës, shoqërive, personave fizik të cilët prodhojnë, përpunojnë, stokojnë, përdorin, transportojnë apo tregtojnë produkte të tjera nga ato të duhanit, pijeve alkoolike dhe energjetike; - Kryen kontrolle a posteriori pranë operatorëve të akcizës ose të çdo personi që në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë në ushtrimin e profesionit të tij, ka lidhje me produkte të tjera nga ato të duhanit, pijeve alkoolike dhe energjetike*”.

Sa më sipër nga auditimi i dosjes së kontrollit të zhvilluar për operatorin G SHPK është konstatuar se kontrolli i zhvilluar nga grupi nuk është kryer i plotë dhe në përputhje me tematikat e kontrollit përcaktuar në program kontrolli.

Lidhur me problematikën e trajtuar më sipër është paraqitur observacioni nr.283/30 datë 07.09.2023 nga zj.A.M dhe zj.E.C, me përmbajtje të ngjashme me observacionin e trajtuar në projekt raportin e auditimit, si dhe nr.283/34 datë 08.09.2023 me dokumentacion shtesë bashkëngjitur, i cili është marrë pjesërisht në konsideratë.

-Sektori i Paisjeve, Matësve dhe Linjave Teknologjike

Gjatë auditimit është kërkuar dhe vendosur në dispozicion informacion dhe dokumentacion mbi veprimtarinë e sektorit gjatë vitit 2022 nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se janë bërë në total 49 verifikime, prej të cilave 46 verifikime të normativës së prodhimit, koeficientet e humbjeve dhe firove, 1 verifikim i ndryshimeve në skemën teknike të magazinës fiskale dhe 2 verifikime të kartës teknologjike mbi konsumin e lëndës djegëse, në të cilat janë lënë detyrat specifike sipas rastit si për operatorët edhe për degët doganore mbikëqyrëse.

Nga auditimi i evidencës së këtij sektori me 49 rekorde dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontrolleve të realizuara nga ky sektor ka variuar nga 16 ditë – 170 ditë. Prej tyre janë përzgjedhur për testim 2 dosjet si më poshtë:

1.”A”- në zbatim të Program Kontrollit nr.16715 datë 21.09.2022 grupi i punës i përbërë nga z.G.G, znj.L.H, znj.T.B, z.D.M dhe znj.F.H inspektuan në ambientet e operatorit "A" sha me NIPT: L.....P, Fier me qëllim verifikimin e kartës teknologjike.

Nga verifikimet fizike të kryera dhe nga deklarimi i operatorit, rezultoi se puna në rafinerinë / impiantin e përpunimit të naftës bruto ishte e ndalur dhe se rafineria kishte ndërprerë punën pasi operatori ishte në procesi të plotë, i cili kishte të bënte me përmirësime në sistemin e vakumit si dhe zëvendësime të pompave me avull me pompa centrifugale dhe të gjitha këto përmirësime do të ndikonin në uljen e konsumit të lëndës djegëse. Operatori ka rinovuar në datën 15.08.2022 vërtetimin teknik “*Për kartën teknologjike të rafinerisë të naftës*”. Karta teknologjike e rinovuar përshkruan proceset e prodhimit, parametrat teknologjik, bilancin material të prodhimit, normativat e konsumit të lëndës djegëse për konsum vetjak.

Nga inspektimi i linjave ka rezultuar se linjat e tubacioneve hyrëse të lëndës së parë në impiant dhe linjat e lëndës djegëse për konsum vetjak ishin të plumbosura nga autoriteti doganor, kalimatësit e naftës bruto dhe lëndës djegëse për konsum vetjak ishin të plumbosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjise dhe autoriteti doganor.

Iu la detyrë operatorit që në përfundim të procesit të remontit dhe modifikimit të impiantit teknologjik të depozitonte dokumentacionin teknik të rinovuar (skicën teknologjike) si dhe të

njoftojë autoritetin doganor për rifillimin e aktivitetit prodhues dhe u mbajt proces verbali nr.0021426 datë 23.09.2022, nënshkruar nga operatori dhe autoriteti doganor.

2."K" në zbatim të Program Kontrollit nr.20103 datë 15.11.2022 grupi i përbërë nga z.G. G, znj.L.H dhe znj.T.B inspektuan në ambientet e operatorit "K" me NIPT: L....A, Shkodër me qëllim verifikimin e normativave teknike (humbjeve, firove) në procesin e prodhimit. Nga verifikimet e kryera në ambientin e operatorit rezultoi se operatori në momentin e inspektimit kishte futur në magazinën fiskale të prodhimit 120,979 kg rush, e cila ishte përpunuar dhe në momentin e kontrollit ishte në fazën 73,230 litra lëngu vere në procesin përfundimtar të prodhimit. Sipas deklaratave të operatorit për këtë sasi të përpunuar ishin realizuar proceset e seleksionimit, heqjes së frenjëve të ndarjes së bërsive nga lëngu i verës si dhe tërheqjet nga llumrat. Në përfundim u konkludua se në të gjitha fazat e prodhimit të verës humbjet rezultuan të ishin 39.5 % dhe për vitin 2022 normativa e procesit të prodhimit rezultoi 60.5 %. Iu la detyrë operatorit të depozitojë pranë Degës Doganore Shkodër dhe pranë Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit(Aposteriori)/ Departamenti i Analizave dhe Aposteriorit / DPD *"Evidencën e përlllogaritjes së humbjeve dhe firove në procesin e prodhimit të verës për vitin 2022"* bazuar kjo evidencë në rezultatet përfundimtare të procesit të prodhimit, si dhe Degës Doganore Shkodër monitorimi i operatorit "K.M." në lidhje me ngarkimin në sistem të prodhimit të ri për vitin 2022, si dhe u mbajt proces verbali nr.0023947 datë 09.12.2022, nënshkruar nga operatori dhe autoriteti doganor.

-Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Regjimeve Doganore

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion mbi kontrollin e realizuar nga ky sektor gjatë 2022 dhe i është vendosur në dispozicion evidenca me subjektet e kontrolluara me email-in e datës 17.05.2023, gjithsej 33 subjekte, nga të cilat janë përzgjedhur në kampionin e testimit 8 me përzgjedhje rastësore. Nga auditimi është konstatuar se mungojnë evidencat dhe dokumentacioni përkatës mbi analizën e riskut të realizuar nga sektori përcaktuar në, Urdhrin nr.7 datë 28.01.2021 *"Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore"*.

Nga auditimi i evidencës së këtij sektori me 33 rekorde dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontrolleve të realizuara nga ky sektor ka variuar nga 15 ditë – 106 ditë. Prej tyre janë përzgjedhur për testim dosjet si më poshtë.

1."E.D" SHPK me Nipt K....U- në zbatim të Program Kontrollit nr.2008/2 datë 16.02.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.S.A dhe z.O.C ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "E.D" SHPK në datat 14-23 shkurt 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin mbi dokumentet tregtar dhe dokumentet kontabël mbi zbatimin e procedurave doganore në procesin e vlerësimit doganor, klasifikimit tarifor dhe origjinën e mallrave. Sa më sipër evidentohet se afati kontrollit nis 2 ditë pra programit të kontrollit.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.1 në datën 04.04.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 2,753,630 lekë dhe penalitet 1 fish i detyrimit doganor 2,753,630 lekë, pra në total 5,507,260 lekë për shkak të ndryshimit të vlerës doganore të mallrave deklaruar në import, si pasojë e diferencave në vlerën e transportit.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.3 në datën 04.04.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 44,347 lekë dhe penalitet 1 fish i detyrimit doganor 44,347

lekë, pra në total 88,694 lekë për shkak të ndryshimit të vlerës doganore të mallrave deklaruar në import, si pasojë e diferencave në vlerën e transportit.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Verifikimit të Shkeljes Nr.2 në datën 04.04.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin është vendosur penalitetet për agjentin doganor “L” në vlerën 380,000 lekë, nga 20,000 lekë për secilin DAV jo të saktë pra 19 gjithsej.

I është dërguar subjektit, agjencisë doganore “L” dhe Degës Doganore Tiranë Raporti Paraprak i kontrollit me shkresën nr.2008/5 datë 07.04.2022, si dhe informacion për kontrollin Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën nr.2008/6 datë 06.05.2022.

Në dosje gjendet gjithashtu observacioni sjellë nga agjencia doganore “L.C” prot.7767 datë 22.04.2022 me pretendimet për kundërvajtjet e konstatuara.

Jan mbajtur nga grupi Proces Verbalet Përfundimtar Nr.1, Nr.2 dhe Nr.3 në datën 12.05.2022 pas observacioneve të subjektit, të pa protokolluar dhe të firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit përfundimtar, në të cilët detyrimet dhe penalitetet mbeten të njëjta me ato të përcaktuara në PV e verifikimit të shkeljes 1,2 dhe 3.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.1 është marrë nga Dega Doganore Tiranë vendimi nr.801 datë 08.07.2022 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.3 është marrë nga Dega Doganore Tiranë vendimi nr.802 datë 08.07.2022 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Lidhur me penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.2 për agjentin doganor nuk është marrë vendim nga DDTiranë mbi penalitetin e vendosur prej 380,000 lekësh.

2.”M” SHPK me Nipt K...U - në zbatim të Program Kontrollit nr.16724 datë 21.09.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.A.S dhe zj.M.L ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "M" SHPK, në datat 22-29 shtator 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave në magazinën doganore A25 si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me përcaktimet ligjore për periudhën shtator 2019 deri në shtator 2022.

Në dosje gjendet Autorizimi nr.16724/1 datë 21.09.2022 për verifikimet e nevojshme të grupit të kontrollit, si dhe proces verbali i kontrollit fizik të mallrave i mbajtur datë 22.09.2022 i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, por i pa protokolluar në të cilin evidentohet gjendja si më poshtë.

Pasqyra 51:Gjendja nga kontrolli fizik

Nr.	Përshkrimi	Kodi Tarifor	Total
1	Lentet e Pamjes	90013000	91
2	Lentet e Pamjes	90015020	30
2	Skelet Optik	90031100	2007
3	Skelet Optik	90031900	3837
4	Syze Dielli	90041091	1458
5	Syze Dielli	90041099	81

Burimi: Dosja kontrollit të operatorit, DPD

I është dërguar DP informacioni nr.16724/2 datë 29.09.2022, pa mbaruar akoma afati programit mbi kontrollin dhe i është dërguar operatorit dhe DDTiranë raporti përfundimtar i kontrollit nr.16724/3 datë 02.11.2022, në të cilin nuk janë konstatuar gjetje apo shkelje nga subjekti.

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, pika 4 C Administrimi dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi dosjes në zyrën e protokollit.

3."R" me Nipt J...U- në zbatim të Program Kontrollit nr.17349 datë 30.09.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.R.SH dhe zj.E.N ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "R", në datat 03-07 tetor 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave në magazinën doganore C47 si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me përcaktimet ligjore për periudhën nga tetor 2019 deri në tetor 2022.

Në dosje gjendet proces verbali i kontrollit fizik të mallrave i mbajtur datë 22.09.2022 i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, por i pa protokolluar në të cilin evidentohet gjendja si më poshtë, por mungon Autorizimi për verifikimet e nevojshme të grupit të kontrollit.

I është dërguar DP informacioni nr.17348/2 datë 20.10.2022 mbi kontrollin dhe i është dërguar operatorit dhe DDTiranë raporti përfundimtar i kontrollit nr.17348/3 datë 01.11.2022, në të cilin nuk janë konstatuar gjetje apo shkelje nga subjekti.

Në dosje mungon relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur subjekti sikurse përcakton Urdhri nr.7 datë 28.01.2021 "Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore".

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 "Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore", pika 4 C Administrimi dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi dosjes në zyrën e protokollit.

4."M" me Nipt K...Q- në zbatim të Program Kontrollit nr.17346 datë 30.09.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.A.S dhe zj.M.L ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "M", në datat 03-07 tetor 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave në magazinën doganore C42 si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me përcaktimet ligjore për periudhën tetor 2019 deri në tetor 2022.

Në dosje gjendet Autorizimi nr.17346/1 datë 30.09.2022 për verifikimet e nevojshme të grupit të kontrollit, si dhe proces verbali i kontrollit fizik të mallrave me përzgjedhje rastësore i mbajtur datë 07.10.2022 i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, por i pa protokolluar në të cilin evidentohet gjendja si më poshtë.

I është dërguar DP informacioni nr.17346/3 datë 08.11.2022 mbi kontrollin dhe i është dërguar operatorit dhe DDTiranë raporti përfundimtar i kontrollit nr.17346/4 datë 10.11.2022, në të cilin nuk janë konstatuar detyrime apo penalitete për subjektin, por autoritetet doganore nuk monitorojnë në kohë reale për çdo produkt gjendje në peshë (kg), njësi suplementare (cop, m2, etj), origjinë dhe vlerë mallrash, pasi sistemi elektronik "Aberon WMS" i të dhënave ku pasqyrohen lëvizjet mbi hyrje-daljen e mallrave në magazinën doganore nuk është i azhurnuar dhe hyrje daljet nga ky sistem nuk kryhen me kod tarifor me bazë 8 shifrore të mallrave, siç janë hyrjet dhe daljet e mallrave nga magazina doganore dhe nuk procedohet me një nënndarje në kodin 11 shifror, duke qenë se aktiviteti i operatorit ekonomik në regjimin e magazinimit doganor është shumë i lartë, pasi në magazinë ka gjendje (stok) rreth 153,626 lloje artikujsh të ndryshëm.

Në dosje mungon relacioni për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur subjekti sikurse përcakton Urdhri nr.7 datë 28.01.2021 "Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore".

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, pika 4 C Administrimi dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi dosjes në zyrën e protokollit.

5.”D” SHPK me Nipt K....J- në zbatim të Program Kontrollit nr.17756 datë 07.10.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.A.S dhe zj.M.L ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "D" SHPK, në datat 11-15 tetor 2022 në Elbasan me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave në magazinën doganorë C91 si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me përcaktimet ligjore për periudhën 3 vjeçare.

Në dosje gjendet Autorizimi nr.17760 datë 07.10.2022 për verifikimet e nevojshme të grupit të kontrollit, si dhe proces verbali i kontrollit fizik të mallrave i mbajtur datë 11.10.2022 i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, por i pa protokolluar në të cilin evidentohet gjendja si më poshtë. I është dërguar DP informacioni nr.17756 datë 20.10.2022 mbi kontrollin dhe i është dërguar operatorit dhe DDDurrës raporti përfundimtar i kontrollit nr.17756/2 datë 01.11.2022, në të cilin nuk janë konstatuar gjetje apo shkelje nga subjekti.

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, pika 4 C Administrimi dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi dosjes në zyrën e protokollit.

6.”A” SHPK me Nipt L....N - në zbatim të Program Kontrollit nr.18583 datë 20.10.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.Sh.Sh. dhe zj.E.N. ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "A" SHPK me NIPT L....N, në datat 24-28 tetor 2022 në Tiranë me qëllim verifikimin e natyrës së mallrave të importuara fizikisht gjëndje në magazinën e operatorit si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat e klasifikuara në kreun tarifor 9021 për të cilat operatori ka përfituar përjashtim nga pagesa e TVSH -së për periudhën nga 01.01.2020 deri në 24.10.2022.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.1 në datën 08.11.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 58,948 lekë dhe penalitet 50,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin “A” me eksportues shoqërinë “ASrl”.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.2 në datën 08.11.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 521,768 lekë dhe penalitet 50,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin për subjektin “A” me eksportues shoqërinë “B”.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.3 në datën 08.11.2022, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 1,034,505 lekë dhe penalitet 100,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin “A” me eksportues shoqërinë “G”.

I është dërguar subjektit dhe Degëve Doganore Raporti Paraprak i kontrollit me shkresën nr.18583/1 datë 15.11.2022, si dhe informacion për kontrollin Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën nr.21248 datë 07.12.2022.

Mungon në dosje observacioni sjellë nga subjekti me pretendimet për kundërvajtjet e konstatuara. Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Përfundimtar Nr.1 në datën 16.12.2022 pas observacioneve të subjektit, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit përfundimtar, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 58,948 lekë dhe penalitet 50,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Përfundimtar Nr.2 në datën 16.12.2022 pas observacioneve të subjektit, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit përfundimtar, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 521,768 lekë dhe penalitet 50,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin për subjektin “A” me eksportues shoqërinë “B. I.”. Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Përfundimtar Nr.3 në datën 16.12.2022 pas observacioneve të subjektit, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit, bashkëngjitur raportit përfundimtar, në të cilin ka rezultuar detyrim i munguar në shumën 1,034,505 lekë dhe penalitet 100,000 lekë për shkak të mungesës së certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga AKBPM për subjektin “A” me eksportues shoqërinë “G”. Për sa më sipër pas verifikimit të deklaratave doganore të nxjerra nga sistemi Asycuda Word ka rezultuar se subjekti “A” ka importuar artikuj në kodin 8-shifror 90212900 nga 3 subjekte eksportuese dhe prodhuese të pajisjeve mjekësore dhe me parregullsinë për shkak të mospasjes me certifikatën e regjistrimit nga subjekti eksportues përpara datës së zhdoganimit në disa praktika doganore sipas tabelës më poshtë:

Subjekti “A” si pasojë e mungesës së certifikatës së regjistrimit lëshuar nga AKBPM për importimin e *“pajisjeve dhe materialeve të implantueshme dentare”* nga 3 kompanitë eksportuese më lartë, në kohën e duhur përpara datës së zhdoganimit, rezulton me një *detyrim doganor të munguar* në total në masën 1,615,221 lekë dhe *penalitet* në masën 200,000 lekë, pra në total 1,815,221 lekë.

Me shkresën nr.18583/3 datë 16.12.2022 i është dërguar subjektit dhe Degëve Doganore Tiranë, Durrës dhe Rinas Raporti Përfundimtar i kontrollit me rezultatet e evidentuara më sipër.

Nga auditimi është konstatuar se nuk është argumentuar nga grupi i kontrollit masa e caktuar e penalitetit për secilin proces verbal.

Grupi i kontrollit nuk ka argumentuar se si e ka zbatuar nenin 260, që citon dhe vet ne raport mbi *“kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë”* në të cilin përcaktohet se *“Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas”*. Pra në sa trajtuar më sipër është konstatuar e njëjta kundërvajtje në të 3 PV ku në të parin është caktuar penaliteti minimum 50,000 lekë, në PV e dytë është caktuar përsëri penaliteti 50,000 lekë minimum për një detyrim të munguar 8 herë më të madh se i pari dhe në PV e tretë është caktuar penaliteti 100,000 lekë për një detyrim 17 herë më të madh se detyrimi PV1 dhe 2 herë më të madh se detyrimi PV2. Baza ligjore cituar në PV dhe RP kontrolli në caktimin e detyrimeve neni 257 për kundërvajtjet e kryera në neglizhencë, pika 1 shkronja “b” i Ligjit Nr.102 datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, përcakton se *“1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: b) kur kundërvajtja nuk ka të bëjë me mallrat, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, zbatohet sanksion në masën 50 000 lekë deri në 500 000 lekë”*.

Sa i takon proporcionalitetit të vlerës së detyrimit përsëri këto penalitete rezultojnë të mos jenë në proporcion me vlerat e konstatuara sipas PV, të cilat janë si më poshtë.

Pasqyra 52: Detyrimet e konstatuara për operatorin “A”

PV	Detyrim	Vendimi DD	%detyrim totalit ndaj	Penalitet	Vendimi DD	Përsëritja e Kundërvajtjes
1	58,948	58,948	4%	50,000	50,000	1
2	521,768	521,768	32%	50,000	50,000	2
3	1,034,505	1,034,505	64%	100,000	50,000	3
Total	1,615,221	1,615,221	100%	200,000	150,000	

Burimi: Raport Kontrolli, përpunuar KLSH.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.1 është marrë nga Dega Doganore Tiranë vendimi nr.1262 datë 27.12.2022 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.2 është marrë nga Dega Doganore Durrës vendimi nr.95 datë 16.01.2022 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.3 është marrë nga Dega Doganore Rinas vendimi nr.10 datë 28.02.2023 për vlerën 1,034,505 lekë të detyrimit përcaktuar në PV dhe për vlerën 50,000 lekë për penalitetin, pra ndryshe nga sa është caktuar në PV penaliteti prej 100,000 lekë duke mos argumentuar këtë vendimmarrje.

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, pika 4 C Administrimi dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi dosjes në zyrën e protokollit.

7.”A” me Nipt J.....P - në zbatim të Program Kontrollit nr.20459 datë 22.11.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.A.S dhe zj.E.N. ushtruan kontroll në ambientet e operatorit “A” në datat 22-25 nëntor 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave që gjenden në regjimin e përpunimit aktiv dhe kontrollin dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin përpunimit aktiv/pasiv në përputhje me përcaktimet ligjore.

Është mbajtur nga grupi kontrollit proces verbali mbi kontrollin fizik në datën 23.11.2022, i firmosur nga grupi por i pa protokolluar me gjendje mallrash si në vijim: profile alumini 7,751 kg, lingotë 68,587 kg dhe skrap 71,765 kg.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbal Verifikimit të Shkeljes Nr.1 në datën 23.01.2023, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, bashkëngjitur raportit paraparak, në të cilin është penalizuar në vlerën 50,000 lekë subjekti për kundërvajtje administrative kryer në neglizhencë, konkretisht për mos mbajtje të saktë regjimit të përpunimit aktiv.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për autorizimin nr.20200214/3264/1 ka rezultuar se operatori ekonomik ka plotësuar dhe paraqitur dokumentin “Aneks 8”, sipas Udhëzimit nr.4 (nr.7888 prot.), datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit aktiv” për mbylljen e autorizimit të Regjimit të Përpunimit Aktiv, të protokolluar me nr.2799 Prot., Dega e Doganës Tiranë, datë 30.03.2021, ku diferenca në peshë neto është -2,142 kg dhe vlerë materiale është -2 euro. Në zbatim të pikës XI të Udhëzimit Nr.04 datë 28.03.2019 (Nr.7888 Prot., datë 28.03.2019) të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” është konstatuar se operatori ekonomik ka rieksportuar më shumë produkt, në krahasim me mallrat e importuar dhe produktin e blerë brenda vendit. Nga analizimi i të dhënave

është konstatuar se në procesin e mbajtës së regjimit të përpunimit aktiv, në mbylljen e regjimit nuk është përfshirë hedhja në qarkullim të lirë të mallrave (IM-4) janë bërë llogaritjet gabim, ndaj autorizimi rezulton me diferencë negative në peshë neto, ndërsa në vlerë nuk rezulton me diferencë.

Është mbajtur nga grupi Proces Verbali Verifikimit të Shkeljes Nr.2 në datën 23.01.2023, i pa protokolluar dhe i firmosur nga grupi kontrollit dhe subjekti, bashkëngjitur raportit paraprak, në të cilin është penalizuar në vlerën 50,000 lekë subjekti për kundërvajtje administrative kryer në neglizhencë, konkretisht për mos mbajtje të saktë regjimit të përpunimit aktiv.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për autorizimin nr.20210416/22906/1 ka rezultuar se operatori ekonomik ka plotësuar dhe paraqitur dokumentin “Aneks 8”, sipas Udhëzimit nr.4 (nr.7888 prot.), datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit aktiv” për mbylljen e autorizimit të Regjimit të Përpunimit Aktiv, të protokolluar me nr.10063 Prot., dega e doganës Tiranë, datë 27.10.2022, ku diferenca në peshë neto është -14,565 kg, pra është eksportuar peshë më shumë dhe vlerë materiale është -5 euro. Në zbatim të pikës XI të Udhëzimit Nr.04 datë 28.03.2019 (Nr.7888 Prot., datë 28.03.2019) të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv” është konstatuar se operatori ekonomik ka riekportuar më shumë produkt, në krahasim me mallrat e importuar dhe produktin e blerë brenda vendit. Nga analizimi i të dhënave është konstatuar se në procesin e mbajtës së regjimit të përpunimit aktiv, në mbylljen e regjimit nuk është përfshirë hedhja në qarkullim të lirë të mallrave (IM-4) dhe llogaritjet janë bërë gabim në peshë neto, ndërsa në vlerë nuk rezultojnë diferenca.

I është dërguar subjektit dhe Degës Doganore Tiranë Raporti Paraprak i kontrollit me shkresën nr.90452/2 datë 31.01.2023, por mungon në dosje informacioni për DP nga Drejtoria e Drejtorisë, përcaktuar në manual.

Janë hartuar sërish PV përfundimtare me të njëjtën përmbajtje si ato më lartë në datën 27.02.2023 dhe është dërguar raporti përfundimtar me shkresën nr.4388 datë 08.03.2023.

Lidhur me penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.1 është marrë nga Dega Doganore Tiranë vendimi nr.518 datë 02.05.2023 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.2 është marrë nga Dega Doganore Tiranë vendimi nr.519 datë 02.05.2023 për të njëjtën vlerë përcaktuar në PV.

Në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, pika 4 C Administrimi i dokumentacionit nuk është bërë ende inventarizimi dhe arshivimi i dosjes në zyrën e protokollit.

8.”P” SHPK me Nipt K...P- në zbatim të Program Kontrollit nr.20461 datë 22.11.2022 grupi i kontrollit i përbërë nga z.Sh.SH, z.O.C dhe z.M.H ushtruan kontroll në ambientet e operatorit "P" SHPK, në datat 22-25 nëntor 2022 në Tiranë me qëllim kontrollin fizik mbi përcaktimin e gjendjes fizike të mallrave në magazinën doganore C10 si dhe ushtrimin e kontrollit dokumentar/kontabël mbi respektimin e procedurave doganore për mallrat nën regjimin e magazinimit doganor në përputhje me përcaktimet ligjore për një periudhë 3 vjeçare.

Në dosje gjendet relacioni nr.20451 datë 21.11.2022 për DP mbi kërkesën për kontroll për operatorin si dhe analiza e riskut mbi të cilën është përzgjedhur subjekti sikurse përcakton Urdhri nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, si dhe autorizimi nr.20458 datë 22.11.2022 për ushtrimin e kontrollit në subjekt.

Është vendosur në dispozicion me observacion proces verbali mbi kontrollin fizik të mallrave si dhe gjendja kontabël e magazinës doganore C10 deri më datë 23.11.2022 me vlerë 746,212 Euro dhe dy deklarata doganore import 7 dhe import 4.

Në dosjen e kontrollit të operatorit gjendet vetëm shkresa nr.20461/1 datë 20.12.2022 me informacionin për Drejtorin e Përgjithshëm në të cilën ndër të tjera citohet se “Nga verifikimi në sistemin Asycuda Word rezultojnë po 31 automjete gjendje në magazinën doganore me nr identifikimi C10. Pra nga verifikimi në të dy sistemet Oracle dhe Asycuda Word rezultojnë 31 automjete gjendje në magazinën doganore. Edhe gjendja kontabël e ditës së kontrollit dorëzuar nga zj.E. kishte po 31 automjete, të dhënat e të cilave janë të njëjta me ato të nxjerra nga sistemi Oracle. Po aq mjete figurojnë dhe gjendje në të dy mjediset në magazinën doganore me nr identifikimi C10. Pra kontrolli fizik rezultoi në rregull me gjendjen kontabël të automjeteve.”

Gjithashtu është konstatuar se ende nuk është hartuar raporti përfundimtar i kontrollit mbi operatorin.

Lidhur me zbatimin e afateve procedurale që rregullojnë procedurën e kontrollit aposterior përcaktuar në Urdhrin nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, situata paraqitet si në tabelën më poshtë.

Pasqyra 53: Zbatimi afateve procedurale për dosjet e përzgjedhura

Subjekti	Program kontrolli (1)	PV paraprak (2)	(3)= (2)- (1) 30ditë	Raport Përfundimtar (4)	(5)= (4)-(1) 60ditë	Vendimi (6)	(7)= (6)-(4) 60ditë
E.D	17.02.2022	04.04.2022	45	13.05.2022	85	08.07.2022 08.07.2022	56 56
M	22.09.2022	-	-	02.11.2022	41	-	-
R	03.10.2022	-	-	01.11.2022	29	-	-
M	07.10.2022	-	-	10.11.2022	36	-	-
D	11.10.2022	-	-	01.11.2022	21	-	-
A	24.10.2022	08.11.2022	15 ditë	16.12.2022	53 ditë	27.12.2022 16.01.2022 28.02.2023	11 32 75
A	23.11.2022	23.01.2023	61	08.03.2023	105	02.05.2023 02.05.2023	55 55
P	23.11.2022	-	-	-	-	-	-

Burimi: Dosjet e kontrollit aposterior, përpunuar KLSH.

Sikurse evidentohet edhe në tabelën e afateve për dosjet e përzgjedhura nga auditimi është konstatuar se ka tejkalim të afateve ligjore në zbatimin e procedurave të kontrollit aposterior që variojnë deri në 45 ditë.

Mbi Planin Operacional datë 25.07.2022 – 16.09.2022

Grupi i auditimit ka kërkuar dhe i është vendosur në dispozicion plani operacional nr.13790 datë 25.07.2022 “Për kontrollin e prodhimit, mbajtjes dhe tregtimit të produkteve alkolike të akcizës”, në të cilin përcaktohet koha e zhvillimit të operacionit, drejtimet (operatorët S, B.T, T, B, A sha), grupet që do të angazhohen në turn, mënyra e organizimit të operacionit dhe raportimi veprimtarisë. Konkretisht pika VI, e planit operacional përcakton se “Në përfundim të kontrolleve

(çdo 15 ditë) nga përgjegjësit e grupeve do të hartohet një informacion i detajuar për mbarëvajtjen dhe dinamikën e kontrolleve të kryera, drejtuar Zv.DP dhe për dijeni DP.” Grupi i auditimit ka kërkuar korrespondencën sipër cituar dhe i është vendosur në dispozicion shkresa nr.13790/6 datë 28.09.2022 me lëndë “Informacion mbi planin operacional” nga DKAA drejtuar DP për të gjithë periudhën 53 ditore, me regjistrat e kontrollit në operatorët e cituar bashkëngjitur. Sa më sipër mungon dhe nuk është vendosur në dispozicion informacioni i detajuar mbi mbarëvajtjen dhe dinamikën e kontrolleve të kryera nga përgjegjësit e grupeve në përfundim të kontrolleve. Nga informacioni përmbledhës me shkelje ka rezultuar vetëm operatori “B”, sasi tepër prej 1512 kanace format 0.5 Ltr birrë e konvertuar në 756 litra.

Nga auditimi i praktikës së procedurës në librat e protokoll-arkivës u konstatua se në datë 27.07.2022 është hartuar shkresa nr.13790/2 nga drejtori DKAP z.J.Ç , për dijeni të DP me lëndë “Anulim i program kontrolleve pra subjekteve P, AL, G SHPK dhe Th.E, të miratuar me programet respektive nr.13596 datë 21.07.2022, nr.13595 datë 21.07.2022, nr.13705 datë 24.07.2022 dhe nr.13668/1 datë 25.07.2022, për arsye të angazhimit të specialistëve në planin operacional në ditët e përcaktuara të kontrollit.

Sa më sipër është konstatuar se kjo vendimmarrje nuk është kryer në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 6.4.1.ç “Miratimi i Programit të Kontrollit”.

Janë vendosur në dispozicion bashkëngjitur observacionit relacionet shpjegues me indikatorë risku për përzgjedhje edhe të dy subjekteve “P” dhe “AL” si dhe për dy operatorët “G” SHPK dhe Th.E në shkresën nr.13668 datë 22.07.2022 drejtuar DP ‘Relacion mbi kërkesën për kontroll pranë ambienteve të operatorëve’ sqarohet se ‘për hartimin e program kontrolleve janë përdorur të dhënat e gjeneruara nga databazë e sistemit Oracle Discovery dhe Asycuda Word, ku nga krahasimi i të dhënave lidhur me DSHA tip 4 ‘hedhje për konsum’ për periudhën janar-qershor 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, rezulton se operatorët kanë rënie të sasive të hedhura në konsum, rrjedhimisht rënie të të ardhurave’.

Nga auditimi i evidencave me kontrollet e ushtruara të vëna në dispozicion është konstatuar se në muajt shtator dhe nëntor janë rihapur programet e kontrollit për subjektet e mësipërme.

1. Titulli i Gjetjes: Nga auditimi është konstatuar se mungon një analizë risku në nivel drejtorie apo sektori vjetore apo 6 mujore për përcaktimin e operatorëve me risk dhe përzgjedhjen e tyre për kontroll bazuar në vlerësimin e riskut sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021.

Situata:

Grupi i auditimit ka kërkuar informacion dhe evidencat përkatëse mbi kontrollet e zhvilluara gjatë vitit DKAP nga secili sektor dhe analizën e riskut mbi të cilën është realizuar përzgjedhja e subjekteve për kontroll në secilin sektor, nga të cilat janë vendosur në dispozicion vetëm evidencat për subjektet e kontrolluara. Nga auditimi është konstatuar se mungon një analizë risku në nivel drejtorie apo sektori vjetore apo 6 mujore për përcaktimin e operatorëve me risk dhe përzgjedhjen e tyre për kontroll bazuar në vlerësimin e riskut sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.02 date 28.01.2021, pika 6.3 “Ne përfundim të analizës së riskut, specialistet e sektorit se bashku me përgjegjësin e sektorit, identifikojnë operatorët me risk të lartë dhe i adresojnë tek eprorët direkt (Drejtor Drejtorie/Shef departamenti) dhe mbas shqyrtimit prej tyre përcaktohen operatorët mbi të cilët do të kryhen kontrolle aposterior dhe /apo të akcizës”.

Kriteri:

Impakti:

Shkaku:

Rëndësia

Rekomandimi:

2. Titulli i Gjetjes:

Situata:

Kriteri:

I vetmi dokument i evidentuar lidhur me këtë procedurë është relacioni me propozimin për kontroll për DP, që gjendet në një pjesë të dosjeve dhe që bëhet para hartimit të programit të kontrollit.

Udhëzimi nr.02 date 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 6.3.

Risk se operatorët e kontrolluar të mos jenë ata me risk më të lartë.

Mungon një analizë risku periodike mbi përzgjedhjen e operatorëve për kontroll dhe mos dokumentim i gjurmës së auditimit.

E mesme

DKAP të marrë masa për realizimin dhe dokumentimin e analizës së riskut sipas sektorëve për operatorët ekonomik në nivel vjetor dhe 6 mujor, evidentimin e operatorëve me risk në akte administrative, propozimin dhe miratimin e operatorëve të përzgjedhur; si dhe të marrë masa për rregullimin e afateve procedurale të kontrollit sipas fazave në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”.

Nga auditimi është konstatuar se në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, nuk rregullohen afatet procedurale të kontrollit për 4 sektorët e DKAP, duke rezultuar në kontrole që janë zgjatur deri në 511 ditë pa arsye të evidentuara.

Nga auditimi evidencave të kontroleve dhe dosjeve specifike është konstatuar se afati i kontroleve të realizuara nga drejtoria ka variuar në një afat kohor nga 7 ditë deri në 511 ditë, evidentuar në tabelën më poshtë sipas sektorëve.

Sektori	OE kontroll	Kohëzgjatja e procedurës nga programi në raport (ditë)
Produkte Cigareve dhe Pijeve Alkolike	93	19 - 511
Produkte Energjetike	23	7 - 109
Produkte të tjera	71	8 - 178
Pajisjet, Matësit dhe Linjat Teknologjike	49	16 - 170

Burimi: Drejtoria e Kontroleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit

Sektori më problematik sa i takon afatit të kontrollit rezulton të jetë ai i cigareve dhe pijeve alkolike me një maksimum ditësh prej 511 ditë.

Nga auditimi është konstatuar se mungon një rregullim i afateve procedurale për këto procedura kontrolli në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, çka dëshmon për një sistem kontrolli të pa ngritur ende, jo në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 9 ‘Përgjegjshmëria manaxheriale e nëpunësit autorizues’, pika 4 ‘Nëpunësit autorizues të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a. Propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi’.

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 9.

Impakti:	Procedura kontrolli të tej zgjatura në afat pa arsye të evidentuara.
Shkaku:	Mos rregullim i afateve procedurale.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	DPD të marrë masa për rregullimin e afateve procedurale të kontrollit sipas fazave në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”.
3. Titulli i gjetjes:	Nga auditimi është konstatuar se strukturat përkatëse në DKAP në përfundim të veprimeve përgatitore nuk kanë hapur dosje kontrolli për çdo operator sikurse përcakton Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021, në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet.
Situata:	Nga auditimi është konstatuar se strukturat përkatëse në DKAP në përfundim të veprimeve përgatitore nuk kanë hapur dosje kontrolli për çdo operator sikurse përcakton Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 6.4.2. Në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”, pika 8.4 ‘Administrimi i dokumentacionit’.
Kriteri:	Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim edhe me përcaktimet e ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 për ‘Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’, neni 4, pika 8 “Gjurma e auditimit” <i>përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve</i> ” dhe neni 16 ‘Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit’, pika 2 dhe 3 “2.Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3.Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.” Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, neni 9;
Impakti:	Mungon gjurma e auditimit.
Shkaku:	Mos zbatim i procedurave mbi dokumentimin.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	DKAP sipas strukturës të marrë masa për hapjen e dosjes së kontrollit me nisjen e kontrollit, përfshirjen e dokumenteve të shqyrtuara dhe mbi të cilin mbështetet kontrolli dhe rezultatet e tij, mbajtjen e proces verbaleve të kontrollit fizik dhe të kundërvajtjeve administrative në përputhje me përcaktimet ligjore, inventarizimin dhe arkivimin e saj në përputhje me

përcaktimet ligjore. DP të marrë masa në adresimin e përgjegjësiave për parregullsitë e evidentuara.

4. Titulli i Gjetjes:

Nga auditimi i dosjeve të kontrollit të DKAP është konstatuar se në proces verbalet e kontrollit fizik nuk janë mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbale tepricat e konstatuara në inventarizim, si dhe nuk i janë bashkëlidhur procesverbaleve deklaratat përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore, si dhe procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative janë pa datë verifikimi.

Nga auditimi i dosjeve të kontrollit të DKAP është konstatuar se në proces verbalet e kontrollit fizik për operatorët e përzgjedhur “K”, “V”, “N.P”, “M.d”, “A.M”, “J sha” nuk janë mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr.612 datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbale tepricat e konstatuara në inventarizim, si dhe nuk i janë bashkëlidhur procesverbaleve deklaratat përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c.

VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68 ‘Procedura e inventarizimit’ pika 4 përcakton se ‘4. Autoritetet doganore, kur fillojnë procesin e inventarizimit, verifikojnë të dhënat e gjeneruara nga sistemi informatik doganor me regjistrat e inventarizimit, të mbajtur nga depozituesi i miratuar dhe me stokun real’ dhe neni 69 ‘Tepricat dhe mangësitë në inventarizim’, pika c dhe ç përcaktohet se ‘c) Në këto raste, autoriteti doganor duhet të kërkojë shkaqet e tepricës. Kjo tepri shënohet në procesverbalin e inventarizimit dhe mund të shërbejë për klasifikimin e një shkeljeje. ç) Në fund të inventarizimit, për tepricat kryhet regjistrimi në rubrikën ‘Hyrje të kontabilitetit të stokut’, me përshkrimin ‘Tepriçë e evidentuar nga kontrolli’, si dhe shënohen ekstremitetet e procesverbalit të përcaktuar në shkronjën “c”, të kësaj pike. Të gjitha këto veprime duhen kryer përpara kryerjes së veprimeve të tjera hyrëse.’

Situata:

Gjithashtu është konstatuar se procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative në të gjithë dosjet e kontrollit të përzgjedhura për testim janë pa datë verifikimi në kundërshtim me nenin 98 ‘Forma e procesverbalit’ ku përcaktohet se “1. Procesverbali duhet të përmbajë: a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja.

Neni 97 ‘Verifikimi’ përcakton gjithashtu në pikën 4 se “4. Në rast se konstatimi i shkeljes, sipas këtij ligji, bëhet a posteriori nga strukturat doganore kompetente ose nga struktura të tjera hierarkike doganore apo të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi, kopja e procesverbalit të nënshkruar nga punonjësit doganorë apo përfaqësuesit e strukturave kontrolluese, që ushtruan verifikimin dhe kontrollin, i njoftohet shkelësit nga autoriteti doganor kompetent brenda 5 ditëve kalendarike. Në procesverbal përcaktohet edhe e drejta e shkelësit për të paraqitur pretendimet e tij me shkrim, brenda 10 ditëve kalendarike, pranë autoriteteve doganore kompetente.”

Udhëzimi nr.05 datë 31.03.2016 “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës”, në shënimet shpjeguese për

aneksin 1, e detajon sipas kutive specifike plotësimin e procesverbalit të kundërvajtjes administrative.

Ligji nr.61/2012 datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 90 pika 4, neni 98,pika 1a dhe neni 97;

Kriteri: VKM nr.612 datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”, i ndryshuar, neni 68, pika 4 dhe neni 69, pika1 c dhe ç, pika 2c;
Udhëzimi nr.05 datë 31.03.2016 “Mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës”, në shënimet shpjeguese për aneksin 1.

Impakti: Parregullsi në procedurat e kontrollit dhe risk i shtuar.

Shkaku: Mos zbatim i procedurës ligjore për mbajtjen e proces verbaleve fizike dhe të verifikimit të shkeljeve administrative.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Specialistët e DKAP të marrin masa në vijimësi për mbajtjen e proces verbaleve të kontrollit fizik dhe të kundërvajtjeve administrative në përputhje me përcaktimet ligjore me qëllim vlerësimin e saktë në kohë dhe koherent të veprimtarisë së operatorëve ekonomik si dhe DPD të marrë masa për mos zbatimin e procedurave të evidentuara.

5. Titulli i Gjetjes: Nga auditimi është konstatuar se në kontrollin e ushtruar në operatorin “N.P” në aspektin tatimor nuk është analizuar procesi prodhimit sipas kartës teknologjike, si dhe nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare pas rivlerësimit doganor të konkluduar me detyrime shtesë akcize në vlerën 2,652,000 lekë, sepse me detyrimet shtesë të akcizës do të duhej të ishte kryer rillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme duke rezultuar në detyrime shtesë për TVSH-në vlerën 530,400 lekë dhe gjobë për 100% të vlerë, pra në total 1,060,800 lekë.

Në zbatim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018, është zhvilluar kontrolli pranë subjektit “N.P ” sipas Program Kontrollit nr.10431/1 datë 14.06.2021 me grup të përbashkët kontrolli.

Situata: Në dosjen e kontrollit mungonte raporti i ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore me verifikimin e veprimtarisë ekonomike dhe deklarimeve të periudhës së kontrollit kërkuar nga DPD me shkresën nr.9926 datë 20.05.2022, në bazë të të cilit është mbajtur dhe procesverbali i kundërvajtjes administrative nr.0029569. Ky raport është ri kërkuar nga DPD me shkresën nr.8823 datë 25.05.2023 pranë DRT, ka ardhur në DPD datë 26.06.2023 me shkresën nr.10617 dhe i është vendosur në dispozicion grupit të auditimit në datë 30.06.2023.

Nga auditimi i përmbajtjes së tij është konstatuar se nuk është analizuar procesi prodhimit sipas kartës teknologjike.

Gjithashtu për sa trajtuar më sipër nga auditimi i raportit të kontrollit kanë rezultuar nga rivlerësimi doganor detyrime shtesë akcize në vlerën 2,652,000 lekë, por nga ana e inspektorit tatimor z.F. P nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare, sepse me detyrimet shtesë të akcizës do të duhej të ishte kryer rillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme duke rezultuar në detyrime shtesë për TVSH, konkretisht si në vijim.

Emërtimi	Vlera e tatueshme
VI Tatueshme' (Rivlerësim Akciza)	2,652,000
Detyrime shtesë TVSH (20%)	530,400
Gjobë (100%)	530,400
Totali	1,060,800

Neni 5 i Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikon se: a) “Administratë tatimore” përfshin Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, drejtoritë rajonale të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel kombëtar dhe njësitë tatimore të qeverisjes vendore, të ngarkuara për administrimin e tatimeve, taksave dhe kontributeve në nivel vendor; me përjashtim të akcizës. Nga data 1 tetor 2012 taksa e akcizës administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe neni 70 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”: 1. Drejtoria rajonale tatimore nxjerr njoftimin e vlerësimit tatimor për tatimpaguesit e regjistruar në administratën tatimore qendrore.

Gjithashtu neni 39 Vlera e tatueshme të Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” përcakton se “1. Në vlerën e tatueshme përfshihen elementet e mëposhtme: a) tatimet, taksat, detyrimet, tarifrat dhe pagesa të ngjashme, me përjashtim të TVSH-së.”

Gjithashtu do të duhej të ishte kryer penalizmi i subjektit për vlerën e TVSH-së sipas përcaktimeve të nenit 116 “Evazion tatimor”, të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mos deklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara apo deklaratave ose informacioneve të rreme, që çojnë në përlllogaritjen e pasaktë të shumës së tatimit, taksës apo kontributit, përbën evazion tatimor dhe dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të diferencës së shumës së përlllogaritur nga ajo që duhet të ishte në fakt.”

Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 5, neni 70, neni 116.

Kriteri:

Ligji nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 39, pika 1a;

“Marrëveshje e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT” nr.14355 datë 19.06.2018.

Impakti:

Detyrim i munguar dhe mos zbatim i detyrave funksionale.

Shkaku:

Mos vlerësim i saktë i situatës së operatorit ekonomik.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

DPD të përcjellë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë problematikën e mësipërme, për të cilën të merren masat për të kaluar në ri kontroll veprimtarinë e operatorit “N.P” për aspektin tatimor të kontrollit, me qëllim realizimin e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e detyrimeve dhe penalteteve administrative.

6. Titulli i Gjetjes:

Nga auditimi u konstatua se subjekti H.D.A ka kryer shkelje administrative doganore në fushën e akcizës dhe kontrolli i realizuar nga DKAP nuk ka evidentuar saktë inventarin fizik dhe dokumentar të operatorit.

Nga auditimi i dosjes së kontrollit të operatorit “H” është konstatuar se në dosje nuk është argumentuar në mënyrë të detajuar procedura kontrolluese për operatorin dhe konkluzionet e nxjerra dhe nga kontrolli në sistem i hyrje daljeve të mallit me DSHA rezulton se operatori ka paguar 5,603,038 lekë ditën e fundit të programit të kontrollit apo një ditë pas mbajtjes së proces verbalit të verifikimit fizik dhe në vijim gjatë muajit tetor në total vlerën 30,098,907 lekë me frekuencë të shpeshtë krahasuar me gjithë lëvizjet e vitit dhe që në total përbën rreth 60% të akcizës vjetore të paguar në DSHA nga operatori, si në tabelën më poshtë.

Bazuar në sa më sipër, nga ana e grupit të kontrollit të specialistëve të Drejtorisë së Kontroleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriorit) zj.M.J dhe zj.A.ZH nuk është kryer siç duhet kontrolli fizik i stokut në magazinë, duke i krijuar kështu subjektit mundësinë për shmangien e pagesës së detyrimeve për penalitet për sasi të produkteve të munguara, si dhe të detyrimeve për pullat e munguara. Gjithashtu, dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontroleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit (Aposteriorit) z. J.Ç nuk ka shqyrtuar, analizuar dhe monitoruar në kohë rezultatet e këtij kontrolli, për të siguruar zbatimin rigoroz të legjislacionit doganor, megjithëse ka pasur në dispozicion gjithë kohën dhe dokumentacionin e nevojshëm, nga data 13.10.2022 i mbajtjes së Procesverbalit të inventarizimit fizik nga grupi i kontrollit, deri më datë 01.11.2022 i përgatitjes së informacionit përkatës për Drejtorin e Përgjithshëm.

Situata:

Nga auditimi u konstatua se subjekti H.D.A ka kryer shkelje administrative doganore në fushën e akcizës pasi nga rillogaritjet e kryera nga grupi auditues për të dhëna të marra nga sistemi Asicyda Word pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në lidhje aktivitetin e kryer për periudhën 12.08.2020 deri më datën e përfundimit të kontrollit nga strukturat e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior për procedura importi për mallrat të hyra sipas procedurës doganore 4700 (*hyrje në magazinë fiskale*) dhe procedura doganore dalje nga magazina fiskale sipas tipit DSHA 4 dhe DSHA 6 ku rezultoi se subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta ligjore për sasinë prej 2,617 litra me vlerë malli në shumën 101,893 Euro të llojit pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me gradë alkolike nga 37.5% deri 40% të rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën prej 909,372 lekë dhe 200,000 lekë gjobë, të cilat rezultojnë të shmangura dhe të papaguara. Nga auditimi i dosjes së kontrollit të operatorit “H” është konstatuar se në dosje nuk është argumentuar në mënyrë të detajuar procedura kontrolluese për operatorin dhe konkluzionet e nxjerra. Gjithashtu nga kontrolli në sistem i hyrje daljeve të mallit me DSHA rezulton se operatori ka paguar 5,603,038 lekë ditën e fundit të programit të kontrollit apo një ditë pas mbajtjes së proces verbalit të verifikimit fizik dhe në vijim gjatë muajit tetor në total vlerën 30,098,907 lekë me frekuencë të shpeshtë krahasuar me gjithë lëvizjet e vitit dhe që në total përbën rreth 60% të akcizës vjetore të paguar në DSHA nga operatori.

Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk është kryer raportim shkresor bazuar në “*Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT*” nr.14355 datë

19.06.2018 në lidhje me sasinë e mallit të gjetur në mungesë me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve me detyrime tatimore në shumën 8,839,140 leke për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Kriteri:	<p><i>Udhëzimi nr.2 datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”.</i></p> <p><i>Ligjit nr 61 “Per Akcizat në RSH”Neni 85 dhe 87 i Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT nr.14355 datë 19.06.2018</i></p> <p><i>Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Neni 5 i Ligjit Nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”Neni 39.</i></p>
Impakti:	Risk i lartë evident për kontroll jo të plotë.
Shkaku:	Mos pasqyrim i detajuar i kontrollit të realizuar.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të të marrë masa për të kaluar në procedurë ri kontrolli veprimtarinë e operatorit “H”, me qëllim realizimin e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e situatës për periudhën e kontrolluar sipas Program Kontrollit nr.17747 datë 07.10.2022 sipas gjetjeve dhe konstatimeve të rrillogaritura për sasinë prej 2,617 litra me vlere malli në shumën 101,893 euro të llojit pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me grade alkolike nga 37.5% deri 40% të rezultuar me detyrime akcize në shumën <i>prej 1,109,372 lekë</i> te cilat rezultojnë të shmangura dhe të papaguara.</p> <p>Drejtoria e Pergjithshme te Doganave të kryejë raportim shkresor bazuar në “<i>Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT</i>” nr.14355 datë 19.06.2018 në lidhje me sasinë e mallit të gjetur në mungesë me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve me detyrime tatimore në shumën <u>8,839,140 leke</u> për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në total detyrime në vlerën 9,948,512 lekë.</p>
7.Titulli i Gjetjes:	<p>Nga auditimi i 8 dosjeve të kontrollit të Sektorit Aposterior janë konstatuar parregullsi të ndryshme procedurale si tejkalim i afateve procedurale, mos evidentim i relacioneve të riskut dhe mos inventarizim dhe arshivim i dosjeve të kontrollit, mos protokollim i proces verbaleve dhe të tjera në kundërshtim me legjislacionin.</p>
Situata:	<p>Nga auditimi i 8 dosjeve të kontrollit të Sektorit Aposterior janë konstatuar parregullsi të ndryshme procedurale si tejkalim i afateve procedurale, mos evidentim i relacioneve të riskut dhe mos inventarizim dhe arshivim i dosjeve të kontrollin në kundërshtim me Urdhrin nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”, si dhe proces verbalet e kontrolleve fizike nuk protokollohen dhe i bashkëngjiten si dokumente shoqërues informacionit për DP.</p>

Subjekti	Program kontrolli (1)	PV paraprak (2)	(3)= (2)-(1) 30ditë	Raport Përfundimtar (4)	(5)= (4)-(1) 60ditë	(6)= (vendim)-(4) 60ditë
E.D	17.02.2022	04.04.2022	45	13.05.2022	85	56 56
M	22.09.2022	-	-	02.11.2022	41	-
R	03.10.2022	-	-	01.11.2022	29	-
M	07.10.2022	-	-	10.11.2022	36	-
D	11.10.2022	-	-	01.11.2022	21	-
A	24.10.2022	08.11.2022	15 ditë	16.12.2022	53 ditë	11 32 75
A	23.11.2022	23.01.2023	61	08.03.2023	105	55 55
P	23.11.2022	-	-	-	-	-

Për operatorin "A" SHPK nuk është argumentuar masa e penaltetit vendosur në secilin PV për kundërvajtjet e konstatuara si dhe as DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penaltetin e vendosur më të vogël në vlerë se ai i caktuar në PV. Në PV 1, 2 dhe 3 nuk është argumentuar nga grupi i kontrollit masa e caktuar e penaltetit për secilin proces verbal dhe grupi i kontrollit nuk ka argumentuar se si e ka zbatuar nenin 260, që citon dhe vet ne raport mbi "kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë" në të cilin përcaktohet se "*Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas*". Pra në sa trajtuar më sipër është konstatuar e njëjta kundërvajtje në të 3 PV ku në të parin është caktuar penalteti minimum 50,000 lekë, në PV e dytë është caktuar përsëri penalteti 50,000 lekë minimum për një detyrim të munguar 8 herë më të madh se i pari dhe në PV e tretë është caktuar penalteti 100,000 lekë për një detyrim 17 herë më të madh se detyrimi PV1 dhe 2 herë më të madh se detyrimi PV2.

Për operatorin P. A. kontrolli është mbyllur pa raport përfundimtar. Ligji nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 "Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore". Të ardhura të munguara dhe risk i shtuar në procedurat administrative. Mos zbatim i procedurave dhe mos nxjerrja akteve administrative. E mesme

Kriteri:

Impakti:

Shkaku:

Rëndësia

Rekomandimi

Sektori i Kontrollit Aposterior të marrë masa sipas strukturës për dokumentimin e gjurmëve të auditimit, zbatimin e afateve procedurale dhe argumentimin e masës së penaltiteve të vendosura sipas rastit.

Për detyrimin e nxjerrë nga kontrolli i operatorit E.D për agjentin doganor "L" nuk është nxjerrë nga Dega Doganore Tiranë mbi penaltetin e vendosur në vlerën 380,000 lekë për përpilimin e 19 DAV jo të sakta.

8.Titulli i Gjetjes:

DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penaltetin e vendosur në vlerën 50,000 lekë më të vogël se ai i caktuar në proces verbalin e kontrollit aposterior, duke rezultuar në një vlerë të ardhurash të munguara prej 430,000 lekësh, si pasojë e mos vendimmarrjes së Degëve Doganore.

Situata:

Nga auditimi i 8 dosjeve të kontrollit të Sektorit Aposterior janë konstatuar parregullsi të ndryshme procedurale. Për detyrimin e nxjerrë nga kontrolli i operatorit E.D për agjentin doganor "L" nuk është nxjerrë nga Dega

Doganore Tiranë mbi penalitetin e vendosur në vlerën 380,000 lekë për përpilimin e 19 DAV jo të sakta.

Për operatorin “A” SHPK nuk është argumentuar masa e penalitetit vendosur në secilin PV për kundërvajtjet e konstatuara si dhe as DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penalitetin e vendosur më të vogël në vlerë se ai i caktuar në PV. Në PV 1, 2 dhe 3 nuk është argumentuar nga grupi i kontrollit masa e caktuar e penalitetit për secilin proces verbal dhe grupi i kontrollit nuk ka argumentuar se si e ka zbatuar nenin 260, që citon dhe vet ne raport mbi “kundërvajtjet e kryera në të njëjtën kohë” në të cilin përcaktohet se “*Kur i njëjti person ka kryer disa kundërvajtje në të njëjtën kohë, çdo kundërvajtje sanksionohet veçmas*”. Pra në sa trajtuar më sipër është konstatuar e njëjta kundërvajtje në të 3 PV ku në të parin është caktuar penaliteti minimum 50,000 lekë, në PV e dytë është caktuar përsëri penaliteti 50,000 lekë minimum për një detyrim të munguar 8 herë më të madh se i pari dhe në PV e tretë është caktuar penaliteti 100,000 lekë për një detyrim 17 herë më të madh se detyrimi PV1 dhe 2 herë më të madh se detyrimi PV2.

Lidhur me detyrimin dhe penalitetin e përcaktuar në Proces Verbalin nr.3 është marrë nga Dega Doganore Rinas vendimi nr.10 datë 28.02.2023 për vlerën 1,034,505 lekë të detyrimit përcaktuar në PV dhe për vlerën 50,000 lekë për penalitetin, pra ndryshe nga sa është caktuar në PV penaliteti prej 100,000 lekë duke mos argumentuar këtë vendimmarrje. DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penalitetin e vendosur në vlerën 50,000 lekë më të vogël se ai i caktuar në proces verbalin e kontrollit aposterior, duke rezultuar në një vlerë të ardhurash të munguara prej 430,000 lekësh, si pasojë e mos vendimmarrjes së Degëve Doganore.

Ligji nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Urdhrit nr.7 datë 28.01.2021 “Manual mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore”.

Të ardhura të munguara dhe risk i shtuar në procedurat administrative.

Mos zbatim i procedurave dhe mos nxjerrja akteve administrative.

E mesme

Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Degët Doganore Tiranë dhe Rinas në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën 430,000 lekë.

Kriteri:

Impakti:

Shkaku:

Rëndësia:

Rekomandimi:

2.7. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit vjetor

Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave është:

- *Mbrojtja e interesave financiare dhe ekonomike të Shqipërisë;*
- *Kontributi për sigurinë dhe mbrojtjen e shoqërisë;*
- *Lehtësimi i tregtisë, bashkëpunimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me të gjithë aktorët përkatës.*

Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare në RSH, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare që ndikojnë në tregtinë dhe sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar.

Qëllimi i Politikës së Programit të Buxhetit të DPD është : “Menaxhimi efektiv, efikas, i drejtë dhe transparent i të ardhurave doganore”.

Plani i PBA-së

Në kuadër të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2028 “Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe udhëzimit nr. 8, datë 26.02.2021 të MFE “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”, me shkresën nr. 5403/1, prot datë 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është përcjellë pranë MFE dokumenti i PBA-së së fazës së parë, së bashku me relacionin shoqërues. Me shkresën nr. 15238/1, prot datë 26.08.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është përcjellë pranë MFE dokumenti i PBA-së së fazës së dytë së bashku me relacionin shoqërues dhe pasqyrat përkatëse, në zbatim të udhëzimit plotësues 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”. Në vijim të shkresës nr. 15953, prot datë 21.09.2021 “Mbi rishikimin e prioriteteve buxhetore në përputhje me programin e qeverisë 2021-2023”, është ri dërguar dokumenti i kërkesave buxhetore 2022-2024. Nga ndryshimi i prioriteteve janë rishikuar kërkesat si më poshtë, ku janë reduktuar fondet në total me vlerën 43,969,000 lekë, nga limitet e planifikuara në fazën e dytë të PBA-së:

Pasqyra 54: Rishikimi i prioriteteve

Projekti	PBA faza II	Rishikimi i prioriteteve
91005AA	1,921,775,242	1,917,806,242
91005AC	155,875,200	115,875,200
Total shpenzime 2022	4,594,187,000	4,550,218,000

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPD

Me ligjin nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i është miratuar buxheti fillestar për vitin 2022 prej 3,806,010 mijë lekë, nga të cilat 3,532,100 mijë lekë për shpenzime korrente dhe 273,910 mijë lekë për shpenzime kapitale. Buxheti i miratuar është rishikuar me anë të Aktit Normativ nr 3 datë 12.03.2022. Buxheti përfundimtar për vitin 2022 është 3,876,510, mijë lekë, nga të cilat 3,602,600 mijë lekë shpenzime korrente dhe 273,910 shpenzime kapitale. Realizimi sipas artikujve buxhetorë për periudhën Janar-Dhjetor 2022, paraqitet si më poshtë:

Pasqyra 55: Realizimi sipas artikujve buxhetorë për periudhën Janar-Dhjetor 2022

Në mijë lekë

Art.	Emërtimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6) -(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Difere nca
		i vitit paraar dhës Viti 2021	Plan Viti 2022	Plan Fillestar Viti 2022	Plan i Rishikuar Viti 2022	Plani i Periudhës/pr ogresiv	Periudhës/pr ogresiv	
600	Paga	1,025,832.0	1,101,900.0	1,101,900.0	1,034,345.0	1,034,345.0	1,032,255.0	-2,090.0
601	Sigurime Shoqërore	172,271.0	182,100.0	182,100.0	172,413.0	172,412.0	172,292.0	-120.0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,202,150.0	2,038,883.0	2,238,983.0	2,534,517.0	2,534,517.0	2,520,741.0	13,776.0
603	Subvencione	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
604	Transferta Korente të Brendshme	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
605	Transferta Korente të Huaja	6,393.0	9,117	9,117.0	6,417.0	6,417.0	6,325.0	-92.0
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	2,639.0	0	0.0	17,599.0	17,599	17,525	-74.0

<i>Nen-Totali</i>	<i>Shpenzime Korrente</i>	<i>3,409,285.0</i>	<i>3,332,000.0</i>	<i>3,532,100.0</i>	<i>3,765,291.0</i>	<i>3,765,290.0</i>	<i>3,749,138.0</i>	<i>-16,152.0</i>
230	Kapitale të Patrupëzuara	601.0		2,314				0.0
231	Kapitale të Trupëzuara	102,833.0	153,220.0	150,906	52,574.0	52,574.0	50,271.0	-2,303.0
232	Transferta Kapitale			0.0	0.0	0.0		0.0
<i>Nen - Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale me financim te brendshëm</i>	<i>103,434.0</i>	<i>153,220.0</i>	<i>153,220.0</i>	<i>52,574.0</i>	<i>52,574.0</i>	<i>50,271.0</i>	<i>-2,303.0</i>
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.0	120,690.0	120,690.0	80,994.0	80,994.0	20,088.0	-60,906.0
231	Kapitale të Trupëzuara	62,054.0			39,696.0	39,696.0	0.0	-39,696.0
232	Transferta Kapitale	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
<i>Nen - Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</i>	<i>62,054.0</i>	<i>120,690.0</i>	<i>120,690.0</i>	<i>120,690.0</i>	<i>120,690.0</i>	<i>20,088.0</i>	<i>-100,602.0</i>
<i>Totali</i>	<i>Shpenzime Kapitale</i>	<i>165,488.0</i>	<i>273,910.0</i>	<i>273,910.0</i>	<i>173,264.0</i>	<i>173,264.0</i>	<i>70,359.0</i>	<i>-102,905.0</i>
	<i>Shpenzime nga të ardhurat jashtë limiti</i>	167,480				268,353	223,999	-44,354.0
	Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)	3,742,253.0	3,605,910.0	3,806,010.0	3,938,555.0	4,206,907.0	4,043,496.0	-163,411.0

Burimi: DPD

Pasqyra 56: Realizimi nga të ardhurat jashtë limitit:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Realizimi	% realizimit
1	Shpenzime personeli (600+601)	36,429	34,906	96
2	Shpenzime të tjera korente (602)	15,935	14,798	93
3	Shpenzime kapitale (230+231)	208,036	167,283	80
4	Transferta korrente të brendshme (art 604)	7,953	7,011	88
	TOTALI	268,353	223,999	83

Burimi: DPD

Referuar buxhetit të aparatit të DPD, krahasimisht me buxhetin e degëve doganore, situata paraqitet sipas aneksit më poshtë.

Pasqyra 57: Referuar buxhetit të aparatit të DPD, krahasimisht me buxhetin e degëve doganore

	Plan	Fakt
Shpenzime nga te ardhurat jashtë limitit		
600	34,602	33,317
Shpërblime nga te ardhurat jashtë limitit	23,956	23,714
Paga për punonjësit qe punojnë pranë operatoreve ekonomik Operator ekonomik	10,646	9,603
601	1,827	1,590
602	15,935	14,798
Fond I krijuar nga sanksionet doganore	15,216	14,131
Për analiza Laboratorike	719	667
231	7,953	7,011
604 (transferte për rentën minerare)	208,036	167,283
Totali	268,353	223,999

Burimi: DPD

Në shpenzimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga të ardhurat jashtë limitit përfshihen:
 -Fondet e krijuara nga vendosja e sanksioneve doganore në zbatim të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.919, datë 29.12.2014 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 285.

- Të ardhurat nga pagesat e kryera nga deklaruesit për shërbimin e kryerjes së analizave

laboratorike për verifikime doganore, në zbatim të marrëveshjes së asistencës ndërmjet Agjencisë së Doganave Italiane, dhe Strukturës Përgjegjëse për Doganat Shqiptare në fushën e laboratorëve kimikë doganorë si dhe nga operatorët ekonomikë në ambientet e të cilëve ka prezencë të personelit doganor.

-Gjithashtu gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 është kryer transfera prej 223,999 mijë lekë njësi vendore për rentën minerare të shfrytëzuar në territorin e tyre (art 604) në bazë të autorizimeve të lëshuara nga Ministria e Financave në zbatim të: Ligjit nr.157/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare, të ndryshuar”, në zbatim të Udhëzimit nr.12 datë 04.04.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.26, datë 04.09.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Shpenzimet kapitale të realizuara përgjatë vitit 2022, të ndara sipas projekteve paraqiten më hollësisht sipas aneksit më poshtë. Gjithashtu, rezultuan projekte të përfshira në PBA-në e fazës së Dytë po të pa realizuara:

Pasqyra 58: projekte të përfshira në PBA-në e fazës së dytë po të pa realizuara

Kodi i projektit	Projekti	Vlera e projektit sipas PBA-së
M100479	Sistem monitorimi	29,000,000
18AË302	Dixhitalizimi shërbimeve doganore	9,450,000

Burimi: DPD

Realizimi i buxhetit:

Në zbatim të udhëzimit nr. 22, date 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” dhe udhëzimit plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të viti 2023” nga ana e DPD janë përcjellë pranë MFE raportet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, konkretisht:

- Raporti me shkresën nr. 9865, prot datë 18.05.2022;
- Raporti me shkresën nr. 16949, prot datë 23.06.2022;
- Raporti me shkresën nr. 2404, prot datë 13.02.2023.

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me ecurinë e disa prej kontratave të investimeve sipas projekteve, krahasimisht me planifikimin e tyre dhe fondet disponibël përgjatë vitit 2022, trajtuar rast pas rasti si më poshtë:

Për shpenzimet kapitale

1. Për projektin me kod 18CC80 "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë", fillimisht fondet rezultojnë të jene çelur në vlerën 77,000,000 leke, ndërkohë që deri në fund të vitit fondet për këtë projekt rezultojnë në vlerën 28,580,120 lekë, me një diferencë prej rreth 38,819,880 lekë të pakësuara përgjatë vitit 2022. Procedura e prokurimit për kontratën është shpallur gjatë 2022, ku ndërkohë në 13.09.2022 janë pakësuar me 27,000,000 lekë. Sipas DPD, ky është projekt i propozuar nga ana e Degës së Doganës Gjirokastër dhe Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, të cilat kanë përcjellë edhe shumën e nevojshme për kryerjen e këtij rikonstruksioni. Projekti është miratuar gjatë fazave të hartimit të PBA dhe me miratimin e Ligjit të Buxhetit është përcjellë pranë MFE. Për realizimin e këtij rikonstruksioni nga ana e sektorit të prokurimeve është hartuar urdhri i prokurimit nr.8045 prot, datë 28.04.2022 në të cilin është parashikuar vlera e prokurimit në shumën 31,395,905 lekë pa TVSh, dhe 37,675,097 lekë me TVSh. Nisur nga kjo është raportuar nga DPD pranë MFE fond i lire në shumën 27,000,000 lekë dhe nga Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me anë të shkresës nr 14405/5 prot, datë 03.08.2022 dalë në zbatim të Aktit Normativ nr.12, datë 29.07.2022, kjo shume është pakësuar.

2. Për projektin me kod 18CC805- "Zbatim i projektit Krijimi i ambienteve shitesë në Parkingun e Degës Doganore Morinë, sistemim asfaltim, rrethim" fondet disponibël në vlerën 40,269,000 lekë çelur në fillim të vitit 2022, rezultojnë të pa përdorura deri në fund të vitit ku edhe janë pakësuar po në këtë vlerë. Ky projekt është çelur në fillim të vitit buxhetor, parashikuar gjatë fazave të hartimit të kërkesave buxhetore nga ana e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse si dhe është miratuar nga ana e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor, problematike për këtë projekt gjatë vitit 2022 ka qenë mos miratimi i VKM-së për kalim pronësie e më pas për marrjen e lejes ndërtimit. Marrë shkak nga këto vonesa shuma e fondit të parashikuar është pakësuar me anë të Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022.

3. Projekti me kod 18AW502- "Kontratë binjakëzimi IPA 2017 -Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në përafrim legjislativ & procedurash me EU acquis, përgatitje për ndërveprimin me sistemin IT (BE) për mallrat e falsifikuara" është çelur në Nëntor 2022, dhe nuk rezultoi i planifikuar në fillim të vitit 2022. Ky projekt ka qenë financim i Bashkimit Evropian në kuadër të programit IPA 2017 i cili administrohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe zbatohet nga Ministria Federale e Financave e Austrisë për një shumë totale prej 400,000 Euro. Periudha e zbatimit projektit ishte **12 muaj** dhe ka filluar të zbatohet në **24 Nëntor 2020** deri në **Nëntor të vitit 2021**. Për këtë kontratë, para financimi ka qenë në shumën 312,643.29 euro, pagesë kjo e kryer nga autoriteti kontraktues në datë 29/12/2020. Shpenzimet e kryera për këtë projekt kontrollohen dhe certifikohen në raportimin e fundit financiar i cili është përcjellë nga ana e Drejtorisë së Financimit dhe Kontraktimit të Fondeve të Huaja pranë MFE, në DPD me anë të shkresës nr.933 prot, datë 26.09.2022. Ndërkohë po nga ana e tyre është hedhur në sistemin financiar të qeverisë realizimi në shumën 19,106,390 lekë. Duke qenë se për këtë vit buxhetor DPD nuk ka patur të planifikuara fonde për këtë projekt, pasi afati i përfundimit të tij ka qenë Nëntori i vitit 2021, për të sistemuar situatën financiare, është kërkuar rialokimi i fondit.

4. Fondet e projektit 18AW101- "Pajisje kompjuterike licenca, softë" (Kompjuteri, printera, laptop Skaner, video projektor)" rezultojnë të mos jënë realizuar deri në fund të vitit, ku në dhjetor janë pakësuar fondet në vlerën 3,400,000 lekë. Për këtë projekt është parashikuar në fillim të vitit buxhetor shuma prej 15,000,000 lekë. Procedurat e prokurimit për këto pajisje janë kryer nga AKSH-i. Pranë DPD janë përcjellë autorizimet për lidhjen e kontratave sipas loteve. Fondi i pakësuar prej 3,400 mijë lekë rezultonte i lirë pas lidhjes së kontratave dhe është pakësuar me Aktin Normativ nr.19, dt 29.12.2022 përcjellë nga MFE me shkesë nr. 24043 /12 prot, datë 30.12.2022.

Për shpenzimet operative:

1- Në muajin Dhjetor 2022 rezultojnë të jënë shtuar fondet në vlerën 45,856,000 lekë, nën kodin 91005AB "Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara". Nisur nga fondet e miratuara me anë të ligjit nr.115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", për programin "Menaxhimi i të ardhurave doganore" në fillim të vitit buxhetor për produktin 91005AB nuk është miratuar çelje fondi. Nisur nga ecuria e realizimit të zërave të shpenzimeve korrente fondet e lira janë rialokuar me anë të Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022, përcjellë zyrtarisht nga MFE me shkresë nr. 23351/127 prot, datë 29.12.2022.

Mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura

Deri në fund të vitit 2022, detyrimet e prapambetura paraqiten në vlerën prej 86,653 mijë lekë, nga ku:

- Detyrime të trashëguara në vlerën 122,445 mijë lekë, nga të cilat janë likuiduar 36,943 mijë lekë;
- Detyrime të reja të vitit 2022 në vlerën 11,724 mijë lekë, nga të cilat janë likuiduar 10,572 mijë lekë.

Detyrimet e prapambetura të shërbimit të skanimit, ku në fillim të vitit rezultojnë në 419,357,761 lekë janë likuiduar dhe diferenca prej 13,000,057 lekë është konstatuar si diferencë kursi këmbimi me urdhër nr.23065 të Drejtorit të DPD.

Gjendja e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022, (rakorduar me evidencën në thesar) rezultojnë në vlerën 86,653.538 lekë, detajuar në:

a-Llog. 4864200/ mbetje (rakorduar 31.12.2022)-detyrim për S2.Albania = 0 € ose =0 lekë;

b-Llog. 4864100// mbetje (rakorduar 31.12.2022)(detyrim për vendime gjyqësore)=86,653,538 lekë;

b1-Ish-punonjës/mbetje (detyrim për vendime gjyqësore tatim në burim F.)=1,151,779 lekë;

b2-Subjekte /mbetje (detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore)M. = 85,501,759 lekë.

Për sa më sipër:

-Shuma prej 1,151,779 lekë (detyrim për vendime gjyqësore tatim në burim F.) konstatuar për t'u paguar sipas formularit të deklarimit të mbajtur në burim në sistemin elektronik të tatimeve (e-filling) dhjetor 2022 është likuiduar me Urdhër-Shpenzimin nr.17 datë 12.01.2023.

-Shuma 85,501,759 lekë (detyrime të prapambetura për vendime gjyqësore M. SHPK) i rakorduar me evidencën e fundit të vitit (dt.31.12.2022) në thesar është mbartur për vitin 2023. Fillimisht detyrimi i prapambetur për M. SHPK ka ardhur si pasojë e ekzekutimit të titullit ekzekutiv Vendimit nr.788 dt.22.09.2020 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, kontabilizuar me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm sipas shkresës nr.20086/1 prot, dt.16.11.2020. Nga ana e Drejtorisë Juridike Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është ankimuar në Gjykatën e Lartë dhe është pezulluar ekzekutimi deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga kjo gjykatë. Për sa më sipër, Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me nr. 00-2022-1944, datë 15.09.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Avokatura e Shtetit dhe pala e paditur Dega e Doganës Tiranë, ndaj vendimit nr. 788, datë 22.09.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë **dhe në vijim** me shkresën nr.19384/2 prot, dt.06.12.2022 *“Për një shtesë në Urdhrin nr. 21219/1 prot, datë 25.11.2019, “Urdhër për kontabilizim detyrim kreditori për vendim gjyqësor të formës së prerë” ndaj subjektit “M.” SHPK, me NUIS K....C”, DPD/Drejtoria e Buxhetit dhe Financës ka vijuar me ekzekutimin dhe likuidimin ndaj detyrimit për subjektin M. SHPK, gjatë muajit dhjetor 2022 duke e pakësuar detyrimin ndaj tij në shumën 36,943,326 lekë, (me Urdhër-Shpenzimin nr.949 datë 27.12.2022 dhe me nr.977 datë 29.12.2022). Pra, detyrimi për “M.B” SHPK fillimisht në masën 122,445,085 lekë rezultojnë i mbetur për 85,501,759 lekë, vlerë e cila është planifikuar për vitin 2023 dhe është likuiduar me Urdhër Shpenzimin nr.62 dt.10.02.2023.*

Në mënyrë të përmbledhur, realizimi i buxhetit të vitit 2022, krahasimisht me planin fillestar, atë të rishikuar dhe PBA-së sipas fazave për total programin e menaxhimit të të ardhurave doganore dhe aparatit të DPD paraqitet si më poshtë:

Pasqyra 59: Realizimi i buxhetit të vitit 2022, krahasimisht me planin fillestar, atë të rishikuar dhe PBA-së sipas fazave për total programin e menaxhimit të të ardhurave doganore

Emërtimi i artikujve	PBA faza I		PBA faza II		PBA faza III	Çelje	Plani rishikuar	Realizimi
	Sipas Taveaneve	Kërkesa Institucionit	Sipas Taveaneve	Kërkesa Institucionit				
600	1,101,900	1,190,639	1,101,900	1,199,574	1,161,897	1,101,900	1,034,345	1,032,255
<i>Nga të cilat aparati</i>	484,836	532,004	484,836	532,004	532,004	486,798	482,288	482,276
601	182,100	198,668	182,100	200,173	200,173	182,100	172,412	172,292
<i>Nga të cilat aparati</i>	80,124	88,689	80,124	88,689	88,689	80,250	80,519	80,517
602	2,341,303	2,873,136	2,038,883	2,911,413	2,911,413	2,238,983	2,534,517	2,520,741
<i>Nga të cilat aparati</i>	2,341,303	2,616,316	2,038,883	2,646,169	2,646,169	2,082,983	2,294,392	2,284,479
605	6,697	6,697	9,117	9,117	9,117	9,117	6,417	6,325
<i>Nga të cilat aparati</i>	6,697	6,697	9,117	9,117	9,117	9,117	6,417	6,325
606	0	0	0	0	0	0	17,599	17,525
<i>Nga të cilat aparati</i>	0	0	0	0	0	0	7,323	7,311
Total korrente	3,632,000	4,269,140	3,332,000	4,320,277	4,282,600	3,532,100	3,765,290	3,749,138
<i>Nga të cilat aparati</i>	2,912,960	3,243,706	2,612,960	3,275,979	3,275,979	2,659,148	2,870,939	2,860,908
230	0	0	0	0	2,314	2,314	0	0
<i>Nga të cilat aparati</i>	0	0	0	0	2,314	2,314	0	0
231	153,220	256,390	153,220	153,220	150,906	153,220	52,574	50,271
<i>Nga të cilat aparati</i>	150,906	254,076	148,978	148,978	150,906		49,598	47,690
Financim I Huaj	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	70,359
<i>Nga të cilat aparati</i>	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	120,690	20,088
Total kapitale	273,910	377,080	273,910	273,910	273,910	273,910	173,264	120,630
<i>Nga të cilat aparati</i>	150,906	254,076	269,668	269,668	273,910	123,004	170,288	67,778
TOTALI	3,905,910	4,646,220	3,605,910	4,594,187	4,556,510	3,806,010	3,938,554	3,869,768
<i>Nga të cilat aparati</i>	3,063,866	3,497,782	2,882,628	3,545,647	3,549,889	2,782,152	3,041,227	2,928,686

Burimi: DPD

Sikundër vërehet nga tabela e mësipërme, konstatohen diferenca të konsiderueshme mes tavaneve buxhetore të përcaktuara gjatë fazave të hartimit të planeve buxhetore afatmesme, krahasimisht me total kërkesat e DPD, diferenca këto që gjatë hartimit të fazës së tretë të PBA-së rezultojnë në rënie, për tu rritur më pas gjatë çeljes së fondeve buxhetore dhe planit të rishikuar.

Lidhur me **rishikimet e kryera pas datës 15 Nëntor**, sipas databazës së Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit pranë MFE, u kërkua informacion pranë DPD për këto rishikime, ku në tabelën e aneksit më poshtë pasqyrohen rishikimet e kryera dhe komentet e DPD, nga ku rezulton se rishikimet e kryera në sistem pas datës 15 Nëntor, përjashtimisht për ndryshimet me VKM apo Akt Normativ, ndryshimet e tjera janë iniciuar para datës 15 Nëntor nga ana e DPD sipas shkresave respektive të cituara më poshtë.

Nga ana e DPD u informuam se ne lidhje me Aktet Normative nga ana e MFE ne mënyrë elektronike është kërkuar raportimi i fondeve te lira dhe me pas po nga MFE është përcjellë akti normativ; dhe pas daljes se tij dërgohet detajimi nga ana e institucionit. Pra, rishikimet e kryera me aktin normativ nuk rezultojnë të jenë finalizuar sipas kërkesave të DPD.

-Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me pagesat e kryera në tejkalim të afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi (30 ditë për U.Sh nga data e furnitorit+30 ditë për likuidimin, ne total 60 dite), ku nga ana e DPD u informuam rast pas rasti trajtuar sipas aneksit më poshtë nga ku ka rezultuar se vonesat kanë ardhur për shkak të faturave të likuiduara me vonesë të Rapiscan për të cilat është miratuar edhe shtyrja e pagesave me VKM, si dhe faturave të përcjella me vonesë nga AKSH-i.

Lidhur me urdhër shpenzimet e regjistruara në tejkalim të afatit 30 ditor, komentet e DPD paraqiten sipas aneksit më poshtë nga ku ka rezultuar se vonesat kanë ardhur për shkak të faturave të përcjella me vonesë nga AKSH-i, si dhe pagesa për shërbimin e të dhënave të bursës.

M.K me shkresën nr. 283/21, prot në KLSH datë 14.08.2023 dhe në DPD nr. 11604/2, prot datë 10.08.2023, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Komenti i subjektit: Aparati i DPD është pjesë e një programi të vetëm buxhetor dhe monitorimi i zbatimit të buxhetit është kryer sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 dhe anekseve përkatëse. Nga ana e aparatit të DPD si njësi më vetë hartohet dhe rakordohet me Degën e Thesarit Tiranë evidenca e realizimit të buxhetit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa trajtuar në këtë observacion sqarojmë se rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit ka për qëllim përmirësimin e procedurave të brendshme institucionale në drejtim të hartimit të një raporti të konsoliduar për monitorimin e buxhetit në të cilin paraqitet situata në rang programi për të gjithë degët doganore, ku konkretisht hartimi më vete në rang njësisht shpenzuese paraprakisht i raporteve të monitorimit, në gjykimin e grupit të auditimit do të mundësonte një paraqitje më të saktë dhe të detajuar të situatës, material ky që mund t'u shërbejë më pas për të hartuar një përmbledhëse.

Titulli gjetjes: **Mbi problematikat e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e buxhetit të DPD të tilla si diferenca të konsiderueshme mes kërkesave të DPD për fonde dhe tavaneve të miratuara apo mos realizimi i disa projekteve të investimeve të institucionit.**

Situata: Nga auditimi u konstatua se pas përcjelljes së propozimeve të DPD pranë MFE në kuadër të hartimit të PBA-së së fazës së dytë 2022-2024, në vijim të shkresës së MFE, janë rishikuar prioritetet në kërkesa buxhetore, si rezultat i së cilave janë reduktuar fondet e DPD me 43,969 mijë lekë, krahasuar me limitet e planifikuara në fazën e dytë të PBA-së, duke rezultuar me diferenca të konsiderueshme mes tavaneve buxhetore të përcaktuara gjatë fazave të hartimit të planeve buxhetore afatmesme, krahasimisht me total kërkesat e DPD. Këto diferenca kanë ardhur në rënie gjatë hartimit të fazës së tretë të PBA-së dhe gjatë çeljes së fondeve buxhetore të vitit 2022 apo planit të rishikuar përgjatë vitit. Konkretisht, në fazën e I-rë të PBA-së, kërkesat e institucionit paraqiten në vlerën 4,646,220 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,497,782 mijë lekë), ndërkohë që limitet në tavane janë miratuar në vlerën 3,905,910 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,063,866 mijë lekë) dhe në fazën e II-të PBA-së, kërkesat e institucionit paraqiten në vlerën 4,594,187 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,545,647 mijë lekë), ndërkohë që limitet në tavane janë miratuar në vlerën 3,605,910 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,882,628 mijë lekë). Fondet janë çelur fillimisht në vlerën 3,806,010 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,782,152 mijë lekë), dhe sipas planit të rishikuar paraqiten në vlerën 3,938,554 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,041,227 mijë lekë) dhe realizimi në vlerën 3,869,768 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,928,686 mijë lekë).

- Nga auditimi konstatohet se në kuadër të hartimit të dokumentacioneve të buxhetit si në fazën e planifikimit (PBA-ja) dhe atë të realizimit të buxhetit (raportet e monitorimit 4 mujore), nga ana e DPD hartohet përmbledhësja që pasqyron të dhënat e konsoliduara në rang sistemi doganor për të gjitha degët doganore, duke mos u dokumentuar realizimi i buxhetit vetëm për DPD si njësi shpenzuese më vete.

- Nga auditimi i rishikimeve të fondeve të investimeve sipas akteve normative, konstatohet se këto ndryshime nuk rezultojnë të jenë një produkt i kërkesave të DPD për shpërndarjen e fondeve në programe/produkte të tjera buxhetore, pasi nga ana e tyre është kryer vetëm raportimi i fondeve të lira në mënyrë elektronike sipas kërkesës së MFE.

- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të DPD sipas projekteve buxhetore u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Për projektin me kod **18CC804** “Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë”, fillimisht fondet rezultojnë të jenë çelur në vlerën 77,000 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit ato rezultojnë rreth 38,819 mijë lekë më pak, pasi pas kryerjes së procedurës së prokurimit, fondet për këtë projekt **janë pakësuar me 27,000 mijë lekë.** Ky

projekt është propozuar nga Dega e Doganës Gjirokastër dhe Drejtoria e Burimeve Mbështetëse, të cilat kanë përcjellë edhe shumën e nevojshme për kryerjen e këtij rikonstruksioni. Për realizimin e tij, nga ana e Sektorit të Prokurimeve është hartuar urdhri i prokurimit në të cilin është parashikuar vlera prej 31,395 mijë lekë pa TVSh dhe diferenca e fondeve në shumën 27,000 mijë lekë është pakësuar më pas me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022.

2. Për projektin me kod **18CC805** “Zbatim i projektit krijimi i ambienteve shtesë në parkingun e Degës Doganore Morinë, sistemim asfaltim, rrethim” fondet janë çelur fillimisht në vlerën **40,269 mijë lekë, të cilat rezultojnë të pa përdorura deri në fund të vitit**, për shkak të mos miratimit të VKM-së për kalim pronësie e më pas për marrjen e lejes ndërtimit, ku si rezultat fondet kanë mbetur të pa përdorura dhe janë pakësuar me anë të Aktit Normativ nr. 17 datë 01.12.2022.

3. Në muajin Dhjetor 2022 rezultojnë të jenë shtuar fondet në vlerën **45,856 mijë lekë**, nën kodin **91005AB** “Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara”, pasi në fillim të vitit buxhetor për këtë produkt nga ana e MFE nuk janë çelur fonde për DPD. Nisur nga ecuria e realizimit të zërave të shpenzimeve korrente fondet e lira janë rialokuar me anë të Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022.

4. Gjithashtu, u konstatua se projekti M100479 “Sistem monitorimi” planifikuar në vlerën 29,000 mijë lekë dhe projekti 18AË302 “Dixhitalizimi shërbimeve doganore” planifikuar në vlerën 9,450 mijë lekë , pavarësisht se janë propozuar gjatë hartimit të PBA-së së fazës së dytë, rezultojnë të pa realizuara deri në fund të vitit 2022.

Kriteri :

Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ;

Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 75 “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit”;

Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”.

Ndikimi/Efekti:

Rishikimet e fondeve përbëjnë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.

Shkaku:

Problematikat në planifikim dhe tavaneve e miratuara, të cilat nuk mbulojnë kërkesat reale të institucionit.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

- DPD të marrë masat për hartimin e dokumenteve për monitorimin e realizimit të buxhetit vetëm për institucionin si njësi shpenzuese më vete, pa përfshirë degët doganore brenda programit të të ardhurave doganore, duke përfshirë treguesit gjatë të gjithë procesin nga planifikimi buxhetor deri në realizim, në kuadër të përmirësimit të procedurave të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

- DPD të marrë masat për intensifikimin e bashkëpunimit me MFE me qëllim kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucional gjatë miratimit të tavaneve buxhetore, me qëllim shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve, dhe garantimin e një monitorimi të plotë realizimit të fondeve buxhetore sipas planifikimit, duke identifikuar në kohë projektet që janë me realizim më të ulët, në mënyrë që fondet në dispozicion të tyre, të rishpërndahen në projekte të tjera brenda programit të menaxhimit të të ardhurave doganore.

2.8. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjor të veprimtarisë së Drejtorisë së Departamentit Administrativ

2.8.a Zbatimi i legjislacionit për realizimin e procedurave të prokurimit publik. Lidhja dhe zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve

Me shkresën nr. 293/1, prot datë 14.01.2022 të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm, znj. M.D, në mungesë dhe me urdhër të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, znj. A.T, janë caktuar personat përgjegjës për prokurimin për vitin 2022, z.A.L, z.R.H, z.S.R. Në kuadër të hartimit të projektbuxhetit të vitit 2022, nga ana e DPD është vijuar me hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimeve bazuar në kërkesat e drejtorive të DPD, në zbatim të kërkesave të udhëzimit nr. 4, datë 18.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik”, Kreu I, pika 4, me shkresën nr. 2595, prot datë 11.02.2022 të zv. Drejtorit të Përgjithshëm Administrativ, znj.M.D, ku konstatohet se ky regjistër është hartuar në tejkallim të afatit të parashikuar në pikën 3 të udhëzimit “Regjistri i parashikimit të procedurave të prokurimit duhet të përgatitet nga autoriteti ose enti kontraktor, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi i ligjit për buxhetin të vitit ushtrimor përkatës”.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se për hartimin e regjistrit të prokurimeve nuk është dokumentuar shqyrtimi i kërkesave të DPD dhe degëve doganore me qëllim përcaktimin e kriterëve të vendimmarrjeve referuar prioritetëve, apo faktorëve të tjerë që mund të kenë ndikuar, për të garantuar mirë planifikimin e fondeve që do të prokurohen, për të reflektuar drejt nevojat si dhe vlerën e kohën për plotësimin e tyre, sikundër përcakton udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik.

Sipas sistemit elektronik të prokurimeve publike, rezulton se ky regjistër është rishikuar përgjatë vitit dhe në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për vendosjen në dispozicion të këtyre korrespondencave që justifikojnë çdo rishikim të kryer, shkresat e kërkesave të nevojave për kryerjen e prokurimeve nuk u përcollën.

-Në dispozicion të grupit të auditimit u vendosën procesverbalet e mbajtur nga KVO për krijimin në APP të procedurave të prokurimit, rast pas rasti, përgjatë vitit. Referuar regjistrit të **parashikimeve të rishikuar**, rezulton të jenë planifikuar deri në fund të vitit 2022 kryerja e prokurimit për procedurat e trajtuara në vijim, të cilat janë krahasuar edhe me planin fillestar të prokurimeve ku situata paraqitet sipas aneksit më poshtë nga ku rezulton se sipas planit fillestar të hartuar në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit që do të zhvillohen nga DPD janë planifikuar në fillim të vitit 2022 **vetëm 10 procedura në vlerën totale prej 34,844,590 lekë**. Si rezultat i rishikimeve të kryera përgjatë vitit, deri në fund të vitit 2022 rezultojnë të jenë planifikuar 55 procedura me vlerën totale prej 167,032,266 lekë .

-Për sa i përket regjistrit të realizimit të prokurimeve, përcjellë me shkresën nr. 196, prot datë 06.01.2022* (data e protokolluar nuk është e saktë pasi ky regjistër duhet të ishte përcjellë përgjatë vitit 2023), rezulton se janë realizuar procedurat e mëposhtme:

Të ndara sipas tipologjisë së kontratës, llojit të procedurës së prokurimit dhe organit që ka zhvilluar procedurën e prokurimit, situata paraqitet si në vijim:

Pasqyra 60: Procedurat e prokurimit të kryer nga DPD sipas tipit të kontratës

Tipi i Kontratës (mall/punë/shërbim) Marrëveshje Kuadër	Fondi limit me të cilin është shpallur procedura	Vlera e Kontratës së nënshkruar	Numri i procedurave
Mallra	17,350,920	9,180,939	34
Punë	-	28,531,680	1
Shërbim	5,217,300	6,535,700	31
Total	22,568,220	44,248,319	66

Burimi: Dosja e procedurës, DPD

Pasqyra 61: Procedurat e prokurimit të kryer nga DPD sipas organit që ka zhvilluar procedurën

Organi që ka zhvilluar procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara / autoriteti/enti i deleguar	Fondi limit me të cilin është shpallur procedura	Vlera e Kontratës së nënshkruar	Numri i procedurave
AKSHI	10,909,717	2,110,602	6
ASHPP	953,466	5,259,101	9
DPA	-	-	1
DPD	10,705,037	36,878,616	50
Total	22,568,220	44,248,319	66

Burimi: Dosja e procedurës, DPD

Pasqyra 62: Procedurat e prokurimit të kryer nga DPD sipas llojit të procedurës

Lloji i procedurës	Fondi limit me të cilin është shpallur procedura	Vlera e Kontratës së nënshkruar	Numri i procedurave
Blerje Dinamike e Biletave për Transportin Ajror	1,785,394	1,877,450	15
Blerje me vlerë të vogël	1,335,325	1,810,476	8
Blerje me vlerë të vogël	-	-	1
Blerje me vlerë të vogël. Nen 100 000 leke	404,143	512,548	18
Minikontratë në kuadër të marrëveshjes kuadër	12,444,208	8,066,933	17
Procedurë e hapur	-	28,531,680	1
Procedurë e hapur e thjeshtuar	6,599,150	3,449,232	4
Procesverbal i rasteve të emergjencës (blank)	-	-	2
Grand Total	22,568,220	44,248,319	66

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Përgjatë vitit 2022 rezultojnë të jenë lidhur nga DPD kontratat si më poshtë:

Pasqyra 63: Kontratat e nënshkruara në vitin 2022

Nr	Procedura	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Vlera e kontratës me TVSH
1	Rikonstrukcion dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e PKK Kakavijë	31,395,905	24,037,167	28,531,680
2	Mbikqyrësi i Punimeve (Supervizori) i Rikonstrukcion dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë	413,000	330,272	396,326
3	Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagente kimik	4,103,150	2,874,360	3,449,232
4	Mirëmbajtje e sistemeve të peshimit	2,496,000	1,990,000	2,388,000
5	Loti 1, Mirëmbajtje dhe kalibrim i aparaturave të Laboratorit Doganor - HPLC DAD Shimadzu	978,000	977,000	1,172,400
6	Blerje Latina	2,239,400	2,138,000	2,565,600
7	Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Diesel (Gazoil)	8,556,250	8,556,250	10,267,500
8	Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Benzinë pa plumb	1,244,583	1,244,583	1,493,500
9	Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Diesel (Gazoil)	20,508,788	20,508,788	24,610,546
10	Furnizim me lëndë djegëse për automjetet Benzinë pa plumb	1,144,135	1,144,135	1,372,962
11	Riparim mirëmbajtjeje automjeteve per DPD	2,333,333	2,333,333	2,800,000
12	Riparim mirëmbajtjeje automjeteve per DPD	307,680	307,680	369,216
13	Blerje vajra, lubrifikant, alkol frenash dhe pastrues motori	581,025	581,025	697,230
14	Loti 1 Blerje UPS	1,044,582	566,205	679,446
15	Loti 2 Blerje Skanera	133,855	57,000	68,400
16	Loti 3 Blerje Tonera	6,309,668	1,570,067	1,884,080
17	Loti 4 Blerje Fotokopje	1,589,448	777,500	933,000
18	Loti 5 Blerje Printera	428,060	306,230	367,476
19	Loti 6 Blerje Kompjutera	9,065,380	7,906,000	9,487,200
20	Loti 7 Blerje Switch, Router	237,840	51,900	62,280
21	Materiale kancelarie me baze letre	2,536,574	1,095,785	1,314,942
22	Materiale kancelarie te tjera zyre	731,833	645,785	774,922
23	Blerje kuti dhe dosje per ruajtje te perhershme	1,223,540	1,223,540	1,468,248

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer përzgjedhja e **dosjeve të procedurave të prokurimit të realizuara**, duke konsideruar si kriter për përzgjedhjen vlerën e fondit limit, llojin e procedurës, tipin e kontratës:

1. *Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit per krijimin e kushteve optimale per udhëtarët e PKK Kakavijë."*

2. *Materiale dhe pajisje laboratorike te shërbimit publik dhe reagente kimik."*

Gjithashtu, u kërkua vendosja në dispozicion e dokumentacionit lidhur me **zbatimin e kontratave të mëposhtme:**

1. *"Rikonstruksion dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e PKK Kakavijë";*

2. *"Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagente kimik";*

3. *"Loti 6 Blerje Kompjutera".*

1. Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë".

-Procedurë e rishpallur

Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit: REF-27716-05-06-2022

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion, sipas shkresës nr. 8045/4, prot datë 17.05.2022 të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Autorizuar, me lëndë "Njoftim anulimi", procedura është anuluar duke cituar si arsye përcaktimin e nenit 98, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik": "c. Konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme". Bashkëlidhur njoftimit gjendet edhe formulari për kërkesë për sqarim "Në tender ka disa paqartësi: Kapitulli E/2 "E/2 Sistemi i transmetimit data-telefoni", ka shumatore të emëruar E/4. Mos ka ndonjë lapsus, apo ka kapitull shtesë që mund të mos jetë paraqitur?" "Kapitulli E/5 impianti i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike dhe.." nuk është i plotë në emërtim. Shumatorja e kapitullit E/5 është shënuar E/2. Mos është lapsus?". Në vijim të kërkesës nuk rezulton të jenë dokumentuar nga ana grupit të punës dhënia e komenteve/sqarimeve përkatëse për gabimet/problematikat e vëna në pah nga OE.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

Pasqyra 64: Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë".

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur" Ref-30995-05-27-2022 Urdhri nr. 10, datë 24.04.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhri nr. 7125, prot datë 13.04.2022 a. R.J- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse b. R.T - Drejtoria e Burimeve Mbështetëse c. S.A- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse	2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 7125/1, prot datë 24.05.2022 1. A.L 2. S.R 3. R.H	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 7125/4, prot datë 24.05.2022 1. R.SH 2. A.L 3. L.Z
4. Fondi Limit (pa TVSh) 31,395,905.5 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: I 24,037,167 lekë pa TVSh.		6. Diferenca me fondin limit 7,358,738.5 lekë pa TVSh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 15.06.2022	Burimi Financimit Fonde të tjera		9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 5 OE b) Skualifikuar 2 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj			
10. Ankimime Nuk ka patur	11. Data e lidhjes të kontratës: Kontrata nr. 15753, datë 02.09.2022		12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: Nuk ka patur

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 është përcjellë nga shoqëria “N” SHPK projekt zbatimi me objekt “Studim e projektim të rikonstruksionit dhe zgjerimit të terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit Kakavijë”, në zbatim të kontratës së lidhur me të nga DPD nr. 23401, datë 14.12.2021. Bashkëlidhur dokumentit janë dorëzuar specifikimet teknike, grafiku i punimeve, hartimi i preventivit (analiza e çmimeve), relacioni teknik, dhe projektet e ndryshme si p.sh. ai arkitektonik, konstruktiv, hidrosanitar, elektrik, etj.

Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Me urdhrin nr. 7125, prot datë 13.04.2022 të znj. M.D, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, ka ngritur grupin e punës së posaçëm **për përcaktimin e kriereve teknike e profesionale kualifikuese** të operatorëve ekonomik pjesëmarrës për prokurimin me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë”, në zbatim të kriereve përcaktuar në nenin 36,37,76,77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39,43,44,45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, projektin e dërguar me shkresë nr. 24123, prot datë 30.12.2021 si dhe bazuar në rekomandim-njoftim nr. 3872/1, prot datë 29.06.2021, me përbërje:

a. R.J- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

b. R.T- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

c. S.A- Drejtoria e Burimeve Mbështetëse

Anëtarët e përzgjedhur kanë dorëzuar formularët e deklaramit dhe me shkresën nr. 7125/1, prot datë 20.05.2022 kanë dërguar procesverbalin e kriereve për kontratën, elementët e së cilat trajtohen si më poshtë:

Vlera e fondit limit: 31,395,905.5 lekë.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Financës pranë DPD, konstatohet se fondet për këtë projekt investimi “18CC804- Godina të ndërhuara dhe ri konstruktuar” Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavije”, janë çelur në vlerën 77,000,000 lekë, pra më shumë se dyfishi i fondit limit të përlllogaritur për kryerjen e prokurimit, përcjellë me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 nga OE i kontraktuar nga DPD për përlllogaritjen e kostos së investimit. Si rezultat, diferencave e fondeve prej 45,605,095 lekë, ka mbetur e papërdorur nga DPD dhe të pa shpërndara në projekte të tjera, deri në Shtator të vitit 2022, duke përbërë kështu risk të shtuar për krijimin e efekteve financiare negative për përdorimin pa efektivitet, efience dhe ekonomicitet të fondeve publike në kushtet kur për periudhën 9 mujore këto fonde mund të ishin përdorur në një tjetër destinacion për projekte prioritare të DPD në të njëjtin program, apo edhe programeve të tjera me miratimin e strukturave përkatëse pranë MFE.

Në aneksin bashkëlidhur paraqiten argumentimet për specifikimet teknike të vendosura, ku konstatohet se për kriteret për angazhimin e punonjësve sipas profesioneve dhe numri i fuqisë punëtore rezultojnë të pa argumentuar nga ana e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për të dokumentuar edhe analizën e kryer nga ana tyre, për të konkluduar më pas në këtë kriter. Gjithashtu referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, nuk shpjegohet në asnjë moment përlllogaritja e orëve të punës, mjeteve të kërkuara dhe argumentimi i stafit të kërkuar, se si rezultat i cilave llogaritjeve është kërkuar një numër i tillë mjeteve dhe punonjësish. Veprimet e mësipërme janë jo në përputhje me LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 4 në të cilën citohet se:

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë

markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në këtë procedurë vendosja e kërkesave të veçanta për kualifikimin e operatorëve ofertues, nuk është e sqaruar në mënyrë teknike dhe ligjore pasi; nuk argumentohet arsyeja e vendosjes së tyre, veprim ky jo në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;

... Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...

Gjithashtu, konstatohet se për kriteri për nevojën e pajisjes me certifikatat e cilësisë së punimeve të listuara më sipër rezulton i pa argumentuar nga ana e komisionit për hartimin e specifikimeve teknike për të dokumentuar edhe analizën e kryer nga ana tyre, për të konkluduar më pas në këtë kriter.

Për sa më sipër konstatohet se kriteret për të cilat janë identifikuar problematika nga ana e grupit të auditimit, përbëjnë risk të shtuar për ndikimin në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik e konkretisht nuk janë në përputhje Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cilat citohet se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se:

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mos diskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

Për sa më sipër për parregullsitë e konstatuara në argumentimin e kritereve të vendosura në specifikime teknike mbajnë përgjegjësi anëtarët e grupit të punës: z. R.J., z. R.T., z. S.A. dhe titullari i AK, znj. M.D.

Me urdhrin nr. 7125/1, prot datë 24.05.2022 të titullarit të autoritetit kontraktues znj. M.D është urdhëruar kryerja e prokurimit të fondit prej 31,395,905.5 lekë pa TVSH me afat zbatimi 4 muaj, sipas procedurës së hapur të prokurimit nga Njësia e Prokurimit me përbërje:

- z. A.L.
- z. S.R.
- z. R.H.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me urdhrin nr. 7125/4, prot datë 24.05.2022 të titullarit të autoritetit kontraktues znj. M.D është urdhëruar ngritja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, përgjegjës për shqyrtimin e ofertave të dorëzuara për këtë procedurë, me përbërje:

- z. R.SH, Kryetar i Degës së Doganës Kakavijë
- z. A.L, anëtar i Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse
- znj. L.Z, anëtar i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financë

Anëtarët e përzgjedhur kanë dorëzuar formularët e deklarimit.

Kriteret e vlerësimit

Me procesverbalin e datës 27.05.2022, Njësia e Prokurimit ka autorizuar z. S.R për kryerjen e veprimeve në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) të kësaj procedure. Bashkëlidhur procesverbalit janë hartuar Dokumentet Standarde të Tenderit për procedurën e hapur.

Ofertat e marra do të vlerësohen në bazë të ofertës ekonomikisht më të favorshme bazuar në çmim. Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e Fondit limit ose 627.918 (gjashtëqind e njëzetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë)

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: 15/06/2022(d/m/v) Ora 10: 00

Kërkesa për sqarim

OE "A." SHPK ka përcjellë kërkesën për sqarim në datën 07.06.2022 duke kërkuar një informacion lidhur me infrastrukturën e ndërtimit, ku sipas anëtarëve është kthyer përgjigje në datën 08.06.2022 se pjesë e projektit janë projektuar 4 mbulesa me konstruksion metalik në katër pozicione të ndryshme të cilat do të shërbejnë për pushimin e autobuzëve si dhe struktura metalike lidhëse me objektet e propozuara "Terminali i Udhëtarëve" janë të nevojshëm të paktën dy montator të specializuar për montimin e konstruksioneve metalike.

OE "P." ka përcjellë kërkesën në datën 11.06.2022 për një udhëzim në lidhje me çmimet e pajisjeve në preventiv, nëse duhet të jenë me apo pa TVSH sipas zërave të përfshirë? Në vijim të saj është kthyer përgjigje në datën 14.06.2022 duke përcaktuar se duhet ti referohen VKM nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit", pa detajuar më tej informacionin e kërkuar nga OE. Grupi i auditimit kërkoi zyrtarisht vendosjen në dispozicion të

VKM-së së cituar në përgjigje për të kryer edhe vlerësimet e nevojshme të kërkesës së OE, por dokumenti nuk u përcoll deri në fund të fazës së auditimit në terren.

Ofertat ekonomike

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar procesverbalit datë 15.06.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Pasqyra 65: Ofertat ekonomike

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa TVSh	Kualifikuar/Skualifikuar
1	I SHPK	24,037,167	Kualifikuar
2	K SHPK	25,110,938	Kualifikuar
3	P SHPK	25,771,789	Kualifikuar
4	ASHPK	31,324,720	S'kualifikuar; Gabime në përlogaritjen e fondit rezervë, ku në zbatim të pikës 3 të nenit 82 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, oferta refuzohet pasi tejkalon 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.
5	T SHPK	25,228,770	S'kualifikuar; "Nuk disponon arkitekt si drejtues teknik në licencën e shoqërisë; në 2 raste nuk ishte e mundur gjenerimi i certifikatës nga sistemi nëse personat kanë qenë të dënuar;"

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Me shkresën nr. 12515, prot datë 04.07.2022 Titullarit të AK është njoftuar fituesi i procedurës, e cila më pas ka dërguar dokumentacionin e mëtejshëm për procedim, përcjellë nga KVO.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës me nr 14968 prot, më datë 16.08.2022, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, AK ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "I" SHPK renditur në vend të parë. Pas përfundimit të afatit të ankimimit është raportuar se nuk ka patur ankesa. Shoqëria "I" SHPK ka dorëzuar sigurimin e kontratës, dhe më pas është finalizuar kontrata me të nr. 15753, datë 02.09.2022, në vlerë 24,037,167 lekë pa TVSH.

Plani i zbatimit të kontratës ka përcaktuar se grafiku i punimeve do të jetë ai i dorëzuar në DST.

Vlerësimi përpara shpalljes se OE fitues

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është skualifikuar ofertuesi "T" për mos paraqitjen në licencën e kompanisë së arkitektit të deklaruar në ofertën e OE si arkitekt të kompanisë.

-Nga auditimi konstatohet se për kriterin 2.3.6 "*Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit): Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Kokore minimumi 22 copë, Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë, Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 4 copë, Zyre kantierie lëvizshme 1 (një) cope*", në formularin e vetedeklarimit nuk raportohet sasia e pajisjeve në dorëzim, por vetëm nr serial, konkretisht "*Kokore Fat.Nr.937 Nr.Serial.661572 97, Fikëse zjarri të lëvizshme Nr.serial 68010017 date 14.09.2018, Komplet i ndihmës së shpejtë nr.serial 17367156 date 17.06.2016, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt nr.serial 44607778 date 13.02.2014, Zyre kantierie lëvizshme nr.serial 96097777 date 16.02.2021*". Megjithatë nga ana e KVO ky kriter është konsideruar si i plotësuar vetëm me listimin e pajisjeve nga ana e OE në formular.

Vlerësimi pas shpalljes se OE fitues

-Nga auditimi konstatohet se pas shpalljes fitues, OE "I" SHPK ka dorëzuar dokumentacionin përkatës pranë DPD ku konstatohet se për kriterin: 2.3.4. "Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

Pasqyra 66: Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar

NR	EMERTIMI	
1	Teknik Ndërtimi	(1 persona)
2	Elektracist	(1 persona)
3	Hidraulik	(2 persona)
4	Karpentier	(2 persona)
5	Hekurthyes	(1 persona)
6	Murator	(2 persona)
7	Shtgues pllakash	(2 persona)
8	Bojaxhi	(2 persona)
9	Saldator	(2 persona)
11	Montator	(2 persona)

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Ndërsa operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten CV-të, dëshmitë/certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të jenë të pajisur gjithashtu edhe me kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga organe kompetente në bazë të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Secili specialistë i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën Shkurt-Mars 2022.

Grupi i auditimit shqyrtoi formularët e list pagesës së periudhës Shkurt-Mars 2022 të dorëzuar nga OE ku rezulton se nuk plotësohen kriteret për: 2 hidraulik, 2 montator, 2 shtgues pllakash.

Nga ana e shoqërisë në formularin e vetëdeklarimit janë raportuar si:

a) 2 hidraulike: z.B.L, z.R.SH

Sipas E sig, rezultojnë që: z.B.L - Shkurt, Mars Hidraulik; z. R.SH - Shkurt, Mars Karpentier

b) 2 shtgues pllakash: z.S.K; z.D.S

Sipas E sig, rezultojnë që: z.S.K- murator për konstruksione; z.D.S -murator për mure tulle

c) 2 montator- z.I.SH, z.G.SH

Sipas E-sig, rezultojnë që: z.I.SH-suvatues; z.G.SH-suvatues

Komisioni i vlerësimit të ofertave është mjaftuar me listimin e punonjësve në formularin e listë pagesës së dorëzuar, pa kërkuar formularin që paraqet edhe të dhëna mbi profesionin e punonjësit, sikundër përcaktojnë edhe specifikimet teknike të procedurës: "Secili specialistë i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën periudhën Shkurt-Mars 2022.

Për parregullsitë e trajtuara më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e KVO: z.R.SH,

z.A.L, znj.L.Z, dhe titullari i AK, znj.M.D.

2. Procedura "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik "

Pasqyra 67: Procedura "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik "

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik".			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit REF-27690-05-06-2022 Procedura e hapur e thjeshtuar Urdhri nr 9, sipas shkresës nr. 7989, prot datë 28.04.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Urdhrin sipas shkresës nr. 4292, prot datë 01.03.2022: -z. D.SH. -znj. S.D. -znj. L. D.	2 Njësia e Prokurimit A.L. S.R. R.H.	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Me urdhri nr. 7989/1, prot datë 28.04.2022 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje: z. L. M. znj. Xh. B. znj. A.K.
4. Fondi Limit (pa tvsh)	5. Oferta fituese, vlera fituese:	6. Diferenca me fondin limit	

4,103,150 lekë	Operatori Fitues: K SHPK 2,874,360 lekë pa tvsh.	1,228,790 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 20.05.2022.	Burimi Financimit Fonde të tjera	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 6 OE b) S'kualifikuar 2 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë		
10. Ankimime Nuk ka patur	11. Data e lidhjes të kontratës: 24.06.2022	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: Nuk ka patur

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Grupi i auditimit kërkoi një informacion lidhur me aktivitetin e laboratorit doganor pranë DPD dhe certifikimet/akreditimet që ai disponon, ku u informuam se Drejtoria e Laboratorit Doganor ka si objekt kryesor të punës analizimin e mallrave që vijnë për analizim nga Administrata Doganore (degët doganore) me qëllim verifikimin e llojit të mallit për të shmangur keq klasifikimet doganore dhe shmangien e evazionit fiskal. Bazuar në rezultatet e analizave laboratorike të lëshuara nga Drejtoria e Laboratorit, me tej nga Drejtoria e Tarifës dhe Origjinës konkludohet mbi klasifikimin tarifor dhe emërtimin të sakte të tij sipas Nomenklatures së Mallrave dhe lëshohet Certifikata përkatëse "Certifikata e verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor". Veprimtaria e Laboratorit Doganor kryhet sipas kërkesave të standardit ndërkombëtarë SSH EN 17025 :2017 "Kërkesa të përgjithshme të laboratorëve testues dhe kalibrues". Ky standard është i njëjti që zbatohet në laboratorët doganore europiane, nga të gjithë laboratorët e akredituar. Analizat që kryhen në laborator bazohen në standarde ndërkombëtare, europiane dhe shqiptare dhe aparaturat që disponon ky laborator janë aparatura bashkëkohore. Aparaturat, reagentet, mjetet e përdorura në laborator janë konform standardeve ndërkombëtare dhe praktikave me të mira laboratorike të laboratorëve doganore europiane.

Laboratori Doganor ka patur të vlefshme Certifikatën e Akreditimit të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe statusin laborator i akredituar për periudhën 4 vjeçare Tetor 2018 -Tetor 2022. Pas përfundimit të procedurave për mirëmbajtje dhe kalibrim të aparaturave Drejtoria e Laboratorit Doganor ka informuar se do të aplikohet për rinovimin e certifikatës dhe ri konfirmim të akreditimit për periudhën e ardhshme 4 vjeçare. Fazat për procedurat e mirëmbajtjes dhe kalibrimit të aparaturave, si me poshtë vijon:

Loti 1- është në proces . -Ka përfunduar kryerja e shërbimit për një pjesë aparaturash dhe është dërguar situacioni i pjesshëm. Aktualisht, për pjesën e mbetur, grupi i punës është në proces të verifikimit të dokumentacionit përkatës të dorëzuar nga operatorët ekonomik lidhur me shërbimet e kryera për mirëmbajtjen dhe kalibrimin.

Loti 2- është në proces-Kontrata nënshkruar në 23.05.2023, vlefshmëria 60 dite.

Loti 3- janë dorëzuar shërbimet

Loti 4- janë dorëzuar shërbimet

Pas përfundimit të procedurave për mirëmbajtje dhe kalibrim të aparaturave do të aplikohet për rinovimin e certifikatës.

Grupi i auditimit mori në shqyrtim procedurën e prokurimit "Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik "

Specifikimet teknike:

Me urdhrin sipas shkresës nr. 4292, prot datë 01.03.2022 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Autorizuar, znj. M.D është ngritur grupi i posaçëm për përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret për kualifikim të operatorëve ekonomik pjesëmarrës, llogaritjen e vlerës limit dhe grafikonin e dorëzimit të mallit brenda 20 ditësh nga marrja në dijeni e urdhrin, për prokurimin me objekt "Materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik" me fond limit 5,000,000 lekë me përbërje:

-z. D.SH. -Drejtoria e Laboratorit Doganor
-znj. S.D. -Drejtoria e Laboratorit Doganor
-znj. L.D. -Drejtoria e Laboratorit Doganor

Bashkëlidhur në dosje gjenden edhe deklaratat e konfliktit të interesit të grupit të punës.

Sipas email-t të datës 24.03.2022 të znj.L.D., është vënë në dukje fakti se grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, në bazë të kërkesave të ardhura nga secili grup pune i sektorit analitik ka hartuar listën paraprake me 114 artikuj të kërkuar për blerje në total, ku për 48 artikuj janë bërë përlllogaritjet e vlerës së çmimit bazuar në çmimin e blerjeve të fundit (2021) të cilat kapin shifrën rreth 26-27 milion lekë pa TVSh. Për 66 artikuj (nga të cilët 28 janë CRM) nuk ka një çmim referues nga 3 vitet e mëparshme. Për sa më sipër, referuar fondit limit prej 5,000,000 lekë nga ana e grupit të punës është kërkuar rishikimi i kërkesave dhe sasisë së kërkuar nga secili grup në mënyrë që të arrihet realizimi i detyrës brenda fondit limit. Në korrespondencat e dosjes janë ridërguar kërkesat me e-mail nga sektorët (ku bashkëlidhur nuk disponohen listat e mallrave të kërkuara nga ta).

Nga korrespondencat më sipër konstatohet se fondet disponibël të akorduara për DPD nuk mbulojnë nevojat për shpenzime të Laboratorit Doganor, ku konkretisht nevojat për materiale dhe pajisje laboratorike rezultojnë mbi 5 herë më shumë se fondi limit i procedurës së prokurimit publik. Me email-in e datës 4.04.2022 të znj.L.D. është bërë me dije se deri në datën 04.04.2022 nuk është siguruar asnjë ofertë ekonomike nga OE të cilët kanë kërkuar më tepër kohë, e si rezultat është kërkuar akordimi i 15 ditëve shtesë për zbatimin e urdhrin.

Sipas procesverbalit me shkresën nr. 4292, prot datë 21.04.2022 janë hartuar specifikimet teknike nga grupi i punës, në tejkallim të afatit të paracaktuar në urdhrin e titullarit të AK, pasi sikundër është trajtuar më lart është kërkuar akordimi i 15 ditëve shtesë, por nuk dokumentohet rishikimi i urdhrin të titullarit për shtyrje të afatit.

Fondi limit është përlllogaritur në masën 4,103,150 lekë, si vlera me ë vogël e tre ofertave të paraqitura nga operatorët, pasi mesatarja e tyre tejkallon fondin limit.

Në dosje paraqiten edhe shkresat e dërguara nga 3 OE ofertues për përlllogaritjet e kryera lidhur me koston e materialeve objekt prokurimi.

Specifikimet teknike janë trajtuar më hollësisht në aneksin bashkëlidhur.

Me urdhrin nr 9, sipas shkresës nr. 7989, prot datë 28.04.2022 është urdhëruar kryerja e prokurimit të fondit prej 4,103,150 lekë pa TVSh sipas procedurës së hapur të thjeshtuar në mbështetje të nenit 49, të ligjit “Për prokurimin publik” dhe nenit 55 të VKM nr. 285 prot datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Njësia e prokurimit është përcaktuar :

- A.L.
- S.R.
- R.H.

Me urdhrin nr. 7989/1, prot datë 28.04.2022 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me përbërje:

- z. L.M., Kryetar, Drejtoria e Laboratorit Doganor
- znj. XH.B., Drejtoria e Laboratorit Doganor
- znj. A.K., Drejtoria e Laboratorit Doganor

Bashkëlidhur në dosje gjenden edhe deklaratat e konfliktit të interesit të grupit të punës.

Formulari i njoftimit të kontratës është përcjellë më shkresën nr. 7989/2, prot datë 28.04.2022 duke përcaktuar afatin e fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave datën 20.05.2022 ora 10.00.

Kohëzgjatja e kontratës: 90 ditë.

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve) REF-27690-05-06-2022

Lloji i procedurës: procedure e hapur e thjeshtuar

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së prokurimit konstatohet se nuk është hartuar grafiku i lëvrimit të mallit në kontratën e nënshkruar, duke u kufizuar vetëm në furnizimin me materiale brenda harkut kohor 90 ditor.

Me procesverbalin e datës 24.05.2022, anëtarët e KVO kanë konstatuar se shoqëria “T” SHPK në ofertën e paraqitur ka gabime aritmetikore në zërin 15 dhe 31 dhe nga ana e KVO është kërkuar korrigjimi i tyre brenda afatit 3 ditor, përcjellë kjo me shkresën nr. 10139, prot datë 24.05.2022 të Titullarit të AK, dhe që më pas janë rishikuar nga OE.

Sipas procesverbalit me shkresën nr. 6, prot datë 23.05.2022, znj. K.V. ka dorëzuar pranë KVO certifikatat e gjendjes gjyqësore të personave të vetëdeklaruar ku nuk kanë rezultuar persona të dënuar.

Formulari i fituesit është përcjellë me shkresën nr. 10576, prot datë 31.05.2022 të titullarit të AK. Sipas raportit përmbledhës me shkresë nr. 11633, prot datë 17.06.2022 të KVO miratuar nga titullarit të AK të autorizuar kanë marrë pjesë ofertuesit:

Pasqyra 68: Ofertuesit

OE	Oferta	Koment
A SHPK	3,549,570	Kualifikuar
E SHPK	3,753,930	Skualifikuar, sepse nuk ka realizuar me sukses kontratën nr. 10126, prot datë 07.06.2021 me objekt “Blerje material dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik” bazuar me email e datës 23.05.2022 nga njësia e prokurimeve sipas se cilës ka patur problematika, vonesa në zbatim dhe nuk është realizuar plotësisht.
E SHPK	3,412,664	Kualifikuar
I SHPK	3,400,800	Kualifikuar. Ka patur gabime gramatikore të cilat me pas u korrigjuan.
K SHPK	2,874,360	Kualifikuar- I renditur në vend të parë si oferta me ekonomike.
G	-	Skualifikuar pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për të përmbushur kriteret kualifikues sipas DST

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Pas përfundimit të afatit të ankimimit nuk ka patur ankesa.

Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e paraqitur nga “K.” SHPK i renditur në vend të parë ka konstatuar se është në përputhje me dokumentacionin e paraqitur në dosje të tenderit dhe e ka konfirmuar si fitues.

Lidhur me citimin në relacion të email-it të datës 23.05.2022 i njësisë së prokurimeve me lëndë “Formular raportimi për zbatimin e kontratës sipas së cilës ka patur problematika, vonesa në zbatim dhe nuk është realizuar plotësisht”. në vijim të kërkesës për informacion pranë DPD lidhur me këtë raportim të njësisë së prokurimeve u informuam nga njësia e prokurimeve se:

“Ky informacion i është dërguar KVO, pas kërkesës së tyre në rrugë verbale për tu pajisur me dokumentacion provues për mos realizim kontrate me sukses për një nga operatorët ofertues në procedurën e viti 2022, me të cilin Drejtoria e Përgjithshme e Doganave kishte lidhur kontratë me të njëjtin objekt për vitin 2021, për të cilin njeri prej anëtarëve të KVO, L.M. kishte qenë anëtar në Grupin e Punës në marrjen në dorëzim të mallit si punonjës i Laboratorit Doganor i cili kishte dijeni që operatori në fjalë nuk e kishte realizuar me sukses kontratën. Pra nuk është procedure rutine dhe në nuk kemi patur rastet e ngjashme me parë për mosrealizim me sukses të kontratës.”

Për sa më sipër konstatohet se nuk rezultojnë të jetë dokumentuar kryerja e një verifikimi i tillë i ngjashëm për performancën e OE ofertues në procedura të tjera prokurimi, apo përfshirja e këtij elementi kontrolli në kriteret kualifikuese të ofertave të dorëzuara.

Nga auditimi konstatohet se nuk dokumentohet vlerësimi i kryer nga anëtarët e KVO për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara për specifikimet teknike si me poshtë:

1. Të gjithë reagentët do të jenë të shkallës së pastërtisë GR.
 2. Të deklarohen emrat e kompanive prodhuese (vendeve të prodhimit).
 3. Reagentet do të jenë sipas standardeve të BE.
 4. Reagentët, dhe të gjitha materialet do të jenë sipas karakteristikave të kërkuara, për GC, HPLC, UV-VIS, FT-IR.
 5. Enët e qelqit do të jenë Class A.
 6. CRM të jenë të pajisura me certifikatë kalibrimi nga prodhuesi dhe me afat skadence 1-2 vjet nga data e pranimit.
 7. Çdo reagent kimik (kimikat) të ketë dokumentin shoqërues konform VKM 9 datë 09.01.2019.
 8. Materialet kimike dhe pajisjet e kërkuara për aparaturat ekzistente të jenë dhe/ose ekuivalente por kompatibël me aparaturat.
- Sipas argumentit të anëtarëve të KVO, specifikimet teknike ato kanë qenë të shprehura tek kriteret e përgjithshme shtojca VIII tek vetëdeklarimet, ku operatorët i kanë pranuar ato dhe janë zotuar për plotësimin e tyre dhe gjatë verifikimit të dokumentacionit kjo është marrë e mirëqenë se do të verifikohen gjatë zbatimit të kontratës nga grupi i pranimit i caktuar nga Autoriteti Kontraktues. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar sipas shkresës nr. 11950/3, prot datë 24.06.2022. Kontrata është nënshkruar datë 24.06.2022 në vlerën 2,874,360 lekë pa TVSH dhe 3,449,232 lekë me TVSH, me afat 90 ditë.

Mbi zbatimin e kontratave

1. Kontrata nr. 15753, datë 02.09.2022 “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë”

Dokumentacionet e administruara lidhur me këtë kontratë paraqiten si më poshtë:

Kontrata është lidhur mes DPD si autoritet kontraktor përfaqësuar nga znj. M.D në cilësinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, dhe operatorit ekonomik “I” SHPK, përfaqësuar nga z. F.C., administrator në cilësinë e kontraktuesit (sipërmarrësit).

Neni 2-Vlera e kontratës

Vlera e kontratës pa TVSH është 24,037,167 lekë dhe vlera totale e saj është 28,531,680 lekë, vlerë në të cilën janë përfshirë të gjithë detyrimet fiskale, përfshirë TVSH.

Neni 3- Afati i kontratës

Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 4 (katër) muaj (nga data e marrjes në dorëzim të kantierit), sipas grafikut të punimeve bashkëlidhur, pjesë e kësaj kontrate.

Neni 5 “Autoriteti Kontraktor (Investitori) Investitori, kompetencat dhe detyrat e tij”

5. Ka të drejtë të kërkojë likuidimin e dëmeve për vonesën në zbatim, nëse kontraktuesi dështon në përfundimin e afateve brenda afatit të kësaj kontrate, përveç rastit të një force Madhore, sipas kushtit penal që do të llogaritet me tarifën ditore referuar nenit 20 .

Neni 7 “Sipërmarrësi i punimeve, kompetencat dhe detyrat e tij”

5. Pas nënshkrimit të kontratës, investitori dorëzon:

- a) projektin e zbatimit për punimet e ndërtimit, infrastrukturës, montimit, sistemimit të territorit dhe preventivin e punimeve;
- b) planin e vendosjes (piketimit) të objektit
- c) përshkrimin teknik të punimeve dhe specifikimet teknike;
- ç) studimet inxhinjerieke për ndërtimin e veprës.

Neni 10 Ekzekutimi i punimeve

Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo të marrë në dorëzim sheshin e ndërtimit. Ekzekutimi do të mbarojë brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

Neni 14- Përgjegjësitë e kontraktorit

Kontraktori do të jetë përgjegjës për realizimin e të gjithë punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, terma reference apo detyrë projektimi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe me standardet teknike në fuqi.

Neni 22 “Specifikimet dhe standartet”

Kontraktori duhet të sigurojë që punimet, shërbimet e lidhura, apo materialet, pajisjet produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve, termave të referencës dhe detyrës së projektimit sipas kushteve në DST..... Çdo ndryshim në cilindo kod dhe standard gjatë ekzekutimit të kontratës do të zbatohet vetëm pas miratimit nga AK dhe do të trajtohet në përputhje me nenin 26 dhe 27 të kontratës. Kontraktori në rast se evidenton mospërputhje apo mangësi në projekt preventiv dhe kantier, brenda një afati të përcaktuar në kontratë, paraqet kërkesën për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor administron kërkesat dhe sigurohet që këto kërkesa të shqyrtohen në strukturat përkatëse brenda afateve në kontratë.

Nga auditimi konstatohet se kontrata nuk ka përcaktuar afat sikundër është cituar më sipër për evidentimin e mospërputhjeve nga ana e OE dhe për afatet lidhur me vendimmarrjen që do të vijoje pas konstatimit të tyre.

Fillimi i punimeve

Me shkresën nr. 16689, prot në DPD datë 20.09.2022, është përcjellë nga mbikëqyrësi i punimeve shkresa për **njoftimin e fillimit të punimeve në datën 07.09.2022, me afat 4 muaj nga fillimi i punimeve, pra deri në datën 07.01.2023.** Bashkëlidhur gjendet edhe akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, dhe procesverbali për fillimin e punimeve, në po të njëjtën datë.

Urdhër shpenzimet e dorëzuara

1. Urdhër shpenzimi nr. 822, datë 14.11.2022

U.SH në vlerën 11,509,518 lekë dhe garanci 5% në vlerën 575,476, pra është ekzekutuar pagesa për vlerën 10,934,042 lekë;

Situacioni nr. 1 përcjellë nga mbikëqyrësi i punimeve;

Fatura elektronike e OE;

Relacioni mbi ecurinë e zbatimit të punimeve për periudhën 22.08.2022-04.11.2022. Nga auditimi konstatohet se sipas situacionit 1, punimet kanë filluar para nënshkrimit të kontratës dhe para marrjes në dorëzim të vendit të punës. Sipas relacionit të paraqitur nuk kanë rezultuar problematika dhe dokumenti është firmosur nga mbikëqyrësi i projektit, kontraktuesi i punimeve dhe grupi i punës së DPD me përbërje: R.J., V.N., A.L..

2. Urdhër shpenzimi nr. 822, datë 14.11.2022

U.SH në vlerën 15,220,362 lekë dhe garanci 5% në vlerën 761,018 lekë, pra është ekzekutuar pagesa për vlerën 14,459,344 lekë.

Kërkesa e OE datë 29.12.2022 me lëndë “Kërkesë për likuidimin situacioni pjesor nr.2”.

Situacioni nr. 2 përcjellë nga mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr.15870/8, datë 30.12.2022.

Fatura elektronike e OE.

Relacioni mbi ecurinë e zbatimit të punimeve për periudhën 04.11.2022-29.12.2022. Sipas situacionit 2, punimet janë realizuar në masën 100%, me përjashtim të punimeve elektrike realizuar 95%, dhe instalimit të pajisjeve, ndërsa për pikat e tjera nuk janë konstatuar problematika. Dokumenti është firmosur nga mbikëqyrësi i projektit, kontraktuesi i punimeve dhe grupi i punës së DPD me përbërje: R.J., V.N., A.L.

c) Kryerja e ndryshimeve

Me shkresën nr. 15870/4, prot datë 19.12.2022, është paraqitur pranë DPD shkresa e mbikëqyrësit të punimeve të kontratës, z.V.B. në cilësinë e përfaqësuesit të "N." SHPK, me lëndë "Kërkesë për miratimin e ndryshimeve në projekt-preventivin e punimeve dhe kërkesë për miratimin e përdorimit të fondit rezervë për objektin "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë", sipas së cilës kërkohet ndryshimi në projekt-preventivin e punimeve dhe kërkesa për miratimin e përdorimit të fondit rezervë. Bashkëlidhur kërkesës janë përcjellë relacioni teknik, pasqyra e ndryshimit të volumeve të punimeve, preventive që shtohen dhe që hiqen, preventivi i rishikuar, procesverbal për miratimin e ndryshimeve, preventivi fondit rezervë, procesverbal për përdorimin e fondit rezervë.

Bashkëlidhur saj gjendet kërkesa e OE "I." SHPK për punime që hiqen e shtohen, ku është konstatuar se ka lëvizje të volumeve të punimeve të planifikuara për këtë objekt, si pasojë e mos parashikimit të saktë të volumeve në preventivin e tenderuar. Këto punime janë gjykuar si të nevojshme për tu kryer.

Në dosje mungon kthimi i përgjigjes per miratim të kërkesës.

Nga auditimi konstatohet se kjo kërkesë, e ardhur rreth 3 muaj pas nënshkrimit të kontratës nxjerr në pah parregullsitë në zbatim të kontratës, ku konkretisht rezulton se nuk është zbatuar grafiku i punimeve si më poshtë, duke vënë në pah edhe realizimin e punimeve jo në përputhje me grafikun, pasi këto punime janë planifikuara për tu realizuar në fillim të zbatimit, që faktikisht kanë rezultuar në proces edhe në momentin e përcjelljes së kërkesës pranë DPD për kryerje të ndryshimeve:

Pasqyra 69: Grafiku i punimeve

KATEGORIA E PUNIMEVE	MUAJ I	MUAJ II	MUAJ III	MUAJ IV
Punime germimi				
Punime b/a				
Punime hekuri				
Punime shtresash				
Punime bojatisje				
Punime tavani dhe mure				
Punime shtresash dhe patinime				
F. V Dyer Dritare				
Rrjeti i Kanalizimeve te Zeza				
Punime Hidrosanitare				
Punime Elektrike				

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Bashkëlidhur kërkesës gjendet procesverbali për përdorimin e fondit rezervë firmosur nga përfaqësuesi i "I." SHPK, z. F.C.; mbikëqyrësi i punimeve "N." SHPK, z.V.B.; dhe në cilësinë e autoritetit kontraktor, nga DPD znj.M.D, duke cituar se bashkëlidhur gjenden:

Relacioni teknik mbi nevojën e ndryshimit të volumeve të punimeve

Pasqyra e ndryshimit të volumeve të punimeve të rehabilitimit

Preventivi i punimeve të shtohen

Preventivi i punimeve që hiqen
Preventivi i rishikuar i punimeve
Procesverbali mbi miratimin e ndryshimeve në volumet e punimeve
Preventive i fondit rezervë
Procesverbal mbi miratimin e përdorimit të fondit rezervë.

Në dosje nuk disponoheshin relacioni teknik mbi nevojën e ndryshimit të volumeve të punimeve, Pasqyra e ndryshimit të volumeve të punimeve të rehabilitimit.

Në dosjen e vendosur në dispozicion gjenden: 1. Kërkesa e "I." SHPK për punime që hiqen e shtohen duke cituar se ndryshimet gjenden në tabelën bashkëlidhur.

Nga auditimi konstatohet se tabela e cituar nuk është pjesë e dosjes. 2. Procesverbali për përdorimin e fondit rezervë: Sipas procesverbalit është përshkruar se duke patur parasysh platformat ekzistuese, është gjykuar si më efikase zgjidhja dhe pozicionimi i objekteve mbi këto struktura. Mund të shihet qartë krijimi i hapësirave të reja për kontrollin e udhëtarëve në dy anët e objektit të doganës. Në pikën dalëse të doganës kemi një sheshpushim për autobuzët, ku udhëtarët zbresin për t'ju nënshtruar kontrollit, i cili mbulohet me kanop që zgjatohet deri në hyrje të objektit të kontrollit të udhëtarëve. Godina e kontrollit ofron ambiente optimale për kryerjen e procesit të kontrollit dhe shoqërohet me dalje me një tjetër hapësirë për autobuzët dedikuar ngarkimit të udhëtarëve, e mbuluar me mbulesë metalike. Gjithashtu kemi edhe zgjerimin e korsisë së parë të kalimit të autobuzëve për të përshtatur kalimin e autobuzëve. Si rezultat i këtyre ndryshimeve kemi një zhvendosje të kabinave të kontrollit për t'i hapur rrugë zgjerimit të korsisë. Hapesira e re mendohet të jetë funksionale edhe për kalimtarëve ku janë parashikuar 3 akse për to. Me qëllim që investimi të jetë i qëndrueshëm jetëgjatë dhe funksional, është parë e nevojshëm rishikimi i një prej zërave të preventivit në mënyrë që të përshtatet me detajet dhe specifikimet sipas projektit të miratuar. Nisur nga sheshpushimet që do krijohen sikundër trajtuar më sipër, pesha e autobusëve gjatë qëndrimit dëmton shtresën e propozuar të asfaltit dhe propozohet të zbriten zërat e punimeve në lidhje me këto punime dhe të shtohet zëri llustër, çimento me kuarc trajtuar me helikopter+zgarë 15*15. Ky zë do të ezaurohet me fond rezervë. Pas matjeve faktike dhe zbrërthimit të projektit u vunë re diferenca volume në zërin F V hekur betoni periodik 6-10 mmeshte, prandaj diferenca 0,667 do të ezaurohet brenda vlerës së fondit rezervë. Është vënë re që kishte diferencë volume për zërin që sip totale e ndërhyrjes së projektit nuk është e njëjtë me sip në preventive. Si rrjedhojë ndryshon dhe volumi i gërmimeve. Volumi i gërmimeve faktike është 423 m³, pra kemi 93 m³ më shumë se ai i parashikuar. Sipërfaqja totale e të dy shesheve është 846 m² kemi 0,5 m gërmim= 423 m³. Pra, për realizimin e kësaj barriere metalike nevojitet përdorimi z fondit rezervë me vlerën 1,070,052 lekë pa TVSH ose 1,284,062 lekë me TVSH, për të cilin është hartuar preventivi z fondit rezervë, procesverbali z përdorimit të fondit rezervë si dhe analiza e çmimit për zërin e ri në këtë preventiv.

3. Preventivi i fondit rezervë

Pasqyra 70: Preventivi i fondit rezervë

Emërtimi i punimeve	Vlera
Llustër çimento me kuarc trajtuar me helikopter zgare 15*15	966,000
F V hekur betony periodik 6-10mm	104,052
Total	1,070,052

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Preventivi i rishikuar i punimeve

Tabela krahasuese e volumeve që hiqen dhe shtohen

Pasqyra 71: Tabela krahasuese e volumeve që hiqen dhe shtohen

Emërtimi	Vlera sipas kontratës fillestare	Vlera sipas ndryshimeve	Diferenca (ndryshime-kontrata fillestare)
Punime gjurmimi	96,635	457,930	361,295
Punime B/A	461,000	1,441,600	980,600
Punime hekuri	4,869,000	5,395,000	526,000
Punime shtresash	299,455	293,150	-6,305
Punime hidroizolimi dhe çatie	2,916,560	2,435,080	-481,480
Punime Tavani dhe mure	2,206,500	3,184,130	977,630
Punime shtresash dhe patinime	2,004,460	1,922,610	-81,850
F.V dyer dritare	1,159,800	1,200,072	40,272
Rrjeti I kanalizimeve të zeza	213,525	213,525	0
Punime hidrosanitare	956,340	426,350	-529,990
Punime elektrike	6,219,170	5,450,588	-768,582
Pajisje	1,564,600	343,200	-1,221,400
Fond rezervë	1,070,052	1,070,052	0
Shuma totale pa TVSH	24,037,167	23,833,287	-203,810
TVSH	4,494,513	4,698,017.4	+203,518
Total	28,531,680	28,531,304	292

Burimi: Dosja e procedurës, DPD.

Referuar tabelës së mësipërme rezultojnë pasaktësi në përlogaritjet e kryera për efekt rishikimi të çmimit të preventivit të kontratës, të cilat nuk janë monitoruar nga ana e DPD në momentin e miratimit të ndryshimeve.

-Nga auditimi rezulton se janë pakësuar investimet e planifikuara për t'u kryer për pajisje; punime hidrosanitare; elektrike; hidroizolimi; patinime, me qëllim alokimin e këtyre fondeve në punime B/A, hekuri, Tavani dhe mure, gjurmime.

Këto ndryshime janë bërë sipas kërkesës së OE, dhe janë pranuar nga DPD. Nga auditimi konstatohet se për hartimin e preventivit të kontratës dhe termave të referencës nga ana e DPD është lidhur kontrata me operatorin ekonomik "N." SHPK në vlerën 500,630 lekë, me detyrime të OE; "Projekti të parashikojë ndërhyrjet të brendshme, të jashtme (për rimodelim të fasadës), sistemim të ambientit të jashtëm, si dhe dorëzimin e gjithë fletëve: 11.Hartimi i preventivit (dhe analizat e çmimeve)".

Referuar ecurisë së kontratës së rikonstruksionit ku ka lindur nevoja për rishikimin e termave me impakt reduktimin e çmimeve për pajisje, konstatohet se nga ana e DPD nuk ka patur një qëndrim për të gjykuar nëse kryerja e ndryshimeve ka ardhur si pasojë e parregullsive në hartimin e preventivit nga ana e operatorit të kontraktuar për hartimin e termave dhe marrjen e masave përkatëse; apo nëse ka patur parregullsi nga ana e OE përgjegjës për kontratën e ndërtimit, për të cilën nuk duhet të ishin miratuar ndryshimet përkatëse.

Nga auditimi konstatohet se në kundërshtim me përcaktimet e kontratës në nenin 22 "**Specifikimet dhe standartet-Kontraktori duhet të sigurojë që punimet, shërbimet e lidhura, apo materialet, pajisjet produktet që përdoren për realizimin e objektit të kontratës të jenë sipas specifikimeve teknike, projekteve, termave të referencës dhe detyrës së projektimit sipas kushteve në DST..... Çdo ndrysim në cilindro kod dhe standard gjatë ekzekutimit të kontratës do të zbatohet vetëm pas miratimit nga AK dhe do të trajtohet në përputhje me nenin 26 dhe 27 të kontratës. Kontraktori në rast se evidenton mospërputhje apo mangësi në projekt preventiv dhe kantier, brenda një afati të përcaktuar në kontratë, paraqet kërkesën për ndryshime/modifikime/përshtatje të zbatimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor administron kërkesat dhe sigurohet që këto kërkesa të**

shqyrtohen në strukturat përkatëse brenda afateve në kontratë.” dhe Neni 27 “Modifikimet e kontratës: Autoriteti/Enti kontraktori në çdo kohë mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës, në secilin nga elementët e mëposhtëm;

Korrigjime ne projektin, vizatimin apo specififikimet e punës

Korrigjime në material

Korrigjime në sasi

Asnjë modifikim i kontratës nuk do të bëhet pa miratimin e autoritetit, shoqëruar me një marrëveshje me shkrim dhe firmosur nga një përfaqësues i kontraktorit dhe AK” konstatohet se nuk është kryer rishikimi/amendimi i kontratës, por miratimi për kryerjen e ndryshimeve është kryer vetëm nëpërmjet firmosjes së dokumentit për përdorimin e fondit rezervë dhe kryerjen e ndryshimeve nëpërmjet zërave të preventivit.

Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i AK, znj. M.D.

Me urdhrin nr. 15909, prot datë 06.09.2022 të titullarit të AK është ngritur komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratës së punimeve me përbërje:

a. Z. R.J., Drejtorja e Burimeve Mbështetës

b. V.N., Dega e Doganës Kakavijë

c. A.L., Dega e Doganës Kakavijë

Në dosjen e vendosur në dispozicion rezulton se janë hartuar raportet e mëposhtme lidhur me realizimin e zbatimit të punimeve:

Relacioni mbi ecurinë e zbatimit të punimeve përcjellë me shkresën nr. 7.11.2022 , sipas së cilës është raportuar se ecuria e punimeve është e mire dhe është konfirmuar se punimet janë realizuar konform situacionit nr.1.

Ky relacion është përgatitur 2 muaj pas fillimit të punës, ku sipas grafikut të punimeve të kontratës duhet të ishin realizuar në masën 100% punimet sipas situacionit që i përkasin: gërmim, punim b/a, punim hekuri.

Sipas tabelës përmbledhëse të relacionit, faktikisht janë raportuar si të realizuara në masën 100% vetëm punimet B/A, ndërkohë që punimet e gërmimit janë raportuar të realizuara në masën 93.2%; punime hekuri në masën 73.5%. Gjithashtu, pavarësisht se sipas grafikut të punimeve janë planifikuar të kryhen në një periudhë të mëvonshme, në këtë relacion janë raportuar të realizuara punime edhe për zëra të tjera të kontratës, të tilla si punime shtresash. Hidroizolim çatie, shtresa dhe patinime, etj.

Këto parregullsi nuk rezultojnë të jenë raportuar nga ana e strukturave përgjegjëse të ngritura për monitorimin e kontratës duke filluar nga grupi i punës: a. z. R.J., V.N., A.L., dhe titullari i AK, znj. M.D për miratimin e situacionit të punimeve në të cilat janë raportuar punime për zërat e sipërcituar.

Relacioni mbi ecurinë e zbatimit të punimeve përcjellë me shkresën nr. 30.12.2022 , sipas së cilës është raportuar se ecuria e punimeve është e mire dhe është konfirmuar se punimet janë realizuar konform situacionit nr.2.

Ky relacion të jetë hartuar 1 javë para përfundimit të punimeve, në kushtet kur afati i ekzekutimit të kontratës sipas nenit 3 të saj është përcaktuar 4 muaj nga data e marrjes në dorëzim të kantierit, pra data 07.01.2023. Sipas këtij relacioni janë raportuar realizimi në masën 100% të të gjitha zërave të punimeve, me përjashtim të zërit të punimeve elektrike 96% dhe pajisje 0%.

Këto parregullsi nuk rezultojnë të jenë raportuar nga ana e strukturave përgjegjëse të ngritura për monitorimin e kontratës duke filluar nga grupi i punës: a. z. R.J., V.N., A.L., dhe titullari i AK, znj. M.D për miratimin e situacionit të punimeve në të cilat janë raportuar punime për zërat e sipërcituar.

2. Kontrata nr. 12394, prot datë 01.07.2022 me objekt “Blerje Kompjutera”

Në dispozicion të grupit të auditimit u vendos në dispozicion dosja për këtë kontratë, me dokumentacionin si më poshtë:

Procesverbali për marrjen në dorëzim të pajisjeve, sipas shkresës nr. 12394/3, prot date 15.07.2022, mbajtur nga përfaqësuesi ligjor i operatorit ekonomik “I.S.” SHPK, z. E.S., dhe komisioni i posaçëm i DPD, me përbërje anëtarët:

- R.T.
- SH.V.
- A.H.

Komisioni ka marë në dorëzim akt dorëzimin datë 14.07.2022, faturën elektronike, kompjuter desktop (75), laptop praktik (5); fletë hyrjen në magazinë; fletë garancia. Anëtarët e komisionit kanë përcaktuar në procesverbal se pajisjet janë në sasinë, llojshmërinë dhe vlerën sipas faturës elektronike nr. 1177/2022, datë 14.07.2022, furnizuar me datë 14.07.3033 si dhe në përputhje me specifikimet teknike.

Marrja në dorëzim është kryer brenda afatit të ekzekutimit në kontratë, përcaktuar sipas nenit 9 të saj, në 30 ditë.

Bashkëlidhur dosjes gjenden:

- Urdhër shpenzimi nr. 502, datë 27.07.2022 në vlerë 9,487,200 lekë;
- Fatura nr 1177/2022, datë 14.07.2022;
- Fletë hyrja nr. 35, datë 14.07.2022;
- Fletë garancia (36 muaj);
- Akt dorëzimi.

Kontrata e furnizimit nr. 12394, datë 1.7.2022 lidhur mes DPD në cilësinë e AK dhe OE “I.S.” SHPK si kontraktor, me objekt “Blerje kompjutera”, në vlerë totale 9,487,200 lekë me TVSH lidhur mes znj. M.D përfaqësues i DPD dhe E.S., përfaqësues i OE “I.S.” SHPK.

Shkresa nr. 7191, prot datë 20.05.2022 e DPD drejtuar AKSHI-t, sipas së cilës është dërguar lista e pajisjeve për tu prokuruar me fondin 15,000.000 lekë me TVSH për zërin “Pajisje kompjuterike, licenca, softë”, pra procedura e prokurimit është kryer nga AKSHI.

Urdhri i prokurimit i znj. M.K. në cilësinë e titullarit të AK, me nr. 3079/1, datë 08.06.2022 për fillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK” në DPD me 7 lote, nga të cilat loti 6 “Blerje kompjutera” me fond limit 9,065,380 lekë;

Formulari i njoftimit të fituesit me shkresën nr. 3585, datë 09.06.2022;

Autorizimi për lidhje kontrate nga AKSHI për DPD sipas shkresës nr. 3634, datë 13.06.2022;

Specifikimet per Desktop 2, dhe Laptop praktik.

Nga verifikimi i listës së mallrave të dakortësuar në kontratë për t’u furnizuar nga OE, me mallrat e faturuar dhe të bëra hyrje në magazinë, nuk rezultuan diferenca.

Nga auditimi konstatohet se komisioni për marrjen në dorëzim nuk ka dokumentuar procesin e verifikimit të pajisjeve në përputhje me specifikimet teknike, për të verifikuar çdo specifikë të kompjuterëve me ato të parashikuara në kontratë, referuar kapacitetit apo kritereve të tjera të përcaktuar në DST.

3. Kontrata nr. 11950/1, prot datë 24.06.2022 “Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik me vlerë 3,449,232 lekë me TVSH.”

-Neni 6 i kontratës ka përcaktuar se “kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e palëve dhe afati i ekzekutimit të saj është 90 ditë nga data e nënshkrimit”

-Nga auditimi konstatohet se referuar Nenit 7 të kontratës “Të drejtat dhe detyrimet e kontraktori” është cilësuar se furnizuesi do të furnizojë AK me mallra sipas (iii) grafikut të lëvrimit të parashikuar në specifikimet teknike dhe ofertën fituese. Këto dokumente dhe DST do i bashkëngjiten kontratës si aneks dhe janë pjesë e saj.”, grafiku nuk rezulton të jetë pjesë e DST apo kontratës, dhe si rezultat, marrja në dorëzim është kryer pjesë pjesë nga ana e OE fitues, pa paracaktuar një grafik për periudhën kohore që duhet të bëhej kjo shpërndarje.

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se sipas procesverbaleve për marrjen në dorëzim të mallrave dhe pajisjeve, rezulton se nga ana e komisionit nuk dokumentohen procedurat e kryera për verifikimin e përputhshmërisë së materialeve me kriteret në specifikime teknike, konkretisht për:

1. Të gjithë reagentët do të jenë të shkallës së pastërtisë GR.
2. Të deklarohen emrat e kompanive prodhuese (vendete të prodhimit).
3. Reagentet do të jenë sipas standardeve të BE.
4. Reagentët, dhe të gjitha materialet do të jenë sipas karakteristikave të kërkuara, për GC, HPLC, UV-VIS, FT-IR.
5. Enët e qelqit do të jenë Class A.
6. CRM të jenë të pajisura me çertifikatë kalibrimi nga prodhuesi dhe me afat skadence 1-2 vjet nga data e pranimit.
7. Çdo reagent kimik (kimikat) të ketë dokumentin shoqërues konform VKM 9 datë 09.01.2019.
8. Materialet kimike dhe pajisjet e kërkuara për aparaturat ekzistente të jenë dhe/ose ekuivalente por kompatibël me aparaturat.

Nga grupi i punës marrja në dorëzim është kryer duke verifikuar faturat e mallrave, të cilat paraqesin informacion për emërtimin e mallit, sasisë dhe çmimit, duke mos paraqitur një informacion lidhur me kërkesat më sipër.

Grupit i punës për marrjen në dorëzim sipas kontratës së nënshkruar është përcaktuar me përbërje:

- Znj. L.D.
- Z. D.SH.
- Znj. S.D.

sipas nenit 13 “ për AK përfaqësuesi do të ketë komisioni i posaçëm përbërë nga: D.SH., S.D., L.D. në përfundim do të hartohet raporti.. ”.

Formulari i njoftimit të fituesit me shkresën nr. 10576, prot date 31.05.2022;

Formulari i njoftimit të kontratës me shkresën nr. 7989/2, prot datë 28.04.2022;

Formulari i ofertës së K. SHPK;

Lista e çmimeve të artikujve;

Polica e sigurimit të kontratës;

Plani i zbatimit të kontratës me shkresë nr. 11950/2, prot datë 24.06.2022;

Urdhër prokurimi nr.9, datë 28.04.2022 me fond limit 4,103,150 lekë pa TVSH, si procedurë e hapur e thjeshtuar. Njësia e prokurimit përbërë nga: A.L , S.R, R.H.

Pasqyra 72: Urdhër shpenzimi të procedurës

Urdhër shpenzimi	Vlera
Urdhër shpenzimi nr. 497, datë 14.07.2022	476,772
Urdhër shpenzimi nr. 507, datë 28.07.2022	1,292,136
Urdhër shpenzimi nr. 636, datë 19.09.2022	905,688
Urdhër shpenzimi nr. 679 datë 27.09.2022	295,680
Urdhër shpenzimi nr. 702 datë 05.10.2022	472,057
Total	3,442,333

Burimi: Dosja e procedurës, DPD

Urdhër shpenzimi nr. 497, datë 14.07.2022

Procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesshëm (pjesa e parë) nr. 11950/4, prot datë 13.07.2022, në zbatim të kontratës së furnizimit me dokumentacione bashkëlidhur:

Procesverbali i dorëzimit tek Përpunuesja e Informacionit në Laboratorin Doganor

Fletë hyrja në magazinë nr. 13,13/1, datë 07.07.2022

Fatura tatimore nr. 1047/2022 datë 07.07.2022

Lista analitike e mallrave (me përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë)

Akt dorëzimi i mallit

Urdhër shpenzimi nr. 507, datë 28.07.2022

Procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesshëm (pjesa e dytë) nr. 11950/5, prot datë 27.07.2022, në zbatim të kontratës së furnizimit me dokumentacione bashkëlidhur:

Procesverbali i dorëzimit tek Përpunuesja e Informacionit në Laboratorin Doganor

Fletë hyrja në magazinë nr. 14, datë 25.07.2022

Fatura tatimore nr. 1120/2022 datë 25.07.2022

Lista analitike e mallrave (me përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë)

Akt dorëzimi i mallit

Urdhër shpenzimi nr. 636, datë 19.09.2022

Procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesshëm (pjesa e tretë) nr. 11950/6, prot datë 13.09.2022, në zbatim të kontratës së furnizimit me dokumentacione bashkëlidhur:

Procesverbali i dorëzimit tek Përpunuesja e Informacionit në Laboratorin Doganor

Fletë hyrja në magazinë nr. 16 dhe 16/1, datë 08.09.2022

Fatura tatimore nr. 1314/2022 datë 08.09.2022

Lista analitike e mallrave (me përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë)

Akt dorëzimi i mallit

Urdhër shpenzimi nr. 679 datë 27.09.2022

Procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesshëm (pjesa e katërt) nr. 11950/8, prot datë 23.09.2022, në zbatim të kontratës së furnizimit me dokumentacione bashkëlidhur:

Procesverbali i dorëzimit tek Përpunuesja e Informacionit në Laboratorin Doganor

Fletë hyrja në magazinë nr. 18, datë 20.09.2022

Fatura tatimore nr. 1387/2022 datë 20.09.2022

Lista analitike e mallrave (me përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë)

Akt dorëzimi i mallit

Urdhër shpenzimi nr. 702 datë 05.10.2022

Procesverbali i marrjes në dorëzim të pjesshëm (pjesa e pestë) nr. 11950/10, prot datë 27.09.2022, në zbatim të kontratës së furnizimit me dokumentacione bashkëlidhur:

Procesverbali i dorëzimit tek Përpunuesja e Informacionit në Laboratorin Doganor

Fletë hyrja në magazinë nr. 19, datë 23.09.2022

Fatura tatimore nr. 1421/2022 datë 23.09.2022

Lista analitike e mallrave (me përshkrimin e mallit, njësinë dhe sasinë)

Akt dorëzimi i mallit

Sipas relacionit përmbledhës për marrjen në dorëzim të mallit, me shkresën nr. 11950, prot datë 06.10.2022 është raportuar pranimi në laborator i mallrave objekt kontrate, ku kanë rezultuar 15 artikuj sipas faturës tatimore me kod 399, nr. 1421/2022 datë 23.09.2022 të dorëzuar jashtë afateve kohore të parashtruar në kontratë, për të cilat OE është penalizuar nga DPD, sipas urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm përcjellë me shkresën nr. 11950/1, prot darë 03.10.2022 , në zbatim të nenit 12 të kontratës “sanksionet”.

Nga verifikimi i listës së mallrave të dakortësuar në kontratë për t'u furnizuar nga OE, me mallrat e faturuar dhe të bëra hyrje në magazinë, nuk rezultuan diferenca.

Për sa më sipër është përcjellë Projektraporti pranë DPD, dhe për këtë çështje z.R.H, z.A.L dhe z.S.R me shkresën nr.11604/12, prot në DPD datë 06.09.2023 dhe nr. 283/31, prot në KLSH datë 07.09.2023, kanë bërë komente dhe shpjegime ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Lidhur me Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit Publik, sqarojme se, në zbatim të udhëzimit nr.4, datë 18.06.2021 të APP “Për Hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik”, Kreu I, pika 4, shkresa nr.2595 prot, datë 11.02.2022 ka të bëjë me dergimin e regjistrit pranë thesarit, ndërkohë theksojmë se regjistri është krijuar që më datë 19.01.2022 e duke vijuar me tej në vazhdim të viti ushtrimor.Bashkalidhur do gjeni faqen e printuar nga SPE të APP ku evidentohet data e krijimit të regjistrit.

Gjithashtu, autoriteti ynë Kontraktor konkretisht Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pranë D.P.D., e ka të dokumentuar të gjithë procesin e shqyrtimit të kërkesave të DPD dhe degëve doganore nisur që në muajin Gusht të vitit 2021 dhe të finalizuar përmes shkresave nr.1014 prot date 19.01.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Detajimi i planit të shpenzimeve operative të vitit 2022, i ndryshuar me shkresën nr.2550/2 prot datë 24.02.2022, shkresën nr.20334 prot datë 18.11.2022 dhe shkresën nr.22922/210 prot datë 11.02.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Detajimi i planit të shpenzimeve kapitale të vitit 2022”, dërguar me shkresë nr. 22922/223 (3110) prot, date 15.02.2022(17.12.2022), përcjelle me shkresë nr.3110/1 prot, date 23.02.2022 të DPD. Dosja me të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojave të D.P.D., ju është vënë në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës sqaruar për këtë znj.XH.XH në takimin verbal me znj.M.D. dhe z.S.R. Njësia e Prokurimit me vënien në dijeni të shkresave nr.1014 prot date 19.01.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave “Detajimi i planit të shpenzimeve operative të vitit 2022”, i ndryshuar me shkresën nr.2550/2 prot datë 24.02.2022, shkresën nr.20334 prot datë 18.11.2022 dhe shkresën nr.22922/210 prot datë 11.02.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Detajimi i planit të shpenzimeve kapitale të vitit 2022”, dërguar me shkresë nr. 22922/223 (3110) prot, date 15.02.2022(17.12.2022), përcjelle me shkresë nr.3110/1 prot, date 23.02.2022 të DPD, ka nisur hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik, ku shkresat e lartpërmendura janë bërë pjesë e dosjes së regjistrit, të cilat ju janë vënë në dispozicion gjatë auditimit bashkëlidhur regjistrin të printuar nga SPE e APP. Në dosjen Regjistrin të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik , dorëzuar pranë jush për auditim bashkëlidhur regjistrin ndodhen të gjitha shkresat e nevojave për cdo zë të krijuar për gjithë vitin 2022 , të evidentuar me cdo procesverbal përkatës. Në Aktkonstatim, lidhur me Regjistrin e Realizimit të Prokurimit Publik, nga ana juaj është konstatuar se: “...Për sa i përket Regjistrin të Realizimit të Prokurimit Publik, përcjellë me shkresë nr.196, prot, date 06.01.2022(data e protokollit nuk është e sakte pasi ky regjistër duhet të ishte përcjellë për gjatë vitit 2023...”. Lidhur me këtë konstatim sqarojmë se, ky regjistër është përcjellë në vitin 2023 pasi data e vendosur 2022 është një lapsus gjatë protokollimit. Procedura e prokurimit publik me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerimi i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë” .Sqarojmë se, në kthimin e përgjigjes OE është nga Autoriteti kontraktor është cituar UKM nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra Udhëzim i Këshillit të Ministrave dhe jo Vendim. Në këtë udhëzim përcaktohet qartë struktura e kostos së punimeve të ndërtimit përfshirë dhe pajisjet etj, pra operatori është orientuar qartë mbi kërkesën që i është bërë Autoritetit Kontraktor. Bashkëlidhur do gjeni udhëzimin e sipercituar dhe kopje të printuar nga SPE të korenspondenës me OE. Sqarojme se, Nenin 26 të këtyre kushteve i referohet Shtojcës 16 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK) të Dokumenteve Standarde të Tenderit të shkarkuara nga SPE “mbi modifikimin e Kontratës”, ndërsa në kontratën Nr.15753 Prot., datë 02.09.2022 citohet Neni 127 i dispozitave të LPP-së dhe jo neni 27 i cituar në akt konstatim, sqarojmë se neni 127 i ligjit të prokurimit i referohet “modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre”. Theksojmë se evidentimi i mospërputhjeve nga ana e OE janë parashikuar në nenet 26, 28 dhe 29 të kontratës. Konkretisht në nenin 28 të kontratës Nr.15753 Prot., datë 02.09.2022. Për sa më lartë neni 22 i kontratës nuk ka të bëjë me evidentimin e mospërputhjeve nga ana e OE dhe për afatet lidhur me vendimmarrjen që do të vijojë pas konstatimit të tyre por me rastet e

modifikimit të kontaktës. Në Akt konstatimin Nr.7, , nga ana juaj gabimisht është cituar si anëtar i Komisionit të Ofertave z.R.H, i cili është anëtar i Njësisë së Prokurimit.Në faqen 8 të aktkonstatimit keni listuar vetë ju keni listuar emrat e anëtarëve të KVO dhe Njësisë së Prokurimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: *Observacioni i paraqitur rezulton i njëjtë me atë të përcjellë pas dorëzimit të Akt Konstatimeve dhe nuk paraqet argumente të reja nga sa trajtuar në Projektraport.*

Për sa më sipër është është përcjellë Projektraporti pranë DPD, dhe për këtë çështje me shkresën nr.11604/3, prot në DPD datë 15.08.2023 dhe nr. 283/26, prot në KLSH datë 01.09.2023, nga z. R.SH, znj. L.Z, z. A.L, në cilësinë e KVO të një procedure prokurimi, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë” për sa i përket konstatimit për mos evidentimin e sasive të mjeteve për realizimin, sqarojmë se në shtojcën 08 të vetëdeklarimit OE ka deklaruar se disponon pajisjet dhe sasi të, pa i detajuar ato në sasi dhe kjo nuk përbën arsye për skualifikimin e tij. Për sa i përket vlerësimit të KVO për profesionet e punonjësve pas shpalljes së fituesit, sqarojmë se KVO nuk është mjaftuar vetëm me list pagesat E-sig, por është bazuar edhe në kontratat e punës mes OE dhe punonjësit, CV e tyre dhe dokumentet e ISHTI-t që provojnë profesionet e kërkuara në kriteret kualifikuese.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për sa i përket mos plotësimit të sasive të mjetit në kushtet kur është plotësuar vetë deklarimi për disponimin e tyre, sqarojmë se në kushtet për çështje të tjera të ofertës ekonomike është plotësuar numri nga OE, e njëjta formë vlerësimi duhet të ishte ndjekur për të gjitha çështjet, për më tepër që në këtë rast OE ka listuar numrat e referencës së pajisjeve, gjithmonë vetëm 1 rast për secilin zë. Lidhur me analizat e profesioneve të punonjësve, sqarojmë se në specifikimet teknike është përcaktuar qartazi në kriterin 2.3.4. se “ Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar.. dhe “Secili specialistë i sipërcituar sipas profesioneve, duhet të figurojë në listë pagesat e shoqërisë për të paktën periudhën Shkurt-Mars 2022”. Si rezultat nuk paraqiten fakte të reja nga sa trajtuar në material.*

Për sa më sipër është përcjellë Projektraporti pranë DPD, dhe për këtë çështje me shkresën nr.14213, prot në DPD datë 01.09.2023 dhe nr. 283/27, prot në KLSH datë 04.09.2023, nga z.R.T., z.S.A., si dhe me shkresën nr.14202, prot në DPD datë 01.09.2023 dhe nr. 283/28, prot në KLSH datë 04.09.2023, nga z. R.J. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë” për sa i përket pikës 2.3.3, email-it tuaj “ju lutem një informacion.” pikës 2.3.5 “ju lutem një konfirmim.”, dhe pikës 2.4.1 “ju lutem një informacion për përzgjedhjen e këtyre certifikatave..”, argumentimi: AK ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik që kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Në lidhje me zbatimin e kontratave, për kontratën nr.15753, datë 02.09.2022 “ Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë” objekti është i përbërë nga 6 struktura të veçanta të cilat nuk lidhen fizikisht me njëra tjetrën dhe i përbërë nga 2 objekte dhe 4 struktura metalike të shkëputura nga njëra tjetra me funksion vend qëndrimi autobuzësh dhe për rrjedhojë sjell dhe një segmentizim të punimeve të cilat kanë rezultuar dhe të konfirmuara nga supervizori gjatë zbatimit të punimeve. Lidhur me konstatimin se këto parregullsi nuk janë raportuar nga ana e strukturave përgjegjëse për monitorimin e kontratës, sqarojmë se me shkresën nr.16689, prot në DPD datë 20.09.2022 është përcjellë nga mbikqyrësi i punimeve shkresa për njoftimin e fillimit të punimeve në datën 07.09.2022 me afat 4 muaj nga fillimi i punimeve ku bashkëlidhur gjendet dhe akt dorëzimi i sheshit të ndërtimit, ndërkohë situacioni dhe relacioni janë me nr.15870/3, prot datë 07.11.2022 kërkojmë mirëkuptimin tuaj sepse rezulton një gabim njerëzor i pa vërë re nga ana jonë dhe e supervizorit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për sa i përket observacionit lidhur me pikën 2.3.3, 2.3.5 dhe 2.4.1, çështjet e trajtuara nuk lidhen me materialin e paraqitur në projektraport, por me përgjigjet e nje email-i të dërguar nga grupi i auditimit përgjatë fazës së auditimit në terren, për të cilin nuk pati përgjigje nga ana e subjektit të audituar, dhe për sa më sipër observacionet nuk merren në konsideratë. Për sa i përket observacioneve*

lidhur me specifikat e ndërtimit sqarojmë se nuk janë sjellë argumente të tjera nga sa trajtuar në projektraport. Lidhur me konstatimin për problematikën e raportit të monitorimit sqarojmë se gjetja e grupit të auditimit nuk lidhet me gabimin njerëzor të pretenduar.

- 1. Titulli gjetjes:** **Mangësi të konstatuara në hartimin e regjistrit të parashikimeve të DPD.**
Nga auditimi konstatohet se regjistri i parashikimit të prokurimeve është hartuar në tejkallim të afatit të parashikuar në Kreun I , pika 3 të Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik”. Gjithashtu, për hartimin e regjistrit të prokurimeve nuk është dokumentuar shqyrtimi i kërkesave të DPD dhe degëve doganore me qëllim përcaktimin e kritereve të vendimmarrjeve referuar prioriteteve, apo faktorëve të tjerë, për të garantuar planifikimin eficient të fondeve që do të prokurohen, duke reflektuar drejt nevojat si dhe vlerën e kohës për plotësimin e tyre, sikundër përcakton udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 dhe VKM-ja nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”.
- Situata:**
- Sipas sistemit elektronik të prokurimeve publike, rezulton se ky regjistër është rishikuar përgjatë vitit ku konstatohet mungesa e korrespondencave që justifikojnë çdo rishikim të kryer, dokumentuar me shkresat e kërkesave të nevojave për kryerjen e prokurimeve që nuk kanë patur mundësi të planifikohen në fillim të vitit. Nga krahasimi i regjistrit fillestar të hartuar të parashikimeve të prokurimeve publike, me atë të rishikuar deri në fund të vitit, u konstatuan diferenca të konsiderueshme, ku konkretisht fillimisht janë planifikuar vetëm 10 procedura në vlerën totale prej 34,844,590 lekë, dhe deri në fund të vitit 2022 rezultojnë të jenë planifikuar 55 procedura me vlerën totale prej 167,032,266 lekë, situatë kjo që nxjerr në pah mangësitë e procesit të planifikimit.
- Kriteri :**
Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik”, Kreu I, pika 3, 4; VKM- nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik.
- Ndikimi/Efekti:**
Risk i shtuar për planifikimin dhe realizimin sa më efektiv të fondeve buxhetore në përputhje me kërkesat e institucionit.
- Shkaku:**
Mos hartimi i regjistrit të parashikimeve duke dokumentuar procesin dhe prioritarizuar kërkesat e institucionit; kryerja e rishikimeve të shpeshta të planit të procedurave të prokurimit duke mos u kufizuar vetëm në ndryshimin e këtij regjistri për nevoja emergjente.
- Rëndësia:**
E mesme
- Rekomandimi:**
Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marin masat për të garantuar hartimin në kohë të një regjistri planifikimi të prokurimeve publike duke prioritarizuar nevojat e institucionit, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta apo diferencave të konsiderueshme në vlerë dhe numër kontratash në regjistrin fillestar dhe atë të rishikuar, për të garantuar përdorimin efektiv të fondeve buxhetore disponibël për institucionin.

- 2. Titulli gjetjes:** **Mangësi të konstatuara në planifikimin, argumentimin e specifikimeve teknike, në vlerësimin e kryer nga anëtarët e KVO në procedurën e prokurimit, zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë”.**

Nga auditimi konstatohet se, me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 është përcjellë nga shoqëria “N.G.” SHPK projekt zbatimi me objekt “*Studim e projektim të Rikonstruksionit dhe zgjerimit të terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kakavijë*”, në zbatim të kontratës së lidhur me të nga

DPD nr. 23401, datë 14.12.2021, në të cilin hartimi i preventivit (analiza e çmimeve) ka përcaktuar fondin limit në vlerë 31,396 mijë lekë. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Financës pranë DPD, konstatohet se fondet disponibël për këtë projekt investimi “18CC804- Godina të ndërtuara dhe ri konstruara” Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë”, janë çelur në vlerën 77,000 mijë lekë, pra më shumë se dyfishi i fondit limit të përlogaritur për kryerjen e prokurimit, përcjellë me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 nga OE i kontraktuar. Si rezultat, diferencave e fondeve prej 45,605 mijë lekë, ka mbetur e papërdorura nga DPD dhe e pa shpërndarë në projekte të tjera, deri në Shtator të vitit 2022, duke përbërë kështu risk të shtuar për krijimin e efekteve financiare negative për përdorimin pa efektivitet, efieciencë dhe ekonomicitet të fondeve publike në kushtet kur për periudhën 9 mujore këto fonde mund të ishin përdorur në një tjetër destinacion për projekte prioritare të DPD në të njëjtin program, apo edhe programeve të tjera me miratimin e strukturave përkatëse pranë MFE.

-Përgjatë zbatimit të kontratës të lidhur me operatorin ekonomik “I.” SHPK me objekt “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë” janë konstatuar pamjaftueshmëri fondesh në zërat e miratuar sipas preventivit të kontratës, për të cilat është alokuar fondi rezervë dhe janë kryer rishikime sipas zërave të miratuar pa u shoqëruar me një marrëveshje me shkrim për modifikimin e kontratës, pasi miratimi për kryerjen e ndryshimeve është bazuar vetëm në firmosjen nga të dyja palët të kërkesës për përdorimin e fondit rezervë dhe kryerjen e ndryshimeve nëpërmjet zërave të preventivit. Në dosje nuk disponohej relacioni teknik mbi nevojën e ndryshimit të volumeve të punimeve, pasqyra e ndryshimit të volumeve të punimeve të rehabilitimit, apo tabela që përshkruan punime që hiqen e shtohen, për të cilat nga ana e grupit të auditimit janë konstatuar pasaktësi në përlogaritjet e kryera për efekt rishikimi të çmimit të preventivit të kontratës, të cilat nuk janë monitoruar nga ana e DPD në momentin e miratimit të ndryshimeve. Ndryshimet në preventivin e kontratës kanë sjellë pakësim të investimeve për të cilat OE ka marrë angazhimin për t’u kryer në zërat për pajisje, punime hidrosanitare, elektrike, hidroizolimi, patinime, pasi këto fonde janë alokuar në punime B/A, hekuri, tavani dhe mure, gërmime, të cilat duhet të ishin përfunduar në fillim të kontratës. Nga auditimi konstatohet se referuar ecurisë së kontratës së rikonstruksionit pas evidentimit të nevojës për rishikimin e termave me impakt reduktimin e çmimeve për pajisje, nga ana e DPD nuk ka patur një qëndrim për të gjykuar nëse kryerja e ndryshimeve ka ardhur si pasojë e parregullsi në hartimin e preventivit nga ana e operatorit të kontraktuar për hartimin e termave dhe marrjen e masave përkatëse; apo nëse ka patur parregullsi nga ana e OE përgjegjës për kontratën e ndërtimit, për të cilën nuk duhet të ishin miratuar ndryshimet përkatëse. Gjithashtu, përgjatë zbatimit të kontratës u konstatuan vonesa në realizim krahasuar me grafikun e punimeve, problematika të cilat nuk janë identifikuar nga grupi i ngritur për monitorimin e zbatimit të kontratës.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë”, u konstatuan mangësi në argumentimin e specifikimeve teknike, situatë kjo që përbën një risk të shtuar për ndikimin në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik e konkretisht nuk janë në përputhje Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, por që nuk kanë impaktuar vlerën e prokuruar pasi operatori fitues ka qenë oferta më e ulët. Konkretisht problematikat

Situata :

e konstatuara lidhen me mos argumentimin e kriterit për të figuruar si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues punonjësit sipas profesioneve (arkitekt, inxhinier, etj); kriteret për angazhimin e punonjësve sipas profesioneve dhe numri i fuqisë punëtore; dhe kriteri për nevojën e pajisjes me certifikatat e cilësisë së punimeve, përlllogaritja e orëve të punës, mjeteve të kërkuara dhe argumentimi i stafit të kërkuar. Gjithashtu KVO, pas shpalljes së fituesit, nuk ka verifikuar formularët e listëpagesave të shoqërisë për të evidentuar përputhshmërinë e punonjësve sipas kriterëve, duke u mjaftuar me kontratat e punës të dorëzuara pranë AK.

Kriteri :

Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 1, në të cilin citohet se;

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

nenin 3, parimet e përgjithshme në të cilat citohet se;

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Kreu V, neni 21, Autoriteti ose enti kontraktor, pikat 1 dhe 5 ku përcaktohet se;

Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mos diskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, në kuptim të këtij ligji, është personi përgjegjës për menaxhimin e fondeve publike.

LPP nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 36, pika 4 në të cilën citohet se; *Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu X, neni 40, pika 3 e cila citon se; *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.* neni 78, pika 2, paragrafi dytë i cili citon se;... *Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.* Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar për ndikimin në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen Kualifikimi i OE, të cilët nuk përmbushin të gjitha kriteret e cilësuar në DST, mund të jetë shkak për mos përmbushje të kushteve të kontratës dhe realizimin e saj në kohë e cilësi, Risk të shtuar për krijimin e efekteve financiare negative për përdorimin pa efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike; Miratimi i fondit limit në një vlerë më të ulët se nevoja reale për fonde për këtë projekt, Vonesa në realizimin e kontratës, mos realizim i disa prej zërave në masën e dakortësuar në preventivin fillestar.

Shkaku: Mangësi në argumentimin e specifikimeve teknike nga ana e strukturës përkatëse, Mangësi në vendimmarrjen e përfaqësuesve të DPD për vlerësimin e ofertës dhe nënshkrimin e kontratës, Mangësi në zbatimin e kontratës, mos identifikimi/raportimi i mangësive.

Rëndësia: E mesme
- Titullari i DPD të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, për kryerjen e verifikimeve të nevojshme të fondeve të miratuara për këtë procedurë, duke filluar nga detajimi i fondit limit për projektin e investimit dhe përcaktimin e shkaqeve që kanë çuar në planifikimin e kontratës në nivele tepër të ulta krahasuar me fondet buxhetore disponibël të alokuara për këtë projekt, si dhe më pak se nevojat reale që kanë rezultuar përgjatë zbatimit të kontratës shoqëruar me ndryshime, duke marrë masat sipas përgjegjësive të identifikuar si nga ana e strukturave përgjegjëse të DPD ashtu edhe ndaj OE të kontraktuar për shërbimet përkatëse. Gjithashtu, grupi i punës të vlerësojë parregullsitë e konstatuara përgjatë zbatimit të kontratës, duke analizuar edhe impaktin që ka patur kryerja e ndryshimeve në preventivin e punimeve duke reduktuar fondet sipas disa zërave për shkak të pasaktësive në përlllogaritjen e fondeve, me qëllim ndërmarrjen e masave ndaj strukturave përgjegjëse për problematikat e shkaktuara.

Rekomandimi: - Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat për hartimin me cilësi të lartë të specifikimeve teknike duke argumentuar për çdo rast kriteret e vendosura të shoqëruara me analizat dhe vlerësimet përkatëse që justifikojnë vendimmarrjen, për të garantuar ekzistencën e konkurrencës së lirë pa kufizuar pjesëmarrjen dhe dokumentimin e procesit për verifikimin e përmbushjes së plotë të kriterëve të cilësuar gjatë fazës së prokurimit të procedurës, për të garantuar se operatori i garantuar do të arrijë të përmbushë kushteve të kontratës dhe realizimin e saj në kohë e cilësi.

3. Titulli gjetjes: Mangësi të konstatuara në argumentimin e specifikimeve teknike dhe marrjes në dorëzim në procedurat e prokurimit të DPD.

Certifikata e Akreditimit e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për Laboratorin Doganor pranë DPD ka qenë e vlefshme për periudhën 4 vjeçare Tetor 2018 -Tetor 2022. Nga auditimi konstatohet se deri në përfundim të vitit 2022 laboratorin doganor nuk e ka mbartur më statusin laborator i akredituar, për shkak të mos përfundimit të procesit të mirëmbajtjes dhe kalibrimit të pajisjeve të laboratorit, impaktuar nga vonesat në procedurat respektive të prokurimit, të cilat nuk kanë mundur të kontraktjnë në kohë operatorin ekonomik për ofrimin e këtij shërbimi. Ky proces, së bashku me aplikimin për rinovimin e certifikatës dhe ri konfirmimin e akreditimit për periudhën e ardhshme 4 vjeçare, planifikohet të përfundojë brenda vitit 2023. Si rezultat, kjo situatë mbart riskun që analizat e kryera nga laboratorin doganor, për periudhën që ai ka vijon i pa akredituar, të jenë të kontestueshme për periudhat e tjera në vijim.

Situata

- Nga auditimi konstatohet se fondet disponibël të akorduara për DPD prej rreth 4 milion lekë, nuk mbulojnë nevojat për shpenzime të Laboratorit Doganor (materiale dhe pajisje laboratorike), pasi ato rezultojnë mbi 6 herë më shumë se fondi limit i procedurës së prokurimit publik.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë procedurës së prokurimit me objekt "*Blerje materiale dhe pajisje laboratorike te shërbimit publik dhe reagent kimik* " nuk dokumentohet vlerësimi i kryer nga anëtarët e KVO për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara duke marrë të mirëqenë se do të verifikohen gjatë zbatimit të kontratës nga grupi i pranimit. Nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të kësaj kontrate, si dhe kontratës me objekt "*Blerje Kompjutera*", u konstatua se komisioni për marrjen në dorëzim nuk ka dokumentuar procesin e verifikimit të pajisjeve në përputhje me specifikimet teknike, për të verifikuar çdo specifikë me ato të parashikuara në kontratë, referuar kapacitetit apo kriterëve të tjera të përcaktuar në DST, por është kufizuar me verifikimin e faturave të mallrave me emërtimin e mallit, sasisë dhe çmimit. Gjithashtu, marrja në dorëzim nuk ka paracaktuar një grafik për periudhën kohore që duhet të bëhej kjo shpërndarje nga OE si pjesë e DST apo kontratës.

Kriteri:

Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik.

Kontrata "*Blerje materiale dhe pajisje laboratorike te shërbimit publik dhe reagent kimik* " nënshkruar datë 24.06.2022.

Ndikimi/Efekti:

Risk i shtuar për garantimin e përputhshmërisë së materialeve të dorëzuara nga OE me ato në kontratë, cenim i vijueshmërisë së punës së laboratorit doganor

Shkaku:

Mangësi në dokumentimin e procedurës së verifikimit të rregullshmërisë në dorëzimin e mallrave, mos plotësim i nevojave të laboratorit doganor për materiale dhe mjete pune për kryerjen e shërbimeve.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

- Titullari i DPD të marrë masat për vlerësimin e problematikës së mësipërme, për të identifikuar strukturat përgjegjëse që nuk kanë arritur të garantojnë në kohë vijueshmërinë e procesit të certifikimit dhe efektet që kjo situatë ka shkaktuar, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procesit të akreditimit të Laboratorit Doganor.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik pranë DPD në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për vlerësimin e nevojave të laboratorit doganor, për të garantuar mbulimin me fonde të mjaftueshme për të realizuar furnizimin me materialet dhe pajisjet për vijueshmërinë normale të punës.

- Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat që për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të dokumentohet rast pas rasti kontrolli i kryer nga grupi i

punës për përputhshmërinë e materialeve/mjeteve/pajisjeve të dorëzuara me kriteret në kontratë, duke mos u mjaftuar vetëm tek emërtimi i produkteve dhe sasisë së tyre.

2.8. b . Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore në përputhje me legjislacionin në fuqi

Në zbatim të ligjit nr.102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM -së nr.921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, dhe VKM-së nr 2, datë 08.01.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar, është miratuar organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me 1102 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor, nga të cilët **464 punonjës janë të Drejtorisë së Përgjithshme e Doganave dhe 638 punonjës të Degëve Doganore, sipas** strukturës së mëposhtme:

Pasqyra 73: Struktura e DPD sipas pozicioneve të punës

Nr	Emërtimi	Grupi	Nr. punonjësish
1	Drejtor i Përgjithshëm	II A	1
2	Drejtor Kabineti	A	1
3	N/Drejt i Përgjithshëm	II B	4
4	SECI	A	1
5	Këshilltare	A	4
6	Drejtor Drejtorie	A	21
7	Kryetar Dogane	A	7
8	Kryetar Dogane	B	10
9	Përgjegjës Sektori	B	49
10	Përgjegjës i Administratës dhe Shërbimit	B	16
11	Specialist	C1	242
12	Specialist	C1	5
13	Oficer i OPGj	C1	7
14	Përgjegjës Operacional/Tumi	C1	81
15	Auditues	C1	7
16	Koordinator per Skanimet	C1	5
17	Komandant	C1	22
18	Doganier kategoria	C2	384
19	Specialist	GFI	5
20	Inspektor Antikontrabande,	C2	49
21	Asistent Laborant	C2	6
22	Sekretar/Përpunues Informacioni/Arkivist	C3	34
23	Doganier Peshore/ Pike Kontrolli	C3	119
24	Magaznier/Teknik Mirëmbajtje/Shofer	D1	17
25	Punëtor mirëmbajtje	D2	0
26	Sanitar/Punonjës Pastrimi	D3	5
	Shuma		1102

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022, me urdhrin nr.10998 prot., datë 17.06.2021, “Për ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e projektvendimit “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 921. datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për personelin e administratës doganore“, të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur grupi i punës për hartimin e relacionit shpjegues, organigramës dhe përshkrimet e punës së pozicioneve brenda një muaji, me përbërje:

- Znj. A.T., Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- N.C., Këshilltar
- I.B., Drejtor i Drejtorisë Juridike
- P.M., Këshilltar
- S.R., Shef Sektori i Degës së Doganës Tiranë

Grupi i punës ka hartuar relacionin në bazë të propozimeve të bëra nga strukturat gjithëpërfshirëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në vijim të propozimit, struktura organike dhe analitike

e Drejtorisë së Përgjithshme ka pësuar ndryshime, finalizuar me VKM-në nr. 355 datë 26.05.2022, e cila në pikën III të saj ka përcaktuar se: “*Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave marrin të gjitha masat dhe kryejnë të gjitha procedurat për plotësimin e vendeve të punës sipas përcaktimeve të këtij vendimi*”, dhe në pikën IV: “*Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare*”. Botimi në Fletoren Zyrtare është kryer sipas fletores zyrtare nr. 82, datë, 31.05.2022. Deri në fund të vitit 2022 efektet e kësaj VKM-je nuk janë zbatuar, për shkak të vonesave në vendimmarrjen e komisionit të ristrukturimit, ku referuar përcaktimeve të VKM-së së sipërcituar, përgjegjësia mbetet nën vendimmarrjen e strukturave përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, trajtuar në vijim, duke sjelle per pasojë shkelje te disiplinës financiare.

Në zbatim të VKM-së nr. 355 datë 26.05.2022, organika e DPD është miratuar të funksionojë me **1074 punonjës** të shpërndarë në nivel qendor dhe vendor, **pra 28 punonjës më pak se** VKM nr.2, datë 08.01.2018. Ndryshimet në strukturë mes dy VKM paraqiten krahasimisht sipas dy organigramave paraqiten në aneksin më poshtë.

Me shkresën nr, 10520/1, prot datë 31.05.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD është përcjellë vendimi nr.355, datë 26.05.2022 pranë DPD dhe degëve doganore, me qëllim njohën me vendimin, njoftimin e punonjësve në varësi si dhe fillimin e procesit të ristrukturimit. Në vijim të saj në datën 06.6.2022 është njoftuar DAP për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, me përfaqësues të DPD znj. M.D, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil të institucionit, me funksion Zv. Drejtoreshë e Përgjithshme. Drejtori i DAP më pas ka përcjellë urdhrin nr.298, datë 09.06.2022 për krijimin e këtij komisioni me përbërje:

-Znj. O.M., specialiste pranë DAP

-Z. A.GJ., Sekretar i Përgjithshëm pranë MFE

-Znj. M.D., zv. Drejtor i Përgjithshëm i DPD

Ky urdhër është rishikuar më pas me urdhrin e datës 25.01.2023, për ndryshimin e anëtarit të MFE, duke vendosur anëtar të komisionit znj. M.DH. dhe më pas me urdhrin e datës 24.03.2023 për vendosjen e znj. R.XH..

Komisioni i ristrukturimit për punonjësit jashtë shërbimit civil

Me urdhrin nr. 11013, prot datë 08.06.2022 “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit për punonjësit jashtë shërbimit civil” është krijuar komisioni nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD, me përbërje:

-z. E.H.

-znj. M.D.

-z. I.B.

Komisioni ka hartuar një relacion pranë Drejtorit të Përgjithshëm në datën 29.06.2022, duke trajtuar ndryshimet në strukturën e DPD dhe degëve doganore trajtuar në numër total punonjësish, në konkluzion të së cilës është përcaktuar se për punonjësit vendet/pozicionet e punës së të cilëve janë suprimuar e kur marrëdhëniet e punës rregullohen nga kontratat e punës, nëse nuk gjendet një vend tjetër pune për të cilën plotësohen kriteret, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të fillojë procedurat të parashikuara nga Kodi i Punës në zbatim të neneve 141, 143 dhe 144. Në vijim të relacionit, me vendimet e datës 30.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave janë

miratuar zgjidhjet e kontratave të punës për shkak të ristrukturimit, ku për pasojë është pakësuar numri i punonjësve dhe është suprimuar pozicioni i punës respektiv për 15 raste.

Komisioni i Ristrukturimit për punonjësit me status të nëpunësve civil

Fillimisht, Komisioni i Ristrukturimit është mbledhur në datën 13.06.2022 për të shqyrtuar dhe analizuar strukturën ekzistuese dhe atë të re të DPD duke marrë nën shqyrtim dosjet e punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe përshkrimet e reja të punës sipas pozicioneve. Për shkak të ndryshimeve të mëdha dhe numrit të konsiderueshëm të dosjeve të punonjësve, dhe mos finalizimit të dosjeve të përshkrimeve të punës, takimi i rradhës është vendosur në datën 13.07.2022.

Me vendimin e datës 13.07.2022, komisioni ka evidentuar se preken 474 nëpunës nga ristrukturimi dhe 144 përshkrime të reja pune, ku ka vendosur të zgjasë një herë të vetme afatin e kësaj procedure, pa përcaktuar një datë në vendimin përkatës. Nga auditimi rezulton se afati është shtyrë edhe 2 herë të tjera, sipas mbledhjeve më poshtë:

-Me procesverbalin e datës 08.09.2022, komisioni ka evidentuar se sërish nuk mund të konkludonte me vendim, dhe u planifikua mbledhja e rradhës në 19.10.2022.

-Me procesverbalin e datës 19.10.2022, komisioni ka evidentuar se sërish nuk mund të konkludonte me vendim, dhe është planifikuar mbledhja e rradhës në 07.12.2022.

Komisioni ka konkluduar më pas në vendimet si më poshtë:

1. Në vijim të procesverbalit të datës 7.12.2022 të anëtarëve të komisionëve të ristrukturimit dhe vendimit nr. 21290, datë 07.12.2022 të lidhur me të, është finalizuar me shkresën nr. 6653/2, datë 09.12.2022 të Drejtorit të DAP, vendimi për transferimin e përhershëm të 214 nëpunësve³ në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Në vijim të procesverbalit të datës 20.12.2022 të anëtarëve të komisionëve të ristrukturimit dhe vendimin nr. 22102/1 datë 20.12.2022 të lidhur me të, është finalizuar me shkresën nr. 6842/2, datë 23.12.2022 të Drejtorit të DAP vendimi për transferimin e përhershëm të 94 nëpunësve⁴ në Degën e Doganës Durrës, në kuadër të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet e VKM-së nr. 355 datë 26.05.2022 ende nuk janë reflektuar në Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të DPD, e cila deri në fund të auditimit në terren rezulton në proces hartimi.

Mbi vakancat dhe punësimet

Informacioni lidhur me vakancat dhe punësimet nga fillimi i vitit 2022, ndryshimet përgjatë vitit dhe situata në fund të 2022, paraqitet si më poshtë:

Aneksi 74: Informacioni lidhur me vakancat dhe punësimet

DPD/Degët	Statusi	Nr i planifikuar i punonjësve sipas strukturës	Numri faktik i punonjësve Janar/2022	Vakanca Janar 2022	Numri faktik i punonjësve Dhjetor 2022	Vakanca Dhjetor 2022
DPD	VKM	2	1	1	2	0
	Status nc	305	274	31	269	36
	Kod Pune	157	153	4	156	1
	Totali	464	428	36	427	37
Dega Doganore Shkodër	Status nc	39	33	6	32	7
	Kod Pune	10	10	0	10	0
	Totali	49	43	6	42	7
	Status nc	12	11	1	12	

³ Vendimi fillestar përfshinte 215 punonjës, por njëri prej tyre është larguar me kërkesë të tij dhe për këtë arsye nuk ka vijuar vendimi për transferimin e tij.

⁴ Vendimi fillestar përfshinte 215 punonjës, por njëri prej tyre është larguar me kërkesë të tij dhe për këtë arsye nuk ka vijuar vendimi për transferimin e tij.

Dega Doganore Lezhë	Kod Pune	3	3		3	
	Totali	15	14	1	15	0
Dega Doganore Bllatë	Status nc	10	8	2	9	1
	Kod Pune	4	4	0	4	
	Totali	14	12	2	13	1
Dega Doganore Morinë	Status nc	33	27	6	27	6
	Kod Pune	13	13		11	2
	Totali	46	40	6	38	8
Dega Doganore Tiranë	Status nc	53	50	3	51	2
	Kod Pune	14	14	0	14	
	Totali	67	64	3	65	2
Dega Doganore Durrës	Status nc	105	96	9	98	7
	Kod Pune	19	19	0	19	0
	Totali	124	115	9	117	7
Dega Doganore Rinas	Status nc	38	35	3	34	4
	Kod Pune	1	1	0	1	0
	Totali	39	36	3	35	4
Dega Doganore Elbasan	Status nc	26	26	0	22	4
	Kod Pune	4	3	1	4	0
	Totali	30	29	1	26	4
Dega Doganore Qafë Thanë	Status nc	27	24	3	24	3
	Kod Pune	10	10	0	10	
	Totali	37	34	3	34	3
Dega Doganore Korçë	Status nc	16	14	2	14	2
	Kod Pune	7	7	0	7	0
	Totali	23	21	2	21	2
Dega Doganore Kapshticë	Status nc	21	21		19	2
	Kod Pune	7	7		7	
	Totali	28	28	0	26	2
Dega Doganore Vlorë	Status nc	24	22	2	22	2
	Kod Pune	7	7	0	7	
	Totali	31	29	2	29	2
Dega Doganore Fier	Status nc	36	26	10	30	6
	Kod Pune	7	6	1	7	
	Totali	43	32	11	37	6
Dega Doganore Berat	Status nc	12	9	3	9	3
	Kod Pune	4	4	0	4	
	Totali	16	13	3	13	3
Dega Doganore Kakavijë	Status nc	23	20	3	21	2
	Kod Pune	13	13	0	13	
	Totali	36	33	3	34	2
Dega Doganore Sarandë	Status nc	18	15	3	15	3
	Kod Pune	9	9	0	9	
	Totali	27	24	3	24	3
Dega Doganore Tre Urat, Përmet	Status nc	10	8	2	7	3
	Kod Pune	3	3	0	3	
	Totali	13	11	2	10	3
Shuma Dege		638	578	60	579	59
Shuma Drejtori		1102	1006	96	1006	96

Burimi: DPD

Deri në datën 31.12.2022 konstatohen **96 vende vakante**, nga të cilat 59 i përkasin vakancave në drejtoritë doganore, dhe 37 në DPD. Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit lidhur me procedurat e ndjekura për përcjelljen e kërkesave për shpalle pranë Departamentit të Administratës Publike, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPD u raportua se shpalljet e vakancave nuk janë kryer nga DAP, pasi institucioni është orientuar se procedurat e rekrutimit do të vijojnë pas përfundimit të procesit të ristrukturimit. Duke qenë se ky proces ka patur vonesa sikundër trajtuar më sipër, nuk është bërë iniciimi i procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve vakante pranë DPD.

Punonjësit me kontratë në DPD dhe degët doganore

Punonjës shërbimi

Në zbatim të VKM-së nr. 35, datë 19.01.2022 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2022 në njësitë e qeverisjes qendrore", të VKM nr. 717, datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore, i ndryshuar, nga 147 punonjës shërbimi të planifikuar për t'u punësuar, në strukturën e autoritetit doganor janë punësuar 119 punonjës, nga të cilët 41 në DPD dhe 78 në degët doganore.

Punonjës ekselentë

Në zbatim të VKM-së nr. 665, datë 10.11.2021 për një shtesë në vendimin nr. 568, datë 30.08.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të Ekselencës në Institucionet e Administratës Shtetërore", të ndryshuar, në strukturën e autoritetit doganor janë punësuar 4 punonjës ekselentë me kontratë 1 vjeçare, nga të cilët 2 në DPD dhe 2 në degët doganore.

Praktikantë me kontratë

Në zbatim të VKM-së nr. 395, datë 29.04.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike" i ndryshuar, në strukturën e autoritetit doganor janë punësuar 6 praktikantë me kontratë 1 vjeçare, të gjithë në DPD.

Më hollësisht, të ndara sipas DPD dhe degëve doganore, situata paraqitet si më poshtë:

Aneksi 75: Struktura sipas degëve doganore

Institucioni	Punonjës Shërbimi		Punonjës Ekselentë me Kontrate nga DAP per vitin 2022	Punonjës me Kontrate Praktikante. Ministria e Shtetit per Rininë dhe Fëmijët
	Plan	Fakt		
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	63	41	2	6
Dega Doganore Shkodër	11	11		
Dega Doganore Lezhë	0	0		
Doga Doganore Bllate (Peshkopi)	2	2		
Dogana Doganore Kukës (Morinë)	11	11		
Dega Doganore Tiranë	11	10		
Dega Doganore Durres	10	9		
Dega Doganore Rinas	3	3		
Dega Doganore Elbasan	4	4		
Dega Doganore Qafe Thane	8	7	1	
Dega Doganore Korce	2	2	1	
Dega Doganore Kapshtice	3	3		
Dega Doganore Vlore	4	4		
Dega Doganore Fier	4	3		
Dega Doganore Berat	2	2		
Dega Doganore Kakavije (Gjirokaster)	3	2		
Dega Doganore Sarande	4	3		
Dega Doganore Tri Urat (Permet)	2	2		
TOTALI	147	119	4	6

Burimi: DPD

Përlllogaritja e pagës sipas gjithë komponentëve përbërës

Niveli i pagave për personelin është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.187 datë 08.03.2017 "Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit" lidhja nr 1 "Struktura e pagave për

nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi dhe lidhja nr 6/7 “Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të punonjësve të sistemit doganor”. Nga shqyrtimi i lidhjes nr.1 “Struktura e pagave për nëpunësit civilë/nëpunësit në të gjitha Institucionet pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi” është përcaktuar paga bazë dhe shtesa e pozicionit që nga klasa I-a që është dhe klasa më e lartë dhe deri tek klasa IV-c që është dhe klasa më e ulët. Nga shqyrtimi i lidhjes 6/7 tabela e pagave për DPD, kategoria A, konstatohet se klasa më e lartë, II-a, është përcaktuar ajo e Drejtorit të përgjithshëm dhe mbi këtë bazë, është përcaktuar niveli i pagave deri tek Klasa D3 që është punonjës pastrimi/sanitar në DPD dhe degë doganore.

Mbi procedurat e ndjekura për rekrutimet e punonjësve pranë autoritetit doganor për vitin 2022

Për sa i përket emërimeve të kryera gjatë vitit 2022, të ndara sipas së kategorive të punonjësve (nëpunës civil dhe kod pune) paraqiten si më poshtë:

Pasqyra 76: Emërimet e nëpunësve pjesë e shërbimit civil

Procedura e ndjekur	Numri i punonjësve
Totali i Rikthimeve nga Pezullimi	5
Transferim Nder Institucional	1
Totali i Emërimit me Dap Student Ekselenc	6
Emërim Nc nga Dap	20
Totali Rikthim me Vendime Gjykatë	0
Shuma	32

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022 janë emëruar 32 nëpunës pjesë e shërbimit civil në strukturën e DPD dhe degëve doganore, nga të cilët 5 janë rikthime në punë nga pezullimi; 1 transferim ndër institucional; 6 emërimet të studentëve të ekselencës dhe 20 emërimet nëpunësish civil nga DAP.

Grupi i auditimit për zgjedhjen në bazë risku verifikimin e 5 procedurave të emërimit të punonjësve me status të nëpunësit, ose 16 % te totalit, trajtuar si më poshtë:

1-Për procedurat e ndjekura për emërimin e punonjësit E.B., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave referuar Listës së pritjes në Departamentin e Administratës Publike, i është drejtuar me shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes me nr.4978 prot datë 10.03.2022” për vakancën e pozicionit të doganierit në zyrën e skanerit në Sektorin e Kontrollit të Sigurisë, në Degën e Doganës Durrës-kategoria IV-a. Me shkresën nr. 1079/8, prot datë 28.03.2022 të Drejtorit të DAP është shpallur fitues z. E.B. nëpunës civil në periudhë prove. Si rezultat, me vendimin nr. 6027/1, prot datë 31.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave janë ndërprerë marrëdhëniet e punës të z. E.B. në detyrën sekretar/arkivist/magaziner, zyra e administratës pranë Degës Doganore Bllatë në referim të shkresës së DAP për emërimin në një pozicion të shërbimit civil të punonjësit. Me urdhër nr. 2649, prot datë 31.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është emëruar punonjësi në pozicionin e sipërcituar.

2- Për procedurat e ndjekura për emërimin e punonjësit R.R., për pozicionin Doganier, Sektori Doganore Porto Romano, në Degën Doganore Durrës, ka dale në listë pritje nga DAP nga procedura e vendeve të shpallura me kërkesën e nr.16235 prot., datë 13.09.2021. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar me shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes në kategorinë ekzekutive me nr.5795 prot datë 24.03.2022 për pozicionin e sipërcituar. Me shkresën nr. 2037/8, prot datë 05.04.2022 të Drejtorit të DAP është shpallur fitues z. R.R., nëpunës civil në periudhë prove. Me urdhër nr. 6448/1, prot datë 14.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është emëruar punonjësi në pozicionin e sipërcituar.

3- Për procedurat e ndjekura për emërimin e punonjësit I.C., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar me shkresë “Kërkesë për shpalljen e vendeve vakantë në kategorinë ekzekutive, nr.16235 prot datë 13.09.2021 për pozicionin Doganier, Sektori i Vlerës në Qendër, Drejtoria e

Vlerësimi në Qendër në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Procedura e konkursit ka filluar që në vitin 2021. Me shkresën nr. 452, prot datë 21.02.2022 të Drejtorit të DAP është shpallur fitues znj. I.C., nëpunës civil në periudhë prove. Me urdhër nr. 1318/1, prot datë 08.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është emëruar punonjësi në pozicionin e sipërcituar. Me urdhër nr. 5297, prot datë 15.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, punonjësi është transferuar në pozicionin e specialistit të analizës së riskut, Sektori i Zhvillimit të Profileve të Riskut, Drejtoria e Informacionit, Analizës së Riskut dhe Monitorimit.

4- Për procedurat e ndjekura për emërimin e punonjësit A.J., Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është drejtuar me shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes në kategorinë ekzekutive me nr.5795 prot datë 24.03.2022” për pozicionin e doganierit në Sektorin e Mbikëqyrjes Doganore, në Degën Doganore Durrës- kategoria IV-a. Me shkresën nr. 458, prot datë 21.01.2022 të Drejtorit të DAP është emëruar z. A.J. nëpunës civil në periudhë prove. Me urdhër nr. 1330/1, prot datë 08.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave është emëruar punonjësi në pozicionin e sipërcituar. Me urdhër nr. 5942, prot datë 25.03.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave punonjësi është transferuar në pozicionin e doganierit të terminalit të trageteve, sektori i operacioneve doganore në terminalin e trageteve, anijeve, konteniereve, Dega Doganore Durrës.

Emërimet të kthyera si pasojë rikthimi me pezullim me kërkesë

5- Për procedurat e ndjekura për emërimin e punonjësit A.V., në dosjen e vendosur në dispozicion me shkresën nr. 5259, prot datë 15.03.2022 të punonjësit A.V. është përcjellë kërkesa për pezullimin nga shërbimi civil për periudhën 2 vjeçare, në vijim të emërimit të punonjësit në një pozicion tjetër pune, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013 dhe VKM-së nr. 124, datë 17.02.2016. Me vendimin e zv. Drejtorit të Përgjithshëm të DPD nr. 5259/1, prot datë 15.03.2022 është miratuar kërkesa. Me shkresën nr. 7354/1, prot datë 22.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPD është përcjellë pranë Drejtorit të Përgjithshëm të DAP kërkesa për rikthimin nga periudha e pezullimit të punonjësit, në vijim të kërkesë së DAP nr. 2239/1, prot datë 15.04.2022 “Mbi rikthimin në detyrë të nëpunësit z.A.V. i pezulluar me kërkesë”. Kërkesa është miratuar me shkresën nr. 2239/3, prot date 18.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të DAP për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës: Kryetar i Degës Doganore Berat, Kategoria III-a/1.

Pasqyra 77: Emërimet me kod pune

Procedura e ndjekur	Numri i punonjësve
Emërimet me kod pune, Konkurse të Brendshme	26
Emërimet pa Konkurs	4
Emërimet me VKM	1
Shuma	31

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022 janë emëruar 31 punonjës me kod pune në strukturën e DPD dhe degëve doganore, nga të cilët 26 janë emërimet me kod pune me konkurs të brendshëm; 4 janë emërimet pa konkurse dhe 1 emërim me VKM. *Grupi i auditimit përzgjedhi në bazë risku 8 procedura emërimi të punonjësve me kod pune, ose 26 % te totalit, trajtuar si më poshtë:*

1-Njoftimi i shpalljes për pozicionin e Përpunuesit të Informacionit, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Operativo Hetimor pranë DPD është kryer sipas shkresës nr.15096, prot datë 17.08.2022. Me procesverbalin e datës 29.08.2022 në referim të shpalljeve komisioni ka konstatuar se është depozituar kërkesa e znj.V.M., e cila sipas shqyrtimit të dokumentacionit ka plotësuar kriteret për të vijuar me fazën e intervistës me gojë; dhe në përfundim të konkurimit Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka shpallur fitues znj.V.M. sipas relacionit datë 01.09.2022. Kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 15869, prot datë 06.09.2022 për emërimin e znj.V.M. në pozicionin të Përpunuesit të Informacionit, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Operativo

Hetimor pranë DPD. Në dosje administrohej i gjithë dokumentacioni sipas çështjes “*Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë*” të shpalljes. Me procesverbalin e datës 29.08.2022 në referim të shpalljeve komisioni ka konstatuar se është depozituar kërkesa e znj. V.M. e cila sipas shqyrtimit të dokumentacionit ka plotësuar kriteret për të vijuar me fazën e intervistës me gojë; dhe në përfundim të konkurrimit Komiteti i Përhershëm i Pranimit me përbërje znj. M.D, ZH.G., R.K. ka shpallur fitues znj.V.M. sipas relacionit datë 01.09.2022. Kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 15869, prot datë 06.09.2022 për emërimin e znj.V.M. në pozicionit të Përpunuesit të Informacionit, Drejtoria e Antikontrabandës, Departamenti Operativo Hetimor pranë DPD.

2- Njoftimi i shpalljes për pozicionin e Komandantit të Grupit pranë Sektorit të Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria e Antikontrabandës pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria C1, kategoria e pagës III-b është kryer sipas shkresës nr. 23138, prot datë 15.12.2021. Me procesverbalin e datës 31.12.2021 nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është konstatuar se janë depozituar 8 kërkesa për pozicionin e punës të cilat të 8 kandidatët plotësojnë kriteret për të vijuar konkurrimin. Komiteti i Përhershëm i Pranimit me anëtarë Y.K., A.T., R.K. ka verifikuar kërkesat dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është shpallur fitues z. E.M. Kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 1084, prot datë 20.01.2022. Në dosjen e punonjësit M.N. konstatohet se referuar dokumentacionit që duhet të dorëzohej nga kandidati sipas çështjes “*Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë*” të shpalljes nuk janë dorëzuar vërtetimet nga Prokuroria apo Gjykata për punonjësin; vërtetimet nga tatim taksat.

3- Njoftimi i shpalljes për pozicionin e doganierit të peshores/pikë kontrolli është kryer sipas shkresës nr. 5058 prot datë 10.03.2022. Me procesverbalin e datës 29.03.2022 nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është konstatuar se janë depozituar 3 kërkesa për pozicionin e punës, nga të cilat të 3 kandidatët plotësojnë kriteret për të vijuar konkurrimin. Sipas vlerësimit të Komisionit të Përhershëm të Pranimit me përbërje znj. M.D., A.T., R.K., është shpallur fitues z. XH.D. Në dosje administrohej i gjithë dokumentacioni sipas çështjes “*Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë*” të shpalljes. Kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 7939/1, prot datë 27.04.2022.

4- Njoftimi i shpalljes për pozicionin e 4 doganiereve të peshores/pikë kontrolli është kryer sipas shkresës nr. 11610 prot datë 16.06.2022. Me procesverbalin e datës 15.07.2022 nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është konstatuar se janë depozituar 20 kërkesa për pozicionin e punës, nga të cilat të 20 kandidatët plotësojnë kriteret për të vijuar konkurrimin. Sipas vlerësimit të Komisionit të Përhershëm të Pranimit me përbërje znj. M.D, ZH.G., R.K. është shpallur fitues znj. M.P., R.D., O.I., M.N.. Në dosjen e punonjësit M.N. konstatohet se referuar dokumentacionit që duhet të dorëzohej nga kandidati sipas çështjes “*Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë*” të shpalljes nuk është dorëzuar fotokopja e diplomës dhe lista e notave të noterizuara, CV, vetë deklarami, vërtetimi nga prokuroria, fotokopje e ID, letër reference nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës, dokumentacione për trajnime të kryera, etj. Duke qenë se punonjësi kishte qenë rishtazi i punësuar pranë DPD këto dokumentacione ishin pjesë e dosjes së tij personale. Kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 15473, prot datë 26.08.2022.

5- Njoftimi i shpalljes për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Antikontrabandës në Departamentin Operativ Hetimor është kryer sipas shkresës nr. 13400 prot datë 18.07.2022. Në dosje disponohet kontrata e punës e nënshkruar sipas shkresës nr. 13751, prot datë 25.07.2022 e nënshkruar me z.F.Sh. dhe dokumentacionet e kërkuara në çështjen “*Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë*” të shpalljes, me përjashtim të vërtetimit nga prokuroria, vërtetimi nga tatim taksat, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, letra reference nga eprori i pozicionit të fundit

të punës, trajnime të tjera. Në dosjen e vendosur në dispozicion nuk dokumentohet vazhdimi i procedurës së rekrutimit, pas shpalljes së pozicionit, përfshirë këtu relacionet e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore për kandidatët e procedurës; apo procesverbalet e Komitetit të Përhershëm i Pranimit për shpalljen fitues të kandidatit, sikundër përcakton neni 15 pika 11 të ligjit nr 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenin 3 dhe nenin 6 të rregullores nr 10 datë 05.02.2015 “Për miratimin e Rregullores së Konkursit për Punonjësit Administrativ të Administratës doganore”; proces i cili është finalizuar me nënshkrimin e kontratës për punonjësin e emëruar në këtë pozicion sipas shkresës nr. 13751, prot datë 25.07.2022.

6-Njoftimi i shpalljes për pozicionin e Komandantit të Grupit, Sektori i Antikontrabandës Tokësore, Drejtoria e Antikontrabandës pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria C1, paga III-b (një vend pune) është kryer sipas shkresës nr. 17401, prot datë 30.09.2022. Me procesverbalin e datës 10.10.2022 është raportuar se janë dorëzuar 11 kërkesa nga të cilat sipas verifikimit të DMBNJ plotësojnë kriteret 11 punonjës për të vijuar fazat e konkurrimit. Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka vijuar fazën dhe ka shpallur fitues z. F.B.. Gjithashtu, punonjësit në listë pritje janë listuar edhe punonjës në listë pritje, nga të cilët edhe z. E.H. dhe E.K. në zbatim të Rregullores nr. 95, datë 25.05.2022 “Për procedurat e konkurrimit”.

Kontrata e punës për punonjësin F.B. është nënshkruar sipas shkresës nr. 18618, prot datë 21.10.2022 ku në dosje disponohen dokumentacionet e kërkuara në çështjen “Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë” të shpalljes.

Kontrata e punës për punonjësin E.H. është nënshkruar sipas shkresës nr. 17954, prot datë 10.10.2022 ku në dosje disponohen dokumentacionet e kërkuara në çështjen “Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë” të shpalljes.

Kontrata e punës për punonjësin E.K. është nënshkruar sipas shkresës nr. 18618, prot datë 21.10.2022 ku në dosje disponohen dokumentacionet e kërkuara në çështjen “Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionet si më poshtë” të shpalljes.

Mbi procedurat e ndjekura për largimet nga puna të punonjësve të punësuar pranë autoritetit doganor përgjatë vitit 2022

Përgjatë vitit 2022, rezultojnë 72 punonjës të larguar nga puna, ku largimet sipas motivacionit në numër paraqiten si më poshtë:

Pasqyra 78: Largimet sipas motivacionit

Arsye e Largimit	Nr i punonjësve
Ndarje nga Jeta	3
Kod Pune/ Zgjidhje e menjëhershme e Kontratës	4
Komision Disiplinor	3
Pleqërie Pension	13
Larguar me Kërkese	24
Transferim i Paralele	0
Pezullim me kërkese	10
Ristrukturim	15
Per shkak te Ligjit	0
Totali	72

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022 janë larguar 72 punonjës nga struktura e DPD dhe degëve doganore, nga të cilët 24 punonjës janë larguar me kërkesë; 15 punonjës si rezultat i ristrukturimit; 10 punonjës kanë pezulluar statusin me kërkesë të tyre, 4 punonjës janë larguar si rezultat i zgjidhjes së menjëhershme të kontratës së punës 3 punonjës me komision disiplinor; 13 punonjës kanë dalë në pension dhe 3 punonjës janë ndarë nga jeta. Grupi i auditimit përzgjedhi në bazë risku 17 procedura emërimi të punonjësve me kod pune, ose 24 % te totalit, trajtuar si më poshtë.

Problematikat e konstatuara në lidhje me dosjet e audituara listohen sa më poshtë:

-Me anë të shkresës me nr 21239.1 Prot të datës 02.12.2021 z. E.S. është lajmëruar për njoftimin e fillimit të procedurës disiplinore në lidhje me shkeljen e pretenduar për mosparaqitjen në punë për një periudhë të gjatë kohore, dhe me anë të shkresës me nr 21239/9 Prot të datës 11.02.2022 z.E.S. është njoftuar për vendimin përfundimtar të Komisionit Disiplinor i cili ka marrë si masë Largimin nga shërbimi civil për z.E.S. Nga auditimi konstatohet se përmes shkresës me nr.21239/6 Prot të datës 10.01.2022 z.E.S. njoftohet për zhvillimin e seancës dëgjimore e cila do të zhvillohet me datë 12.01.2022, jo në përputhje me pikën “ç” të nenit 13 të VKM-së nr 115 datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” ku cilësohet: *“Për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 “.* Nga auditimi konstatohet se Vendimi Përfundimtar i Komisionit Disiplinor që ka vendosur largimin nga shërbimi civil i z.E.S. është protokolluar me nr. 21239/8 prot., datë 11.02.2022. i pa protokolluar dhe pa numër dhe datë, në kundërshtim me nenin 24 të Urdhrit nr.146 të datës 07.05.2018 *“Për miratimin e rregullores së brendshme të Administratës Doganore”* ku cilësohet: *”Dokumentet e brendshme si vendimet.....regjistrohen në regjistrin e korrespondencës(librin e protokollit) në sekretari-protokoll”.* Ky rast është në proces gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar vendimin nr. 776 (80-2023-778), datë 12.05.2023 me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit Disiplinor 21239/8 prot., datë 11.02.2022, me palë paditëse z. E.S., dhe ka disponuar Rrëzimin e kërkesë padisë, si të pabazuar në ligj dhe prova.

-Me anë të shkresës me nr 7260 Prot të datës 15.04.2022 znj.H.C. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përsa i përket procedurës së ndjekur. -Me anë të shkresës drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, dërguar me datë 07.01.2022, protokolluar me nr 181 nga ana e DPD-së, punonjësja M.M. e punësuar në pozicionin Doganier, Dega Doganore Durrës njoftohet dorëheqja e parevokueshme nga pozicionin i mësipërm. Me anë të vendimit me nr.181/1 Prot të datës 07.01.2022 njoftohet përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil për znj. M.M. si pasojë e dorëheqjes. Nga auditimi konstatohet se vendimi për përfundimin e marrëdhënies të punës në shërbimin civil është marrë në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 64 të ligjit nr 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”* ku parashikohet *“Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit dhe me miratimin e njësisë së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi. ”*

-Me anë të urdhrit me nr.1326/1 Prot të DMBNJ të datës 08.02.2022 z.A.K. emërohet nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin doganier në degën doganore Gjirokastër. Ky emërim vjen pas shkresës së DAP-it me nr 454 të datës 21.01.2022 *“Mbi emërimin e nëpunësit civil”.* Në dosjen personale të punonjësit konstatohet që z. A.K. është i regjistruar si subjekt fizik në regjistrin tregtar të të dhënave për subjektet në QKB dhe pas dorëzimit të akt konstatimeve, punonjësi ka depozituar në Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dokumentacionin për mbylljen e aktivitetit privat, provuar me Ekstrakt nga QKB. Njoftimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për z.A.K. jepet nëpërmjet vendimit të datës 08.02.2022 me nr 1326/2 Prot dhe parashikon përfundimin e marrëdhënies financiare në të njëjtën ditë si rezultat i shkresës së datës 08.02.2022 me nr 1362/1 Prot që njofton emërimin e z.A.K. si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e doganier në Degën Doganore Gjirokastër, pra përfundimi i marrëdhënies të punës nuk ka ardhur

si pasojë e dorëheqjes së A.K. në pozicionin e mëparshëm, por si pasojë e emërimit të saj në një pozicion tjetër.

-Për z. D.M. është miratuar vendimi për pezullimin e marrëdhënieve në shërbimin civil me kërkesë të nëpunësit me shkresën nr. 11816/1, prot datë 21.06.2022, në vijim të kërkesës së punonjësit me nr. 11816, prot. datë 21.06.2022, ku rezulton se afati për pezullimin paraqiten në kundërshtim me pikën 3 të nenit 55 të Ligjit nr 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”* ku cilësohet: *“Kërkesa për pezullimin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqitet me shkrim, të paktën 15 ditë përpara datës së kërkuar për pezullimin”*.

-Njoftimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për znj.I.B. jepet nëpërmjet vendimit të datës 08.02.2022 me nr 2385 Prot dhe parashikon përfundimin e marrëdhënieve financiare në të njëjtën ditë si rezultat i shkresës së datës 08.02.2022 me nr. 1320/1 Prot. që njofton emërimin e znj.I.B. si nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin e doganier në Degën Doganore Fier. Nga auditimi konstatohet se nga sa më sipër përfundimi i marrëdhënieve të punës nuk ka ardhur si pasojë e dorëheqjes, por si pasojë e emërimit të saj në një pozicion tjetër.

-Njoftimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës për z.E.B. jepet nëpërmjet vendimit të datës 14.06.2022 me nr. 11451/1 Prot. Nga auditimi konstatohet se vendimi për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës jepet pasi z.E.B. ka shkelur pikën 12.4 të urdhrin 90 të datës 29.12.2014 dhe nenin 5 të VKM-së nr 874 të datës 29.09.2021.

-Me anë të shkresës me nr. 781 Prot. të datës 17.01.2022 znj.M.T. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përse i përket procedurës së ndjekur

-Me anë të shkresës me nr.11149 Prot të datës 09.06.2022 z.R.Z. kërkon pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për një periudhë 2 vjeçare. Me anë të vendimit të protokolluar me nr.11149/1 të datës 16.06.2022 z.R.Z. i miratohet pezullimi nga detyra me afat 2 vjecar. Nga auditimi konstatohet se pezullimi i z.R.Z. është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 55 të Ligjit nr 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”* ku cilësohet: *“Kërkesa për pezullimin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqitet me shkrim, të paktën 15 ditë përpara datës së kërkuar për pezullimin”*. Përse më sipër afati u pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil për z.R.Z. është kryer 8 ditë përpara afatit minimal ligjor.

-Me anë të shkresës me nr.20614 Prot të datës 24.11.2022 z.Xh.N. kërkon pezullimin e marrëdhënies në shërbimin civil për një periudhë 2 vjeçare. Me anë të vendimit të protokolluar me nr.20614/1 të datës 02.12.2022 z.Xh.N. i miratohet pezullimi nga detyra me afat 2 vjecar. Nga auditimi konstatohet se pezullimi i z.Xh.N. është në kundërshtim me pikën 3 të nenit 55 të Ligjit nr 152/2013 *“Për Nëpunësin Civil”* ku cilësohet: *“Kërkesa për pezullimin, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqitet me shkrim, të paktën 15 ditë përpara datës së kërkuar për pezullimin”*.

-Me anë të shkresës me nr. 19641 Prot. të datës 07.11.2022 z.A.S. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përse i përket procedurës së ndjekur.

-Me anë të shkresës me nr. 12366 Prot. të datës 30.06.2022 z.B.P. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me anë të shkresës me nr.14412 Prot të datës 04.08.2022 z.B.P. është shpërblyer me dy paga mujore.

-Me anë të shkresës me nr. 5429 Prot. të datës 17.03.2022 z.L.V. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përse i përket procedurës së ndjekur.

-Me anë të shkresës me nr 12365 Prot të datës 30.06.2022 z.E. L. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me anë të shkresës me nr.14412 Prot të datës 04.08.2022 z.E.L. është shpërblyer me dy paga mujore.

-Me anë të shkresës me nr 12354 Prot të datës 30.06.2022 z.B.Ll. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me anë të shkresës me nr.14364 Prot të datës 04.08.2022 z.B.Ll. është shpërblyer me 14 ditë pune (pushime të pakryera).

-Me anë të shkresës me nr 17984 Prot të datës 10.10.2022 z.B.D. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përsa i përket procedurës së ndjekur.

-Me anë të shkresës me nr 7260 Prot të datës 15.04.2022 znj.H.C. lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përsa i përket procedurës së ndjekur.

-Me anë të shkresës me nr 5801/1 Prot të datës 24.03.2022 z.N.S. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Nga auditimi nuk konstatohet problematika përsa i përket procedurës së ndjekur.

-Me anë të shkresës me nr 12358 Prot të datës 30.06.2022 z.Y.R. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me anë të shkresës me nr.13804 Prot të datës 04.08.2022 z.L. është shpërblyer me dy paga mujore.

-Me anë të shkresës me nr 12359 Prot të datës 30.06.2022 z.I.Th. është lajmëruar për përfundimin e marrëdhënies financiare të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. Me anë të shkresës me nr.13804/1 Prot të datës 04.08.2022 z.I.Th. është shpërblyer me dy paga mujore.

Mbi procedurat e ndjekura për transferimet e punonjësve të punësuar pranë autoritetit doganor përgjatë vitit 2022

Në zbatim të nenit 48, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ku përcaktohet që: “Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve”, u kërkuar informacion mbi numrin total të transferimeve të kryera nga DPD përgjatë vitit 2022, paraqitur si më poshtë:

Pasqyra 86: Transferime të nëpunësve sipas statusit

Kategoria e nëpunësit të transferuar	Numri i punonjësve
Transferim të nëpunësve civil	131
Transferim të punonjësve jashtë statusit të nëpunësit civil	41
Totali transferime	172

Burimi: DPD

Përgjatë vitit 2022 janë kryer 172 procedura transferimesh, nga të cilët 131 transferime të nëpunësve civil dhe 41 transferime të punonjësve jashtë statusit të nëpunësit civil.

Numri i transferimeve të kryera për çdo muaj paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Pasqyra 79: Transferimet në muaj

Muaji	Nr
Janar	12
Shkurt	27
Mars	24
Prill	31
Maj	12
Qershor	19
Korrik	4
Gusht	8
Shtator	20
Tetor	6
Nëntor	5

Dhjetor	4
Total	172

Burimi: DPD

-Nga auditimi konstatohet u konstatuan fenomene të **transferimeve të realizuar për një periudhë me kohëzgjatje mbi 6 muaj** në kundërshtim me paragrafin “a” të pikës nr “7” të nenit “15” të ligjit nr 102/2014 “Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë” ku parashikohet “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje: ne interes të institucionit, deri në 6 muaj*”; **transferime në kategori të ndryshme; transferime nga një pozicion me status në pa status dhe anasjelltas**, trajtuar më hollësisht rast pas rasti çdo transferim në anekset bashkëlidhur, problematikë kjo e konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH.

Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për argumentimin e vendimmarrjes për kryerjen e një numri të konsiderueshëm të transferimeve të punonjësve, duke shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ku cilësohet se: “*Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, atë të ulët apo të mesme drejtuese bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele*”, dhe sipas pikës “3” gërma “a” të kreu “I” të VKM-së nr 125 të datës 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”: “*Në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij vendimi, transferimi i përkohshëm nuk bëhet për: Nëpunësit civilë në periudhë prove*”, nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore u informuam se transferimet e përkohshme në DPD kryhen bazuar në përputhje me pikën 3 të nenit 13 dhe pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, : “*Neni 13 - Statusi, kategorizimi, të drejtat dhe detyrimet e personelit të administratës doganore 3. Përrjashtimisht përcaktimeve të ligjit “Për nëpunësin civil”, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, pranimi në detyrë, emërimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, elementë specifikë të procedurës së dhënies së masave disiplinore të personelit të administratës doganore pjesë e shërbimit civil, bëhet sipas parimeve dhe procedurave specifike të këtij Kodi dhe akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij për këtë qëllim. Neni 15 - Marrëdhëniet e punës, pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore 7. Transferimi i përkohshëm bëhet si më poshtë: dh) Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishtme për transferimin e përkohshëm, sipas kësaj pike. Si dhe sipas pikës 7 të nenit 15 të Kodit Doganor, janë miratuar me VKM Nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar, ku në pikën 1, Kreu V, parashikohet edhe si më poshtë vijon: “V. Transferimi i përkohshëm 1.Drejtori i Përgjithshëm i Doganave bën transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor për shkaqet, që parashikohen në Kodin Doganor. Në rastin e punonjësve doganorë, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, një kopje aktit të transferimit i dërgohet për dijeni Departamentit të Administratës Publike. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit mund të kryhet edhe për nëpunësit civilë në periudhë prove.”. Neni 15 - Marrëdhëniet e punës, pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore 7. Transferimi i përkohshëm bëhet si më poshtë: a) Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, për këto arsye dhe kohëzgjatje: i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj; ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj; iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës dhe referuar pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 48 të ligjit nr.152/2013*

“Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikohet: *Neni 48 Transferimi i përkohshëm 1. Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje: a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve; 2. Transferimi mund të bëhet: a) brenda institucionit ku është emëruar, përfshirë edhe degët e tij territoriale; b) në një institucion të varësisë të institucionit ku është emëruar; c) në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Nëpunësi civil mund të refuzojë transferimin në këto raste: a) kur gjendja e tij shëndetësore, provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; b) nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil. 4. Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi civil kthehet në pozicionin e mëparshëm.* Për sa më sipër, sipas DPD në rastin e shërbimit doganor, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve e kohëzgjatjes së tyre, ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime, ku në shkronjën “i”, pika 7/a, të nenit 15, të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka dispozitë kufizimi të ngjashme me pikën 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas së cilës mund të bëhet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (me/ose pa ndërprerje) për nevoja të punës, ku kjo lejohet një herë gjatë dy viteve dhe sipas kësaj dispozitë një punonjës doganor, mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa here çmohet një nevojë e tillë, pa patur ndonjë kufizim.

Transferimet nga një pozicion jo pjesë të shërbimit civil në administratën doganore në pozicion me status nëpunësi civil dhe anasjelltas, nga ana e DPD janë kryhet duke patur për bazë dispozitat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 13, pikën 7 të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikën 1 të Kreut V, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të ndryshuar, ku parashikohet: “V. Transferimi i përkohshëm 1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave bën transferimin e përkohshëm të punonjësit doganor për shkaqet, që parashikohen në Kodin Doganor. Në rastin e punonjësve doganorë, që gëzojnë statusin e nëpunësit civil, një kopje aktit të transferimit i dërgohet për dijeni Departamentit të Administratës Publike. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit mund të kryhet edhe për nëpunësit civilë në periudhë prove.”

Procesi i transferimit të përkohshëm në administratën doganore, është mbikëqyrur për çdo rast nga Departamenti i Administratës Publike (shkronja “c”, pika 2, neni 7 i ligjit nr.152/2013), pasi, për çdo rast akti i transferimit i është dërguar edhe këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 1 të Kreut V, të VKM nr. 921, datë 29.12.2014.

Nga 172 transferime të kryera përgjatë vitit 2022, nga të cilët 131 transferime të nëpunësve civil dhe 41 transferime të punonjësve të tjerë, grupi i auditimit përzgjodhi 13 procedura transferimi për verifikimin e dokumentacionit justifikues për çdo rast sipas aneksit bashkëlidhur.

Mbi procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës

Nga auditimi u konstatuan parregullsi lidhur me procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës së punonjësve të larguar nga DPD. Konkretisht, u kërkua informacion nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, e cila në përgjigjen e saj vuri në dukje se ky proces administrohet nga vetë drejtoria/ sektori ku punonjësi ka qenë i punësuar dhe kjo strukturë nuk disponon kopje të akteve për dorëzimin e detyrës. Kjo situatë konsiderohet të jetë në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së Nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, kreu 3, pikat si më poshtë “Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil. 28. Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve e të mjeteve të punës në inventar. 29. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në

inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirim. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera. 30. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29, të këtij vendimi, Fletorja Zyrtare Viti 2016 – Numri 28 Faqe|2379 konsiderohet shkelje e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore.”

Mbi procedurat e ndjekura për ish punonjësit në autoritetin doganor

Grupi i auditimit kërkoi informacion mbi databazën e vendimeve gjyqësore të formës së prere për ish punonjësit e larguar nga puna. Ky informacion i cili u vendos në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik, të cilët administronin këto të dhëna sipas kompetencave përkatëse të tyre.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore vendosi në dispozicion databazën e vendimeve gjyqësore, në zbatim të Kreut II të Urdhrit nr. 5151, datë 28.19.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, ku fillimisht databaza e administruar rezultonte me pasaktësi pasi nuk reflektonte të gjitha ndryshimet në statusin e punonjësit, problematika këto që u sistemuan përgjatë auditimit. Në përfundim situata për ish punonjësit paraqitet si më poshtë:

Pasqyra 80: Për vendimet gjyqësore të punonjësve të shërbimit civil

Nr	Nr. vendimi	Date vendimi	Palët ndërgjyqësi	Funksioni ne kohën e largimit /Kategoria	Objekti i padisë	Pozicioni fillestar i disponueshem	SHENIME
1	3074(80-2019-3133	29.09.2019	M.T.	Kryetar I Deges Doganore Tirane (A)	Detyrimine e Pales se Paditur DPD te nderprese vendimin e pezullimit Komisionit Disiplinor, dhe te nxjere aktin e Rikthimit ne detyre	Pergjegjes Sektori, Sektori I Operacioneve Dogaore, Dega Doganore Durres, kategoria III-a/1	Pozicionuar me Ristrukturim, Bashkalidhur vendimet e dapit
2	209	15.02.2019	L.Nj.	Kryetar I Deges Doganore Fier (A)	Detyrimine e Pales se Padotur DPD te nderprese vendimin e pezullimit Komisionit Disiplinor, dhe te ncjere aktin e Rikthimit ne detyre	Pergjegjes Sektori, Sektori I Administrates dhe Sherbimit, Dega Doganore Tiranë, kategoria III-a/1	Pozicionuar me Ristrukturim, Bashkalidhur vendimet e dapit
3	3356	11.10.2019	S.G.	Komandant Grupi i Antikontrabandes Tokesore	Gjykata ka vendosur qe detyrohet DPD te ekzekutoj detyrimin per pages sipas 317/v te KPRC dhe detyrimi per rikthimin ne detyre nga marrja e formes se prere te ketij vendimi sipas Ligjit	jo	

Burimi: DPD

Sipas të dhënave të mësipërme rezultojnë **3 vendime të pa ekzekutuara**, si më sipër. Për vendimet gjyqësore **të punonjësve me kod pune:**

Pasqyra 81: Vendimet gjyqësore të punonjësve me kod pune

Nr	Date vendimi	Palet ndergjyqese	Pozicioni fillestar i disponueshem
1	06.12.2016	V.K.	jo

Burimi: DPD

Rezulton 1 vendim (datë 6.12.2016) i cili nuk është ekzekutuar, për të cilin pozicioni nuk është i disponueshëm.

Grupi i auditimi kërkoi informacion lidhur me aktivitetin e Komisionit të Posaçëm, ku rezulton se komisioni nga momenti krijimit të tij, ka pësuar ndryshime dhe deri në fund të vitit 2022 rezulton me përbërje:

- M.D, Kryetar
- A.T.
- I.B.
- M.Z.

Referuar databazës së mbajtur nga drejtoria e burimeve njerëzore nuk rezulton asnjë emërim përgjatë vitit 2022 me objekt rikthim në punë të ish punonjësve gjyq fitues. Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Pranimiit ku nuk u vendosën në dispozicion informacione që dokumentojnë takime të kryera nga ana e tyre përgjatë vitit 2022 për sistemin e këtyre punonjësve referuar Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore” ku parashikohet që:

KP duhet të shqyrtojnë të gjitha rastet e gjyqfituesve, të pasistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, që kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrit”. Urdhëri përcakton gjithashtu në Kreun IV, pika 2 se “KP thirret nga Kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në dijeni DAP-in”. Kreu IV, pika 3 përcakton se “Shqyrtimi administrative përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”. Kreu VI, pika 4 përcakton se “KP në përfundim të shqyrtimit administrativ, brenda 3 ditëve pune, i parashtron me shkrim gjyqfituesit alternativat, objektivisht të mundshme, për t’u punësuar në një pozicion të rregullt të të njëjtës kategori dhe në pamundësi objektive, në një kategori më të ulët brenda institucionit nga ku është larguar apo në një institucion varësie”. Kryetari i KP përgjatë vitit 2022 nuk e ka thirrur komisionin ashtu sikurse parashikohet në dispozitat ligjore, të cituara më sipër me qëllim rikthimin e punonjësve në punë Komisioni i Posaçëm për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave, pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për t’i rikthyer të gjithë, në kohë, dhe sipas radhës së daljes së vendimit të formës së prerë të Gjykatës.

Informacioni përmbledhës për Vendimet Gjyqësore të parashikuar në PBA, miratuar me ligjin e buxhetit, ndryshuar gjatë vitit, plani rishikuar dhe realizimi i tij për vitin 2022 është si me poshtë:

Pasqyra 82: Vendimet Gjyqësore të parashikuar në PBA, miratuar me ligjin e buxhetit, ndryshuar gjatë vitit, plani rishikuar dhe realizimi i tij për vitin 2022

Në mijë lekë

Projekti buxhetor	PBA	Ligj Buxheti	Ndryshim	Plani rishikuar	Fakti
Vendime Gjyqësore të ekzekutuara	155'410	0	58,442	58,442	58,442

Burimi: DPD

Konkretisht, sipas së dhënave të Drejtorisë së Financës, gjatë vitit 2022 janë likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë ish punonjës të larguar nga puna, në vlerën 5,847,352 lekë. Referuar vendimeve të përcjella për t’u likuiduar, rezultojnë të kenë mbetur pa paguar deri në

31.12.2022 vendime në vlerën 2,362,792 lekë, të cilat janë likuiduar përgjatë muajit Janar dhe Shkurt të vitit 2023. Pra në total, rezultojnë vendime në vlerën totale prej **8,210,144 lekë**, nga të cilat vlera prej 416,535 lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës nga 9 vendimet e ekzekutuara, rezultojnë 3 vendime gjyqate që i përkohjnë vitit 2022, dhe 6 vendime të periudhave të mëparshme. Më hollësisht sipas aneksit bashkëlidhur. ***Këto shpenzime konsiderohen si efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.*** Për sa i përket vendimeve të gjykatës të vitit 2021 dhe më parë, konstatohet se këto vendime nuk janë njohur si detyrime të prapambetura në periudhat e mëparshme, duke mbartur kështu një risk për ekzistencën e vendimeve të tjera, për të cilat DPD raporton se nuk ka informacion se ka të tilla.

Cështje gjyqësore në proces

Sipas informacionit të vendosur në dispozicion lidhur me çështjet gjyqësore në proces që lidhen me marrëdhëniet me punonjësit, rezultojnë në total **46** të tilla, nga të cilat 15 çështje lidhen me ish punonjës dhe 31 çështje me objekt transferimesh apo orësh jashtë orarit të punonjësve aktual të autoritetit doganor, ku më hollësisht:

Pasqyra 83: Çështje gjyqësore në proces

Tipologjia e çështjeve gjyqësore	Statusi i punonjësve	Numri i çështjeve	Numri i çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë	Numri i çështjeve në Gjykatën e Apelit
Ish punonjës	Ish nëpunës me status	5	4	1
	Ish nëpunës me kod pune	10	10	0
	Total	15	14	1
Punonjës	Nëpunës me status	17	16	1
	Nëpunës me kod pune	14	12	2
	Total	31	28	3
Total		46	42	4

Burimi: DPD

Në aneksin bashkëlidhur trajtohen edhe rast pas rasti çështjet gjyqësore që janë në proces sipas shkallës së gjykatës dhe numrit të vendimit.

Për sa i përket informacionit lidhur me punonjësit që kanë mbushur moshën e pleqërisë përgjatë vitit 2022, në vijim të shkresës së KMSHC përcjellë pranë DPD prot nr.16921/1, prot datë 28.09.2022, nga ana e DPD është informuar me shkresën nr. 16921/1 prot datë 28.09.2022 se kanë përfunduar marrëdhëniet e punës për 10 punonjës pas mbushjes së moshës për daljen në pension; apo përcjelljen e informacionit pranë KMSHC për mos finalizimin e lirimt nga detyra të punonjësve në rastet kur është gjykuar se për arsye specifike të veçanta të pozicionit të punës punonjësi do të mbahet në detyrë deri në përfundim të procedurave të konkurrimit dhe shpalljes së fituesit në vendin vakant. Duke qenë se përgjatë vitit 2022 procedurat e konkurrimit janë pezulluar sikundër cituar më sipër, kjo situatë është pasuar me vonesa për lirimt nga puna të punonjësve që kanë mbushur moshën e pensionit, dhe deri në fund të vitit rezultojnë punonjës që kanë mbushur moshën por nuk është vijuar me lirimt e tyre.

Për sa më sipër është është përcjellë Projektraporti pranë DPD dhe për këtë çështje nga znj. M.D dhe z. I.B. me shkresën nr. 11604/14 prot në DPD datë 06.09.2023 dhe në KLSH prot nr. 283/33 datë 08.09.2023 janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Lidhur me procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve për vitin 2022 në mënyrë analitike paraqiten shkresat e cituara si mungesa në akt konstatim : Drejtoria e Përgjithshme e Doganave referuar Listes së pritjes në Departamentin e Administratës Publike, i është drejtuar me shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes me nr.4978 prot datë 10.03.2022”, shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes në kategorinë ekzekutive me nr.5795 prot datë 24.03.2022”, shkresë “Kërkesë për shpalljen e vendeve vakantë

në kategorinë ekzekutive, nr.16235 prot datë 13.09.2021, shkresë “Kërkesë nga Lista e Pritjes në kategorinë ekzekutive me nr.5795 prot datë 24.03.2022.

Lidhur me procedurat e rekrutimit DPD i është drejtuar DAP me shkresat resektive për cdo rast.

Lidhur me procedurat e ndjekura për largimin e punonjësve për vitin 2022 vendimi i largimit nga shërbimi civil për z. E.S. është i protokolluar me nr. 21239/8 prot., datë 11.02.2022.

Në lidhje me procedurën e njoftimit për fillim të ecurisë disiplinore nga Komisioni Disiplinor të z. S, ju sqarojmë se KD ka kryer njoftime të njëpasnjëshme në adresa të ndryshme të deklaruara nga z. S me qëllim njoftimin efektiv të tij dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar rrezimin e kërkesë padisë, si të pabazuar në ligj dhe prova. Lidhur me znj. H.C. punonjësi ka mbushur moshën e pleqërisë; znj.M.M. për arsye shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor i është miratuar kërkesa për dorëheqje. Lidhur me problematikën e z. A.K., punonjësi ka depozituar në Zyrën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dokumentacionin për mbylljen e aktivitetit privat, provuar me Ekstrakt nga QKB.

Lidhur me procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës për vitin 2022 sqarojmë se sipas detyrimeve të përcaktuara në pikën 28 të VKM-së Nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, i ndryshuar, parashikohet citojmë: “28. Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të njësisë përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar.”Pra sa më sipër, këto përcaktime janë të detyruara për tu zbatuar nga nëpunësi civil, eprori direkt dhe njësisë përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik.

Lidhur me procedurat e ndjekura për transferimet për vitin 2022 në mënyrë analitike sqarojmë se transferimet e përkohshme në DPD kryhen bazuar në përputhje me pikën 3 të nenit 13 dhe shkronjën "a", pika 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Gjithashtu referuar pikave 2, 3 dhe 4 të nenit 48 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Duke bërë vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të transferimit të përkohshëm objekt trajtimi/konstatimi, evidentojmë se në legjislacionin specifik doganor (pika 3 e nenit 13 të Kodit Doganor), për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve e kohëzgjatjes së tyre, ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime. Siç shihet, në shkronjën "i", pika 7/a, të nenit 15, të ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nuk ka dispozitë kufizimi të ngjashme me pikën 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, sipas se cilës mund të behet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (me/ose pa ndërprerje) për nevoja të punës, ku kjo lejohet një herë gjatë dy viteve. Përkundrazi, sipas kësaj dispozitë një punonjës doganor, mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa here çmohet një nevojë e tilla, pa patur ndonjë kufizim, prandaj në këtë vështrim transferimet e përkohshme nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara. Ndërkohë edhe referuar rregullave të posaçme të përcaktuara në Kreun V “Transferimi i Përkohshëm” të VKM nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar. Lidhur me procedurat e ndjekura për punonjësit që kanë fituar vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthim në detyrë për vitin 2022 Komisioni i Posaçëm i ngritur pranë DPD-së, vlerëson të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të gjyqfituesit në një pozicion tjetër pune, pjesë e Shërbimit Civil, me të njëjtën kategori me pozicionin e punës përpara largimit, në përfundim të ristrukturimit, dhe do të japë zgjidhje problematikave të ngritura Gjyq Fituesi me Kod Pune, z.V.K. do të thirret, do të propozohet një pozicion pune që ndodhet vakant në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Me finalizimin e Ristrukturimit të DPD dhe fillimin e procedurave të rekrutimit Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të procedojë me punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit të pleqërisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për sa trajtuar në observacion, nuk rezultojnë argumente të tjera nga sa trajtuar në projektraport. Qëndrimi i grupit të auditimit mbetet i njëjtë.*

1. Titulli gjetjes: **Mos zbatimi i efekteve të VKM-së nr. 355 datë 26.05.2022 për miratimin e strukturës së re organizative.**

Situata: Nga auditimi kontatohet se VKM nr. 355 datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për personelin e administratës doganore”, nuk është zbatuar brenda afatit të parashikuar, për shkak

të vonesave në vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit. Ky komision ka zhvilluar mbledhjen e parë më datën 13.06.2022, dhe pavarësisht se është cituar nga vetë komisioni se vendimmarrja mund të shtyhet vetëm një herë, afati për të finalizuar procesin e ristrukturimit është shtyrë edhe dy herë të tjera, ku deri në përfundim të fazës së auditimit në terren nuk rezulton të jetë finalizuar. Kështu, deri në fund të vitit 2022 janë marrë vetëm 2 vendime për transferimin e përhershëm të punonjësve me status nëpunësi civil (datë 7.12.2022, dhe 20.12.2022) duke mos realizuar procesin e ristrukturimit në nivel sistemi. Për sa i përket vendimmarrjes së komisionit për punonjësit jashtë shërbimit civil, është marrë vetëm 1 vendim më datën 30.06.2022 për largimin e 15 punonjësve si rezultat i ristrukturimi.

Nga auditimi rezulton se, deri më datën 31.12.2022 janë 96 vende vakante në sistemin doganor, nga të cilat 59 i përkasin vakancave në degët doganore, dhe 37 në DPD. Shpalljet e vakancave nuk janë kryer nga DAP, pasi institucioni është orientuar se procedurat e rekrutimit do të vijojnë pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, duke nxjerrë kështu në pah problematikat në drejtim të disiplinës financiare, për shkak të planifikimit të fondeve të pagave dhe sigurimeve shoqërore referuar strukturës së planifikuar. Duke qenë se ristrukturimi ka patur vonesa, nuk është bërë inicimi i procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve vakante pranë DPD. Gjithashtu, edhe procedurat e transferimeve të përkohshme të punonjësve kanë vijuar deri në pritje të përfundimit të procesit të ristrukturimit.

Në zbatim të VKM-së nr. 355 datë 26.05.2022, organika e DPD është miratuar të funksionojë me 1074 punonjës të shpërndarë në nivel qendor dhe vendor, pra 28 punonjës më pak se VKM nr.2, datë 08.01.2018. Për shkak të numrit të lartë të vakancave në administratën doganore, mos zbatimi në afat i efekteve të VKM-së, pavarësisht se nuk rezulton në efekte financiare, nxjerr në pah mangësitë që ekzistojnë në drejtim të garantimit të performancës optimale në punë, për sa kohë detyrat realizohen nga një personel më i ulët nga sa parashikuar; apo në drejtim të një organike të planifikuar në nivele më të larta nga sa janë nevojat reale të DPD, për sa kohë objektivat institucionale raportohen të realizuar pavarësisht vakancave. Ligji nr.102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së Nr.921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, dhe VKM-së nr 2, datë 08.01.2018 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.921 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Personelin e Administratës Doganore”, VKM-së nr. 355 datë 26.05.2022.

Kriteri :

Ndikimi/Efekti

Shkaku:

Rëndësia

Rekomandimi

Shkelje të disiplinës financiare për shkak të mbulimit të pozicioneve të DPD me punonjës në pozicione pune të transferuar, për shkak të mos finalizimit të procedurës së ristrukturimit.

Ndryshimet në përbërjen e komisionit të ristrukturimit;; ndryshime të mëdha, numrit të konsiderueshëm të dosjeve të punonjësve, mos finalizimi i dosjeve të përkrahjeve të punës.

E lartë

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin masat për kryerjen e të gjitha procedurave e nevojshme për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës organizative të DPD të miratuar me VKM-në nr. 355 datë 26.05.2022, në kuadër të mbarëvajtjes së punës, rritjen e performancës së punonjësve publik, si dhe me qëllim shmangien e praktikave të transferimeve të punonjësve në pozicione të tjera.

2. Titulli gjetjes:

Situata:

Parregullsi lidhur me procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës.

Janë konstatuar parregullsi lidhur me procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës së punonjësve të larguar nga DPD, të cilët nuk kanë ndjekur procedurat e

përcaktuara VKM-në nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, Kreu 3, pasi janë larguar nga puna duke mos kryer dorëzimet e nevojshme të detyrës, dokumentacionit pranë eprorëve direkt, situatë kjo që ka ndikuar vijueshmërinë e punës së strukturave të DPD.

Referuar numrit të lartë të transferimeve (172 procedura) dhe largimeve(72 procedura), kjo situatë konstatohet si me risk të shtuar. Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore konstatohet se kanë vijuar procedurat për miratimin e largimit të punonjësve (dorëzimi i librezës së punës, etj), pa kryer paraprakisht veprimet e nevojshme për të garantuar se punonjësit nuk kanë patur asnjë detyrim ndaj institucionit për dokumentacionin, pajisjet dhe mjetet e punës në inventar.

VKM nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, kreu 3, pikat si më poshtë “*Nëpunësi që largohet nga shërbimi civil duhet të bëjë të gjitha veprimet e duhura për dorëzimin e detyrës në mënyrë korrekte dhe në përputhje me etikën e nëpunësit civil. 28. Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimin e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të njësisë përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve e të mjeteve të punës në inventar. 29. Dorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar bëhet, si rregull, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit të lirim. Në raste të veçanta, me urdhër të eprorit direkt, ky afat mund të zgjatet edhe me 5 (pesë) ditë të tjera. 30. Mosdorëzimi i detyrës, i dokumentacionit, i pajisjeve dhe i mjeteve të punës në inventar brenda afateve të përcaktuara në pikën 29, të këtij vendimi, Fletorja Zyrtare Viti 2016 – Numri 28 Faqe/2379 konsiderohet shkelje e rëndë e detyrës dhe shkelje e rëndë disiplinore.”*

Kriteri :

Ndikimi/Efekti

Shkaku:

Rëndësia

Rekomandimi

Mungesa në dokumentacione dhe informacione për periudhën në të cilën kanë qenë të punësuar punonjësit respektiv.

Mangësi në procedurat e ndjekura për miratimin e largimit nga puna, duke kryer paraprakisht edhe kontrollet përkatëse për saktësinë në dorëzimin e detyrës.

E lartë

-Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat për të mos miratuar në asnjë rast largimin nga detyra të punonjësve, pa kryer paraprakisht kontrollet e nevojshme dokumentare që garantojnë përmbushjen e të gjitha detyrave dhe detyrimeve ndaj institucionit si në aspektin e pajisjeve të punës, ashtu edhe në dorëzimin e detyrës për pozicionet që kanë mbuluar.

- Për punonjësit e larguar që janë ende pjesë e shërbimit civil dhe që nuk kanë plotësuar detyrimin për dorëzimin e detyrës, të propozohet marrja e masave disiplinore ndaj tyre, për sa kohë kanë kryer shkelje të rëndë disiplinore.

3. Titulli gjetjes:

Mangësi në vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm për sistemimin e ish punonjësve.

Nga auditimi konstatohet se referuar databazës së mbajtur nga drejtoria e burimeve njerëzore nuk rezulton asnjë emërim përgjatë vitit 2022 me objekt rikthim në punë të ish punonjësve gjyq fitues. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të administruar përgjatë auditimit, konstatohet se në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike “*Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore*” ku parashikohet që: **“KP duhet të shqyrtojë të gjitha rastet e gjyqfituesve, të pasistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, që kanë një vendim gjyqësor të formës së prerë, deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrin”**. Urdhëri përcakton gjithashtu në Kreun IV, pika 2 se **“KP thirret nga Kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/lajmërimit me shkrim të kreditorit, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në**

Situata:

dijeni DAP-in”. Kreu IV, pika 3 përcakton se “Shqyrtimi administrative përfundon jo më vonë se 15 ditë nga momenti i depozitimit të kërkesës”. Kreu VI, pika 4 përcakton se “KP në përfundim të shqyrtimit administrativ, **brenda 3 ditëve pune**, i parashtron me shkrim gjyqfituesit alternativat, objektivisht të mundshme, për t’u punësuar në një pozicion të rregullt të të njëjtës kategori dhe në pamundësi objektive, në një kategori më të ulët brenda institucionit nga ku është larguar apo në një institucion varësie”. Kryetari i Komisionit të Pranimet përgjatë vitit 2022 nuk ka thirrur asnjë mbledhje të këtij komisioni me qëllim shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave, pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, referuar pozicioneve në dispozicion në sistemin doganor. Si rezultat, deri në fund të vitit 2022 rezultojnë **3 vendime të pa ekzekutuara punonjësve të shërbimit civil dhe 1 vendim për punonjës me kod pune**.

Kriteri :

Urdhri nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Institucionet e Administratës Shtetërore”.

Ndikimi/Efekti:

Mosekzekutimi në kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, shoqëruar me efekte financiare negative për buxhetin e shtetit.

Shkaku:

Mosveprimi nga ana e Komisionit të Posaçëm për të shqyrtuar në vazhdimësi gjyqfituesit e pasistemuar.

Rëndësia:

E lartë

Rekomandimi:

Titullari i institucionit të analizojë veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm duke nxjerrë përgjegjësitë e veprimtarisë së tij të pamjaftueshme, si dhe Kryetari i Komisionit të Posaçëm të marrë masat për të thirrur mbledhje të komisionit me qëllim shqyrtimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt “Rikthim në punë të punonjësve”, duke parashtruar alternativa të pranueshme ndaj gjyqfituesve, me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e shtetit.

4. Titulli gjetjes:

Efekte financiare të shkaktuara si pasojë e largimeve nga puna të ish punonjësve të DPD.

Gjatë vitit 2022 janë likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë për 8 ish punonjës të DPD të larguar nga puna, në vlerën 5,847,000 lekë. Referuar vendimeve të përcjella për t’u likuiduar, rezultojnë të kenë mbetur pa paguar deri në datën 31.12.2022 vendime për ish punonjës në vlerën 2,362,000 lekë, të cilat janë likuiduar përgjatë muajit Janar dhe Shkurt të vitit 2023. Pra në total, rezultojnë 9 vendime në vlerën totale prej **8,210 mijë lekë**, ku 3 vendime i përkohjnë vitit 2022, dhe 6 vendime të periudhave të mëparshme, dhe nga të cilat vlera prej 416,535 lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore. Nga ana e DPD nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimet gjyqësore për largimet nga puna, duke mos vepruar sipas kërkesës së pikës 60 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Situata:

-Sipas informacionit të vendosur në dispozicion lidhur me çështjet gjyqësore në proces që lidhen me marrëdhëniet me punonjësit, rezultojnë në total **46** të tilla, nga të cilat 15 çështje lidhen me ish punonjës dhe 31 çështje paraqiten me objekt transferimesh apo orësh jashtë orarit të punonjësve aktual të autoritetit doganor.

Pika 5 dhe 9 e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme në llogari të Thesarit.

Kriteri :

Neñit i ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, - Pika 2.3,4 dhe 6 e Urdhrit nr. 5151 datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Ndikimi/Efekti	Efekte financiare në vlerën 8,210,144 lekë .
Shkaku:	Vendimmarrja jo e drejtë për largimin nga puna të ish punonjësve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPD nëpërmjet strukturave të brendshme saj të marrin masat për krijimin e kushteve të favorshme që linjat e raportimit mes sektorëve të garantojnë njoftimin e menjëhershëm të Sektorit të Financës në momentin e marrjes në dorëzim të një vendimi nga Sektori Juridik, me qëllim shmangien e tarifave përmbareme që shoqërohen me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.
	-Titullari i DPD të marrë masa për të garantuar një vendimmarrje sa më të drejtë lidhur me marrëdhëniet e punës së punonjësve të DPD (duke përfshirë këtu largimet, transferimet apo orët e punës për të cilat punonjësit e DPD janë aktualisht në procese gjyqësore), për të shmangur krijimin e efekteve financiare të buxhetit të shtetit në të ardhmen.

5. Titulli gjetjes: Numri i lartë i punonjësve të transferuar përkohësisht në pozicione të tjera pune në strukturën e DPD.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 janë kryer 172 procedura transferimesh, nga të cilët 131 transferime të nëpunësve civil dhe 41 transferime të punonjësve jashtë statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi u konstatuan fenomene të **transferimeve të realizuara për një periudhë me kohëzgjatje mbi 6 muaj, transferime në kategori të ndryshme; transferime nga një pozicion me status në pa status dhe anasjelltas.**

Situata: Në vijim të kërkesës së grupit të auditimit për argumentimin e vendimmarrjes për kryerjen e një numri të konsiderueshëm të transferimeve të punonjësve, duke shmangur procedurën e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele”, të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe sipas pikës “3” gërma “a” të kreut “I” të VKM-së nr 125 të datës 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, nga DPD raportohet se transferimet e përkohshme kryhen bazuar në shkronjën “a” të pikës nr “7” të nenit “15” të ligjit nr 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; pikën 3 të nenit 13 dhe pikën 7, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 13, neni 15 – “Marrëdhëniet e punës, pranimi, lëvizja paralele, ngritja në detyrë, transferimi i përkohshëm, pezullimi dhe largimi nga detyra i personelit të administratës doganore”, pika 7. Për sa më sipër, sipas DPD në rastin e shërbimit doganor, për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, janë parashikuar rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve e kohëzgjatjes së tyre, ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime, ku në shkronjën “i”, pika 7/a, të nenit 15, të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk ka dispozitë kufizimi të ngjashme me pikën 1/a, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sipas se cilës mund të behet një transferim i përkohshëm i një nëpunësi deri në 6 muaj (me/ose pa ndërprerje) për nevoja të punës, ku kjo lejohet një herë gjate dy viteve dhe sipas kësaj dispozitë një punonjës doganor, mund të transferohet përkohësisht, për nevoja të institucionit, sa here çmohet një nevojë e tille, pa patur ndonjë kufizim.

Gjithashtu transferimet nga një pozicion jo pjesë të shërbimit civil në administratën doganore në pozicion me status nëpunësi civil dhe anasjelltas, nga ana e DPD janë kryer duke patur për bazë dispozitat e përcaktuara në pikën 3 të nenit 13, pikën 7 të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe pikën 1 të Kreut V, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të ndryshuar.

Procesi i transferimit të përkohshëm në administratën doganore, është mbikëqyrur për çdo rast nga Departamenti i Administratës Publike (shkronja “c”, pika 2, neni 7 i

	ligjit nr.152/2013), pasi, për çdo rast akti i transferimit i është dërguar edhe këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 1 të Kreut V, të VKM nr. 921, datë 29.12.2014.
	Gjithashtu, përgjatë vitit 2022, transferimet janë impaktuar nga mos finalizimi i procesit të ristrukturimit të institucionit, si dhe pezullimi i procedurave të rekrutimit. Ligji nr 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;
	Ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”;
Kriteri :	VKM nr 125 të datës 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil”;
	VKM Nr. 921, datë 29.12.2014 “Për personelin e administratës doganore”.
Ndikimi/Efekti:	Numri i lartë i transferimeve në pozicione të tjera pune nga ku janë të emëruar punonjësit.
Shkaku:	Mbivendosje në kuadrin ligjor në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës në autoritetin doganor, mos marrja e masave nga ana e autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e rasteve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	DPD, në bashkëpunim me Departamentit e Administratës Publik apo edhe struktura të tjera që gjykohen të nevojshme, të marri masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e procedurës së deritanishme të transferimeve të punonjësve në zbatim të dispozitave të Kodit Doganor, për të konsoliduar strukturën organizative me punonjës të përheshëm dhe për të shmangur mangësitë e trajtuar më sipër që mund të çënojnë arritjen e objektivave institucional.

2.8.c. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë Juridike

Në zbatim të drejtimit “8,c programit të auditimit “Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimtarisë së Drejtorisë Juridike ” u shqyrtuan informacionet dhe dokumentacionet:

-Planin e punës për vitin 2022;

-Raportin e punës të Drejtorisë Juridike për vitin 2022;

-Informacion mbi propozimet ligjore dhe nënligjore të përgatitur nga sektori legjislativ si dhe mendimin juridik për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave në lidhje me shkeljet në fushën doganore, miratimin e manualit udhëzues mbi zbatimin e dispozitave në lidhje me Titullin IX, nenet 250-283 të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Rsh”, I ndryshuar, VKM Nr.651, datë 10.11.2017 për “Dispozitat në zbatim të ligjit 102/2014 “Kodi Doganor I Rsh”, i ndryshuar.

-Informacion mbi administrimin e procesit të ankimit administrative, sektori i ankimeve, referuar legjislativ doganor dhe të akcizës lidhur me vendime të Degëve Doganore;

-Informacion mbi ndjekjen e proceseve gjyqësore administrative/civile, penale në të gjitha nivelet e gjyqimit;

-Informacion mbi ndjekjen e praktikave përmbare për vendimet gjyqësore të formës së prerë duke koordinuar veprimtarinë me struktura të tjera.

-Numri total i ankimeve të trajtuara për vitin 2022

-Numri i ankimeve që nuk janë marrë në shqyrtim përgjatë vitit 2022

-Numri i ankimeve të shqyrtuara që nuk janë pranuar dhe është lënë në fuqi vendimi i Degëve Doganore përgjatë vitit 2022

-Numri i ankimeve të pranuar

Drejtoria Juridike, Sektori i Ankimeve gjatë vitit 2022 në përmbushje të detyrave të tij funksionale administrimin e procesit të rekursit administrative lidhur me vendime të degëve

doganore dhe administrimin dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore administrative civile në të gjitha nivelet e gjykimit, ka kryer këto veprime:

Përfaqësimi në proceset gjyqësore

Juristët e Sektorit të Ankimimeve, gjatë vitit 2022 kanë përfaqësuar Administratën Doganore në gjithsej 217 procese gjyqësore nga të cilat: 4 Padi të ngritura nga DPD: Padi civile 1, Padi administrative 3. Padi të ngritura nga të tretët: - Janë në proces 213 padi me operatorë ekonomik, personel.

Janë arritur këto rezultate: Rezultatet e proceseve të ndjekura në tre shkallët e gjykimit: Fituar 74, Humbur 42, Fituar pjesërisht 3, Humbur pjesërisht 3. Rezulton të jenë ende në proces trajtimi 75 prej tyre. Bëjmë me dije se ky numër është në dinamizëm pasi nuk kanë mbaruar të tre shkallët e gjykimit, por gjithashtu subjektet mund të ngrenë padi të reja me objekte të ndryshme padie.

Ankimimet Administrative

Gjate periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë administruar/shqyrtuar 168 ankime administrative, nga të cilat prej tyre: Kërkesa ankimore të përfunduara: 168; Mospranim ankimi 45, Rishikime 1, Kthim përgjigje 17, Pranime 2, Lënie në fuqi 103. Kërkesat ankimore, në varësi të llojit të shkeljes së kryer vërehet se numrin më të madh e zënë: Rivlerësimi doganor, Keq Klasifikimi, Regjimet Doganore, Akciza, Parregullsi në dokumentacion të natyrave të ndryshme.

Auditimi i përputhshmërisë së Sektorit të Ankimimeve është kryer për:

I. Auditimi i përputhshmërisë së sektorit të ankimimeve për administrimin dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore.

II. Auditimi ankimeve ndaj vendimeve të degëve doganore.

III. Auditimi i ndjekjes së praktikave përmbarimore nga sektori i ankimeve.

Lidhur me pikën e parë të auditimit: Auditimi i përputhshmërisë së sektorit të ankimeve për administrimin dhe ndjekjen e proceseve gjyqësore, konstatohet se:

Nga veprimtaria e administrimit dhe ndjekjes se proceseve gjyqësore nga 42 procese ku Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është palë humbëse janë audituar 8 procese gjyqësore , 5 prej të cilave janë në fazën ku është dhënë vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe është paraqitur kërkesë ankimore dhe 3 Vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ndaj të cilave nuk lejohet ankim dhe është i formës së prerë. Shuma totale e detyrimeve dhe penalteteve në objektin e padisë së këtyre vendimeve gjyqësore të audituara është 16,059,812 lekë. Auditimi është kryer:

1. Lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.3155, datë 24.11.2022 ndër të tjera ka vendosur pranimin e kërkesë padisë të shoqërisë “T.O.” sha me NUIS K...F; Shfuqizimin e vendimit nr.542, datë 31.03.2022 DDT dhe vendimit nr.8809, datë 26.09.2022 të DPT; Detyrimin e DPT të kthejë shumën 1,420,124 lekë të mbajtur padrejtësisht. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën ankimore nr.7000/1prot., datë 04.05.2022.

2. Lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. Vendimi nr.3441, datë 23.12.2022 ndër të tjera ka vendosur pranimin e kërkesë padisë të shoqërisë “G.S.” SHPK me NUIS M..V; Shfuqizimin e vendimit nr.605, datë 13.04.2022 DDT-së dhe vendimit nr.11751/1, datë 28.07.2022 të DPT-së. Detyrimin e DPT-së të kthejë shumën 1,909,641 lekë të mbajtur padrejtësisht. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën ankimore nr.5581/1,prot., datë 06.04.2023.

3. Lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. Vendimi nr.1626, datë 24.05.2022 ndër të tjera ka vendosur pranimin e kërkesë padisë të shoqërisë “P” SHPK me NUIS K..C; Shfuqizimin pjesërisht të aktit datë 29.05.2021, me numër reference R48900 në lidhje me përcaktimin e vlerës së detyrimit doganor sipas “të dhënave të disponueshme”; Shfuqizimin e formularit të rivlerësimit doganor datë 29.05.2021 për R48900 nga zyra e vlerësimit DVQ; Shfuqizimin e vendimit nr.370, datë 08.06.2021 të Degës së Doganës Tiranë; Shfuqizimin e vendimit nr.13720/1, datë 03.09.2021 të DPD-së; Detyrimin e palës së paditur për të kthyer diferencën e pagesës për detyrim doganor nëpërmjet vlerësimit sipas “të dhënave të disponueshme” me vlerësim sipas “vlerës së transaksionit” në masë 3 145 059 lekë. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën ankimore nr.14659/1prot., datë 22.08.2022.

4. Lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. Vendimi nr.34, datë 18.01.2022 ndër të tjera ka vendosur pranimin e kërkesë padisë të shoqërisë “S.” SHPK me NUIS K...T; Shfuqizimin e vendimit nr.222, datë 05.05.2022 DDT-së dhe vendimit nr.12270/1, datë 26.08.2022 të DPD-së. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën ankimore nr.2100/1prot., datë 18.02.2022.

5. Lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor në të cilin Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. Vendimi nr.185, datë 26.05.2021 ndër të tjera ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë të shoqërisë “A.” SHPK me NUIS L...4M; Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të formularit të rivlerësimit doganor për deklarata doganore IM4 me numër R4285, R4855, R4859, R4866, R4864, R 4858, R4865, R4867, R4870, R4869, R4857, R 4863, R4853, datë 05.04.2019 dhe R223, datë 08.04.2019. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka paraqitur kërkesën ankimore nr.15838, datë 14.09.2022.

Lidhur me auditimin e procesit të gjykimit të 3 Vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ndaj të cilave nuk lejohet ankim dhe është i formës së prerë dhe ku DPD është palë humbëse, konkretisht:

-Vendimi nr.1915, datë 22.06.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse shoqëria “A.G.” SHPK, me NIPT L..B, palë të paditura: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Dega e Doganës Tiranë.

-Vendimi nr.80-2022-2095, datë 06.07.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë paditëse “J. D.” PF, me NIPT K..N, palë të paditura: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Dega e Doganës Tiranë.

-Vendimi nr.169, datë 26.05.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me palë paditëse shoqëria “A.G.” SHPK, me NIPT L..B, palë të paditura: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Dega e Doganës Durrës.

A. Konstatohet se për të tre proceset e gjykimit të zhvilluara në shkallë të parë se palët e paditura nuk kanë paraqitur prova dhe fakte për të provuar bazueshmërinë në ligj të formularëve të rivlerësimit doganor të nxjerra jo me kërkesë të paditësve, nuk ka paraqitur prova dhe fakte për të argumentuar se në këto raste jemi në mospranim të vlerës së transaksionit dhe përse nuk janë zbatuar metodat dytësore të vlerësimit doganor.

Në kundërshtim me nenin 70/1 të Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Neni 70 Metoda dytësore për vlerësimin doganor 1. “Kur vlera doganore e mallrave nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 66, ajo përcaktohet duke ndjekur, sipas radhës, procedurën e përmendur nga shkronja “a” deri në “ç”, të pikës 2, të këtij neni, duke u ndalur në të parën shkronjë, sipas së cilës mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave. Radha e zbatimit të shkronjave “c” dhe “ç” këmbëhet nëse këtë e kërkon deklaruesi.”

3. Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1, të këtij neni, ajo përcaktohet në bazë të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të: a) marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT); b) nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë; c) këtij kreu.

B. Konstatohet se për të tre proceset e gjykimit të zhvilluara në shkallë të parë se palët e paditura kanë vepruar në kundërshtim me nenet 35/1,37/1 të Ligjit 49/20112 “Për Gjykata Administrative dhe Gjykimi në Mosmarrëveshje Administrative”, i ndryshuar.

Veprime në kundërshtim të neni 35 Barra e provës 1. Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

Neni 37 Kufijtë e shqyrtimit të çështjes 1. Gjykata shqyrtton ligjshmërinë e veprimit administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ.

Përsa më sipër për Vendimin nr.1915, datë 22.06.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë mban përgjegjësi znj.I.B. në cilësinë e Juristit përgjegjës.

Përsa më sipër për Vendimin nr.80-2022-2095, datë 06.07.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mban përgjegjësi znj.A.G. në cilësinë e Juristit përgjegjës.

Përsa më sipër për Vendimin nr.169, datë 26.05.2022 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës mban përgjegjësi z.B.Gj.në cilësinë e Juristit përgjegjës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga zj.V.N., zj.L.B., zj.V.D., zj.A.G., zj.M.Z., zj.I.B., z.B.Gj. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Lidhur me auditimin e procesit të gjykimit të tre vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë ritheksojmë edhe një herë qëndrimin tonë ashtu si shprehëm edhe në aktin e konstatimit nr.6 që Grupi Auditues nuk mund të bëjë interpretimin e vendimit gjyqësor pasi kjo e drejtë i takon vetëm gjykatës që ka dhënë vendimin. Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata. jemi në juridiksionin gjyqësor dhe për rrjedhojë jashtë juridiksionit të kontrollit administrativ. Konstatimi se nga ana e DPD-së nuk janë përcjellë provat shkresore nuk qëndron pasi në proces janë përcjellë të gjitha provat që Administrata Doganore ka disponuar dhe Drejtoria Juridike nuk mund të përcjellë prova fiktive përveç atyre që disponohen nga institucioni. Pavarësisht kësaj Drejtoria Juridike e ndërton mbrojtjen bazuar jo vetëm në arsyetimin apo procedurën e ndjekur nga dega doganore, por shikon cdo mundësi qoftë nga ana dokumentare e praktikës apo qoftë nga argumentimi më i plotë juridik për të mbrojtur dhe lënë në fuqi rivlerësimin. Për rrjedhojë citimi në arsyetimin e gjykatës që është në funksion të justifikimit të vendimmarrjes së Gjykatës nuk mund të shërbejë si indicje për të arritur në përfundimin që Drejtoria Juridike nuk ka bërë mbrojtje si duhet. Shprehja që përdor gjykata që “organi publik nuk arrit të justifikojë barrën e provës”, nuk interpretohet që nga Drejtoria Juridike nuk është bërë mbrojtje profesionale por ka kuptimin që nga provat e administruara në procesin gjyqësor këto prova nuk justifikojnë “procedurën apo vendimmarrjen e marrë nga administrata doganore”. Juristët e administratës doganore kanë paraqitur të gjitha provat që administrohen nga administrata jonë, termat e përdorur nga gjyqësori nuk do të thotë që nuk janë paraqitur prova por këto prova të administruara nuk janë çmuar nga gjyqësori si prova bindëse për argumentet tona të dhëna gjatë procesit. Kjo nuk do të thotë që nuk janë depozituar të gjitha provat.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për pikën e parë të observimeve paraqitur nga ky sektor (faqe1-8) lidhur me konstatimet e grupit të auditimit se si janë ndjekur nga ky sektor e juristët përgjegjës 3 proceset e perfunduara të gjykimit nga të cilët janë dhënë nga Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë 3 vendime ndaj të cilave nuk lejohet ankimi dhe janë të formës së prerë, në të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është palë humbëse nga shqyrtimi kostatojme se nuk kanë fakte e prova të reja dhe nuk merren parasysh. Gjithashtu per faktin ,(faqe 5) se procesi gjyqësor në lidhje me vendimin nr.80-2022-2095, date 06.07.2022*

i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është ndjekur nga përfaqësuesja e DPD-së zj.A.G., edhe kjo juriste /specialiste ngarkohet më përgjegjësi.

Auditimi ankimimeve ndaj vendimeve të degëve doganore

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë administruar/shqyrtuar 168 ankime administrative, nga të cilat prej tyre: Kërkesa ankimore të përfunduara: 168; Mospranim ankimi 45, Rishikime 1, Kthim përgjigje 17, Pranime 2, Lënie në fuqi 103.

Janë audituar 7 ankimime ndaj vendimeve të degëve doganore, 2 ankimet e pranuar, 1 ankim të rishikuar, 1 mospranim ankimi, 3 ankimet të shqyrtuara të rrëzuara, të pambështetura në ligj, në të cilat është lënë në fuqi vendimi i degëve doganore.

1. Subjekti “E.D”, PF me NUIS K...U ka paraqitur kërkesë ankimore me nr. 19630Prot., datë 07.11.2022 kundër vendimit nr.801, 802, datë 08.07.2022 të Degës Doganore Tiranë. Ankimim brenda afatit kohor, paguar detyrimet e garancinë. Vendimi nr.19630/4prot., datë 23.01.2023 I DPD-së lë në fuqi vendimet e mësipërme.

2. Subjekti “D.” SHPK me NUIS K..A ka paraqitur kërkesë ankimore me nr. 16301Prot., datë 14.09.2021 kundër vendimit nr.877, datë 12.08.2021 të Degës Doganore Durrës. Ankimim brenda afatit kohor, paguar detyrimet e garancinë. Vendimi nr.21738/1prot., datë 24.02.2022 I DPD-së anulon vendimin e DDD-së.

3. Subjekti “D” SHPK me NUIS K...A ka paraqitur kërkesë ankimore me nr. 14657Prot., datë 09.08.2022 kundër vendimit nr.906, datë 15.07.2022 të Degës Doganore Durrës. Ankimim konstatim pavlefshmëri absolute. Vendimi nr.14657/1 prot., datë 18.08.2022 I DPD-së ka vendosur mospranim ankimi.

4. Subjekti “K” SHPK me NUIS K..K ka paraqitur kërkesë ankimore me nr. 11682Prot., datë 20.06.2022 kundër vendimit nr.658, datë 19.05.2022 të Degës Doganore Durrës. Ankimim brenda afatit kohor paguar detyrimet e garanci. Vendimi nr.11682/6prot., datë 21.10.2022 i DPD-së lë në fuqi vendimin e mësipërm.

5. Subjekti “NT” PF me NUIS L...T ka paraqitur kërkesë ankimore me nr.16283Prot., datë 13.09.2021 kundër vendimit nr.7549, datë 01.09.2021 të Degës Doganore Tiranë. Ankimim brenda afatit kohor paguar detyrimet e garanci. Vendimi nr.16283/5prot., datë 02.02.2022 I DPD-së anulon vendimin e mësipërm.

6. Subjekti “T” SHPK me NUIS L..B ka paraqitur kërkesë ankimore me nr.12533prot., datë 07.11.2022 kundër vendimit nr.24, datë 07.10.2022 të Degës Doganore Korçë. Ankimim brenda afatit kohor paguar detyrimet e garanci. Vendimi nr.12533prot., datë 07.10.2022 i DPD-së lë në fuqi vendimin e mësipërm. Pika 1 e vendimit 44, datë 31.08.2022 ndryshohet, pika 2 e vendimit 44 datë 31.08.2022 shfuqizohet.

7. Subjekti “FD” SHPK me NUIS K...B ka paraqitur kërkesë ankimore me nr.9106Prot., datë 26.06.2022 kundër vendimit nr.432, datë 24.03.2022 të Degës Doganore Tiranë. Vendimi nr.9106/2prot., datë 06.07.2022 i DPD-së lë në fuqi vendimin e mësipërm.

Ankimi me nr.9106 Prot., datë 26.06.2022 është paraqitur brenda afatit ligjor, ankimesi ka paguar shumën e përgjithshme të detyrimit si dhe ka garantuar shumën e penaltetit të përcaktuar në nenin 282 të Kodit Doganor.

Auditimi i ndjekjes së praktikave përmbarimore nga sektori i ankimimeve

Sektori i Ankimimeve brenda Drejtorisë Juridike përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe nga 7 specialistë. Përgjatë vitit 2022 struktura e sektorit të ankimimeve ka qenë e plotë.

Sektori i Ankimimeve referuar pikës 4.2 të nenit 64 të Urdhrit nr.146 datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”, ka si detyrë

kryesore të administrojë procesin e rekursit administrative referuar legjislacionit doganor dhe të akcizës lidhur me vendimet e degëve doganore, të ndjekë proceset gjyqësore administrative/civile, të përgatisë informacione, raportime për eprorët e institucionit, të ndjekë praktikatat përbarimore për vendime gjyqësore administrative/civile etj.

Konstatohet se Sektori i ankimimeve nuk ka ndjekur praktikatat përbarimore për vendimet gjyqësore administrative/civile të formës së prerë duke koordinuar veprimtarinë me strukturat e tjera.

Veprimtaria vendimmarrëse dhe zbatuese e këtij sektori nuk përputhet me:

1.Nenin 10/2 të Kodit Doganor sipas të cilit: 2. Autoritetet doganore janë përgjegjëse për: a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod, në ligje të tjera specifike dhe në akte nënligjore për mallrat në hyrje, në dalje dhe brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë; 2.Me nenin 64, pika 4.2 , Detyrat funksionale të Sektorit të Ankimimeve të Urdhëri Nr.146, datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”, sipas të cilit ky sektor ndjek praktikatat përbarimore për vendimet gjyqësore administrative/civile të formës së prerë duke koordinuar veprimtarinë me strukturat e tjera. Sipas përgjigjes detyra nuk është kryer.

Përsa më sipër mban përgjegjësi znj.V.N. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe znj.L.B. në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të ankimimeve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me nr. 283/26 prot., datë 01.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Auditimi i ndjekjes së praktikave përbarimore nga sektori i ankimimeve paraqesim observacionin si më poshtë:

Mbështetur në udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, në asnjë momentaktet ligjore në fuqi nuk ngarkojnë Sektorin e Ankimimeve për të ndjekur dhe mbikëqyrjen e dosjeve përbarimore të përbaruesve. Referuar edhe në VKM nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.921, datë 29.12.2014 për personelin e administratës doganore”, sektori i ankimimeve nuk përfshihet në këto detyra.

Qëndrimi i grupit të auditimit:*Për pikën e dytë të observimeve paraqitur nga ky sektor (faqe 8-13) lidhur me konstatimet e grupit të auditimit se si janë ndjekur praktikatat përbarimore nga sektori i ankimimeve ku theksohet “në asnjë moment aktet ligjore në fuqi nuk ngarkojnë sektorin e ankimimeve dhe mbikëqyrjen e dosjeve përbarimore të përbaruesve”,(paragrafi 3 f.9) se:“konstatimi nuk qëndron se Sektori i Ankimimeve nuk përfshihet në këto detyra për të ndjekur ecurinë e proceseve të ekzekutimit”,(paragrafi 4 f.9) duke anashkaluar ndjekjen e praktikave përbarimore për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe koordinimin me struktura të tjera, ato nuk qëndrojnë e nuk merren në konsideratë. Këto observime nuk kane fakte e prova të reja, ato nuk merren në konsideratë.*

Sektori i Legjislacionit

Sektori i Legjislacionit i Drejtorisë Juridike përbëhet nga një përgjegjës sektori dhe nga 4 specialistë. Përgjatë vitit 2022 struktura e sektorit të legjislacionit ka qenë e plotë.

Sektori i legjislacionit referuar pikës 4.1 të nenit 64 të Urdhrit nr.146 datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”, ka si detyrë kryesore të përgatisë propozime ligjore dhe nënligjore të gjitha niveleve për çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë e administratës doganore në bashkëpunim me strukturat kompetente, të ndjek përafrimin e legjislacionit doganor në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të BE-së, të jap mendim juridik për projekt aktet ligjore dhe nënligjore të gjitha niveleve të hartuara nga strukturat e Administratës Doganore etj.

Auditimi i përputhshmërisë ligjore të Sektorit të Legjislacionit është ushtruar për:

-Përgatitjen e propozimeve ligjore dhe nënligjore të gjitha niveleve për çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë e administratës doganore në bashkëpunim me strukturat kompetente për këtë qëllim;

- Dhënien e mendimeve juridike për projekt aktet ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve të hartuara nga strukturat e administratës doganore.

Kemi audituar dokumentacionin për:

Projekt urdhra/udhëzime dhe rregullore të cilat janë iniciuar nga DPD konkretisht:

1.Manuali Udhëzues “Garancitë për një borxh të mundshëm ose për borxhe doganore ekzistuese”, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit "Mbështetje për administratën doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e Kodit Doganor BE dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në fushën e mallrave të falsifikuara”;

2.Draft udhëzimi "Për procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të “certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor".

Projektvendime të cilat janë iniciuar/hartuar nga DPD ose ku DPD ka qenë pjesëmarrëse:

1.Projektvendimi “Për miratimin e rregullave të hollësishme mbi procedurën e deklarimit në kufi dhe vendosjes së sanksioneve ...”;

2.Projektvendimi "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2023".

I. Konstatohet mungesa e udhëzimit mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizat.

Lidhur me pikën e parë të auditimi konstatohet se ky sektor nuk ka përgatitur projekt udhëzim “Mbi Zbatimin e Dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës në zbatim të ligjit nr. 102/2014, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

Manuali udhëzues nr.05, datë 31.03.2016 Mbi Zbatimin e Dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës , i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është mbështetur në Pjesën VIII, nenet 256 deri 296 , të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në Kreun XII, nenet 84 deri 107 të Ligjit nr.61,datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ky manual udhëzues ka dalë me synim zbatimin korrekt dhe trajtimin uniform të shkeljeve doganore dhe akcizës dhe është bazuar në nenin 3, pika 3.2 të VKM nr.205, datë 13.4.1999, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar dhe nenin 68, pika 10 të VKM nr.612, datë 05.09.2012, “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për Akcizat”, të ndryshuar. Ky udhëzim ka hyrë në fuqi më datë 22.04.2016.

Pas hyrjes në fuqi plotësisht të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", datë 1 Qershor 2017 ky udhëzim duhet të zëvendësohet duke u bazuar në kërkesat e reja të tij.

Në kodin doganor 2014 ligjvënësi në varësi nga lloji i përgjegjësisë, kundërvajtjen e ka ndarë në tri kategori: Kundërvajtje me përgjegjësi objektive, Kundërvajtje të kryer me neglizhencë, Kundërvajtje me dashje. Në këtë mënyrë ndërsa në përkufizimin e mëparshëm të kundërvajtjes neni 256 i kodit faji prezumohej dhe përgjegjësia objektive nuk shprehej tekstualisht në nenet 251-252 të kodit doganor 2014 mungon përkufizimi i kundërvajtjes ndërkohë pranohet instituti i përgjegjësisë objektive. Duke mbajtur parasysh dhe mungesën e një ndarje të qartë të veprimeve që përbëjnë kundërvajtje me përgjegjësi objektive, neglizhencë nga ato me dashje, konstatojmë se në kuptimin e tyre, në zbatimin praktik, në konstatimin e plotë të gjendjes faktike e mënyrës se kryerjes, në klasifikimin e saktë të shkeljeve doganore, si dhe në kalimin e barrës së provës

autoritetit vendimmarrës, kanë lindur probleme me pasoja trajtim jo të barabartë, rëndimin apo lehtësimin padrejtësisht të pozitës së personit që ka kryer shkeljen.

Duke patur parasysh që sanksionet që aplikohen të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese dhe arrijen e synimit për trajtimin uniform të shkeljeve doganore dhe akcizës konstatojmë impaktin e munguar të zbatimit të ligjit në praktikë, moskuptimin e dallimeve ndërmjet shkeljeve me përgjegjësi objektive, me neglizhencë dhe me dashje. Proces verbali i verifikimit të kundërvajtjes administrative është miratuar në udhëzimin për trajtimin e shkeljeve të vitit 2016 dhe është në fuqi megjithëse ka ndryshuar plotësisht titulli IX i Kodit Doganor për shkeljet doganore dhe verifikimin e tyre. Edhe pse kanë kaluar 6 vjet nga hyrja e tij në fuqi e Titullit IX Shkeljet në fushën doganore, Sanksionet dhe Ankimi Manuali udhëzues nr.05, datë 31.03.2016 Mbi Zbatimin e Dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës, i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave edhe pse bie ndesh me këto dispozita të këtij kodi vazhdon të mbetet në fuqi.

Nga auditimet e auditit të brendshëm është rekomanduar nxjerrja e një udhëzimi për trajtimin e shkeljeve doganore. Konstatohet se vullneti për nxjerrjen e këtij udhëzimi për zbatimin e ligjit ka munguar dhe për të realizuar normalitet në këtë veprimtari sektori i legjislacionit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për trajtimin e shkeljeve doganore, duhet me nismën e vet të përgatit projekt udhëzimin jo vetëm si e drejtë por si një detyrim shtetëror. Është e detyrueshme në zbatimin me korrektësi të ligjit nxjerrja e një udhëzimi “Mbi Zbatimin e Dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore dhe akcizës në zbatim të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, interpretimeve të ligjit material nëpërmjet orientimit nga jurisprudenca e praktika gjyqësore e vendeve komunitare.

Duke qenë se Sektori i Legjislacionit është përgjegjës për zbatimin e Kodit Doganor bazuar në nenet 10/2, 737, 739 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Nenet 50,54,64,82 të Urdhëri Nr.146, datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”; Veprimtaria vendimmarrëse dhe zbatuese e këtij sektori nuk përputhet me:

1.Nenin 10/2 të Kodit Doganor , Autoritetet doganore janë përgjegjëse për: a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod, në ligje të tjera specifike dhe në akte nënligjore për mallrat në hyrje, në dalje dhe brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

2.Nenet 737, 739 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

Neni 737 Akte nënligjore 1. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, mbështetur në parimet e përcaktuara në Kod, miraton udhëzime, rregullore apo manuale udhëzuese etj., për zbatimin në praktikë apo në sistemin kompjuterik/elektronik doganor të këtij vendimi. 2. Aktet e nivelit të tretë që rregullojnë elementët procedurale, të dala në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi doganor i R.SH”, dhe vendimit nr. 205, datë 13.4.1999, të Këshillit të Ministrave, do të vijojnë të zbatohen për aq sa nuk bien ndesh me përcaktimet e Kodit dhe të këtij vendimi, deri në shfuqizimin e tyre në mënyrë nominative.

Neni 739 Institucionet zbatuese Ngarkohen ministria përgjegjëse për financat dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Nenet 50, 54, 64, 82 të Urdhëri Nr.146, datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD”;

Neni 50 , hartimi i akteve normative ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve 1.Të drejtën për të iniciuar një projekt ligj, projektvendim të Këshillit të Ministrave, udhëzim, rregullore, urdhër, udhëzues,

manuale, marrëveshje, memorandum bashkëpunimi apo mirëkuptimi etj., e ka çdo strukturë e DPD sipas kompetencave lëndore përkatëse dhe misionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në këtë rregullore.

Neni 54 Drejtori i Përgjithshëm i Doganave: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kryen funksionet e tij bazuar në legjislacionin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përmbytur edhe detyrat e ngarkuara nga strukturat hierarkike. Drejtori i Përgjithshëm ka përgjegjësi si vijon: miraton, rregulloret specifike të funksionimit të drejtorive dhe degëve doganore, si dhe akte të tjera të nivelit të tretë, si, vendime, urdhra, udhëzime, etj., në varësi të nevojave të punës;

Neni 64, pika 4.1; detyrat funksionale të Sektorit të Legjislacionit kemi : Përgatit propozime ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve për çështje që kanë të bëjnë me veprimtarisë e administratës doganore në bashkëpunim me strukturat kompetente për këtë qëllim; Jep mendim juridik për projekt aktet ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve të hartuara nga strukturat e Administratës Doganore, etj.;

Neni 82 Miratimi i rregulloreve specifike dhe akteve të tjera të nivelit të tretë, Kjo Rregullore nuk pengon miratimin e rregulloreve të tjera specifike, në të cilën të përfshihen elemente teknik dhe specifik që nuk janë përfshirë në këtë rregullore. Rregulloret aktuale në fuqi të Drejtorive të DPD-së të cilat trajtojnë detaje të hollësishme të veprimtarisë së strukturës, mbeten në fuqi dhe do të zbatohen paralelisht me këtë rregullore. Në rast të kontradiktave midis dispozitave të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve specifike të Drejtorive, prevalon dhe do të merret për bazë kjo rregullore. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave për funksionimin normal të veprimtarisë doganore, në ushtrim të kompetencave të tij, miraton Rregulloret specifike të strukturave të DPD si dhe akte të tjera të nivelit të tretë, si urdhra, udhëzime, vendime, etj.

II. Lidhur me hartimin e legjislacionit, në dosjet e audituara konstatohet:

A. Nga auditimi i praktikës lidhur me dhënien e mendimit për projekt aktet e Drejtorisë së Laboratorit , analizimit të saj dhe dërgimin për miratim të projekt udhëzimit “Për procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave,, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të “Certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor”, konstatohet se:

1. Drejtoria Juridike, Seksioni i Legjislacionit nuk ka kryer konsultimin juridik në raport me parimet kushtetuese.

a) Nuk është bërë konsultim paraprak në parim për nevojën e hartimit të projekt udhëzimit dhe gjatë hartimit të projekt udhëzimit.

b) Nuk bëhen me dije komentet apo sugjerimet që janë marrë në konsideratë nga grupet me të cilat është bërë konsultimi si dhe përmbledhjen e argumenteve të atyre komenteve dhe sugjerimeve që nuk janë marrë parasysh. Pika 6 e projekt udhëzimit kërkesë për analizim të mostrës nga organe të tjera shtetërore, prokuroria, policia e shtetit, drejtoria e tatimeve e bëjnë të domosdoshme këtë konsultim. Gjithashtu bashkëpunimi me ISHTI-in është i domosdoshëm. ISHTI ofron një gamë të gjerë shërbimesh për vlerësimin e përputhshmërisë të cilësisë të nënprodukteve të naftës për respektimin e standardeve shtetërore dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me drejtorinë e doganave në aspektin e cilësisë, sigurisë për shëndetin dhe mjedisin sipas direktivave europiane.

2. Nuk është vlerësuar harmonizimi me legjislacionin në fuqi vendas dhe te huaj. Nuk janë përcaktuar saktë nenet , paragrafët apo nën paragrafët e Kodit Doganor dhe dispozitave zbatuese mbi të cilat bazohet udhëzimi dhe ato që preken nga ky udhëzim.

3. Nuk garantohet plotësisht një zgjidhje e mbështetur në ligj dhe në prova për të garantuar një proces të rregullt ligjor sepse: Ri analizimi në një laborator të pavarur duhet të jetë i parashikuar në një normë doganore apo në një nenin të Kodit Doganor. Ndërkohë që ri analizimi i mostrave në

laboratorët e tjerë si ISHTI-t apo laboratori ushqimor për artikujt ushqimor, nuk do të zgjidhte plotësisht mosmarrëveshjen lidhur me klasifikimin tarifor të mallit, i cili në bazë të neneve 169-170 të Kodit Doganor dhe neneve 349-352 të DZB është në kompetencë të DPD-së dhe mund të bëhet vetëm në një laborator doganor. Në gjykimin e mosmarrëveshjeve doganore konfliktit lidhur me klasifikimin tarifor të mallit nuk i jepet një zgjidhje e plotë.

4. Udhëzimi ka nevojë për qartësi pasi nuk specifikohen rastet kur nuk duhen lejuar mallrat të hidhen në qarkullim pa u lëshuar më parë certifikata e verifikimit, afatin kohor dhe përgjegjësinë në vonesën e përgjigjes së analizave në rast kontestimi.

5. Në udhëzim nuk përcaktohen kushtet praktike për ruajtjen e mostrave deri në përfundimin e proceseve gjyqësore e përgjegjësia në administrimin e elementëve të sigurisë së mostrave të marra në çastin e deklarimit të mallit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 2,3,4 të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili synon të rrisë llogaridhënien dhe transparencën e organeve publike në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore me interes publik.

Gjithashtu në kundërshtim vendimin nr.20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese, me konceptin e procesit të rregullt ligjor që shtrihet edhe në veprimtarinë ligjvënëse dhe ka të bëjë konkretisht me respektimin e procedurave konkrete të hartimit dhe miratimit të ligjit. Parimi shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësia dhe siguria juridike. Në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 02.11.2005, në të cilin vlerësohet se vetë siguria juridike si element i shtetit të së drejtës ka si kërkesë të domosdoshme që dispozita të veçanta duhet të jenë të qarta të përcaktuara dhe të kuptueshme.

B) Në lidhje me shkresën me Nr.20996Prot., datë 02.12.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i dërgon për miratim Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projekt vendimin për “Miratimin dhe Publikimin Zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2023”, relacionin dhe tabelën e përputhshmërisë. Projekt vendimi ka si objektiv zbatimin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, sipas versionit të përditësuar të Bashkimit Evropian si dhe Sistemin e Harmonizuar për vitin 2023 të Organizatës Botërore të Doganave. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka mundësuar hartimin e NK 2023, me qëllim hyrjen e saj në fuqi në të njëjtën datë me vendet anëtare të BE-së, më 1 Janar 2023, e cila sjell respektimin me korrektes të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe Marrëveshjeve të tjera të Tregtisë së Lirë, përmirëson raportimet statistikore dhe mundëson rakordimin e tyre me ato të BE-së dhe vendeve të tjera. Është përcjell për miratim : Projektvendimi "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2023"; Relacionin për miratimin e projekt vendimit “Për miratimin dhe Publikimin Zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2023” së bashku me tabelat e përputhshmërisë me aktet e BE-së; Lidhjen 1- Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave 2023; Shtojcën – A (Tabela e Korelimeve të kodeve Tarifore që ndryshojnë [NK 2022 – NK 2023].

1)Konstatohet mungesa e konsultimit me operatorët ekonomike para dhe gjatë hartimit të projektvendimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 2,3,4 të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, i cili synon të rrisë llogaridhënien dhe transparencën e organeve publike në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore me interes publik.

C) Me shkresën me nr.6445prot., datë 04.04.2022 Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka miratuar Urdhrin nr.10, date 04.04.2022 për miratimin e Manualit udhëzues “Garancitë për një borxh të mundshëm ose për borxhe doganore ekzistuese”. Me shkresën nr.6445prot., datë 04.04.2022 Drejtori i përgjithshëm i Doganave përcjell për njohje dhe zbatim Manualin udhëzues “Garancitë

për një borxh të mundshëm ose për borxhe doganore ekzistuese”. Lidhur me Manualin Udhëzues “Garancitë për një borxh të mundshëm ose për borxhe doganore ekzistuese”, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit “Mbështetje për administratën doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e Kodit Doganor BE dhe rritjen e kapaciteteve operacionale në fushën e mallrave të falsifikuara”; konstatohet:

1. Konstatohet mungesa e harmonizimit me udhëzimin “Për procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave,, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të “Certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor”, pasi Udhëzimi nuk është i qartë lidhur garancinë e mjaftueshme sipas nenin 355 Depozitimi i një garancie të DZB të Kodit Doganor, për shumën dhe kohën e vlefshmërisë së saj pasi sipas këtij neni kemi : “çlirimi i mallrave do të jetë i kushtëzuar me depozitimin e një garancie të mjaftueshme për të mbuluar diferencën midis shumës sipas deklaratave doganore dhe shumës e cila në fund mund të jetë e pagueshme”, afati kohor nuk mund të përcaktohet me termin “fund” duhet afati të jetë qartësisht i përcaktuar. (duke marrë parasysh edhe afatin e përfundimit të proceseve gjyqësor të mundshme).

2. Konstatohet se nuk janë marrë në konsideratë përgjegjësia, pamundësia e mbledhjes së gjobës dhe efektet e mundshme negative në rastet e çlirimit të mallrave për qarkullim të lirë pa pasur në dispozicion rezultatet e kontrollit dhe certifikatën e klasifikimit të mallrave.

3. Konstatohet se udhëzimi nuk është i qartë lidhur me çlirimin e mallrave lejimin e anijeve për shkarkim para rezultateve dhe lëshimit të certifikatës për klasifikimin tarifor të mallrave kur sipas nenit 357 kemi: “në rastin kur autoritetet doganore kanë dyshime ose një ndalim apo kufizim do të zbatohet apo jo dhe kjo nuk mund të zgjidhet derisa rezultatet e kontroleve të kryera nga autoritetet doganore të jenë në dispozicion, mallrat në fjalë nuk do të çlirohen”. Nuk është i qartë për përcaktimin e momentit të çlirimit e mallrave, dhënies së lejes për shkarkimin e anijeve pas verifikimit të mallrave, parashikuar në nenin 357 të DZB të Kodit Doganor; Pika 2 e këtij neni nuk është e qartë për rastet kur autoritetet doganore kanë dyshime ose një ndalim apo kufizim do të zbatohet. Janë të paqarta se cilat janë kriteret e klasifikimit se një ndalim apo kufizim do të zbatohet apo jo në varësi të përgjigjes së rezultateve të kontrollit laboratorit doganor.

Veprim në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.26, datë 02.11.2005, në të cilin vlerësohet se vetë siguria juridike si element i shtetit të së drejtës ka si kërkesë të domosdoshme që dispozita të veçanta duhet të jenë të qarta të përcaktuara dhe të kuptueshme.

D) Me shkresën Nr.21589/2Prot., datë 27.12.2022 mbi projektvendimin “Për miratimin e rregullave të hollësishme mbi procedurën e deklarimit në kufi dhe vendosjes së sanksioneve” pas shqyrtimit të projektvendimit të sjellë nga MFE kanë shprehur mendim ndër të tjera se duke qenë se pas ndryshimit që iu bë ligjit nr.9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me ligjin 33/2019 për disa ndryshime dhe shtesa u shtua neni 17/1 i cili parashikon se në rastet kur autoritetet doganore kryesisht ose në bashkëpunim me strukturat kompetente të Policisë së Shtetit konstatojnë mos deklaram në kufi, sipas pikës 1 të nenit 17/1, të ligjit, paralelisht me trajtimin e rastit, sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit Procedurës Penale, vendosin gjobë administrative. ... Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla të hollësishme për mënyrën e zbatimit të këtij neni.

- Duhej që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit të nxirrej vendimi nga Këshilli i Ministrave.

- Projekt vendimi është përditësuar shumë herë për shkak të komenteve të institucioneve të tjera akoma nuk është rënë dakord për një draft final.

Konstatohet vonesa në përmbushje të detyrës mos ngritje të një grupi të përbashkët me institucionet e tjera përgjegjëse me qëllim finalizimin e një drafti të dakortësuar dhe zbatueshëm në praktikë nga të gjitha palët.

Konstatohet mungesa e konsultimit me institucionet përgjegjëse për hartimin e projektvendimit.

Përsa me sipër mbajnë përgjegjësi:

Znj.V.N., në cilësinë e drejtores së Drejtorisë Juridike

Znj.V.D., specialist në Sektorin e Legjislacionit

Znj.A.G., specialist sektori i Legjislacionit

Znj.M.Z., specialist sektori i Legjislacionit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga Sektori i Legjislacionit është paraqitur observacioni me nr. 283/26prot, datë 01.09.2023 ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Sektori i legjislacionit mbështet dhe asiston konform ligjit cdo propozim që vjen nga strukturat kompetente zbatuesedhe janë këto struktura zbatuese që duhet të bëjnë propozime konkrete mbi cdo projekt akt, si mund të jetë edhe manuali për trajtimin e shkeljeve doganore. Mungon autorizimi ligjor për hartimin e manualit udhëzues për shkeljet doganore. Administrata doganore nuk mund të unifikojë praktikën për shkeljet doganore sepse shkeljet shqyrtohen apo vlerësohen rast pas rasti.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për ndarjen e parë të observimeve paraqitur nga ky sektor, (faqe 13-16) konstatimi i mungesës së udhëzimit mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet në fushën doganore, duke mos marrë në konsideratë se parimi i ligjshmërisë kërkon një legjislacion të plotë, njohje dhe kuptim të njëjtë të legjislacionit, zbatimin me përpikmëri e të detyrueshëm të tij, se inicimi i nxjerrjes së tij nga ky sektor se është kërkuar nga kontrolli i brendshëm dhe praktika punës së juristëve dhe punonjësve të administratës doganore që janë të ngarkuar me zbatimin e Titullit IX Shkeljet në fushën Doganore, Sanksionet dhe Ankimi të Kodit Doganor dhe duke kundërshtuar në inicimin e tij, ato nuk merren në konsideratë. Këto observime nuk kane fakte e prova të reja, ato nuk merren në konsideratë.*

Pretendimi i subjektit: Projekt udhëzimi “Mbi procedurat e mostrimit, transportimit, pranimit, ruajtjes së mostrave, administrimit të rezultateve laboratorike dhe hartimit të certifikatave të verifikimit të llojit të mallit dhe klasifikimit tarifor është një akt për përdorim të brendshëm, pra një akt i nivelit të tretë dhe procedura që duhet ndjekur për miratimin e tij është përcaktuar në nenin 50 të Urdhërit nr.146, datë 07.05.2018 “Për miratimin e rregullores së brendshme mbi funksionimin e DPD-së. Përsa i përket projekt vendimit “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2023”, sërish mbajmë qëndrimin sekonsultimi publik është proces që kryhet nga ministria përgjegjëse dhe jo nga DPD. Për manualin udhëzues “Garancite për një borxh doganor të mundshëm ose për borxhe doganore ekzistuese” jemi të mendimit se konstatimi nuk qëndron se kemi të bëjmë me një akt të nivelit të tretë, për përdorim të brendshëm për tu ardhur në ndihmë strukturave doganore dhe nuk përbën një akt detyrues me forcën e ligjit. Për projekt VKM “Për miratimin e rregullave të hollësishme mbi procedurën e deklarimit në kufi dhe vendosjes së sanksioneve”, ky projekt është miratuar e vazhdojmë të theksojmë faktin se ligji nr.146./2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik nuk e detyron DPD të bëjë këtë procedurë ligjore.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Për ndarjen e dytë të observimeve të këtij sektori (faqe 16-22) lidhur me mungesën e procesit të njoftimit dhe konsultimit public në proceset e hartimit të projekteve ligjore dhe nënligjore të cilat janë iniciuar/hartuar nga DPD ose ku DPD ka qenë pjesëmarrëse, duke mos marrë në konsideratë në asnjë rast përfshirjen në relacionin shoqërues dhe mendimin e dhënë nga ky sektor i drejtorisë juridike të nevojës për njohje dhe konsultim të palëve të interesuara dhe përfshirjen në planin vjetor aktet që do të konsultohen me publikun periudhën dhe mënyrën e konsultimit, informacion shpjegues për objektin dhe qëllimin e projekt aktit, këto observime nuk merren në konsideratë. Këto observime nuk kanë fakte e prova të reja dhe nuk merren në konsideratë.*

1.Titulli gjetjes: **Mos paraqitja e argumenteve e provave të mjaftueshme për metodën e vlerësimit të zbatuar dhe mungesa e ndjekjes së praktikave përmbarimore.**

Situata: Në ndjekjen e proceseve gjyqësore me objekt pavlefshmërinë e rivlerësimit doganor në gjykimin në shkallë të parë, Sektori i Ankimeve i Drejtorisë Juridike në DPD nuk ka paraqitur argumentet e mjaftueshme mbështetur në prova për metodën e vlerësimit të zbatuar, bazueshmërinë në ligj të formularëve të rivlerësimit doganor të nxjerra pa kërkesën e

paditësve, plotësimin e kushteve në mospranim të vlerës së transaksionit dhe arsyetimin e mungesës së zbatimit të metodave dytësore të vlerësimit doganor, me pasoja në argumentimin kundërshtues të plotë të provave të sjellë në gjykim nga palët paditëse.

- Gjithashtu, konstatohet se Sektori i Ankimimeve ka shfaqur dobësi në vperimtarinë e tij për të ndjekur praktikën përbarimore për ecurinë në ekzekutimin e vendimeve, pasi nuk ka kërkuar informacione në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e ekzekutimit të tyre, dhe nuk ka ushtruar kontrollin e dosjeve përbarimore mbi zbatimin e kontratave nga përbaruesit gjyqësor.

Kriteri :	Ligji nr.102/2014, datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë , i ndryshuar . neni 70/1; Urdhri nr.146, datë 07.05.2018 i MF “Për miratimin e rregullores së brendshme të DPD-së”, neni 64.
Ndikimi/Efekti:	Humbja e proceseve gjyqësor ndikon te të ardhurat doganore; Ndikon në mbledhjen e borxhit doganor;
Shkaku:	Mos zbatimi praktik i procedurave gjyqësore dhe neneve të vlerësimit doganor të Kodit Doganor; Mos kuptimi dhe mos zbatimi i plotë i rregullores së DPD-së.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Sektori i Ankimimeve i Drejtorisë Juridike në DPD të marrë të gjitha masat për të siguruar argumentimin dhe provat e nevojshme në proceset gjyqësore, për bazueshmërinë në ligj dhe në fakte të veprimeve të kryera prej autoriteteve doganore në rastin e rivlerësimit doganor. Gjithashtu, të kryejë një analizë të të gjitha dosjeve përbarimore për të arritur në konkluzione mbi ecurinë e tyre, si dhe të ndjekë në vijimësi praktikën përbarimore duke marrë informacione të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimeve nga përbaruesit gjyqësor.
2.Titulli gjetjes:	Mungesa e manualit udhëzues mbi zbatimin e dispozitave lidhur me shkeljet doganore dhe mungesa e konsultimit publik në hartimin e legjislacionit.
Situata:	Nga auditimi konstatohet se Sektori i Legjislacionit nuk ka përgatitur një akt administrativ për mënyrën e trajtimit të shkeljeve doganore, me qëllim që të ketë uniformitet në trajtimin klasifikimin dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, sipas përcaktimeve në nenet 737 dhe 739 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 50, 54, 64 dhe 82 të Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD” miratuar me Urdhrin nr.146, datë 07.05.2018 të MFE. Gjithashtu, Sektori i Legjislacionit nuk ka kryer konsultimin publik në hartimin e akteve dhe dhënien e mendimeve juridike për to, si një aspekt i rëndësishëm i mirëqeverisjes, pasi janë 2 Projekt urdhra/udhëzime dhe rregullore dhe 2 Projektvendime të cilat janë iniciuar/hartuar ose DPD ka qenë pjesëmarrëse, për të cilat ka munguar dokumentimi një vperimtarie të tillë.
Kriteri:	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Nenet 737, 739; Urdhëri Nr.146, datë 07.05.2018 të MFE për miratimin e Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD” Nenet 50, 54, 64, 82; Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, neni 6.
Ndikimi/Efekti	Mungesa e uniformitetit në trajtimin e shkeljeve doganore nga autoritetet doganore; Mungesa e transparencës në hartimin dhe vështirësi në zbatimin e legjislacionit.
Shkaku:	Mos kuptimi e mos zbatimi i plotë i Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor dhe rregullores së DPD-së; Mos kuptimi dhe mos zbatimi i plote i Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.
Rëndësia	E mesme
Rekomandimi	Sektori i Legjislacionit të hartojë dhe më pas të miratohet nga Titullari i institucionit një akt administrativ për zbatimin e dispozitave mbi shkeljet doganore, si dhe të përfshijë në planin

vjetor aktet që do të konsultohen me publikun, periudhën dhe mënyrën e konsultimit, informacion shpjegues për objektin dhe qëllimin e projekt aktit përkatës.

2.9. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të veprimitarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit

- *Vlerësimet e punës të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*
- *Vendimi përse I përket planifikimit të trajnimeve*
- *Rregullore e Brendshme e DPD dhe Rregullore e Brendshme e Degëve Doganore*
- *Urdhër nr. 2, datë 18.01.2022, “Për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik”*
- *Regjistri i Riskut*
- *Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe Plani i Veprimit të MFK-së*
- *Shkresat përcjellëse për përcaktimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, etj.*
- *Rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave*
- *Strukturën e njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe aktivitetin e saj*
- *Plani Strategjik dhe Plani Vjetor i Auditimit 2022 (së bashku me ndryshimet)*
- *Raporti Vjetor i DAB për vitin 2022*
- *Karta e Auditit të Brendshëm*
- *Dosje auditimi*

Nga auditimi i realizuar për vitin 2022, për aktivitetin e ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në DPD, është konstatuar se qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësia e aktivitetit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara në dokumentet themeluese të njësisë, siç janë Karta e Auditimit dhe Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të DPD, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 146, datë 07.05.2018.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është ngritur dhe funksionon në nivel Drejtorie, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe përcaktimet e standardit 1100 “Pavarësia dhe objektiviteti”, në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

Struktura organizative e DAB

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm (DAB) në aspektin organizativ dhe funksional përgjigjet përpara titullarit të institucionit. Për vitin 2022, veprimtaria e DAB është kryer përgjithësisht në zbatim të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, “Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm”, Kapitulli IV, “Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit”, Kodit të Etikës, Standardeve Ndërkombëtare dhe praktikave profesionale të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të pranuar për zbatim në RSH, dhe Rregullores për funksionimin e ADSH-së.

Struktura dhe organizimi i DAB është miratuar me VKM nr. 2, datë 08.01.2018, “Për personelin e administratës doganore” i ndryshuar dhe me VKM nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”. DAB është pjesë e DPD dhe ka varësi organizative nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm, krahas kuadrit ligjor në fuqi, rregullohet edhe me Rregulloren e brendshme të DPD, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr. 146, datë 07.05.2018.

Në përputhje me strukturën e miratuar sipas VKM nr. 2, datë 08.01.2018, dhe gjithashtu pas hyrjes në fuqi të VKM nr.355, datë 26.05.2022 DAB ka në përbërjen e saj 8 vende pune:

1. Drejtor – 1 vend, kategoria A, niveli i pagës III-a;

2. Auditues – 7 vende, kategoria C1, niveli i pagave III-b.

Përgjatë vitit 2022, DAB ka patur strukturë të plotësuar

Tabela nr. 84. Organigrama e DAB, Dhjetor 2022

	Niveli	Kategoria e pagës	Të emëruar	Të transferuar
Drejtor Drejtorie	A	III-a		R.K.
Auditues	C1	III-b		F.O.
	C1	III-b		F.G.
	C1	III-b		M.P.K.
	C1	III-b	R.S.	
	C1	III-b	V.H.	
	C1	III-b	L. P.	
	C1	III-b	S. T.	

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPD, përpunuar nga KLSH.

Nga auditimi konstatohet si mangësi e funksionimit të DAB-së përgjatë vitit 2022 plotësimi i gjysmës së drejtorisë me anë të transferimeve.

Arsimimi, eksperiencia dhe certifikimi i punonjësve të DAB

Pika 3 e VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm”, citon se: “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak së 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.”

Përsa i përket certifikimit të punonjësve të DAB-së, grupi i auditimit pas shqyrtimit të dosjeve të personelit, konstatoi se jo të gjithë punonjësit e kësaj Drejtorie janë të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, ku konkretisht audituesit M.P., F.G. dhe F.O., nuk janë të certifikuar (pothuajse 1/3 e punonjësve të DAB). Megjithatë 3 punonjësit e mësipërm janë shpallur fitues në konkursin e zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik për të ndjekur procesin e certifikimit si auditues të brendshëm në sektorin publik, dhe aktualisht janë në proces.

Gjithashtu, në lidhje me eksperiencën e kërkuar sipas Pikës c, Neni 20 i Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” specifikohet se: “Audituesi i brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion ose si auditues i brendshëm apo i jashtëm”.

Përsa i përket eksperiencës dhe vjetërsisë në strukturat e auditimit ndarja rezulton si më poshtë:

Vjetërsi pune deri në 5 vite: 0 punonjës

Vjetërsi pune mbi 5 vite: 8 punonjës

Ligji 114/2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në kreun V “Punësimi i audituesit të brendshëm”, neni 11, pika 2.a përcakton: “Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë: b) drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm” dhe të ketë përvojë pune 5 vjet si auditues i brendshëm ose i jashtëm”.

Drejtori i DAB, punonjësi R.K., i emëruar në datë 01.06.2021, rezulton të jetë i certifikuar si Auditues i Brendshëm.

Nga auditimi u konstatua se punonjësit aktualë të DAB i përshtaten kërkesave të veçanta për pozicionin e punës, ku 7 prej tyre rezultojnë me arsim bazë ekonomist dhe 1 jurist (arsimim Drejtësi/Ekonomik-Financë). Ligji 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në kreun V “Punësimi i audituesit të brendshëm”, neni 11, pika 2, gërma a përcakton: “Përveç kushteve të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit që punësohen

në njësinë e auditimit të brendshëm, kërkohet plotësimi i kushteve të posaçme si më poshtë: a) të kenë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, juridike dhe disiplina të tjera, sipas nevojave të sektorit që auditohet.”

Planifikimi vjetor i auditimeve për vitin 2022

Përmes shkresës nr. 17331/2 Prot., datë 12.10.2021, Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së ka miratuar Planin Vjetor të Auditimeve për vitin 2022, ku zgjedhja për auditim është bazuar kryesisht në bazë të vlerësimit të riskut. Në Planin Vjetor të Auditimit 2022 janë planifikuar 12 misione auditimi, ku kryesisht janë auditime të kombinuara (auditime të përputhshmërisë, financiare, duke përfshirë në çdo rast edhe auditimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm).

10 auditime të kombinuara për 9 dogana dhe 1 departament;

1 auditim tematik;

1 auditim këshillimi (96 ditë pune) sipas nevojave të menaxhimit të lartë.

Lidhur me planifikimin e kostos dhe burimeve njerëzore për vitin 2022, rezulton se kosto mesatare planifikohet të jetë përafërsisht 1,430,280 lekë/auditues.

Ndërkohë në planifikimin e kohës së punës, është marrë në konsideratë niveli i riskut dhe kompleksi teti i sistemeve/fushave të llogarisë, si dhe faktorët:

Koha për ndjekjen e rekomandimeve;

Koha rezervë (për probleme të paparashikuara që mund të dalin gjatë vitit);

Koha për menaxhim dhe administrim.

Totali i kohës së parashikuar është 1386 ditë, pra 198 ditë/person në vit.

Në Planin Vjetor të Auditimit janë parashikuar dhe nevojat për trajnime të cilat ndahen në dy drejtime kryesore:

Trajnime që do të kërkohen të organizohen nga DPD me tematika si: Kodi Doganor dhe risitë e tij, procedurat e thjeshtuara AEO (Operatorët Ekonomikë të Autorizuar), rregullat e origjinës, akciza.

Trajnime nga DHAB me tematika: auditimi i sistemeve TI, vlerësimi i funksioneve të MFK, auditimi i sistemit të identifikimit dhe menaxhimit të riskut.

Plani Vjetor është dërguar brenda muajit Tetor, sipas përcaktimit në Manualin e Auditimit, pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DHAB) në MFE, me shkresën nr. 17331/1 prot., datë 12.10.2021. Ndërkohë Plani Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD për vitin 2022-2024” është miratuar nga drejtori me anë të shkresës me nr.17331/5 të datës 29.12.2021. Pas dërgimit nga ana e DPD drejt MFE të Planit Vjetor 2022 Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka dhënë **mendimin** për planin vjetor 2022 si pasojë e mosfunksionimit të këtij komiteti pranë MFE. DAB ka vënë në dispozicion të grupit të auditimit, komunikimin elektronik me Drejtorinë e Auditimit në MFE, ku sqarohet se Komitetit të Auditimit të Brendshëm i ka përfunduar mandati i përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 211, datë 07.06.2019. Sipas këtij komunikimi, DAB është udhëzuar të procedojë me miratimin Vjetor të Auditimit të Brendshëm nga Titullari i Institucionit. Nga auditimi konstatohet se plani strategjik nuk i është dërguar strukturës përgjegjëse për harmonizimin dhe auditimin e brendshëm brenda datës 20 Tetor. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3.3 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.100 datë 25.10.2016.

Tabela 85: Plani Vjetor i Auditimeve për vitin 2022

Nr.	Subjektet që do të auditohen	Parashikimi për auditim	ditë/njerëz
I.	Drejtoria e Përgjithshme		300
II.	Doganat		
1.	Dogana Tiranë	Tetor - Dhjetor 2022	180
2.	Dogana Durrës	Tetor - Dhjetor 2022	180
3.	Dogana Kakavijë	Prill – Maj 2022	100
4.	Dogana Fier	Janar - Shkurt 2022	90

5.	Dogana Sarandë	Prill – Maj 2022	70
6.	Dogana Qafë Thanë	Qershor – Korrik 2022	80
7.	Dogana Shkodër	Janar - Shkurt 2022	90
8.	Dogana Blladë	Qershor - Korrik 2022	70
9.	Dogana Korçë	Prill - Maj 2022	70
III	Auditime tematike		
1.	Auditimi i zbatimit të detyrave dhe rekomandimeve të lëna gjatë auditimit	Mars 2022	60
IV.	Auditime këshillimi		96
	Gjithsej		1386 ditë - për 7 auditues

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPD, përpunuar nga KLSH.

Analiza e Planit Vjetor për vitin 2022

Plani Vjetor i Auditimeve, kishte në përbërjen e tij 12 misione auditimi të planifikuara për vitin 2022, si dhe auditim këshillimi sipas nevojës së menaxhimit të lartë. Nga këto angazhime, me pretendimin se Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në këto subjekte në të njëjtën periudhë që ishin planifikuar misionet e auditimit, nuk janë realizuar:

- Auditimi i Departamentit në DPD
- Auditimi i Degës Doganore Tiranë
- Auditim këshillimi

Gjithashtu nuk është realizuar periudha e audituar e plotë, por është lanë pa u audituar 6 mujori i dytë i vitit 2021 me pretendimin se Kontrolli i Lartë i Shtetit ushtroi auditim në këto subjekte:

Auditimi në Degën Doganore Durrës;

Në lidhje me programet e tjera të auditimit, janë përfunduar:

- Auditim mbi verifikimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga DAB në Doganat Elbasan, Kapshticë, Berat, Morinë, Rinas, Durrës, Vlorë, Lezhë, dhe Drejtoria e Antikontrabandës;
- Auditimi në Degën Doganore Fier
- Auditimi në Degën Doganore Kakavijë
- Auditimi në Degën Doganore Bllatë
- Auditimi në Degën Doganore Korçë
- Auditimi në Degën Doganore Qafë Thanë
- Auditimi në Degën Doganore Shkodër
- Auditimi në Degën Doganore Sarandë.

Sa më sipër, konstatohet se referuar Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pika 2 e nenit 25 i Kreut VIII, i cili cilëson se: “Mbi bazën e këtyre parimeve, fushat kryesore të bashkëpunimit janë: a) shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve; b) shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit;

c) zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimi i përbashkët”, DAB duhej të kishte marrë masa për të shmangur mbivendosjen e auditimeve me KLSH.

Tabela 86. Tabela krahasimore e gjetjeve të DAB në PRA dhe RP

Subjekti i Audituar	Periudha e Audituar	Vlera e gjetjes në lekë (Raport Përfundimtar)	Vlera e gjetjes në lekë (Projekt raport)	Numri i Rekomandimeve
Dogana Durrës	01.07.2020-30.06.2021	38,673,182	38,747,534	20
Doganat Elbasan, Kapshticë, Berat, Lezhë, Morinë, Rinas, Durrës, Vlorë Drejtoria e Antikontrabandës	2020-2021	00	0	opinion
Dogana Fier	01.01.2020–31.12.2021	11,431,115	11,531,115	22
Dogana Kakavijë	01.05.2020 – 31.12.2021	4,576,600	4,576,600	12
Dogana Blladë	01.01.2020 - 31.12.2021	329,930	369,930	8
Dogana Korçë	01.01.2020 - 31.12.2021	1,312,279	1,312,279	15
Dogana Qafë Thanë	01.01.2020 - 31.12.2021	1,475,716	1,475,716	18
Dogana Shkodër	01.01.2020 - 31.12.2021	30,431,510	30,431,510	12

Dogana Sarandë	01.01.2020 - 31.12.2021	3,126,443	3,126,443	11
Total		91,356,775	91,571,125	118

Burimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm në DPD

Nga tabela 9.3, vihet re se për angazhimet e përfunduara brenda vitit 2022, se diferenca mes vlerave të përcaktuara në Projekt-Raport dhe Raportin Përfundimtar janë 214,350 lekë, ose 0.23% në total. Mënyra e zgjedhjes për auditim në Planin Vjetor 2022 është bazuar në bazë të vlerësimit të riskut. Nga auditimet e kryera përgjatë vitit 2022, janë evidentuar edhe fushat me risk të lartë, të mesëm dhe të ulët. Fushat që paraqesin risk të lartë dhe të mesëm janë:

Sistemi i vendimmarrjes: Mosrespektim i afatit të njoftimit/procedurave/vendimmarrjes.

Sistemi i ngritur për rekuperimin e borxhit doganor: mos ndjekja e hapave ligjorë për rekuperimin e borxhit për shkak të mungesës së specialistëve të borxhit.

Sistemi i skanimit: Mosnjohja/moszbatimi i kuadrit nënligjor që rregullon procedurat e skanimit. Mosrikanalizimi në kanal të kuq/mos ushtrimi i kontrollit fizik i mjeteve me gjithë markimin e imazheve.

Sistemi i mostrimit, transportimit, ruajtjes dhe administrimit të rezultateve të mostrave: Mos reagim në të gjitha rastet ndaj përgjigjeve të laboratorit doganor

Sistemi i mostrimit: Mosmarrja e mostrave në rastet e goditjes nga profili i riskut.

Gjetjet kryesore në auditimet e realizuara nga DAB për vitin 2022

Gjetjet që kanë ardhur si rezultat i auditimeve nga DAB për vitin 2022, vijnë kryesisht nga zbatimi i gabuar apo i pjesshëm i legjislacionit apo procedurave doganore. Kryesisht gjetjet më të shumta kanë rezultuar në sistemin e vendimmarrjes, sistemin e skanimit, sistemin e mostrimit/transportimit/ruajtjes/administrimit të rezultateve të mostrave, sistemi i mbikëqyrjes së operatorëve që veprojnë nën regjimet doganore, sistemi i mbikëqyrjes së magazinave doganore. shërbimit ndaj tatimpaguesit, funksionimin e kontrollit të brendshëm, etj.

Gjetjet e auditimit në vlerë janë gjetje me efekte në fushën e tatimeve, taksave, doganave në shumën 91,356,776 lekë, e cila ndahet sipas 8 degëve doganore ku peshën më të madhe e zë Dogana Durrës.

Gjetjet sipas fushës ose sistemeve rezultojnë 118 në total, të cilat ndahen sipas 8 degëve doganore ku peshën më të madhe e zë Dogana Fier.

Së bashku me Planin Vjetor, në DHAB është dërguar edhe Pyetësori i Vetëvlerësimit nga DAB.

Në bazë të gjetjeve nga DAB për auditimet e kryera në vitin 2022 janë dhënë rekomandimet përkatëse për sistemimin dhe përmirësimin e punës në të ardhmen.

Këto rekomandime ndahen sipas kategorive të mëposhtme duke rezultuar në 118 të tilla

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve - 7;
- Rekomandime të karakterit organizativ - 85;
- Rekomandime mbi arkëtimet - 26
- Rekomandimet janë pranuar nga subjektet e audituara në masën 100%.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga DAB për vitin 2022

Sipas Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 42, datë 27.10.2020, “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga audit i brendshëm në sektorin publik”, janë tri forma të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve.

Nëpërmjet vlerësimit të nivelit të pranimin të rekomandimeve;

Nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve;

Nëpërmjet angazhimit të verifikimit të ndjekjes së rekomandimeve në vend/subjekt brenda 3 mujorit të vitit të parë pasardhës.

Nga informacioni i siguruar nga DAB, lidhur me rekomandimet e lëna dhe të pranuar në masën 100%, DAB ka konsideruar se janë zbatuar plotësisht 71 rekomandime ose 59,3% e totalin, janë në proces zbatimi 24 rekomandime ose sa 20.2% e totalit dhe nuk janë zbatuar 23 rekomandime ose sa 19,5% e totalit.

DAB e ka verifikuar zbatimin e këtyre rekomandimeve brenda 3 mujorit të parë të vitit 2023, duke kryer auditim përputhshmërie lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna për vitin 2022 në 8 degë doganore.

Tabela e mëposhtme detajon shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara.

Tabela 87: Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të lëna për vitin 2022

Rekomandime	Rekomanduar	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Papranuar	Vlerësohet në auditimin e radhës	Realiziminë %
Mbi përmirësimin e sistemeve	7	5	0	2	0	2	71.5%
Me karakterorganizativ	85	50	17	18	0	35	58.8%
Mbi arkëtimet	26	16	7	3	0	10	61.5%
Total	118	71	24	23		47	60.1%

Burimi: Të dhënat nga DAB në DPD, përpunuar nga KLSH.

Sa më sipër sipas Raportit të auditimit të zbatimit të rekomandimeve, DAB ka cilësuar se disa nga rekomandimet janë lënë për t'u vlerësuar në auditimin e radhës, duke mos paraqitur kështu një pasqyrë të plotë të shkallës së zbatimit të tyre.

Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve

DAB pas përfundimit auditimeve, ka kryer procesin e inventarizimit të dosjeve. Inventarizimi është bazuar në kërkesat e përcaktuara në Manualin e Auditimit.

Nga dosjet e marra në shqyrtim nga grupi i auditimit, rezultojnë se janë të inventarizuara dhe firmosur nga audituesit, drejtuesi i DAB dhe marrësi në dorëzim. Këto dosje përmbajnë dokumentet përkatës të nevojshëm në një dosje auditimi si: Autorizimi, Deklarata e Konflikti të Interesit të Audituesve të Brendshëm, Njoftimi për Fillimin e Angazhimit të Auditimit, Programin e Angazhimit të Auditimit, ndarja e detyrave, Projekt-Raporti, Observacionet e Njesisë së Audituar, Raporti Përfundimtar i Auditimit, Rishikimi i Cilësisë nga Përgjegjësi i Grupit dhe nga Drejtuesi i Njesisë, Memo për Titullarin, etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë përgjegjësi e:

Z.R. K. në cilësinë e drejtorit të Auditimit të Brendshëm pranë DPD-së

1. Titulli gjetjes: Vonesa në dërgimin e planit strategjik

Situata:

Plani Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD për vitin 2022-2024” është miratuar nga drejtori me anë të shkresës me nr.17331/5 të datës 29.12.2021. Nga auditimi konstatohet se plani strategjik nuk i është dërguar strukturës përgjegjëse për harmonizimin dhe auditimin e brendshëm brenda datës 20 Tetor sipas pikës 3.3 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.100 datë 25.10.2016. Kjo vonesë ka ndikuar në miratimin e planit vjetor të auditimit pa qenë më parë i miratuar plani strategjik.

Kriteri :

Urdhri i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.100 datë 25.10.2016, Pika 3.3

Ndikimi/Efekti:

Miratimi i Planit vjetor përpara miratimit të planit strategjik.

Shkaku:

Dërgimi me vonesë i miratimit të planit strategjik.

Rëndësia:

E Mesme

Rekomandimi:

Drejtori i Auditit të Brendshëm të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD” brenda afateve ligjore të përcaktuara, në mënyrë të tillë që plani vjetor i auditimeve të mbështetet në planin strategjik,

si dhe ta dërgojë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Nga auditimi i realizuar për periudhën objekt auditimi u konstatua se strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. DPD e mbështet veprimtarinë e saj në Ligjin Nr.102, datë 31.07.2014, “*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, i cili përfshin dispozitat bazë për organizimin e administratës doganore, të veprimtarisë doganore, kompetencat, bashkëpunimin, punësimin dhe marrëdhëniet e punës së personelit të administratës doganore. Autoritetet doganore kanë si përgjegjësi kryesore mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, duke kontribuar për tregtinë e hapur e të drejtë në zbatim të politikave tregtare dhe atyre të sektorëve të tjerë të ekonomisë shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe në sigurinë e të gjithë zinxhirit tregtar. Rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka të miratuar dhe në fuqi “Strategjinë e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare 2018-2021”. Në këtë Strategji janë specifikuar objektivat strategjikë, misioni, vizioni, struktura e ADSH-së dhe harta e Strategjisë së Doganave Shqiptare. Megjithatë kjo Strategji, mbetet e pa përditësuar dhe Plani i Veprimit të saj nuk e përfshin vitin 2022. Grupi i auditimit të KLSH konstaton se për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 kanë kryer funksione si nëpunës autorizues (NA) dhe ai zbatues (NZ), si vijon:.

Përmes shkresës nr. 18535/1, datë 09.10.2020, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar Nëpunës Autorizues për DPD, z. G.G, Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së.

Përmes shkresës nr. 259/1, datë 10.01.2022, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është caktuar Nëpunës Zbatues për DPD, z.I.B., Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Në funksion të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, Nëpunësi Zbatues, është niveli menaxherial në varësi direkte të Nëpunësit Autorizues. Në përputhje me kërkesat e Nenit 12/2 të ligjit në fuqi, në funksionet e tij, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës mbulon çështjet e planifikimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetit, monitorimit, si dhe përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore të njësisë. Përgjatë vitit 2022, z.B. ka kryer funksionet e përcaktuara më sipër në përmbushje të kërkesave të Nenit 12/1, “*Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues*” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar. Në institucion, NZ është në varësi direkte të NA, sipas strukturës së miratuar në përputhje me Kapitullin 2 të Manualit të MFK, ku thuhet se “*Nëpunës zbatues i njësisë publike është drejtuesi i strukturës përgjegjëse për financat e njësisë publike, në varësi direkte nga Nëpunësi Autorizues i njësisë*”.

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “*Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit*”, neni 19 citohet: Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

- Mjedisi i kontrollit.
- Menaxhimi i riskut.
- Veprimtaritë e kontrollit.
- Informacioni dhe komunikimi.
- Monitorimi.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës;

mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve. Mjedisi i kontrollit ndikohet më tej nga struktura organizative e njësisë si dhe nga marrëdhëniet e llogaridhënies. Mjedisi i kontrollit ka një ndikim të gjithanshëm në vendimet dhe aktivitetet e një njësie dhe hedh themelet e të gjithë sistemit të kontrollit të brendshëm.

Bazuar në nenin 9 “Përgjegjshmëria Menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, pika 4/a, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, si dhe Manualin për MFK, Kapitulli II “Rolet dhe aktorët në sistemin e MFK-së” germa a, Pika 2.2.7, “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, NA ka përgjegjësinë të propozojë te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi. Nga auditimi rezulton se DPD ka të hartuar Strategjinë e Biznesit 2018-2021, por nuk e ka përditësuar atë edhe pse viti 2022 nuk është pjese e kësaj strategjie, si dhe nuk disponon një plan veprimi bazuar në këtë strategji që të mbulojë vitin 2022.

Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e bazon funksionimin e saj në Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” dhe Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 146, datë 07.05.2018. Në këto dy rregullore të brendshme trajtohen baza ligjore ku mbështetet funksionimi i DPD dhe Degëve Doganore, misioni, detyrat kryesore të Drejtorive, organizimin e tyre, etj. Nga auditimi konstatohet se DPD nuk ka miratuar rregulloren e brendshme të re mbi funksionimin e DPD dhe të DD edhe pas miratimit të strukturës së re nëpërmjet VKM-së nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”. Duke qenë një mospërputhje midis strukturës së DPD/DD dhe rregulloreve përkatëse në fuqi.

Institucioni disponon rregulloren “Për procedurat e konkurrimit dhe punësimit për punonjësit administrativ dhe jo pjesë e shërbimit civil në Administratën Doganore”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 95, datë 25.05.2021. Kjo rregullore detajon procedurat për shpalljen e konkurrimit, përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, fushën e veprimit të këtij Komiteti, kriteret e pranimit, procedurat e konkurrimit, marrëdhëniet e punës, si dhe administrimin e dokumentacionit lidhur me konkurrimin dhe punësimin e punonjësve administrativ dhe jo pjesë e shërbimit civil në Administratën Doganore.

Për më tepër, institucioni disponon rregulloren “Për mbajtjen e uniformës për shërbimin doganor”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 96, datë 04.12.2014, në të cilën specifikohet pajisja me uniformë, armë, tabela apo shenja të tjera të nevojshme, e punonjësve të shërbimit doganor. Në të janë evidentuar edhe kushtet e paraqitjes së uniformës, përgjegjësia e përdorimit apo dëmtimit të saj, ndalimi i mbajtjes së uniformës, tërheqja dhe dorëzimi i saj.

Institucioni operon me Kodin e Etikës miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 90, datë 18.11.2014, dhe është shtuar e ndryshuar me Urdhrin e MFE nr. 123, datë 09.11.2017. Ky Kod Etike ka si qëllim përcaktimin e rregullave të sjelljes që punonjësi e AD duhet t'i zbatojnë në detyrimisht dhe në shkallën më të lartë. Elementët thelbësore të këtij Kodi janë: përgjegjësia personale, respektimi i ligjit, marrëdhëniet me publikun, vënia e kufijve në pranimin e dhuratave/shpërblimeve/ftesave të ndryshme, shmangia e konfliktit të interesit, aktivitete me karakter publik, vënia e kufijve për veprimtaritë politike, sjellje që përfshijnë çështje monetare, përdorimi i informacioneve konfidenciale/Sekreti Profesional, përdorimi i pronave dhe

shërbimeve shtetërore, blera për qëllime private i objekteve që i përkasin shtetit nga ana e punonjësve, si dhe ambienti i punës.

Politikat menaxheriale dhe stili i punës.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në germën a, pika 8, neni 8 i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, përcaktohet se “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave”. Sa më sipër rezulton se DPD ka të hartuar Strategjinë e Biznesit 2018-2021, ku përcakton objektiva strategjike, por kjo strategji nuk përmban vitin 2022. Rezulton se DPD nuk disponon një plan veprimi ku të mbulohet viti 2022 me qëllim përcaktimin e aktiviteteve, personave përgjegjës dhe afatin e realizimit të secilit, në kundërshtim me pikën 8 të ligjit të MFK.

Gjithashtu, në germën b të Ligjit nr. 10296/2010, i ndryshuar, përcaktohet se “Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore:

b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike”. Në nenin 27 të këtij ligji përcaktohet se ‘Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendëstitullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave’.

Për vitin 2022 rezulton të jetë ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhërin e Titullarit të Institucionit nr. 2, datë 18.01.2022, i përbërë nga:

- Drejtori i Përgjithshëm (NA i nivelit të dytë);
- Zv. Drejtori i Përgjithshëm, Dept. Administrativ (NA i nivelit të dytë i deleguar);
- Zv. Drejtori i Përgjithshëm, Dept. Teknik i Akcizës dhe Procedurave Doganore;
- Zv. Drejtori i Përgjithshëm, Dept. i Analizave dhe Aposteriorit;
- Zv. Drejtori i Përgjithshëm, Dept Operativo – Hetimor;
- Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës (NZ, Sekretar i GMS);
- Këshilltari i Drejtorit të Përgjithshëm.

Pjesë e GMS është dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, por pa të drejtë vendimmarrje. Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, lidhur me rolin e GMS në sistemin e MFK, përcaktohet se “GMS duhet të mbledhet të paktën 4 herë në vit. Vendimet duhet të regjistrohen nga sekretari dhe vihen në dispozicion të drejtimit të njësisë publike”.

Mbledhjet e GMS përgjatë vitit 2022 rezultojnë të dokumentuara me procesverbalet, si më poshtë: Procesverbali nr. 7905 prot., datë 27.04.2022 – Ky takim u mbajt për miratimin e kërkesave buxhetore 2023-2025, për miratimin e regjistrimit të riskut, si dhe të planit të masave për minimizimin e tyre.

Procesverbali nr. 15205 Prot., datë 22.08.2022 – Takimi u mbajt për miratimin e kërkesave buxhetore 2023-2025.

Procesverbali nr. 22017 Prot., datë 20.12.2022 – Takimi u mbajt për përditësimin e të dhënave në sistemin AMFIS.

Nga auditimi konstatohet se përgjatë vitit 2022 GMS nuk është mbledhur së paku 4 herë në vite në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Ekipi i Menaxhimit të Riskut është ngritur me Urdhrin e Titullarit të Institucionit nr. 3, datë 08.02.2022 “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Riskut”

Në pikën 2 të nenit 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, përcaktohet se “Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut është miratuar me anë të Vendimit nr. 01, datë 08.07.2021 “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”.

Në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi përcaktohet se Strategjia do të monitorohet në vazhdimësi dhe ecuria e implementimit do të raportohet në mënyrë periodike, duke ngarkuar për ndjekjen dhe monitorimin zv. Drejtorët e Përgjithshëm, Këshilltarin e Drejtorit të Përgjithshëm, Nëpunësin Zbatues dhe Drejtorët e Drejtorive.

Me anë të shkresës nr. 21965/1 prot., datë 28.02.2023, Titullari i Institucionit i ka dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2022, për komponentët e MFK brenda afateve kohore të përcaktuara.

Me anë të shkresës nr. 6149/1 prot., datë 06.04.2023, Titullari i Institucionit i ka dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë deklaratën për cilësinë e kontrollit të brendshëm për vitin 2022, për komponentët e MFK.

Nga auditimi konstatohet se kjo deklaratë është dërguar mbi një muaj me vonesë nga parashikimi i pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar ku cilësohet se:

“Nëpunësi autorizues i njësisë publike, sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 3 të këtij ligji, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual”.

Marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin në DPD, rregullohen në bazë të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”; i ndryshuar, Kodin e Punës në RSH, si dhe rregulloren “Për procedurat e konkurrimit dhe punësimit për punonjësit administrativ dhe jo pjesë e shërbimit civil në Administratën Doganore”, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 95, datë 25.05.2021. dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore për nëpunësit e shërbimit civil dhe ata jashtë shërbimit civil në ATQ, si dhe dispozitat e tjera ligjore si: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, lejojnë Titullarin e Institucionit që në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave, të ndërmarrë hapat e duhura.

Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi u konstatua se, DPD e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përfshin dispozitat bazë

për organizimin e administratës doganore, të veprimtarisë doganore, kompetencat, bashkëpunimin, punësimin dhe marrëdhëniet e punës së personelit të administratës doganore, si dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij. Këto dispozita rregullohen me VKM Nr. 921, datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore” dhe përgjatë vitit të ndryshuar me VKM nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”.. DPD mbështetet në aktivitetin e saj në Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave” dhe Rregulloren e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 146, datë 07.05.2018. Në këto dy rregullore të brendshme trajtohen baza ligjore ku mbështetet funksionimi i DPD dhe Degëve Doganore, misioni, detyrat kryesore të Drejtorive, organizimin e tyre, etj.

Pika 2 e nenit 29 të Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” përcakton se “Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij”.

Nga auditimi konstatohet se DPD nuk ka miratuar rregulloren e brendshme të re mbi funksionimin e DPD dhe të DD edhe pas miratimit të strukturës së re. Referuar kësaj pike, rregullorja e brendshme është miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 146, datë 07.05.2018.

Delegimet e detyrave në DPD, bëhen me urdhër të Titullarit të Institucionit dhe/ose me propozim të Drejtuesit të Drejtorisë përkatëse. Lidhur me delegimin e kompetencave, Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre, siç kërkohet nga ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, njësjë, ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre. Aktet e delegimit përmbajnë kompetencat e deleguara, kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të deleguara, data e fillimit të ushtrimit të kompetencave të deleguara.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të Institucionit janë përcaktuar rregullat dhe detyrat e organizimit, funksionimit dhe marrëdhënieve, ndërmjet njësjëve të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitetin në DPD. Institucioni i ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, etikën, komunikimin e paraqitjen, shkeljet disiplinore, orarin dhe qëndrimin gjatë orarit të punës, etj. Megjithatë pas ndryshimit të strukturës, ka një mospërputhje midis rregullores së brendshme, detyrave të organizimit me strukturën e re.

Stafi i DPD-së është rekrutuar nëpërmjet konkurrimit të kryer nga DAP dhe nëpërmjet procedurave të konkurrimit të menaxhuara nga DPD për pozicionet e punës jashtë shërbimit civil.

Lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore konstatohet një numër i lartë i transferimeve të cilat tejkalojnë afatin 6 mujor, si dhe shkaktojnë shpenzime të larta pagash, duke qenë se sipas specifikimeve të pikës 5 të nenit 48 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, citohet se: “Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësi civil përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Në çdo rast, nëse është e zbatueshme, nëpunësi civil përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit në të cilin është transferuar”.

Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me QTAD ka hartuar planin vjetor të trajnimeve të parashikuara për vitin kalendarik 2022. Drejtoria e Burimeve Njerëzore përcakton programe trajnimi siç kërkohet edhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kapitulli III, pika 3.1. *Mjedisi i kontrollit të brendshëm*, në paragrafët “*Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore*” dhe “*Profesionalizmi i stafit*”. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPD, ka përcaktuar trajnimet që duhet të ndiqen nga punonjësit e rinj si dhe nga ata ekzistues me tema “Kodi i Etikës”, “Kodi i Etikës dhe konflikti i interesit në ADSH”, “Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta për informim”.

Në vitin 2022 janë zhvilluar 123 trajnime dhe në këto trajnime kanë marrë pjesë 1,079 punonjës të Administratës Doganore. Konstatohet se për periudhën në fjalë nuk janë kryer trajnime të punonjësve mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Nga ana e stafit të lartë, të mesëm dhe të ulët menaxherial, rezultoi se nuk janë kryer trajnime, për njohjen e tyre me kërkesat e ligjit, njohjen me procesin e evidentimit dhe menaxhimin dhe monitorimit të riskut, si dhe procesin e implementimit të MFK-së.

2. Menaxhimi i riskut

Referuar Pikës 3.2 “Menaxhimi i riskut” të Manualit të MFK, cilësohet se “*Procesi i vendosjes së objektivave në të gjithë njësinë publike duhet të drejtohet nga titullari dhe t’u komunikohet të gjitha strukturave të njësisë. Të gjitha njësitë publike duhet të zhvillojnë objektivat e tyre dhe t’i vendosin në linjë me objektivat e vendosur në nivelet më të larta të njësisë. Këto objektiva të vendosura tregojnë qartësisht atë që njësia synon të arrijë dhe se si do të matet ecuria*”. Sa më sipër, konstatohet se DPD nuk ka hartuar një Plan Veprimi për vitin 2022, ku të mund të paraqiten këto objektiva të shkruara. Dokumenti i cili ka objektiva të shkruara është Strategjia e Biznesit në ADSH 2018-2021, e cila ka nevojë të përditësohet, duke qenë se ka një afat prej 3 vitesh dhe nuk përmban objektivat për vitin 2022.

Për më tepër, në përputhje me nenin 29 të Ligjit të Menaxhimit të Sistemit Buxhetor, çdo njësi publike duhet të përgatisë planin strategjik për periudhën tre-vjeçare (plani strategjik afatmesëm). Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet. Pra, referuar Ligjit të MSB, DPD duhej të kishte përgatitur një plan strategjik në përputhje me planin financiar buxhetor.

Pas planifikimit të fondeve buxhetore, Institucioni analizon dhe bën kontrollin e risqeve, të cilët mund të venë në rrezik realizimin e treguesve buxhetore. Në mbështetje të pikës 2, neni 11 “*Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë*”, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*” i ndryshuar, si dhe pika 2.5.2, Kapitulli III “*Menaxhimi i Riskut në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, është hartuar Regjistri i Riskut përmes shkresës nr. 4852 Prot., datë 08.03.2022.

Risqet kryesore të evidentuara në Regjistrin e Riskut janë:

Monitorimi i procedurave të rikuperimit me forcë të borxhit doganore dhe atij të akcizës;

Rrezik për humbjen e statusit të akreditimit të Laboratorit Doganor për treguesit analitik;

Mungesa e fondeve për të përballuar shpenzime të analizave në Laboratorin Doganor;

Mungesë fondesh/mundësish për investime në blerje/mirëmbajtje kamerash lidhur me Sistemin e Monitorimit të Kamerave (SMK) në Degë Doganore;

Mungesë vendimmarrje nga ana e Komisionit të Menaxhimit të Kamerave apo dhe nga struktura të tjera në DPD/AKSHI;

Mungesa e modulit përkatës që mundëson analizën paraprake;
 Mosrealizim i procedurave për blerjen e Software, licenca, suport, trajnime, etj;
 Mungesa e modifikimeve të propozuara në versionin që pritet të përditësohet në Ascyuda Word/Mungesë bashkëpunimi të brendshëm;
 Mos zhvillimi në kohë i trajnimeve të planifikuara;
 Mos konfirmim i pjesës së mbetur brenda afateve të punonjësve në periudhë prove.
 Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se struktura e DPD ka mbartur vende vakante përgjatë periudhës objekt auditimi, ndaj në këto kushte riskohet moszbatimi i objektivave. Gjithashtu, problematike shfaqet norma e lartë e transferimeve në administratën doganore. Transferimet e shpeshta dhe ku nuk zbatohet rikthimi në pozicionin e mëparshëm pas periudhës 6 mujore të transferimit, paraqet problematika në shpenzimet e pagave duke mbajtur parasysh se për të njëjtin vend pune paguhen dy punonjës pasi në rastet e transferimit sipas pikës 5 të nenit 48 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, citohet se: *“Gjatë periudhës së transferimit, nëpunësi civil përfiton pagën më të lartë ndërmjet pagës së pozicionit të mëparshëm dhe atij në të cilin është transferuar. Në çdo rast, nëse është e zbatueshme, nëpunësi civil përfiton shtesën për kushtet e punës të pozicionit në të cilin është transferuar”*.
 Në pikën 2 të nenit 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, të ndryshuar, përcaktohet se *“Për t’i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollat që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.”* Për sa më sipër, me Vendimin e Titullarit të DPD-së nr. 1, datë 08.07.2021, është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut, pas përgatitjes, ku përcaktohen parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në DPD, me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive. Qëllimi i saj është të sigurojë që koncepti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të kulturës organizative përmes filozofisë së zvogëlimit të riskut dhe vlerësimit të tij, për çdo veprimtari që kryen DPD. Strategjia e Menaxhimit të Riskut është hartuar mbështetur në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2014, datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, VKM nr. 651, datë 10.11.2017, *“Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014”*, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, *“Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”*, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016, *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*. Strategjia gjithashtu i referohet përgjegjësive dhe objektivave të vendosura në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022. Kjo Strategji konsiston në ecurinë e procesit të menaxhimit të riskut, realizimin e politikës së menaxhimit të riskut, ciklin e menaxhimit të riskut, si dhe në strukturat përgjegjëse për menaxhimin e riskut.

3. Veprimtaritë e kontrollit

"Veprimtari të kontrollit", përkufizohen si kontrole para faktit dhe pas faktit. Ato përfshijnë kontrollin e ligjshmërisë dhe të rregullshmërisë dhe marrin parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 22/3 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, të ndryshuar përcaktohet se veprimtaritë e kontrollit përbajnë minimalisht ndër të tjera edhe sistemin e dy nënshkrimeve i cili nuk lejon që angazhimi

financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë. Për vitin 2022, funksioni i nëpunësit autorizues është kryer nga Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së, z.G.G., ndërsa funksioni i nëpunësit zbatues është kryer nga z. I.B., Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës.

Nëpunësi zbatues në bazë të ligjit për buxhetin, merr përsipër angazhimet për realizimin e programeve buxhetore. Në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit, kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij përpara njohjes së shpenzimit në kontabilitet, ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare, kalon në dy procese. Specialisti e harton, përgjegjësi e kontrollon dhe më pas miratohet nga NZ, i cili ia përcjell NA. Transaksionet financiare në këtë institucion kryen në bazë të rregullave të vendosura nga MFE. Regjistrimet kontabël bëhen me anë të programit excel dhe në programin financiar ALPHA.

Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se: Procedurat e buxhetimit kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018, "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*". Nga ana e NZ të DPD është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit detyrim ky që rrjedh nga përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: "*Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:...përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë*".

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione. Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Nga auditimi konstatohet se, **Drejtorja e Përgjithshme e Doganave për vitin 2022, nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit**, e cila duhet të përgatitet nga manaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi, në kundërshtim me nenin 16 "*Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit*" dhe nenin 12 "*Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ*". Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III "*Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit*", pika 3.2 "*Cikli i MFK-së*", Hapi 5 "*Gjurmët e auditimit*", për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj.

4. Informacioni dhe komunikimi

Titullari i Institucionit informohet mbi aktivitetin e strukturave që Drejtorët drejtojnë me anë të mbledhjeve periodike, informacioneve, evidencave të ndryshme. NZ raporton tek nëpunësi autorizues, me anë të situacioneve buxhetore mujore dhe vjetore të krahasuar me planin në

funksion të realizimit të objektivave. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet. Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, përmes email, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare/email/përmes sistemeve elektronike.

Për të bërë të mundur trajtimin e konsiderimin e ankesave të ardhura për DPD në website-in zyrtar të saj ndodhet një numër jeshil pa pagesë dhe email antikorrupsion.dpd@dogana.gov.al ku mund të bëhet depozitimi i ankesave (korrupsion dhe sjellje jo etike) nga burime të ndryshme. Procedura e sinjalizuesve rregullohet përmes Ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të DPD-së nr. 75, datë 23.11.2018, “Për miratimin e rregulloreve Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave” dhe “Për hetimin e administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”. Në DPD dhe Degët Doganore është afishuar njoftimi për krijimin e Njësisë Përgjegjëse. Njësia Përgjegjëse ka zhvilluar takime në Degët Doganore me qëllim sensibilizimin. Gjithashtu, edhe në Programin e Transparencës së ADSH në rubrikën “Raporto Korrupsionin” gjendet informacion mbi bazën ligjore të sipërcituar.

Në vitin 2021 është bërë rishikimi i Programit të Transparencës, i cili është miratuar përmes Urdhrit të Titullarit të DPD me nr. 16, datë 13.03.2021. Gjithashtu me anë të urdhrit nr.6282/1 Prot të datës 12.04.2022 është caktuar Koordinatori për të drejtën e informimit, megjithatë në faqen e internetit të DPD-së nuk pasqyrohet regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku në nenin 8 cilësohet se: ‘Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuësve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër’.

5. Monitorimi

Në DPD, nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Nga analiza e buxhetit konstatohet se, raportet e monitorimit buxhetor, si dhe raportet periodike janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, por nuk rezultojnë të publikuara në faqen e web-it të institucionit ose të MFE-së.

Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.

Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime. Për sa më sipër, për periudhën nën auditim, rezulton se DPD ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2022, në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, referuar kërkesave të Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Pyetësori i Vetëvlerësimit është plotësuar në përputhje me metodologjinë e monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike, miratuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë me urdhrin nr. 117, datë 01.04.2019, “Për miratimin e metodologjisë

për monitorimin e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive publike” i ndryshuar, dhe elementet sipas vlerësimit paraqiten të strukturuar kundrejt modelit COSO.

Nga auditimi rezulton se lidhur me veprimtarinë e monitorimit, për vitin 2022, nëpunësi autorizues i DPD ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm me vonesë 1 muajore, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontroleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual”.

Përsa i përket auditit të brendshëm, rezulton se DPD ka njësi auditit në organikën institucionale. DPD auditohet nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm (DAB) si dhe nga auditit i jashtëm (Kontrolli i Lartë i Shtetit).

Në auditimet e realizuara nga DAB, tematikë e veçantë e tyre është sistemi i kontrollit të brendshëm me të gjithë komponentët përbërës. Në rastet e konstatimit të mangësive, janë lënë rekomandimet përkatëse për të siguruar përmirësimin e situatës.

Në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”i ndryshuar dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, “Monitorimi” konstatohet se DPD nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë përgjegjësi e:

Z.I.B. me pozicionin e Drejtorit të Buxhetit dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.1 dhe nr.2, datë 14.07.2023, ku pas hartimit të Projektraportit, nga ana e subjektit të audituar nuk janë përcjellë observacione.

Titulli i Gjetjes: **Mosfunksionimi në mënyrë të plotë i sistemit të kontrollit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.**

Situata:

- DPD nuk ka miratuar Rregulloren e Brendshme të re mbi funksionimin e DPD dhe të Degëve Doganore, pas miratimit të strukturës së re organizative sipas VKM-së nr.355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”.
- Përgjatë vitit 2022 GMS nuk është mbledhur së paku 4 herë në vit, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.
- Deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm për komponentët e MFK-së për vitin 2022, është dërguar mbi një muaj me vonesë nga parashikimi i pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që është fundi i muajit Shkurt i vitit aktual.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për vitin 2022, nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, për të gjitha proceset që ndodhin në njësi, në kundërshtim me nenin 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditit” dhe nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”.

Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2 e nenit 20, pika 3 e nenit 8, gërma ç e pikës 4 të nenit 9, gërma a dhe b e pikës 8 të nenit 8, neni 12, pika 2 dhe 3 të nenit 16, pika 21 e nenit 4; neni 15, neni 18; -Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, pika 3.1 të Kapitullit III, pika 2.2.6; -Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 ‘Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike’, pika 15, gërma ‘a’.
Ndikimi/Efekti:	Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve ndikon në arritjen e objektivave të institucionit. Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, sjell risk të lartë për mirë administrimin financiar e organizativ dhe kontrollin e brendshëm të institucionit.
Shkaku:	Nuk njihen plotësisht konceptet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.10 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neglizhencë në zbatimin e tij, si: mungesa e konsolidimit të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, duke reflektuar kështu nivel të lartë të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive mbi problematikat e identifikuara, si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën e re të miratuar, si dhe për gjurmën së auditimit, përfshirë plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, me qëllim dërgimin në afat të deklaratës mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm të monitorojë veprimtarinë e Grupit të Menaxhimit Strategjik që të mbliidhet sipas përcaktimeve ligjore.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të Raportit Përfundimtar të Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (pjesa I-rë) dërguar me shkresën nr. 362/22 prot, datë 15.09.2022, nga ana e DPD është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh dhe 6 muajsh për kthimin e përgjigjes në KLSH mbi masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, respektivisht me shkresat nr. 6729 prot., datë 05.10.2022 dhe nr 6729/63 prot., datë 15.03.2023.

Nga auditimi rezultoi se, nga 20 rekomandime gjithsej të lëna, janë zbatuar 3 rekomandime, janë zbatuar pjesërisht 12 rekomandime dhe nuk janë zbatuar 5 rekomandime, si në vijim:

- Për masat organizative nga 13 masa gjithsej të rekomanduara, rezulton se 3 masa janë të zbatuara, 7 masa të zbatuara pjesërisht dhe 3 prej tyre janë të pazbatuara.

- Për masat për eliminimin e efekteve financiare negative nga 4 masa të rekomanduara, rezulton se 1 prej tyre janë të pazbatuara dhe 3 janë të zbatuara pjesërisht.

-Për 1 masë shpërblim dëmi të rekomanduar, në vlerën 966,239 lekë, ajo rezulton e zbatuar pjesërisht.

-Për 1 masë disiplinore të rekomanduar, ajo rezulton e zbatuar pjesërisht.

-Për 1 masë për njoftimin e Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil të rekomanduar, rezulton se ajo nuk është zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 16-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

1.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju

rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e 5 rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe 12 rekomandimeve të zbatuara pjesërisht të lëna në auditimin e mëparshëm.

Drejtori i Përgjithshëm i DPD-së, të analizojë situatën lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse me rekomandime konkrete për zyrtarët përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se nuk dokumentohet roli i DPD gjatë procesit të planifikimit të të ardhurave doganore, nëpërmjet propozimeve referuar analizave të kryera nga strukturat përgjegjëse të institucionit, duke konsideruar faktorë të tillë si efektet e paketës fiskale, shkalla e reduktuar e TVSH-së 10 % e furnizimit me inpute bujqësore apo efekti i ndryshimit të ligjit për akcizën, etj. DPD nuk disponon një metodologji konkrete të miratuar për procedurën që do të ndiqet për planifikimin e të ardhurave doganore, ku ndarja e planit bëhet në bazë të përqindjes që zë secila degë doganore, për secilën taksë, në periudhën paraardhëse progresive, e cila përgjatë vitit mund të korrigjohet nga faktorë të jashtëm, referuar informacioneve që gjenerohen nga burime të tjera. Lidhur me metodikën e përdorur për planifikimin e të ardhurave doganore dhe aplikimin e modelit ekonometrik të 60 mallrave kryesore, nuk u vendosën në dispozicion analizat/informacionet/dokumentacionet përkatëse që dokumentojnë konkretisht analizat e kryera, duke u kufizuar vetëm me një informacion të përgjithshëm në bazë të të cilit grupi i auditimit e ka të pamundur të vlerësojë nivelin e planifikimit sipas DPD, krahasimisht me planin e miratuar me ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2022.

- Nga auditimi konstatohet mungesa e një plani vjetor të detajuar për çdo muaj sipas degëve doganore dhe llojit të të ardhurave, objekt zbatimi nga ana e degëve doganore për vitin 2022, në vijim të planit të miratuar sipas ligjit të buxhetit dhe aktet normative të dala gjatë vitit. Nga auditimi i kryer lidhur me procesin e ndjekur për planifikimin e të ardhurave doganore që pritet të gjenerohen, konstatohet se degët doganore nuk përfshihen në këtë vendimmarrje, por plani sipas çdo muaji përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, dhe është pikërisht ky autoritet që kryhen dhe ndjekjen e realizimit. Ky planifikim përcillet elektronikisht dhe pëson ndryshime të shpeshta edhe përgjatë muajit, të cilat ndjekin nivelin e realizimit. Duke qenë se plani mujor pëson ndryshime të shpeshta, ai mbetet një faktor kryesor në finalizimin e realizimit të të ardhurave doganore me mbi realizim apo me realizim të lartë të planit sipas degëve. Si rezultat, mos përcaktimi i planeve për degët doganore, ka shkaktuar që kontributi i tyre në monitorimin e realizimit të të ardhurave, të kufizohet vetëm në paraqitjen e statistikave në nivel tepër sintetik dhe të pa shoqëruara me analiza të mirëfillta mbi faktorët që kanë ndikuar në realizim apo mosrealizim.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 24-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

2.1 Rekomandimi: Titullari i DPD, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, të marrë masat për hartimin e një dokumenti që të shërbejë si metodologji për hartimin e planit të të ardhurave doganore dhe monitorimit të realizimit të tyre në rang degë doganore, duke përfshirë në këtë dokument çështje si harta e procesit të punës, strukturat pjesëmarrëse, afatet, metodika e informacionit, faktorët e riskut, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit të të ardhurave doganore, duke u finalizuar me një produkt real të planit dhe që përfaqëson objektivat institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022 të ardhurat doganore janë realizuar në masën 101% kundrejt planit të të ardhurave të rishikuar me Aktin Normativ nr. 12,

datë 29.07.2022 (me një tejkallim në shumën 1,080 milion lekë), ardhur kryesisht nga rritja e importeve dhe rritja e të ardhurave për njësi, për të cilat ka ndikuar rritja e çmimit të importit të këtyre artikujve. Megjithatë, konstatohet se pavarësisht këtij niveli realizimi për total të ardhurat, të ardhurat doganore sipas llojit në të gjitha zërat e tjerë me përjashtim të TVSH-së në import rezultojnë me mosrealizim, ndikuar kryesisht nga niveli i realizimit të të ardhurave nga akciza, renta minerare dhe taksa doganore, konkretisht:

- Të ardhurat nga akciza, e cila është dhe kontribuesi i dytë kryesor në të ardhurat doganore janë realizuar në shumën 53,781 milion lekë, ose në masën 98 % të planit, me një mosrealizim në shumën 1,219 milion lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 1,819 milion lekë më shumë. Negativisht në nivelin e realizimit të të ardhurave të akcizës sipas analizës së DPD-së ka ndikuar importit i karburantit me 1.200 milion lekë më pak, si pasojë e rënies së konsumit të tij me rreth 57,000 ton, e ndikuar nga situata e luftës në Ukrainë dhe embargos Ruse.
- Të ardhurat nga renta minerare janë realizuar në shumën 4,198 milion lekë, ose në masën 93% të planit, me një mosrealizim në shumën 302 milion lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 1,753 milion lekë më shumë.
- Të ardhurat nga taksa doganore janë realizuar në shumën 8,447 milion lekë, ose në masën 99% të planit, me një mosrealizim në shumën 52 milion lekë, ndërsa krahasuar me vitin 2021 janë arkëtuar 989 milion lekë më shumë.

Për mos realizimin e të ardhurave nga renta minerare dhe taksa doganore në raportet e DPD, nuk rezultojnë të jenë kryer analiza në këtë drejtim, pasi raporti i ecurisë së realizimit të të ardhurave doganore konstatohet se është bazuar kryesisht në analiza krahasimore me një vit më parë, dhe jo me planin e të ardhurave doganore.

- Nga auditimi u konstatuan diferenca mes planit mujor dhe progresiv të të ardhurave doganore, të përcjella shkresërisht nga MFE, krahasimisht me planin e raportuar nga DPD, shkaktuar kryesisht si rrjedhojë e pasaktësive në detajimin e këtyre vlerave në njësinë “mijë lekë”. Gjithashtu, konstatohet se evidencat e paraqitura nga DPD nuk paraqesin të dhëna lidhur me realizimin e të ardhurave pa përfshirë rimbursimin e akcizës. Si rezultat, konstatohen diferenca mes të ardhurave të raportuara nga MFE lidhur me zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2022 në të cilin paraqiten të ardhurat doganore dhe tatimore, që konsistojnë në diferenca si në realizimin e të ardhurave bruto, ashtu edhe në disa zëra tjerë, impaktuar sërisht kryesisht nga detajimi i evidencave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

3.1 Rekomandimi: Titullari i DPD, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës të të Ardhurave, të marrë masat për analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mos realizimin e planit të të ardhurave doganore sipas zërave, referuar degëve doganore që operojnë nën juridiksionin e DPD, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë përkatëse për situatën, në funksion të arritjes së objektivave institucional, si dhe duke garantuar një raportim të saktë mbi realizimin e të ardhurave të harmonizuara me modelin e MFE, në mënyrë që të evidentohet qartazi rimbursimi i akcizës apo zërave të tjerë që mund të përbëjnë shkak për diferenca në raportimet mes dy institucioneve si në fazën e planifikimit ashtu edhe realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në fund të vitit 2022, rezulton një nivel borxhi doganor në shumën 46,690,911 mijë lekë, e përfaqësuar nga 4,858 raste, i cili rezulton gjithmonë në rritje, ku për vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 979,324 mijë lekë, ose me 2,14%.

- Nga auditimi konstatohet një diferencë në borxhin doganor prej 3,101 mijë lekë më shumë se borxhi i raportuar nga ana e Drejtorisë së Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave (46,687,810 mijë lekë) për vitin 2022, si rezultat i raportimit të gabuar nga ana e Degës Doganore Rinas për vlerën e mësipërme, për shkak të pagimit të kësaj vlerë në muajin Janar të vitit 2023 (dhe raportimit si të paguar në vitin 2022). Drejtoria e Planifikimit dhe Analizës së të Ardhurave, Sektori i Borxhit, është mjaftuar vetëm në evidentimin e borxhit doganor të raportuar nga degët doganore, por nuk ka nxjerrë udhëzime ose manuale të reja me qëllim specifik vjeljen e detyrimeve dhe përmirësimin e situatës aktuale.

Gjithashtu transferimi i përgjegjësive për vjeljen e detyrimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave drejt Degëve Doganore, ku në pjesën më të madhe të Degëve Doganore ka vetëm një punonjës përgjegjës për arkëtimin e detyrimeve, si dhe nisur nga fakti që ekziston një numër i lartë rastesh dhe rritje e stokut të borxhit, veprimtaria e ndjekjes së detyrimeve është jo efektive, fakt që evidentohet nga viti në vit me rritjen e stokut të borxhit.

- Nga auditimi konstatohet se nuk ka programe pune të përbashkëta përsa i përket mbledhjes së detyrimeve të papaguara midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kundërshtim me pikën 5 të nenit 6 të marrëveshjes së bashkëpunimit midis DPD-së dhe DPT-së nr.14355 prot, datë 19.06.2018, e ndryshuar.

- Nga ana e DPD-së nuk janë marrë në analizë vlerësimet e Kryetarëve të Degëve Doganore të cilat kanë performuar negativisht në uljen e nivelit të borxhit dhe në mos realizimin e objektivave gjatë vitit 2022.

- Nga auditimi konstatohet se rezultatet e arrira nga zyrat e përmbarimit janë të papërfillshme, të cilat kanë arritur të ekzekutojnë plotësisht përgjatë vitit 2022 urdhrat e ekzekutimit që përbëjnë rreth 0,03% të borxhit doganor pajisur me urdhër ekzekutimi (27,370,418 mijë lekë).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqet 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

4.1 Rekomandimi: Nga ana e DPD-së të analizohet me kujdes situata e krijuar përsa i përket rritjes së borxhit doganor në mënyrë të përvitshme, duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse, të plotësohet struktura organike e këtij sektori, të rritet niveli i bashkëpunimit me DPT, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore, me qëllim rekuperimin e borxhit doganor në shumën prej 46,690,911 mijë lekë, duke parandaluar rritjen e mëtejshme të borxhit, duke rritur monitorimin edhe ndaj zyrave përmbarimore.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se në 2 raste pas përfundimit të verifikimit nga ana e grupit të antikontrabandës ka moszbatim të procedurës së verifikimit të shkeljes doganore (seksioni 17 i procesverbalit), duke mos i dërguar autoritetit doganor kompetent procesverbalin përfundimtar dhe duke mos u përgatitur dosja e plotë në lidhje me shkeljen. Si rrjedhojë, këto akte administrative, nuk kanë prodhuar asnjë efekt juridik. Konkretisht, referuar kontrollit të kryer ndaj subjektit V.T. me NIPT L..I me përfaqësues “F.K.” dhe “MB” me NIPT L..K, konstatohet se në procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjes administrative, përshtkrimi i shkeljes e mënyrës se kryerjes është “mungesa e manifestit”, dhe nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes doganore (seksioni 12 i procesverbalit) se përse klasifikohet si kundërvajtje me përgjegjësi objektive bazuar në fakte dhe prova konkrete, sipas nenit 251 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, e cila ka si sanksion penalitetin në masën 1 fish të detyrimit të munguar, ose sanksion në masën nga 20,000 deri në 50,000 lekë. Në seksionin 7 të procesverbalit “Nenet e shkelura” nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontrabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 51-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

5.1 Rekomandimi: Departamenti Operativ Hetimor dhe Drejtoria e Antikontrabandës të ndjekë zbatimin në praktikë të planeve operacionale dhe të mbikqyrë veprimtarinë e kryer, gjithashtu për rastet e konstatimit të shkeljeve të dispozitave të kodit doganor, procesverbali i verifikimit të shkeljes, duhet të mbahet në 3 kopje sipas përcaktimeve ligjore, ku kopja e parë duhet të administrohet nga Dega Doganore vendimmarrëse, kopja e dytë duhet t'i jepet shkelësit dhe kopja e tretë duhet të depozitohet në arshivën e strukturës verifikuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës, në 7 raste, në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet klasifikimi i shkeljes doganore (seksioni 12 i procesverbalit), në kundërshtim me nenet 250, 251, 252 dhe 253 të ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se në 4 raste, referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e kësaj drejtorie, në procesverbalin e mbajtur nuk argumentohet mënyra e kryerjes së shkeljes (seksioni 6 i procesverbalit) për verifikimin e kundravajtjes administrative, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të ligjit nr. 102/2014, i ndryshuar.

- Nga auditimi konstatohet se në 6 raste, referuar kontrolleve të plota të kryera nga ana e kësaj drejtorie, në procesverbalin e mbajtur nuk identifikohet nga ana e grupit të antikontrabandës se çfarë shkelje doganore ka kryer subjekti (seksioni 7 i procesverbalit) “Nenet e shkelura”, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 274 të ligjit nr. 102/2014, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 51-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

6.1 Rekomandimi: Grupet e kontrollit të Drejtorisë së Antikontrabandës të plotësojnë me korrektesë procesverbalet e shkeljeve përkatëse me informacion të detajuar lidhur me llojin e kontrollit të ushtruar, rezultatet e kontrollit, llojin e shkeljes, klasifikimin dhe mënyrën me të cilën është kryer shkelja, penalitetet e vendosura, bazën ligjore dhe masat e tjera të marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer pranë Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD konstatohet se, nuk është identifikuar asnjë rast i ekzistencës së gabimeve në skanim, për të cilat sipas kontratës është vlerësuar aplikimi i penaliteteve në situatat në të cilat “analiza e dështuar e imazheve”, e cila përfshin rastet kur nga ana e skanerit nuk janë identifikuar parregullsi, po ndërkohë nga ana e personelit doganor janë identifikuar përmbajtje të lëndëve të paligjshme. Drejtoria e Antikontrabandës në DPD nuk dispononte një databazë përmbledhëse historike të të gjitha rasteve kur kjo strukturë është përfshirë në kontrolle që lidhen me rezultatet e skanerit, për të dokumentuar kështu diferenca të mundshme që mund të kenë rezultuar nga përgjigja e skanerit me atë që ka rezultuar pas kontrollit, për të cilat kontrata parashikon penalitete nga 30,000 euro për çdo gabim në skanim, deri në zgjidhjen e parakohshme të kontratës. Informacioni u hartua në vijim të kërkesës së grupit vetëm për vitin 2021 dhe 2022 të kontrolleve dhe shoqërimeve të mjeteve për skanim, të raportuara dhe evidentuara nga grupet e terrenit të kësaj drejtorie, ku kanë mbajtur/dorëzuar dhe dokumentacionin përkatës vetëm për rastet ku në dokumentacion është shënuar se ka patur markim nga skaneri, ndërsa për deklaratat e pastra nuk janë raportuar të jenë kryer kontrolle që kanë rezultuar me parregullsi nga ana e kësaj drejtorie. Sipas informacionit, për vitin 2021 janë raportuar 26 raste si indicie nga skaneri, me detyrim në vlerën 12,522,264 lekë, nga të cilat pas kontrollit janë identifikuar parregullsi në 4 raste, dhe për vitin 2022 janë raportuar 7 raste si indicie nga skaneri, ku është përlllogaritur detyrimi në vlerën 56,716 lekë, nga të cilat pas

kontrollit janë identifikuar parregullsi në 2 raste. Këto dobësi të identifikuara në drejtim të sistemit të ngritur për të kontrolluar/verifikuar procesin e punës së lidhur me skanerin, konstatohet se vonojnë vlerësimin e rezultateve të skanimit, për të gjykuar kështu nëse ka patur ose jo dështime në analizat e imazheve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 51-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Antikontrabandës pranë DPD të marrë masat për dokumentimin e të gjitha kontrolleve të kryera nga kjo njësi që lidhen me rezultatin e skanerit, me qëllim verifikimin e saktësisë së skanerit dhe identifikimin e mundshëm të gabimeve në skanim, për të cilat kontrata koncesionare parashikon penalitete, duke parashikuar një marzh për kryerjen e kontrolleve fizike të mjeteve të identifikuara nga skaneri si të rregullta (pa ngjyrë), të cilat deri tani janë jashtë fushës së kontrollit të autoriteteve doganore.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2022, nga ana e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Paszhdoganimit (DKAP) janë administruar 115 kërkesa për rimbursim akcize, në vlerën 234 milion lekë, 85 prej të cilave i përkasin përfaqësive diplomatike dhe 30 operatorëve ekonomik subjekt i parashikimit ligjor. Nga 30 kërkesat e OE për serat dhe industrinë janë përfituar gjithsej rimbursimet e akcizës për 7 operatorë: A, AR, A.C., K, P. dhe R.B.. Nga auditimi konstatohet se, për miratimin e 115 kërkesave për rimbursim akcize në vlerën e 234 milion lekë, për 10 subjekte nuk është ushtruar asnjë kontroll për procedurat e miratimit të këtyre kërkesave nga Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Paszhdoganimit, si dhe nga strukturat e Auditit të Brendshëm në DPD për të konsideruar këto procedura si fusha me risk të lartë, referuar impaktit që kanë operatorët e fushës së akcizës në të ardhurat doganore, si dhe në vijim të përcaktimeve në Rregulloren e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksonimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, neni 73. Gjithashtu, janë evidentuar 4 kërkesa të miratuara jashtë afatit 45 ditor të përcaktuara në ligjin nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 81, pika 1 dhe 2, pasi ky proces ka zgjatur nga 56 deri në 67 ditë. Gjithashtu, nga auditimi i evidencës së rimbursimit të akcizës vendosur në dispozicion është konstatuar se ka thyerje në radhën e shlyerjes sipas parimit FIFO (First In First Out).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditit të Brendshëm dhe Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Paszhdoganimit të identifikojnë në fushat me risk të lartë në rimbursimin e akcizës dhe të marrin masat për kontrollin periodik të procedurave të miratimit të kërkesave për rimbursim.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlefshmërisë së garancive të autorizimeve të magazinave fiskale, për 125 operatorë të testuar me zgjedhje në sistem, në 8 prej tyre kanë rezultuar se gjatë vitit 2022 kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të pa mbuluar me garanci të vlefshme, duke mos përmbushur përcaktimet ligjore, për të cilat nuk kanë nisur procedurat e revokimit të autorizimit nga degët doganore përkatëse, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, i ndryshuar dhe VKM nr. 612, datë 05.09.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit për akcizat”. DPD nuk ka bërë një monitorim periodik mbi Degët Doganore dhe subjektet mbi zbatimin e kushteve për lëshimin e autorizimit të magazinës fiskale në përgjithësi dhe afatit të garancisë së tyre në veçanti, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 20 të ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, afatet procedurale

në miratimin e autorizimeve sipas ligjit nr. 61/2012, datë 24.05.2012 “Për akcizat në RSH”, neni 20, rezultojnë të mos jenë zbatuar në 2 raste nga 7 raste të testuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e konstatuara në çështjen e autorizimeve të magazinave fiskale të cilat rezultojnë të pa mbuluara me garanci sipas legjislacionit doganor e për të cilat nuk kanë nisur ende procedurat e revokimit të autorizimit të magazinës fiskale, si dhe të marrë masa për monitorimin periodik të veprimtarisë së DPD lidhur me vlefshmërinë në kohë të kushteve ligjore, duke identifikuar këtë procedurë në mënyrë të detajuar në rregulloren funksionale, së bashku me evidentimin dhe caktimin e detyrave të sektorit për procedurat që mbulon shqyrtimin e të dhënave të operatorit në sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së DKAP është konstatuar se, përzgjedhja e operatorëve për kontroll nuk është mbështetur në një analizë risku në nivel drejtorie apo sektori për periudha vjetore apo 6 mujore, bazuar në vlerësimin e riskut sikurse përcaktohet në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2021 “Manuali mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”. Gjithashtu, konstatohet se ky manual nuk rregullon afatet proceduriale të kontrollit për 4 sektorët e DKAP, duke rezultuar në kontrole që janë zgjatur deri në 511 ditë, pa arsye të evidentuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

10.1 Rekomandimi: Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Paszhdoganimit të marrë masa për realizimin dhe dokumentimin e analizës së riskut sipas sektorëve për operatorët ekonomikë në nivel vjetor dhe 6 mujor, evidentimin e operatorëve me risk në akte administrative, propozimin dhe miratimin e operatorëve të përzgjedhur, si dhe të marrë masa për rregullimin e afateve proceduriale të kontrollit sipas fazave në Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2021 “Manual mbi metodologjinë e kontrollit të akcizës”.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se strukturat përkatëse në DKAP në përfundim të veprimeve përgatitore nuk kanë hapur dosje kontrolli për çdo operator, sikurse përcakton Udhëzimin nr. 2, datë 28.01.2021. Në dosjet e dorëzuara nuk administrohet informacion i plotë për kontrollin e ushtruar dhe evidencat në të cilat mbështeten përfundimet, si dhe në përfundim të procedurave të kontrollit nuk është bërë inventarizimi dhe arshivimi i dosjeve.

- Nga auditimi i dosjeve të kontrollit të DKAP është konstatuar se në procesverbalet e kontrollit fizik nuk janë mbajtur në përputhje me përcaktimet e nenit 69, pika 1, c dhe ç të VKM-së nr. 612, datë 05.09.2012, duke mos identifikuar në procesverbale tepricat e konstatuara në inventarizim, si dhe nuk i janë bashkëlidhur procesverbaleve deklaratat përmbledhëse me llogaritjen e zbritjeve të humbjeve dhe firove, që njihen në fund të periudhës ushtrimore sikurse përcaktohet në nenin 69, pika 2, c. Gjithashtu, është konstatuar se procesverbalet e verifikimit të kundërvajtjeve administrative në të gjithë dosjet e kontrollit të përzgjedhura për testim janë pa datë verifikimi, në kundërshtim me nenin 98, ku përcaktohet se procesverbali duhet të përmbajë vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Kontrollit të Akcizës dhe Paszhdoganimit, sipas strukturës të marrë masa për hapjen e dosjes së kontrollit me nisjen e kontrollit, përfshirjen e dokumenteve të shqyrtuara dhe mbi të cilin mbështetet kontrolli dhe rezultatet e tij, mbajtjen e procesverbaleve të

kontrollit fizik dhe të kundërvajtjeve administrative në përputhje me përcaktimet ligjore, inventarizimin dhe arkivimin e saj në përputhje me përcaktimet ligjore. Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa në adresimin e përgjegjësive për parregullsitë e evidentuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 dosjeve të kontrollit të Sektorit Aposterior janë konstatuar parregullsi të ndryshme procedurale, nga tejkalimi i afateve, mos evidentimi i relacioneve të riskut dhe mos inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve të kontrollit, në kundërshtim me Manualin mbi kryerjen e kontrollit pas zhdoganimit në ambientet e operatorit ekonomik apo në degët doganore miratuar me urdhrin nr.7, datë 28.01.2021 të DPD, si dhe procesverbalet e kontrolleve fizike nuk protokollohen dhe i bashkëngjiten si dokumente shoqërues informacionit për Drejtorin e Përgjithshëm.

Në një rast, për operatorin “A.” SHPK nuk është argumentuar masa e penaltetit vendosur në secilin procesverbal për kundërvajtjet e konstatuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12. Rekomandimi: Sektori i Kontrollit Aposterior të marrë masa sipas strukturës për dokumentimin e gjurmëve të auditimit, zbatimin e afateve procedurale dhe argumentimin e masës së penalteteve të vendosura sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pas përcjelljes së propozimeve të DPD pranë MFE në kuadër të hartimit të PBA-së së fazës së dytë 2022-2024, në vijim të shkresës së MFE, janë rishikuar prioritetet në kërkesa buxhetore, si rezultat i së cilave janë reduktuar fondet e DPD me 43,969 mijë lekë, krahasuar me limitet e planifikuara në fazën e dytë të PBA-së, duke rezultuar me diferenca të konsiderueshme mes tavaneve buxhetore të përcaktuara gjatë fazave të hartimit të planeve buxhetore afatmesme, krahasimisht me total kërkesat e DPD. Këto diferenca kanë ardhur në rënie gjatë hartimit të fazës së tretë të PBA-së dhe gjatë çeljes së fondeve buxhetore të vitit 2022 apo planit të rishikuar përgjatë vitit. Konkretisht, në fazën e I-rë të PBA-së, kërkesat e institucionit paraqiten në vlerën 4,646,220 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,497,782 mijë lekë), ndërkohë që limitet në tavane janë miratuar në vlerën 3,905,910 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,063,866 mijë lekë) dhe në fazën e II-të PBA-së, kërkesat e institucionit paraqiten në vlerën 4,594,187 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,545,647 mijë lekë), ndërkohë që limitet në tavane janë miratuar në vlerën 3,605,910 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,882,628 mijë lekë). Fondet janë çelur fillimisht në vlerën 3,806,010 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,782,152 mijë lekë), dhe sipas planit të rishikuar paraqiten në vlerën 3,938,554 mijë lekë (nga të cilat aparati 3,041,227 mijë lekë) dhe realizimi në vlerën 3,869,768 mijë lekë (nga të cilat aparati 2,928,686 mijë lekë).

- Nga auditimi konstatohet se në kuadër të hartimit të dokumentacioneve të buxhetit si në fazën e planifikimit (PBA-ja) dhe atë të realizimit të buxhetit (raportet e monitorimit 4 mujore), nga ana e DPD hartohet përmbledhësja që pasqyron të dhënat e konsoliduara në rang sistemi doganor për të gjitha degët doganore, duke mos u dokumentuar realizimi i buxhetit vetëm për DPD, si njësi shpenzuese më vete.

- Nga auditimi i rishikimeve të fondeve të investimeve sipas akteve normative, konstatohet se këto ndryshime nuk rezultojnë të jenë një produkt i kërkesave të DPD për shpërndarjen e fondeve në programe/produkte të tjera buxhetore, pasi nga ana e tyre është kryer vetëm raportimi i fondeve të lira në mënyrë elektronike sipas kërkesës së MFE.

- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të DPD sipas projekteve buxhetore u konstatuan problematikat e mëposhtme:

1. Për projektin me kod 18CC804 “*Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavijë*”, fillimisht fondet rezultojnë të jenë çelur në vlerën 77,000 mijë lekë, dhe deri në fund të vitit ato rezultojnë rreth 38,819 mijë lekë më pak, pasi pas kryerjes së procedurës së prokurimit, fondet për këtë projekt janë pakësuar me 27,000 mijë lekë. Ky projekt është propozuar nga Dega e Doganës Gjirokastër dhe Drejtoria e Burimeve Mbështetëse, të cilat kanë përcjellë edhe shumën e nevojshme për kryerjen e këtij rikonstruksioni. Për realizimin e tij, nga ana e Sektorit të Prokurimeve është hartuar urdhri i prokurimit në të cilin është parashikuar vlera prej 31,395 mijë lekë pa TVSh dhe diferenca e fondeve në shumën 27,000 mijë lekë është pakësuar më pas me Aktin Normativ nr.12, datë 29.07.2022.

2. Për projektin me kod 18CC805 “*Zbatim i projektit krijimi i ambienteve shtesë në parkingun e Degës Doganore Morinë, sistemim asfaltim, rrethim*” fondet janë çelur fillimisht në vlerën 40,269 mijë lekë, të cilat rezultojnë të pa përdorura deri në fund të vitit, për shkak të mos miratimit të VKM-së për kalim pronësie e më pas për marrjen e lejes ndërtimit, ku si rezultat fondet kanë mbetur të pa përdorura dhe janë pakësuar me anë të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

3. Në muajin Dhjetor 2022 rezultojnë të jenë shtuar fondet në vlerën 45,856 mijë lekë, nën kodin 91005AB “*Vendime Gjyqësore të Ekzekutuara*”, pasi në fillim të vitit buxhetor për këtë produkt nga ana e MFE nuk janë çelur fonde për DPD. Nisur nga ecuria e realizimit të zërave të shpenzimeve korrente fondet e lira janë rialokuar me anë të Aktit Normativ nr. 17, datë 01.12.2022.

4. Gjithashtu, u konstatua se projekti M100479 “*Sistem monitorimi*” planifikuar në vlerën 29,000 mijë lekë dhe projekti 18AW302 “*Dixhitalizimi shërbimeve doganore*” planifikuar në vlerën 9,450 mijë lekë, pavarësisht se janë propozuar gjatë hartimit të PBA-së faza e dytë, rezultojnë të pa realizuara deri në fund të vitit 2022.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqet 136-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

13.1 Rekomandimi: DPD të marrë masat për hartimin e dokumenteve për monitorimin e realizimit të buxhetit vetëm për institucionin si njësi shpenzuese më vete, pa përfshirë degët doganore brenda programit të të ardhurave doganore, duke përfshirë treguesit gjatë të gjithë procesit, nga planifikimi buxhetor deri në realizim, në kuadër të përmirësimit të procedurave të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2 Rekomandimi: DPD të marrë masat për intensifikimin e bashkëpunimit me MFE, me qëllim kryerjen e një planifikimi sa më efektiv të fondeve në përputhje me objektivat institucionale gjatë miratimit të tavaneve buxhetore, si dhe shmangien e ndryshimeve të shpeshta në buxhet të fondeve dhe garantimin e një monitorimi të plotë të realizimit të fondeve buxhetore sipas planifikimit, duke identifikuar në kohë projektet që janë me realizim më të ulët, në mënyrë që fondet në dispozicion të tyre, të rishpërndahen në projekte të tjera brenda programit të menaxhimit të të ardhurave doganore.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, regjistri i parashikimit të prokurimeve është hartuar në tejkallim të afatit të parashikuar në Kreun I, pika 3 e Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për hartimin e Regjistrimit të Parashikimeve të Procedurave të Prokurimit Publik”. Gjithashtu, për hartimin e regjistrimit të prokurimeve nuk është dokumentuar shqyrtimi i kërkesave të DPD dhe degëve doganore me qëllim përcaktimin e kriterëve të

vendimmarrjeve referuar prioriteteve, apo faktorëve të tjerë, për të garantuar planifikimin eficient të fondeve që do të prokurohen, duke reflektuar drejt nevojat si dhe vlerën e kohën për plotësimin e tyre, sikundër përcakton Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2021 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Rregullat e Prokurimit Publik”.

- Sipas sistemit elektronik të prokurimeve publike, rezulton se ky regjistër është rishikuar përgjatë vitit, ku konstatohet mungesa e korrespondencave që justifikojnë çdo rishikim të kryer, dokumentuar me shkresat e kërkesave të nevojave për kryerjen e prokurimeve që nuk kanë patur mundësi të planifikohen në fillim të vitit. Nga krahasimi i regjistrit fillestar të parashikimeve të prokurimeve publike, me atë të rishikuar deri në fund të vitit, u konstatuan diferenca të konsiderueshme, konkretisht: fillimisht janë planifikuar vetëm 10 procedura, në shumën 34,844,590 lekë, ndërsa deri në fund të vitit 2022 rezultojnë të jenë planifikuar 55 procedura, në shumën 167,032,266 lekë, duke nxjerrë kështu në pah mangësitë e procesit të planifikimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

14.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masa për të garantuar hartimin në kohë të regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike, duke prioritarizuar nevojat e institucionit, me qëllim shmangien e rishikimeve të shpeshta apo diferencave të konsiderueshme në vlerë dhe numër kontratash në regjistrin fillestar ndaj atij të rishikuar, për të garantuar përdorimin efektiv të fondeve buxhetore disponibël për institucionin.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 është përcjellë nga shoqëria “N.G.” SHPK projekt zbatimi me objekt “*Studim e projektim të Rikonstruksionit dhe zgjerimit të terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kakavijë*”, në zbatim të kontratës së lidhur me të nga DPD nr. 23401, datë 14.12.2021, në të cilin hartimi i preventivit (analiza e çmimeve) ka përcaktuar fondin limit në vlerë 31,396 mijë lekë. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Financës pranë DPD, konstatohet se fondet disponibël për këtë projekt investimi “*18CC804- Godina të ndërtuara dhe ri konstruara*” Rikonstruksioni dhe zgjerimi i Terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e Pikës së Kalimit Kufitar Kakavije”, janë çelur në vlerën 77,000 mijë lekë, pra më shumë se dyfishi i fondit limit të përlllogaritur për kryerjen e prokurimit, përcjellë me shkresën nr. 24123, prot datë 30.12.2021 nga OE i kontraktuar. Si rezultat, diferenca e fondeve prej 45,605 mijë lekë, ka mbetur e papërdorura nga DPD dhe e pa shpërndarë në projekte të tjera, deri në Shtator të vitit 2022, duke përbërë kështu risk të shtuar për krijimin e efekteve financiare negative për përdorimin pa efektivitet, efience dhe ekonomikitet të fondeve publike në kushtet kur për periudhën 9 mujore këto fonde mund të ishin përdorur në një tjetër destinacion për projekte prioritare të DPD në të njëjtin program, apo edhe programeve të tjera me miratimin e strukturave përkatëse pranë MFE.

-Përgjatë zbatimit të kontratës të lidhur me operatorin ekonomik “I.” SHPK me objekt “*Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë*” janë konstatuar pamjaftueshmëri fondesh në zërat e miratuar sipas preventivit të kontratës, për të cilat është alokuar fondi rezervë dhe janë kryer rishikime sipas zërave të miratuar pa u shoqëruar me një marrëveshje me shkrim për modifikimin e kontratës, pasi miratimi për kryerjen e ndryshimeve është bazuar vetëm në firmosjen nga të dyja palët të kërkesës për përdorimin e fondit rezervë dhe kryerjen e ndryshimeve nëpërmjet zërave të preventivit. Në dosje nuk disponohej relacioni teknik mbi nevojën e ndryshimit të volumeve të punimeve, pasqyra e ndryshimit të volumeve të punimeve të rehabilitimit, apo tabela që përshkruan punime që hiqen

e shtohen, për të cilat nga ana e grupit të auditimit janë konstatuar pasaktësi në përlllogaritjet e kryera për efekt rishikimi të çmimit të preventivit të kontratës, të cilat nuk janë monitoruar nga ana e DPD në momentin e miratimit të ndryshimeve. Ndryshimet në preventivin e kontratës kanë sjellë pakësim të investimeve për të cilat OE ka marrë angazhimin për t'u kryer në zërat për pajisje, punime hidrosanitare, elektrike, hidroizolimi, patinime, pasi këto fonde janë alokuar në punime B/A, hekuri, tavani dhe mure, gërmime, të cilat duhet të ishin përfunduar në fillim të kontratës. Nga auditimi konstatohet se, referuar ecurisë së kontratës së rikonstruksionit pas evidentimit të nevojës për rishikimin e termave me impakt reduktimin e çmimeve për pajisje, nga ana e DPD nuk ka patur një qëndrim për të gjykuar nëse kryerja e ndryshimeve ka ardhur si pasojë e parregullsive në hartimin e preventivit nga ana e operatorit të kontraktuar për hartimin e termave dhe marrjen e masave përkatëse; apo nëse ka patur parregullsi nga ana e OE përgjegjës për kontratën e ndërtimit, për të cilën nuk duhet të ishin miratuar ndryshimet përkatëse. Gjithashtu, përgjatë zbatimit të kontratës u konstatuan vonesa në realizim krahasuar me grafikun e punimeve, problematika të cilat nuk janë identifikuar nga grupi i ngritur për monitorimin e zbatimit të kontratës.

- Nga auditimi i procedurës së prokurimit “*Rikonstruksion dhe zgjerim i terminalit për krijimin e kushteve optimale për udhëtarët e pikës së kalimit kufitar Kakavijë*”, u konstatuan mangësi në argumentimin e specifikimeve teknike, situatë kjo që përbën një risk të shtuar për ndikimin në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen, veprime të cilat bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik e konkretisht nuk janë në përputhje Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 36, pika 4, por që nuk kanë impaktuar vlerën e prokuruar pasi operatori fitues ka qenë oferta më e ulët. Konkretisht problematikat e konstatuara lidhen me mos argumentimin e kriterit për të figuruar si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues punonjësit sipas profesioneve (arkitekt, inxhinier, etj); kriteret për angazhimin e punonjësve sipas profesioneve dhe numri i fuqisë punëtore; dhe kriteri për nevojën e pajisjes me certifikatat e cilësisë së punimeve, përlllogaritja e orëve të punës, mjeteve të kërkuara dhe argumentimi i stafit të kërkuar. Gjithashtu KVO, pas shpalljes së fituesit, nuk ka verifikuar formularët e listëpagesave të shoqërisë për të evidentuar përputhshmërinë e punonjësve sipas kriteve, duke u mjaftuar me kontratat e punës të dorëzuara pranë AK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

15.1 Rekomandimi: Titullari i DPD të marrë masat për ngritjen e një grupi pune, për kryerjen e verifikimeve të nevojshme të fondeve të miratuara për këtë procedurë, duke filluar nga detajimi i fondit limit për projektin e investimit dhe përcaktimin e shkaqeve që kanë çuar në planifikimin e kontratës në nivele tepër të ulta krahasuar me fondet buxhetore disponibël të alokuara për këtë projekt, si dhe më pak se nevojat reale që kanë rezultuar përgjatë zbatimit të kontratës shoqëruar me ndryshime, duke marrë masat sipas përgjegjësive të identifikuara si nga ana e strukturave përgjegjëse të DPD ashtu edhe ndaj OE të kontraktuar për shërbimet përkatëse. Gjithashtu, grupi i punës të vlerësojë parregullsitë e konstatuara përgjatë zbatimit të kontratës, duke analizuar edhe impaktin që ka patur kryerja e ndryshimeve në preventivin e punimeve duke reduktuar fondet sipas disa zërave për shkak të pasaktësive në përlllogaritjen e fondeve, me qëllim ndërmarrjen e masave ndaj strukturave përgjegjëse për problematikat e shkaktuara.

Brenda vitit 2023

15.2 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat që gjatë hartimit të specifikimeve teknike të argumentohen për çdo rast kriteret e vendosura të shoqëruara me analizat dhe vlerësimet përkatëse që justifikojnë vendimmarrjen, për të garantuar ekzistencën e konkurrencës së lirë pa kufizuar pjesëmarrjen dhe dokumentimin e procesit për verifikimin e përmbushjes së plotë të kriteve të cilësuar gjatë fazës së prokurimit të procedurës, për të

garantuar se operatori ekonomik do të arrijë të përmbushë kushteve të kontratës dhe realizimin e saj në kohë e cilësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Certifikata e Akreditimit e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për Laboratorin Doganor pranë DPD ka qenë e vlefshme për periudhën 4 vjeçare Tetor 2018 -Tetor 2022. Nga auditimi konstatohet se deri në përfundim të vitit 2022 Laboratori Doganor nuk e ka mbartur më statusin laborator i akredituar, për shkak të mos përfundimit të procesit të mirëmbajtjes dhe kalibrimit të pajisjeve të laboratorit, impaktuar nga vonesat në procedurat respektive të prokurimit, të cilat nuk kanë mundur të kontraktojnë në kohë operatorin ekonomik për ofrimin e këtij shërbimi. Ky proces, së bashku me aplikimin për rinovimin e certifikatës dhe ri konfirmimin e akreditimit për periudhën e ardhshme 4 vjeçare, planifikohet të përfundojë brenda vitit 2023, e për rrjedhojë kjo situatë mbart riskun që analizat e kryera nga laboratori doganor, për periudhën pas muajit Tetor 2022 e në vijim, të jenë të kontestueshme, meqenëse janë kryer gjatë periudhës që laboratori ka qenë i pa akredituar.

- Nga auditimi konstatohet se fondet disponibël të akorduara për Laboratorin Doganor pranë DPD prej rreth 4 milion lekë, nuk mbulojnë nevojat për shpenzime të Laboratorit Doganor (materiale dhe pajisje laboratorike), pasi ato rezultojnë mbi 6 herë më shumë se fondet akorduara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

16.1 Rekomandimi: Titullari i DPD të marrë masat për vlerësimin e problematikës së mësipërme, për të identifikuar strukturat përgjegjëse që nuk kanë arritur të garantojnë në kohë vijueshmërinë e procesit të certifikimit dhe efektet që kjo sitatë ka shkaktuar, si dhe të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për përfundimin e procesit të akreditimit të Laboratorit Doganor.

Brenda vitit 2023

16.2 Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik pranë DPD në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse pranë MFE të marrin masat për vlerësimin e nevojave të laboratorit doganor, për të garantuar mbulimin me fonde të mjaftueshme për të realizuar furnizimin me materialet dhe pajisjet për vijueshmërinë normale të punës.

Brenda vitit 2023 dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se përgjatë procedurës së prokurimit me objekt "*Blerje materiale dhe pajisje laboratorike të shërbimit publik dhe reagent kimik*" nuk dokumentohet vlerësimi i kryer nga anëtarët e KVO për përmbushjen e kriterëve të përcaktuara duke marrë të mirëqenë se do të verifikohen gjatë zbatimit të kontratës nga grupi i pranimit. Nga ana e komisionit të marrjes në dorëzim të kësaj kontrate, si dhe kontratës me objekt "*Blerje Kompjuterë*", u konstatua se komisioni për marrjen në dorëzim nuk ka dokumentuar procesin e verifikimit të pajisjeve në përputhje me specifikimet teknike, për të verifikuar çdo specifikë me ato të parashikuara në kontratë, referuar kapacitetit apo kriterëve të tjera të përcaktuar në DST, por është kufizuar me verifikimin e faturave të mallrave me emërtimin e mallit, sasisë dhe çmimit. Gjithashtu, marrja në dorëzim nuk ka paracaktuar një grafik për periudhën kohore që duhet të bëhet kjo shpërndarje nga OE si pjesë e DST apo kontratës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

17.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat që për marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve, të dokumentohet rast pas rasti kontrolli i kryer nga grupi i punës për përputhshmërinë e materialeve/mjeteve/pajisjeve të dorëzuara me kriteret në kontratë, duke mos u mjaftuar vetëm tek emërtimi i produkteve dhe sasisë së tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi kontatohet se VKM nr. 355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për personelin e administratës doganore”, nuk është zbatuar brenda afatit të parashikuar, për shkak të vonesave në vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit. Ky komision ka zhvilluar mbledhjen e parë më datë 13.06.2022, dhe pavarësisht se është cituar nga vetë komisioni se vendimmarrja mund të shtyhet vetëm një herë, afati për të finalizuar procesin e ristrukturimit është shtyrë edhe dy herë të tjera, ku deri në përfundim të fazës së auditimit në terren nuk rezulton të jetë finalizuar. Kështu, deri në fund të vitit 2022 janë marrë vetëm 2 vendime për transferimin e përhershëm të punonjësve me status nëpunësi civil (datë 7.12.2022 dhe 20.12.2022) duke mos realizuar procesin e ristrukturimit në nivel sistemi. Për sa i përket vendimmarrjes së komisionit për punonjësit jashtë shërbimit civil, është marrë vetëm 1 vendim më datën 30.06.2022 për largimin e 15 punonjësve si rezultat i ristrukturimit.

Nga auditimi rezulton se, deri më datën 31.12.2022 janë 96 vende vakante në sistemin doganor, nga të cilat 59 i përkasin vakancave në degët doganore, dhe 37 në DPD. Shpalljet e vakancave nuk janë kryer nga DAP, pasi institucioni është orientuar se procedurat e rekrutimit do të vijnë pas përfundimit të procesit të ristrukturimit, duke nxjerrë kështu në pah problematikat në drejtim të disiplinës financiare, për shkak të planifikimit të fondeve të pagave dhe sigurimeve shoqërore referuar strukturës së planifikuar. Duke qenë se ristrukturimi ka patur vonesa, nuk është bërë iniciimi i procedurave të konkurrimit për plotësimin e vendeve vakante pranë DPD. Gjithashtu, edhe procedurat e transferimeve të përkohshme të punonjësve kanë vijuar deri në pritje të përfundimit të procesit të ristrukturimit.

Në zbatim të VKM-së nr. 355, datë 26.05.2022, organika e DPD është miratuar të funksionojë me 1074 punonjës të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor, pra 28 punonjës më pak se VKM nr. 2, datë 08.01.2018. Për shkak të numrit të lartë të vakancave në administratën doganore, mos zbatimi në afat i efekteve të VKM-së, pavarësisht se nuk rezulton në efekte financiare, nxjerr në pah mangësitë që ekzistojnë në drejtim të garantimit të performancës optimale në punë, për sa kohë detyrat realizohen nga një personel më i pakët nga sa parashikuar, apo në drejtim të një organike të planifikuar në nivele më të larta nga sa janë nevojat reale të DPD, për sa kohë objektivat institucional raportohen të realizuar pavarësisht vakancave.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

18.1 Rekomandimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrin masat për kryerjen e të gjitha procedurave të nevojshme për plotësimin e vendeve të punës sipas strukturës organizative të DPD të miratuar me VKM-në nr. 355, datë 26.05.2022, në kuadër të mbarëvajtjes së punës, rritjen e performancës së punonjësve publik, si dhe me qëllim shmangien e praktikave të transferimeve të punonjësve në pozicione të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Janë konstatuar parregullsi lidhur me procedurat e ndjekura për dorëzimin e detyrës së punonjësve të larguar nga DPD, të cilët nuk kanë ndjekur procedurat e përcaktuara VKM-në nr. 124, datë 17.2.2016 “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, Kreu 3, pasi janë larguar nga puna duke mos kryer dorëzimet e nevojshme të detyrës, dokumentacionit pranë eprorëve direkt, situatë kjo që ka ndikuar në vijueshmërinë e punës së strukturave të DPD. Referuar numrit të lartë të transferimeve (172 procedura) dhe largimeve (72 procedura), kjo situatë konstatohet me risk të shtuar. Nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore konstatohet se kanë

vijuar procedurat për miratimin e largimit të punonjësve (dorëzimi i librezës së punës, etj), pa kryer paraprakisht veprimet e nevojshme për të garantuar se punonjësit nuk kanë patur asnjë detyrim ndaj institucionit për dokumentacionin, pajisjet dhe mjeteve të punës në inventar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

19.1 Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse pranë DPD të marrin masat për respektimin me riogorozitet të dorëzimit të dokumentacionit, pajisjeve dhe mjeteve të punës në inventar të punonjësve në rastin e largimit nga detyra të punonjësve dhe/ose transferimit, për të siguruar vijimësinë e veprimtarisë institucionale.

Gjithashtu, të analizohet situata dhe për punonjësit e larguar që janë ende pjesë e shërbimit civil dhe që nuk kanë kryer detyrimin për dorëzimin e rregullt të detyrës, të propozohet marrja e masave disiplinore ndaj tyre, duke e konsideruar shkelje të rëndë disiplinore.

Brenda vitit 2023 dhe vazhdimisht

20. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2022 nuk rezulton asnjë emërim me objekt rikthim në punë të ish punonjësve gjyq fitues. Konstatohet se në kundërshtim me Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionit dhe Administratën Publike, Kryetari i Komisionit të Pranimit përgjatë vitit 2022 nuk ka thirrur asnjë mbledhje të këtij komisioni me qëllim shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave, pas marrjes së vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, referuar pozicioneve në dispozicion në sistemin doganor. Si rezultat, deri në fund të vitit 2022 rezultojnë 4 vendime gjyqësore për rikthim në punë të pa ekzekutuara, nga të cilët për 3 punonjës të shërbimit civil dhe për 1 për punonjës me kod pune.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

20.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të analizojë veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm duke nxjerrë përgjegjësitë e veprimtarisë së tij të pamjaftueshme, si dhe Kryetari i Komisionit të Posaçëm të marrë masat për të thirrur mbledhje të komisionit, me qëllim shqyrtimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt “Rikthim në punë të punonjësve”, duke parashtruar alternativa të pranueshme ndaj gjyqfituesve, me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e shtetit.

Brenda vitit 2023 dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Përgjatë vitit 2022, në DPD janë kryer 172 procedura transferimesh të punonjësve, nga të cilët 131 të nëpunësve civil⁵ dhe 41 punonjës, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës, ku konstatohen transferime me kohëzgjatje mbi 6 muaj, transferime në kategori të ndryshme, transferime nga një pozicion me status në atë pa status dhe anasjelltas. Përgjatë vitit 2022, transferimet janë ndikuar nga vonesat në finalizimin e procesit të ristrukturimit të institucionit, si dhe pezullimi i procedurave të rekrutimit. Kjo vendimmarrje ndikon edhe trajtimin financiar të punonjësve sipas pozicionit të transferuar, kur shoqërohet me një ndryshim kategorie page. Numri i konsiderueshëm i transferimeve në sistemin doganor vlerësohet me risk të shtuar në drejtim të garantimit të arritjes së objektivave, mbarëvajtjes apo cilësisë së punës, dhe performancës institucionale në nivelet e duhura, për vetë rëndësinë që mbartin pozicionet në të cilat punonjësit rezultojnë të transferuar. Nga ana e DPD është shmangur procedura e parashikuar nga neni 25 “Lëvizja Paralele” e Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe pikës “3” gërma “a” të kreut “I” të VKM-së nr 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, duke gjetur mbështetje në përcaktimet e nenit 13 dhe 15 të ligjit nr 102/2014

⁵ Akti i transferimit është përcjellë për çdo rast pranë Departamenti i Administratës Publike, sipas përcaktimeve të nenit 7 të ligjit nr.152/2013 dhe Kreut V, të VKM-së nr. 921, datë 29.12.2014

“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” ku parashikohen rregulla të posaçme për shërbimin doganor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

21.1 Rekomandimi: DPD, në bashkëpunim me Departamentit e Administratës Publike apo edhe struktura të tjera që gjykohen të nevojshme, të marin masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim vlerësimin e procedurës së deritanishme të transferimeve të punonjësve në zbatim të dispozitave të Kodit Doganor, për të konsoliduar strukturën organizative me punonjës të përhershëm dhe për të shmangur mangësitë e trajtuar më sipër që mund të çënojnë arritjen e objektivave institucional.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Në ndjekjen e proceseve gjyqësore me objekt pavlefshmërinë e rivlerësimit doganor në gjykimin në shkallë të parë, Sektori i Ankimimeve i Drejtorisë Juridike në DPD nuk ka paraqitur argumentet e mjaftueshme mbështetur në prova për metodën e vlerësimit të zbatuar, bazueshmërinë në ligj të formularëve të rivlerësimit doganor të nxjerra pa kërkesën e paditësve, plotësimin e kushteve në mospranim të vlerës së transaksionit dhe arsyetimin e mungesës së zbatimit të metodave dytësore të vlerësimit doganor, me pasoja në argumentimin kundërshtues të plotë të provave të sjella në gjykim nga palët paditëse.

- Gjithashtu, konstatohet se Sektori i Ankimimeve ka shfaqur dobësi në vperimtarinë e tij për të ndjekur praktikën përbarimore për ecurinë në ekzekutimin e vendimeve, pasi nuk ka kërkuar informacione në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e ekzekutimit të tyre dhe nuk ka ushtruar kontrollin e dosjeve përbarimorë mbi zbatimin e kontratave nga përbaruesit gjyqësor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

22.1 Rekomandimi: Sektori i Ankimimeve i Drejtorisë Juridike në DPD të marrë të gjitha masat për të siguruar argumentimin dhe provat e nevojshme në proceset gjyqësore, për bazueshmërinë në ligj dhe në fakte të veprimeve të kryera prej autoriteteve doganore në rastin e rivlerësimit doganor. Gjithashtu, të kryejë një analizë të të gjitha dosjeve përbarimore për të arritur në konkluzione mbi ecurinë e tyre, si dhe të ndjekë në vijimësi praktikën përbarimore duke marrë informacione të vazhdueshme për ekzekutimin e vendimeve nga përbaruesit gjyqësor.

Menjëherë dhe në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Sektori i Legjislacionit nuk ka përgatitur një akt administrativ për mënyrën e trajtimit të shkeljeve doganore, me qëllim që të ketë uniformitet në trajtimin, klasifikimin dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, sipas përcaktimeve në nenet 737 dhe 739 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 50, 54, 64 dhe 82 të Rregullores së Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin e DPD” miratuar me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018 të MFE.

Gjithashtu, Sektori i Legjislacionit nuk ka kryer konsultimin publik në hartimin e akteve dhe dhënien e mendimeve juridike për to, si një aspekt i rëndësishëm i mirëqeverisjes, pasi janë 2 Projekt urdhra/udhëzime dhe rregullore dhe 2 Projektvendime të cilat janë iniciuar/hartuar ose DPD ka qenë pjesëmarrëse, për të cilat ka munguar dokumentimi i një veprimtarie të tillë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

23.1 Rekomandimi: Sektori i Legjislacionit të hartojë dhe më pas të miratohet nga Titullari i institucionit një akt administrativ për zbatimin e dispozitave mbi shkeljet doganore, si dhe të përfshijë në planin vjetor aktet që do të konsultohen me publikun, periudhën dhe mënyrën e konsultimit, informacionin shpjegues për objektin dhe qëllimin e projekt aktit përkatës.

Brenda vitit 2023

24. Gjetje nga auditimi: Plani Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD për vitin 2022-2024” është miratuar nga drejtori me anë të shkresës me nr. 17331/5, datë 29.12.2021. Nga auditimi konstatohet se plani strategjik nuk i është dërguar strukturës përgjegjëse për harmonizimin dhe auditimin e brendshëm brenda datës 20 Tetor sipas pikës 3.3 të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016. Kjo vonesë ka ndikuar në miratimin e planit vjetor të auditimit pa qenë më parë i miratuar plani strategjik.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 210-227 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

24.1 Rekomandimi: Drejtori i Auditit të Brendshëm të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Planit Strategjik “Për drejtorinë e AB në DPD” brenda afateve ligjore të përcaktuara, në mënyrë të tillë që plani vjetor i auditimeve të mbështetet në planin strategjik, si dhe ta dërgojë në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE.

Vazhdimisht

25. Gjetje nga auditimi: DPD nuk ka miratuar Rregulloren e Brendshme të re mbi funksionimin e DPD dhe të Degëve Doganore, pas miratimit të strukturës së re organizative sipas VKM nr. 355, datë 26.05.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin 921 për personelin e administratës doganore”.

- Përgjatë vitit 2022 GMS nuk është mbledhur së paku 4 herë në vit, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe me pikën 2.2.4 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

- Deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm për komponentët e MFK-së për vitin 2022, është dërguar mbi një muaj me vonesë nga parashikimi i pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, që është fundi i muajit Shkurt i vitit aktual.

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për vitin 2022, nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, për të gjitha proceset që ndodhin në njësi, në kundërshtim me nenin 16 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditit” dhe nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, Hapi 5 “Gjurmët e auditimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9, faqet 210-227 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

25.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të marrë masa për nxjerrjen e përgjegjësive mbi problematikat e identifikuar, si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën e re të miratuar, si dhe për gjurmën e auditimit, përfshirë plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit, me qëllim dërgimin në afat të deklaratës mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm të monitorojë veprimtarinë e Grupit të Menaxhimit Strategjik që të mblihet sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Hetimit janë konstatuar në 5 raste të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, në shumën 2,087,317 lekë (3 subjekte: H.S SHPK, A.C; person fizik A.G , dhe 2 agjenci doganore: “S-AD” dhe X), si pasojë e sanksioneve jo të plota të vendosura nga ana e kësaj Drejtorie referuar hetimeve të kryera, nga ku janë evidentuar problematika si klasifikim i gabuar i shkeljes së kryer, me pasoja në vlerën e sanksionit për kundërvajtjen administrative përcaktuar në nenin 256/1/a, e cila duhet të ishte sipas nenit 257/1/a të Kodit Doganor, në të cilin penaliteti përcaktohet në masën 2 fish të detyrimit të munguar.

-Gjithashtu, ka rezultuar se në 75 raste të evidentuara si kontrabandë nga ana e Drejtorisë së Hetimit, gjatë konstatimit të shkeljes nga ana e kësaj Drejtorie nuk janë konsideruar edhe kundravajtje me masë administrative në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 259 dhe me nenet 260, 262, 268 dhe 274 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 3,750,000 lekë (50,000 lekë*75 raste) .

Pra, si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të Drejtorisë së Hetimit në DPD, kanë rezultuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, gjithsej në shumën **5,837,317 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 51-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Sarandë, Kapshticë, Elbasan, Shkodër, Morinë dhe Tre Urat, si struktura vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e hetimit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Hetimit me efekte negative, të marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej **5,837,317 lekë**.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Antikontrabandës janë konstatuar 3 raste, të cilat i përkasin 3 subjekteve: G.S, K.B dhe T.P, me të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 1,875,870 lekë, si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura nga ana e kësaj Drejtorie, të cilësuar si kundravajtje me përgjegjësi objektive, por që duhej të trajtoheshin si kundravajtje të kryera me neglizhencë, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 252, dhe klasifikimin e sanksionit sipas pikës 1, germa “a” të nenit 257 të Ligjit nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Gjithashtu, është konstatuar 1 rast lidhur me subjektin “A” SHPK, në të cilin vlera e transaksionit është dukshëm më e ulët se vlera e referencës, si dhe mangësi në kryerjen e kontrollit të plotë, duke mos zbatuar metodën 6 të vlerësimit (metoda e të dhënave të disponueshme) me pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën 162,199 lekë.

Pra, gjithsej kanë rezultuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën prej **2,038,069 lekë**, nga veprimet dhe mosveprimet e Drejtorisë së Antikontrabandës në DPD.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqet 51-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Departamenti Operativ Hetimor dhe Kryetaret e Degëve Doganore Tiranë dhe Kakavijë, si strukturë vendimmarrëse për të gjitha vendimet që janë në kompetencën dhe detyrimin e degës doganore, për të cilat janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurën e kontrollit të plotë të kryer nga ana e Drejtorisë së Antikontrabandës me efekte negative, si pasojë e keq klasifikimit të sanksioneve të vendosura në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, të

marrin vendimet përkatëse me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në vlerën gjithsej prej **2,038,069 lekë**.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në kontrollin e ushtruar në operatorin “N.P ” në aspektin tatimor, nuk është analizuar procesi i prodhimit sipas kartës teknologjike, si dhe nuk janë ndërmarrë masa për të kryer vlerësimin korrekt të situatës financiare pas rivlerësimit doganor të konkluduar me detyrime shtesë akcize në vlerën 2,652,000 lekë, pasi me detyrimet shtesë të akcizës, nga rillogaritja në rritje e vlerës së tatueshme rezultojnë detyrime shtesë për TVSH-në vlerën 530,400 lekë dhe gjobë për 100% të vlerës, pra në total **1,060,800 lekë** të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: DPD të përcjellë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë problematikën e mësipërme, për të cilën të merren masat për të kaluar në ri kontroll veprimtarinë e operatorit “N.P ” për aspektin tatimor të kontrollit, me qëllim realizimin e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e detyrimeve dhe penalteteve administrative, të vlerësuara paraprakisht në vlerën gjithsej **1,060,800 lekë** të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, subjekti H.D.A ka kryer shkelje administrative doganore në fushën e akcizës, pasi nga rillogaritjet e kryera nga grupit të auditimit për të dhëna të marra nga sistemi Asyuda Word pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në lidhje aktivitetin e kryer për periudhën 12.08.2020 deri më datën e përfundimit të kontrollit, nga strukturat e Departamentit të Akcizës pranë Departamentit të Akcizës për procedura importi për mallrat të hyra sipas procedurës doganore 4700 (hyrje në magazinë fiskale) dhe procedura doganore dalje nga magazina fiskale sipas tipit DSHA 4 dhe DSHA 6, ku rezultoi se subjekti nuk ka kryer deklarime të sakta ligjore për sasinë prej 2,617 litra, me vlerë malli në shumën 101,893 euro, për pije alkolike të llojit Konjak, Gin, Tekila, Whisky, Vodka, Rum me gradë alkolike nga 37.5% deri 40%, të rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën 909,372 lekë, për të cilat është shmangur pagesa dhe mbi të cilën aplikohet gjobë në masën 200,000 lekë, pra detyrimi gjithsej akcize në shumën 1,109,372 lekë.

Nga ana e Drejtorisë së Kontrollit të Akcizës dhe Aposterior pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk është kryer raportim shkresor bazuar në “*Marrëveshjen e Bashkëpunimit midis DPD dhe DPT*” nr. 14355, datë 19.06.2018 në lidhje me sasinë e mallit të evidentuar, me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të cilat duhet të ndiqen nga Drejtoria e Tatimeve me detyrime tatimore në shumën 8,839,140 lekë për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi, detyrim i cili në total për operatorin bashkë me akcizën përbëjnë **9,948,512 lekë** të ardhura të munguara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për të kaluar në procedurë ri kontrolli veprimtarinë e operatorit “H”, me qëllim kryerjen e një analize të plotë dhe të detajuar në vlerësimin e situatës për periudhën e kontrolluar sipas Program Kontrollit nr. 17747, datë 07.10.2022, sipas gjetjeve dhe konstatimeve të ri llogaritura për sasinë prej 2,617 litra pije alkolike, të rezultuar në mungesë me detyrime akcize në shumën **prej 1,109,372 lekë**, të cilat rezultojnë të shmangura dhe të papaguara.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme të Doganave të kryejë raportim shkresor me DPT për t'ja referuar më pas Drejtorisë Rajonale Tiranë në lidhje me sasinë e mallit të gjetur në mungesë me qëllim ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore të vlerësuara paraprakisht në shumën **8,839,140 lekë** për detyrime tatimore të mospagesës së TVSH-së dhe tatim fitimit të papaguar shoqëruar me sanksionet respektive sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Brenda vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Për detyrimin e nxjerrë nga kontrolli i operatorit E.D për agjentin doganor “L.C ” nuk është nxjerrë nga Dega Doganore Tiranë mbi penaltetin e vendosur në vlerën 380,000 lekë për përpilimin e 19 DAV jo të sakta.

- DDRinas nuk ka argumentuar vendimin për penaltetin e vendosur në vlerën 50,000 lekë më të vogël se ai i caktuar në proces verbalin e kontrollit aposterior, duke rezultuar në një vlerë të ardhurash të munguara prej **430,000 lekë**, si pasojë e mos vendimmarrjes së Degëve Doganore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqet 77-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit Aposterior dhe Degët Doganore Tiranë dhe Rinas në cilësinë e strukturës kompetente të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme dhe vendimet përkatëse në përputhje me kërkesat ligjore dhe proceduriale, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit të evidentuara në vlerën **430,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE FINANCIARE NEGATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2022 janë likuiduar vendime gjyqësore të formës së prerë për 8 ish punonjës të DPD të larguar nga puna, në vlerën 5,847,000 lekë. Referuar vendimeve të përcjella për t'u likuiduar, rezultojnë të kenë mbetur pa paguar deri në datën 31.12.2022 vendime për ish punonjës në vlerën 2,362,000 lekë, të cilat janë likuiduar përgjatë muajit Janar dhe Shkurt të vitit 2023. Pra në total, rezultojnë 9 vendime, në vlerën totale prej **8,210 mijë lekë**, ku 3 vendime i përkojnë vitit 2022, dhe 6 vendime të periudhave të mëparshme, dhe nga të cilat vlera prej 416,535 lekë i korrespondon pagesës së kryer si tarifë përmbartimore. Nga ana e DPD nuk janë analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për vendimet gjyqësore për largimet nga puna, duke mos vepruar sipas kërkesës së pikës 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Sipas informacionit të vendosur në dispozicion lidhur me çështjet gjyqësore në proces për marrëdhëniet me punonjësit, rezultojnë në total **46** të tilla, nga të cilat 15 çështje lidhen me ish punonjës dhe 31 çështje paraqiten me objekt transferimesh apo pagesë orë jashtë orarit të punonjësve aktual të autoritetit doganor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqet 144-210 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: DPD nëpërmjet strukturave të brendshme saj të marrin masat për krijimin e kushteve të favorshme që linjat e raportimit mes sektorëve të garantojnë njoftimin e menjëhershëm të Sektorit të Financës në momentin e marrjes në dorëzim të një vendimi nga Sektori Juridik, me qëllim shmangien e tarifave përmbartimore që shoqërohen me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

-Titullari i DPD të marrë masa për të garantuar një vendimmarrje sa më të drejtë lidhur me marrëdhëniet e punës së punonjësve të DPD (duke përfshirë këtu largimet, transferimet apo orët e punës për të cilat punonjësit e DPD janë aktualisht në procese gjyqësore), për të shmangur krijimin e efekteve financiare të buxhetit të shtetit në të ardhmen.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

E.1 Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germat (b, c, ç), në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në pikën 3 të nenit 13 e pikën 9 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 datë 31.7.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **i rekomandojmë** Drejtorit të Përgjithshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj neni 58, germa “b”, neni 57, pika 3/a e ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”” i ndryshuar,

1. Për znj. V.N., me detyrë Drejtore në Drejtorinë Juridike për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022:

- Për mangësitë e evidentuara në ndjekjen e praktikave përmbarimore dhe për mungesën e manualit për trajtimin e shkeljeve, referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave”e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 64 “Drejtoria Juridike”, pikat 1,2,4.

2. Për znj. L.B., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Ankimimeve në Drejtorinë Juridike për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022:

- Për mangësitë e evidentuara në ndjekjen e praktikave përmbarimore, referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave”e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 64 “Drejtoria Juridike”, pikat 1,2,4.

3. Për z. J.Ç, me detyrë Përgjegjës Turni, pranë Sektorit të Vlerës në Qendër, në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit:

-Për mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në mos zbatimin e afateve procedurale, mos realizimin e analizës së riskut sipas secilit sektor për operatorët, në kontrollin e ushtruar në operatorin H.D.A etj., referuar ‘Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave’ miratuar me urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 73 ‘Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit’, pika 4 dhe 4.2.

II. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet sipas nenit 58, pika c, neni 57, pika 3/a, Ligji 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar:

1. Për znj. A.G., me detyrë specialist në Sektorin e Ankimimeve në Drejtorinë Juridike;

2. Për znj. I.B., me detyrë specialist në Sektorin e Ankimimeve në Drejtorinë Juridike;

3. Për z. B.Gj., me detyrë specialist në Sektorin e Ankimimeve në Drejtorinë Juridike.

-Për mangësitë e evidentuara në ndjekjen e proceseve gjyqësore dhe praktikave përmbarimore, referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave”e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 64 “Drejtoria Juridike”, pikat 1,2,4.

- 4. Për znj. V.D.**, me detyrë specialist në Sektorin e Legjislacionit në Drejtorinë;
- 5. Për znj. A.G.**, me detyrë specialist në Sektorin e Legjislacionit në Drejtorinë Juridike;
- 6. Për znj. M.Z.**, me detyrë specialist në Sektorin e Legjislacionit në Drejtorinë Juridike.

-Për mangësitë e evidentuara në mungesën e konsultimit publik në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe mungesa e manualit për trajtimin e shkeljeve doganore, referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146 datë 07.05.2018, neni 64 “Drejtoria Juridike”, pikat 1,2,4.

- 7. Për znj. M.J.**, me detyrë specialiste pranë Sektorit të Produkteve të Cigareve dhe Pijeve Alkolike, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit:

-Për mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në kontrollin ushtruar në operatorin H.D.A referuar ‘Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave’ miratuar me urdhrin nr.,146, datë 07.05.2018, neni 73 ‘Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit’, pika 4.2.

- 8. Për znj. A.ZH**, me detyrë specialiste pranë Sektorit të Produkteve të Cigareve dhe Pijeve Alkolike, në Drejtorinë e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit:

-Për mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në kontrollin ushtruar në operatorin H.D.A referuar ‘Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave’ miratuar me urdhrin nr.146 datë 07.05.2018, neni 73 ‘Drejtoria e Kontrolleve të Akcizës dhe Paszhdoganimit’, pika 4.2.

E.2 Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 13 i kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë** Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në cilësinë e organit epror, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore:

I. “Gjobjë që nuk kalon pagën e 5 (pesë) ditëve të punës së punëmarrësit”:

- 1. Për z. A.S.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;
- 2. Për z. E.C.**, me detyrë Përgjegjës sektori i Sektorit të Koordinimit për Masatrimet Fiskale i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;
- 3. Për z. K.M.**, me detyrë Hetues i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.
- Për mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në hetimet e kryera në cilësinë e hetuesit dhe mangësitë në plotësimin e procesverbalit përkatës dhe në sanksionet e vendosura , referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 77 “Drejtoria e Hetimit”, pikat 1,2,4.

- 4. Për z. A.RR.**, me detyrë doganier pikë kontrolli i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

- 5. Për z. D.P.**, me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

6. Për z. E.Gj., me detyrë doganier i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

7. Për z. E.K., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

8. Z. I.H., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

9. Z. L.M., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

- Për mangësitë dhe parregullsitë e evidentuara në kontrollet e kryera në cilësinë e inspektorit, dhe mangësitë në plotësimin e procesverbalit përkatës dhe sanksionet e vendosura referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 76 “Drejtoria e Antikontrabandës”, pikat 1,2,4,5.

II. “Vërejtje me shkrim”:

1. Për z. G.T., me detyrë Hetues i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

2. Z. H.P., me detyrë Hetues i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

3. Z. K.M., me detyrë Hetues i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

4. Z. M.B., me detyrë Hetues i Drejtorisë së Hetimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

- Për mangësitë e evidentuara në hetimet e kryera në cilësinë e hetuesit dhe mangësitë në plotësimin e procesverbalit përkatës dhe në sanksionet e vendosura, referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 77 “Drejtoria e Hetimit”, pikat 1,2,4

5. Znj. A.S., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

6. Z. B. K., me detyrë doganier fizik për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

7. Z. B. Z., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

8. Z. E.K., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

9. Z.E.M., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

10. Z.F.O., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

11. Z.F. R., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

12. Znj. I.M., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

13. Z. J.G., me detyrë komandant grupi i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

14. Z. R.V., me detyrë inspektor i Drejtorisë së Antikontrabandës për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022;

15. Z. Y. S., me detyrë doganier pikë kontrolli për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022.

-Për mangësitë dhe parregullsit e evidentuara në kontrollet e kryera në cilësinë e inspektorit, dhe mangësitë në plotësimin e procesverbalit përkatës dhe sanksionet e vendosura referuar Rregullores së brendshme “Mbi organizimin e funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të doganave” e dalë me Urdhrin nr. 146, datë 07.05.2018, neni 76 “Drejtoria e Antikontrabandës”, pikat 1,2,4,5.

F. NJOFTIM I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masa disiplinore, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT